Zhvillimet e planifikuara socio-ekonomike te nje vendi kanë priteshmëri si te tilla, sidomos gjatë periudhes se tranzicionit ekonomik, mirpo në periudhën e implementimit te planeve zhvillimore ekonomike, shkaktohen probleme te shumta dhe të pa parashikuara për mirëfunksionimin e ndermarjeve publike (NP), dhe shpesh i bene ato te pasukseshme dhe te papershtatshme per tregun e lire. Sidomos kur kemi te bejme me menaxhimin e ndermarjeve publike ne nivel komunal, ato shfaqen si organizata shoqerore me interes publik, te cilat veshtire i pershtaten zhvillimeve socio-ekonomike dhe perballjes me realitetin ne treg, gjatë dhenies se sherbimve ndaj konsumatorit, si burim i vetem financiar per ekzistence ekonomike. Gjithashtu, problemi kryesore është veshtirësia e menaxhimit me ato, kur dihet se themeluesi në rastin konkret në Republikën e Maqedonisë emëron anëtarët e Keshillin Drejtues dhe të Keshill Mbikqyres, kurse Kryetari i Komunes emëron Drejtorin e Ndermarjes Publike, me cka krijohen organe drejtuese paralele dhe jofunksionale sipas ligjeve ne fuqi, Ligjit per Ndermarje Publike dhe Ligjit per Shoqeri tregtare. Prandaj zgjidhja e përshtatshme e kësaj situatë do te ishte koncesionimi me menaxhim, sipas Ligjit per Partneritet publik-privat dhe koncesionim. Ne rastin studimor Ndermarja Publike Nderkomunale (NPN) “PROAQUA” me seli ne Struge është themelar nga Keshillat e Komunave te Ohrit dhe te Struges, emerimi i anetareve te Keshillit Drejtues dhe te Keshillit Mbikqyres behet nga te dy Keshillat e Komunes, kurse Drejtori i NPN “PROAQUA” zgjidhet nga Kryetari i Komunes se Ohrit me miratim paraprak nga Kryetarit te Komunes se Struges. Veshtiresite e menaxhimit ne rastin konkrete kane te bejne me konflikete e pushteteve dhe sigurimin e mjeteve financiare per qendrueshmeri dhe arsyetueshmëri ekonomike, ne sherbim te konsumatoreve-qtetareve, duke e ruajtur rolin e mbrojtësit te interesit publik ne komunat ku vepronë dhe ushtron detyrat kjo ndërmarrje, gjatë menaxhuar me resurset ekonomike qe disponon.

Fjalët kyçe: (Ndërmarrjet Publike, Menaxhimi, Koncesionimi;)

CONCESSION MANAGEMENT IN DRINKING WATER SECTOR WITH PUBLIC-PRIVATE PARTNERSHIP (PPP)

Process Concession N.P.N. "Proaqua" - Struga

Doc.D-r Vait Ajro

International University of Struga

Faculty of Economic Sciences

v.ajro@eust.edu.mk

Abstract

Developments planned socio-economic development of a country's expected are as such, during the period of economic transition, but over the implementation of economic development plans, are caused numerous problems and unpredictable in good functioning of public enterprises (PE), and often made them successful without appropriate and without the free market. Especially when it comes to the management of public enterprises at the municipal level, they appear as social organizations of public interest, which suited difficult socio-economic and market facing reality, while giving serv to the consumer, as the only source of financial for economic existence. Also, the main problem with the present difficulties of managing them, knowing that if concrete founder appoints the Management Board and the supervisory board, while the Mayor appoints the Director of Public Enterprise, which create parallel and dysfunctional governing bodies under the laws in force, the Law on Public Enterprises and the Law on Business Associations. Therefore their only solution would be to manage their concession, according to the Law on public-private partnership and concession. In the present case inter Public Enterprise (NPN) "PROAQUA" based in Struga, as founder of the Municipal Councils appear Ohrid and Struga, appointment of members of the Board of Directors and the Supervisory Council, made from two Municipal Councils, and Director NPN "PROAQUA" chosen by Mayor of Ohrid with prior approval by the Mayor of Struga. Management difficulties in the concrete case concerning the conflict of powers, and providing financial resources for sustainability and economic justification, on customer service-citizens, while maintaining the role of defender of the public interest in municipalities where responds and performs tasks, manage the economic resources available.

KEYWORDS: (Public Enterprises; Management; Concession;)

Parathënie

Kjo qasje studimore që ka të bëjë me sektorin e ujit të pijshëm dhe me transformimin e mundshëm të menaxhimit me ndërmarjet nga publik në atë privat, ka për synim ngritjen e vetëdijes publike, nga konsumatori i thjeshtë i këtij shërbimi deri tek ata që kanë në dorë vendimarrjen për një shërbim sa më cilësor dhe bashkëkohor.

Githsesi, kemi të bëjmë me një dukuri jo dhe aq të përhapur në vend dhe në rajon, prandaj kontributet e tilla të studimeve ekomike dhe shkencore në këtë fushë mund të japin shtytje proceseve të filluara apo të përfunduara gjatë transformimit të ndërmarjeve publike nga menaxhimi publik në atë privat.

Rasti studimor ka të bëjë me një situatë dhe një fazë ku procesi ka përfunduar nga aspekti ligjor dhe procedural, por qështja e mos-filimit të zbatimit të një procedure të gjatë të tenderimit për dhënien me koncesion të menaxhimit të NPN Proqaua me seli në Strugë, qëndron tek vendimarrja politike e autoriteve të njësisve vendore si themeluese të Ndërmarrjes Publike Ndërkomunale-Proqaua, e cila menaxhon shërbimet e ujit të pijshëm dhe të kanalizimit me pastrim në rajonin e Ohrit dhe të Strugës.

Realizimi i plotë i këtij projekti kaq të rëndësishëm për komunitat në fjalë do të jetë një shembull i mirë për sektorin e ujit të pijshëm me ndikim në vend dhe në rajon duke ofruar shërbim publik tek konsumatorët me një standard të ri dhe bashkëkohor, në kohezion me nivelin social-ekonomik të një vendi në tranzicion ekonomik dhe politik deri në integrimin e plotë të vendit në strukturat euroatlantike.

Hyrje

Menaxhimi me ujë të pijshëm në sektorin publik paraqet një sfidë në vetë, me çka kemi të bëjmë me një shërbim publik, delikat dhe të përgjegjshëm si nga aspekti social, ekonomik edhe shëndetësor. Ky kompleksitet i shërbimeve publike, e bënë këtë sektor të rëndësishëm dhe të domosdoshëm që të funksionojë pa ndërprerje dhe pa gabime të rënda gjatë funksionimit për shëndetin dhe mirëqënien e konsumatorëve. Gjithashtu kemi të bëjmë edhe me zhvillimin e një shoqërie moderne dhe bashkohore gjatë planifikimit të infrastrukturës urbanistike dhe planifikimit hapsinor të një qyteti apo njësisë vendore, me të gjitha shërbimet e nevojshme, që mirëqënia dhe komoditeti i popullatës ti përshtatet ambientit jetësor. Ky standard bashkëkohor kërkon impenjim dhe investim kolosal për shoqëritë në zhvillim, prandaj synimet e një shoqërie moderne, shpesh herë mbeten një ëndërr e pa realizuar, vetëm pse nuk kanë plotësuar kushtin e domosdoshëm të shërbimit të plotë me ujë të pijshëm dhe largimin, pse jo dhe pastrim të ujrave të zeza. Shoqëritë me tranzicion të vonuar dhe të lodhshëm, për popullatën e cila paraqet konsumatorin në rastin konkret, ballafaqohen me probleme jetike, siç është mungesa e ujit të pijshëm apo mungesa e kanalizimit, ashtu që zhvillimi ekonomik varet drejtpërdrejt nga investimet në këtë sektor. Periudhat kohore të planifikimit deri tek realizimi i projekteve në këtë sektor janë të gjata dhe të mundimshme për arsye teknike dhe financiare që vështirësojnë

edhe më tej arritjen e synimeve për një zhvillim sa më të shpejtë me standarde europiane. Ndërmarrjet publike janë të trashëguara nga sistemi i kaluar i shoqërisë dhe të njëjtat kanë ngelur pa u ndryshuar nga mënyra dhe sistemi i menaxhimit. Ligjet që e rregullojnë këtë lëmi kanë evoluar dhe kanë ndryshuar herë pas here, kurse Ndërmarrjet publike mbeten pa lëvizje dhe avancim në drejtim të zhvillimit ekonomik dhe plotësimit të standardeve europiane, për ku vendi dhe rajoni pretendon të anëtarësohet. Jo pse këto ndërmarrje nuk e kanë kryer funksionin dhe detyrat e tyre për shërbimet në fjalë, por ato nuk e kanë mundësinë e mirëfunksionimit të tyre për shkaqe organizative dhe për shkaqe ligjore, ku vërehet pamundësia e financimit për zhvillim ekonomik, njëkohësisht dhe pregaditja teknike dhe kadrovike e tyre për një shërbim bashkëkohor në raport me konsumatorin e ditëve të sotme. Jemi dëshmitarë të një evolucioni tekniko-teknologjik, të ngritjes dhe vetëdijes sociale dhe ekonomike të shoqërisë e cila lëviz dhe qarkullon në vend, në rajon dhe në shtetet europiane me zhvillim ekonomik. Kjo kategori e konsumatorit duke u kthyer në vendbanimin e tyre me të drejtë kërkojnë një jetë sa më të mirë dhe të ngjajshme me vendet e zhvilluara. Prandaj, kërkesat e kohës dhe të nevojës të konsumatorit, me të drejtë paraqesin problemin kryesor të planifikimit ekonomik, social, urbanistik dhe hapsinor për uji të pijshëm dhe kanalizim, ku barra kryesore rëndon tek mirëmenaxhimi dhe planifikimi resurseve njerëzore, teknike dhe financiare, që në këtë rast i posedon ose duhet ti ketë një Ndërmarrje publike në sektorin e ujit të pijshëm. Mirpo, ndërmarrjet publike sot ballafaqohen edhe me një problem tjetër, gjatë faturimit të shërbimit, konvertimi në mjet financiar për nevojën e vazhdimësisë së punës, për të qënë në krye të detyrës që i takon sipas ligjit, por paradoksi i vërtet është kur NP nuk arrijnë të plotësojnë normat e planifikuara të inkasimit, këtu fillonë problemi pasi që lëndohet sistemi financiar i tyre dhe tregohet paqëndrueshmëri ekonomike, në raste të veçanta dhe paarsyetueshmëri ekonomike për ekzistencë të Ndërmarrjeve publike, sepse ato paraqesin barrë financiare edhe për Komunitat edhe për shoqërinë. Nuk mundet të ketë në njërin anë faturim të mjaftueshëm të shërbimit të ujit të pijshëm dhe kanalizimit me pastrim të ujërave të zeza dhe nga ana tjetër inkasim i ulët i mjeteve financiare për mbarvajtjen e shërbimeve publike! Situata ende më e pakuptimtë në këtë sektor do të ishte kur Ndërmarrjet publike vazhdimisht paraqesin raporte financiare me humbje, dhe të njëjtat raporte kalojnë dhe miratohen nga organet drejtuese deri tek themeluesi i cili është organ përgjegjës për ndërmarrjet publike në fjalë. E gjithë kjo situatë paradoksale që në të shumtën e rasteve tregohet si normale dhe justifikohet me ndikimet politike dhe me vështirësitë e menaxhimit. NP qëndrojnë si të plagosura përball konsumatorit vigjilent dhe të zgjuar që nuk paguan shërbimin publik si detyrë dhe obligim ligjor vetëm e vetëm pse, një ditë në muaj konsumatori ngelet i pakënaqur nga shërbimi publik me uji të pijshëm! Sigurisht që e drejta qëndronë në anën e konsumatorit dhe detyrat e pa zbatuara i takojnë NP, megjithatë fatkeqësia më e madhe në këto kushte i ka kapluar të dy palët dhe problemin nuk mundet ta zgjedhin palët të cilat duhet të bashkëpunojnë mes veti. Por, pala e tretë në këtë rast do të ishte themeluesi i shërbimeve publike Këshilli Komunal, duke qëndruar si arbitër midis organit që zbaton detyrat e marra ndaj konsumatorit, i cili pret që shërbimi të jetë i plotë dhe sa më bashkëkohor kundrejt pagesës dhe vlerës së produktit. Edhe në këtë rast nuk është arritur ndonjë progres i mirë për sa i përket organit më të lartë, themeluesit të NP që të sjellë rregulla dhe ligje në

favor të të dyja palëve. Kjo situatë lë shumë për të dëshiruar sepse të zgjedhurit e popullit, Këshilltarët Komunal, nuk kanë arritur deri më sot të saktësojnë raportin midis NP dhe konsumatorit. Por këtë raport e ka në dorë ligjet dhe direktivat e Qeverisjes qendrore të cilat në të shumtën e rasteve gjatë miartimit të dispozitave ligjore që rregullojnë këtë lëmi, nuk e konsultojnë aspak qeverisjen vendore, dhe kështu problemi thellohet dhe përfundon në një rreth vicioz.

1. OBJEKTIVAT

Objektivat e studimit janë :

- Identifikimi i fushave kyçe në zhvillimin e menaxhimit me PPP-së, ku hulumtimi dhe debatet e mëtejshme janë të nevojshme.
- Të sigurojë njohuri për sistemet dhe proceset e nevojshme për të maksimizuar arritjet dhe të kufizojë ndikimet negative që rrjedhin nga përdorimi i modelit të PPP-ve.
- Ngritja e vetëdijes në mesin e palëve të interesuara në sektorin publik dhe privat për qasjen mbi alternativat që ofron shërbimi në sektorin e ujrave që kanë për qëllim për të përmirësuar qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e shërbimeve publike.
- Të kontribuojë në debatin në lidhje me dobinë dhe pasojat e PPP-ve, në Republikën e Maqedonisë dhe në rajon, në mënyrë që të ndihmojë për të hapur një rrugë të re përpara, për më shumë planifikime strategjike kombëtare me modelin e menaxhimit me PPP-në, si formë konsensuale dhe bashkëpunuese.

2. PYETJE KËRKIMORE

Pyetjet kërkimore të mëposhtme janë:

- Pse duhet të krijohen PPP-të, cilat ishin objektivat e tyre dhe deri në çfarë mase kanë këto objektiva do të përmbushen ? Cilat janë ndikime pozitive dhe negative të PPP-së? Cilët faktorë kanë kontribuar për këto ?
- Në lidhje me ofrertat e shërbimeve të deritanishme çfarë mund të kontribuojë modeli i menaxhimit me PPP, sa mund të arrihet në aspektin i efikasitetit, cilësisë, qasjes dhe mbulimi gjatë ofrimit të shërbimeve? Cila është NPN - Proaqua si rast për ta studiuar në sektorin e ujrave, fektet financiare në drejtim të tarifave të ngarkuar për konsumatorët, financave kapitalit dhe përfitime financiare ndaj partnerit publik?

- Çfarë pasojash ka modeli i menaxhimit me PPP-në për punët në drejtim të krijimit të vendeve të punës, kufizimet, pagat, kushtet e përgjithshme të punës? Cila është perspektiva e organizatave sindikale gjatë organizimit të punës që do të përfshihen në menaxhimin me modelin e PPP-së në çdo nivel, dhe cila është perspektiva e tyre prej këtij modeli?
- Cilat janë perspektivat e palëve të interesuara në sektorët e ujit dhe të ambientit jetësor, nëse këto raste specifike do të ndikojnë në trajtimin e ardhshëm të opsioneve të PPP-së, në ato sektorë ?
- Cilat janë nevojat specifike për trajnim të grupeve të interes që kanë synim të përfitojnë? Dy fushat kryesore të fokusit të identifikuar për studimet e rasteve janë :
 - a) Ofrimi i shërbimit me efikasitet, cilësia, financat, furnizimi me uji të pijshëm dhe përballueshmëria me sasi të mjaftueshme për konsumatorët.
 - b) Çështjet e marrëdhënieve të punës, të tilla si kushtet e shërbimit, krijimin e vendeve të punës, transferimet , kufizimet dhe mjedisi i punës.

3. PËRZGJEDHJA E RASTIT STUDIMOR

Rasti më i mirë dhe unikat që ky studim trajton lidhur me atë që u tha më lartë, është Ndërmarrja Ndërkomunale Publike (NPN) – Proaqua, e themeluar nga Komuna e Ohrit dhe Strugës për shërbimet publike si furnizimi me ujë të pijshëm, kanalizim dhe pastrim të ujrave ta zeza. Në sektori i ujrave për hulumtim të modelit të menaxhimit me PPP-së është zgjedhur NPN Proaqua me seli në Strugë e themeluar nga Komuna e Ohrit dhe Komuna e Strugës ku përfshihet dhënia në koncesion e menxhimit të NPN Proaqua-s, një operatori të huaj që do të ofrojë shërbime të ujit të pijshëm, kanalizimit dhe pastrimit të ujrave të zeza. Arsyet pse është zgjedhur modeli i menaxhimit me PPP-së, janë me sa vijojnë:

c) Kjo ndërmarje që nga themelimi i sajë ka trashëguar tre ndërmarjet që para 15 viteve kanë funksionuar të ndara, kanë operuar në të dyja komunat me shërbim të ujsellsit dhe kanalizimit, dhe e treta me sistemin e kolektorit dhe qendrën e pastrimit të ujrave të zeza. Projekti për bashkimin e tre ndërmarjeve publike si Ujsjellësi i Strugës, Ujësjetësi i Ohrit dhe Ndërmarrja ndërkomunale për mbrojtjen e liqenit të Ohrit nga ujrat e zeza, në fillim të vitit 2000 u prit me entuziazëm dhe me shpresë se shërbimi publik në këtë fushë do të transormohet rrëjnësisht dhe do të bëhet bashkëkohor. Ashtu dhe u veprua me shumë pompozitet dhe me mjete financiare në formë granti dhe kredie, fillojë të funksionojë NPN–Proaqua me seli në Strugë.

d) Pas disa viteve të funksionimit normal, me vështirësi të theksuara, më saktësisht në vitin 2004, NPN–Proaqua ngarkohet me një kredi tjetër financiare me afro 10 mil Euro duke e ngritur kapacitetin e furnizimit dhe duke ndërtuar infrastrukturën e ujsjellësit dhe kanalizimit në rajonine Ohrit dhe të Strugës. Që nga ky moment sipas studimit dhe

analizave të asaj kohe rezulton se për mungesë të menaxhimit të pa mundur për realizimin e objektivave tekniko-finaciare për arsye politike-ekonomike që ka mbizotëruar në atë periudhë kohore, ashtu që nuk u përmirësua situata, por për kundrazi, NPN-Proaqua u bë ngarkesë për të dyja komunat dhe për konsumatorët e rajonit. Arsya është e thjeshtë: Mosefikasitet ekonomik dhe financiar, paarsyetueshmëri financiare dhe paqëndrueshmëri ekonomike, janë dhe mbeten tre faktorë të mospësuksit të një ideje avangarde dhe bashkëkohore, këto faktorë lidhen ngusht me *mënyrën e menaxhimit*, të drejtat dhe kufijtë e veprimit me NPN që operon në rajonin e Ohrit dhe të Strugës, me shërbimet kryesore, furnizimi me ujë të pijshëm, kanalizim dhe pastrim të ujrave të zeza.

e) Rasti i tillë i mospësuksit, parqet rastin më specifik në veprimtarinë ekonomike të një rajoni dhe të një vendi me aspirata për në BE. Projekti i mirëstudjuar nga konzorciumet europiane dhe nga studjues profesionit europian nuk kanë qenë të përshtatshëm me situatën politiko-ekonomike në vend, modeli i dështuar i menaxhimit përball koherencës së organeve drejtuese në raport me organet shtetërore. Me një fjalë, ideja e transformimit të një NP me kapital financiar të siguar në formë kredie dhe zgjedhja e modeli të gabuar mbi menaxhimin e resurseve publike në të dyja Komunat, bëri që të mos ketë sukses përpjekja për modernizimin e shërbimeve publike në Ohër dhe në Strugë. Sot Komunat e Ohrit dhe e Strugës mbushin plotë dhjetë vjetë që nuk kanë mundësi të kthejnë borxhin në formë kredie ndërkombëtare që ka garantuar Qeveria e RM në emër të Komunave, për llogari të NPN Proaqua me seli në Strugë. Pasi ndryshojë ligji për vetëadministrim lokal, territori i Komunës së Strugës dhe e Ohrit u zgjerua, me çka NPN Proaqua ballafaqohet me sfida të reja përballë vështirësive ekonomike.

f) Gjithashtu pas disa tentativave të Komunave për ndarjen e NPN Proaqua, rezultojë se kredia e marrë bashkarisht nuk i lejon ato ta ndajnë ndërmarrjen dhe ta kthejnë në gjendjen e mëparshme të vitit 2000. Ashtu që agonia në këtë ndërmarrje vazhdonë të sundojë me pakënaqësi ndaj konsumatorit, humbje financiare të vazhdueshme, ngarkesë politiko-ekonomike e komunave dhe moszhvillim teknik dhe kadrovik brenda sajë, që nënkupton rrëshqitje dhe degradim ekonomik dhe financiar me pasoja të rënda për rikoprim apo për rikomponim të ndërmarrjes, për të qenë në krye të detyrës së caktuar për furnizim me ujë të pijshëm, kanalizim dhe pastrim të ujrave të zeza.

4. HAPAT E RASTIT STUIMOR

Studimi do ta trajtojë një rast të veçantë, që është N.P.N. Proaqua, e themeluar në vitin 1998 nga Komuna e Ohrit dhe Strugës. Në këtë rast përfshihet koncesionimi i menxhimit të NPN Proaqua nga një operator i huaj që do të ofrojë shërbime të ujit të pijshëm, kanalizimit dhe pastrimit të ujrave të zeza. Arsytet pse është zgjedhur modeli i menaxhimit me PPP janë me sa vijonë:

- Themelimi i ndërmarrjes së përbashkët
- Investimi dhe zhvillimi infrastrukturor

- Rënie dhe humbje financiare
- Përpjekje për këthim në gjendjen e mëparshme
- **Metodologjia e punës në studimin e fizibilitetit**
 - Baza e të dhënave aktuale
 - Përzgjedhja fillestare
 - Të dhënat dytësore
 - Treguesit specifikë
 - Çështjet metodologjike
- **Raporti mbi gjendjen aktuale**
 - Pjesa teknike: Gjendja e përgjithshme, niveli i kyçjeve të popullatës, humbja e ujit, sistemi i ujsjellësit, kanalizimit, sistemit për pastrimin e ujrave urbane, paisjet operative, efikasiteti energjetik, niveli i të punësuarëve dhe investimet afatshkurtëra.
 - Pjesa komerciale: Të dhëna të përgjithshme, Mjete financiare dhe borxhet, financat, likuiditeti etj.

- **Korniza ligjore**

Ligji për veprimtari komunale

Ligji për ndërmarjet publike

Ligji për koncesione dhe PPP

Ligji për ujrat

Ligji për shoqata tregëtare

Ligje të tjera relative si ato për tatimet etj.

Konkluzat lidhur me opcionet juridike

- **Modelet institucionale**

Modeli institucional mundëson që: Pronën dhe infrastrukturën e lë në duart e Komunave. Zvogëlimin e harxhimeve në Proaqua, në kufirin e mundësisë për të qenë e aftë ti paguaj shfrytëzuesit e shërbimeve. Masa për restaurim, duke marrë parasyshë zvogëlimin e harxhimeve për të punësuarit me zgjidhje të pranueshme sociale dhe politike.

- **Qasje teknike / masa dhe parashkime**

- Baza e të dhënave

- Shpenzime operative

Mirëmbajtja dhe riparimi; energjia; materiale të përdorura dhe mbetja; të punësuarit;

Programe për përmirësime operative:

- për ujin e pa faturuar
- për efikasitetin energjetik
- për menaxhim me paisjet
- për shkallën e pagesave

- **Implikimet financiare**

- **Mbështetja e parashikimeve**

- Huamarrje; Logaritja e amortizimit; Tarifat/çmimet; Inflacioni; Financimi i paisjeve të kompanisë koncesionare; Të punësuarit; Shkalla e pagesës; Programi për përmirësim; Shlyerje e borxheve; Të hyra operative; Koncesioni; Të ardhurat për PROAQUA-n

- Biznis plani për koncesionerin
- Biznis plan për Proaqua
- Përshkrimi i potencialeve

- **Programe kryesore për investim**

- Investime operative

- Ndërrimin e rrjetit; Modernizimi i objekteve për pastrimin e ujit; Modernizimi i largimit të ujrave të zeza; Ripërtirja e paisjeve&mjeteve;

- Investime për rritjen e shërbimeve

- Rrjeti i ujësjellsit; Rjeti i kanalizimit

- Investimet për përforcimin e kualitetit dhe ruajtjen e standardeve të UE

- Pastrimi i ujrave të zeza;

- **Qëndrimet**

Studimi i fizibilitetit u kompletua në një takim me bazë diskutimi të palëve të interesuara më datë 21.10.2009, nga ky takim lindën disa mendime:

- Nga frika se qeveria mund të refuzojë ndarjen e PROAQUA-s, sepse në të kaluarën është dëshmuar se e ka penguar ndarjen në tre njësi të mëparshme!

- Kanë shpresë me rëndësi të veçantë sidomos nga partneri privat të investojë së paku 10 mil Euro pa marrë parasyshë se kush do të zgjidhet!
- Duke konsideruar se mbi –punësimi dhe jo-efikasiteti i menaxhimit të PROAQUA-s në raport me konsumatorët do jenë problemet e trashëguara nga më parë por tani nga menaxhuesit e ndërmarjes dhe Krytarët e Komunava shprehin gadishmëri dhe mendojnë se Partneri privat nuk duhet të shqetësohet!

5. PROCESI I TENDERIMIT DHE OFERTA E PARTNERIT PRIVAT

- Studimi i fizibilitetit viti 2010; Vendimi i KD të PROAQUA-s; Vendimet e Këshillave të Komunave; Formimi i Komisionit për tenderim; Shpallja e Tenderit viti 2011; Aplikimi – Dy kompani të huaja; Vendimi i komisioni për fituesin; Shpallet fitues AQUALIA – Spanja; Kontrata - Negociatat vazhdojnë...!

Inflation rate	Inflation rate	Inflation rate	Inflation rate	Inflation rate	
37.57	38.32	39.09	39.87		
10.02	10.22	10.42	10.63		
15.03	15.33	15.64	15.95		
24,606,048	24,606,048			258,317,041	
163,870,430	142,127,250	88,828,750	117,553,750	121,665,000	686,520,943

%	Koncesioni gjatë 4 viteve të para për 35	Ivestime gjatë 7 vitve të para për 35 vjet
40	258,317,041 den ose 4.210.567 euro	686,520,943 den ose 11.190.290 uro
28	258,317,041 den ose 4.210.567 euro	594,825,943 den ose 9.695.662 euro
23	188,615,392 den ose 3.074.430 euro	564,260,943 den ose 9.197.453 euro
0	32,808,063 den ose 534.771 euro	319,740,943 den ose 5.179.803 euro

Sherbimet	2012	2013
Tariff increase (%)	35%	5%
Residential Tariff Water (MKD)	34.43	36.83
Residential Tariff Sewage (MKD)	9.18	9.82
Residential Tariff Wastewater (MKD)	13.77	14.73
Concession Fee payments (MKD)	139,403,297	69,701,649
Investment (MKD)	27,328,167	25,147,597
Tariff increase (%)	18%	10%
Residential Tariff Water (MKD)	30.09	33.70
Residential Tariff Sewage (MKD)	8.02	8.99
Residential Tariff Wastewater (MKD)	12.04	13.48
Concession Fee payments (MKD)	69,701,649	69,701,649
Investment (MKD)	27,328,167	25,147,597
Tariff increase (%)	18%	5%
Residential Tariff Water (MKD)	30.09	32.20
Residential Tariff Sewage (MKD)	8.02	8.59
Residential Tariff Wastewater (MKD)	12.04	12.88
Concession Fee payments (MKD)	69,701,649	69,701,649
Investment (MKD)	27,328,167	25,147,597
Tariff increase (%)	Inflation rat	Inflation rate
Residential Tariff Water (MKD)	25.50	26.01
Residential Tariff Sewage (MKD)	6.80	6.94
Residential Tariff Wastewater (MKD)	10.20	10.40
Concession Fee payments (MKD)	8,202,016	8,202,016
Investment (MKD)	27,328,167	25,147,597

2014	2015	2016	2017	2018-2047	TOTAL
-------------	-------------	-------------	-------------	------------------	--------------

Nr.	Item - Artikulli	Estimated Cost (m.€) Estimated Cost (m. MKD)	City
1	GIS	0.1 - 6.1	Strugë
2	GIS	0.1 - 6.1	Ohër
3	SCADA	0.3 – 18.3	Struga
4	SCADA	0.35 – 21.35	Ohër
5	EBRD drinking water network replacement: 10 km	1 - 61	Ohër
6	WW Main Pipe Insulation: 3,5 km (200-800 mm)	0.35 – 21.35	Ohër
7	Asbestos-Cement drinking water network replacement: 4 km main pipe (400 mm)- 20 km City centre (100-200 mm)	2.4 – 146.4	Strgë
8	Asbestos-Cement drinking water network replacement: 12-13 km (80-300 mm)	1.5 – 91.5	Ohër
9	AMR Water Meters (NO INFORMATION)		Strugë
10	AMR Water Meters: 13.000 units	1.9 – 115.9	Ohër
11	WWTP Capacity increase (2nd Phase)	7 - 427	Strugë
12	Rain water network: 20-25 km (300-800 mm)	2 - 122	Ohër
13	Rain water network: 5 km (300-600 mm)	0.5 – 30.5	Strugë
14	New drinking water connection (20.000):	6.6 – 396.5	Strugë
15	New spring water intake (6.000 inhabitants)	4 - 244	Ohër
	TOTAL	28 - 1708	PROAQUA

6. PËRFUNDIMI

Gjendja e palakmueshme materiale dhe financiare ne PROAQUA-s, tregon qartë se periudha e transformimit të ndërmarjeve publike është tejzgjatur dhe gjendja sa vjenë e bëhet e papërballueshme.

1. Potenciali material, ekonomik dhe kadrovik në PROAQUA-s jep shpresë për mundësinë e tejkalimit të situatatë, sepse resurset natyrore të ujit të pijshëm janë treguesi më i mirë për nga cilësia dhe sasia që kanë burimet në këtë rajon.
2. Nënshkrimi i kontratës me koncesionerin-partnerin privat duhet sa më parë të nënshkruhet nga partneri publik dhe atë nga dy Kryetarët e komunave të Ohrit dhe të Strugës për këto arsye:
 - Hapet rruga e investimeve direkte me kapital të huaj privat.
 - Paguhet borxhi-kredia ndaj EBRD-së, problem ky që e ka dëmtuar rëndë. buxhetin e Komunës së Strugës.
 - Zvogëlimi i numrit të të punësuarëve do të reduktohet në atë masë sa vetë buxheti i palnifikuar ka mundësi ti përballojë.
 - Ndërhyrja urgjente në infrastrukturë me investime direkte do të lehtësonte punën e mirëmbajtjes dhe zgjerimit të rrjetit për furnizim, duke dixhitalizuar të gjithë infrastrukturën që nga burimet e ujit deri te konsumatori
 - Plotësohen dhe ruhen standardet e BE për këtë sektor të rëndësishëm në shoqëri.
 - Konsumatori më në fund do të shërbehet dhe do të këthrrhet në partner real.

7. LITERATURA

- Ligji për koncesione dhe PPP në RM
- Arkivi i NPN “Proaqrua”-Strugë
- Dokumentacioni i tenderit

Sfidat e shteteve në zhvillim për adoptimin e koncepteve të Bazelit dhe ndikimet në R.Maqedonisë

Jeton Shaqiri¹,

¹International University of Struga, j.shaqiri@eust.edu.mk

Abstract

Institucionet bankare duhet të jenë më të qëndrueshme nga ndryshimet ekonomike në të ardhmen. Standartet e Bazel III do të forcojnë sistemin bankar dhe do ta bëjnë më imun nga ndryshimet ekonomike. Parashtrohet pyetja cilat do të jenë efektet e Bazel III për sistemin bankar në Republikën e Maqedonisë? Përdersa tregjet financiare në mënyrë graduale po përmirësohen pas krizës globale ekonomike, sistemet rregulluese në botë po mundohen në sjelljen e rregullave të reja të cilat do të përgatisin sistemin bankar nëpërmjet rritjes së kapitalit nga këto zhvillime ekonomike në periudhën e ardhshme. Bëhet fjaë për masa të cilat do ta rrisin kapitalin dhe do rrisin likuiditetin e bankave. Cilat do të jenë efektet e këtyre masave në sistemin bankar të RM-së?

Në vitin 2012, FSI ka kryer një studim mbi zbatimin e Bazel II, në juridiksionet që nuk janë as anëtarë të Komitetit të Bazelit mbi Mbikëqyrjen Bankare (BCBS) dhe as anëtarë të Bashkimit Evropian. Metodologjia e përdorur në këtë studim është e ngjashme me atë të miratuar nga BCBS në tetor 2011 për raportin e tij mbi përparimin e Basel II.

Mbeshtetur ne te dhenat e raportit te inspektimit te realizuar ne kete periudhe mbi implementimin e Basel II ne rajonin e Ballkanit perkatesisht ne shtetet : Shqiperi, Kosove, Maqedoni, Mal i Zi, Serbi dhe Bosnje Hercegovine, duket qarte qe vendi qe i ka dhene me shume perparimi implementimit te rregullave dhe standarteve te Basel II eshte Serbia me vleresim 4 (rregullore ne fuqi). Me pas renditen vendet e Maqedonise dhe Malit te Zi te cilat shfaqin te njejten ecuri zbatimi ne lidhje me elementet e inspektuara kryesisht me vleresimin 3 (rregulla te publikuara) dhe 4 (rregullore ne fuqi).

Keywords: Fsi, BCBS, BASEL II, BASEL III

1.1 Sfidat me te cilat perballen vendet ne zhvillim ne adaptimin e BASEL II

Shqetësimi kryesor lidhet me nevojën për tu mbështetur në vlerësimin (Rating) e agjensive të jashtme për llogaritjen e kërkesave të kapitalit minimal. Aktualisht agjensitë e brendshme vlerësuese mungojnë totalisht në vende si Maqedonia ose janë pak të zhvilluara në shumë vende jashtë OECD-se. Nga ana tjetër në pjesën më të madhe të këtyre ekonomive shumë ndërmarrje të vogla nuk mund ta përballojnë të jenë klient të agjensive vlerësuese ndërkombetare. Meqënëse huamarrësit e pavlerësuar (unrated) nga agjensitë ndërkombetare të vlerësimit do të shënohen me 100% risk sipas Basel II, fillimisht shumica e kredive të brendshme mund të përfundojnë në këtë kategori (100% risk). Kjo mund të reduktoje analizën sensitive të riskut të sistemit të ri (Basel II) duke e përfruar ose duke e bërë të njëjtë me Basel I. Për më tepër, në disa vende (Maqedoni), bankat mbajnë një pjesë të konsiderueshme të bonove të thesarit të qeverisë. Sipas Basel I, ekspozimit të bankës ndaj qeverisë të përcaktuara në monedhen vendase i është caktuar 0% peshë risku pavarësisht nëse risku i kredisë qeveritare është vlerësuar (rated) ose jo.

Sipas Basel II, është e mundur që kredisë qeveritare t'i caktohet një mase risku ndërmjet 0% deri në 150%, mundësisht 100% meqe ajo bie në kategorinë e pavlerësuar (unrated). Kjo tregon që në një vend me tipare të tilla sa më sipër (p.sh Maqedonia) sistemit bankar do t'i duhet të rrisë alokimin e kapitalit për të qënë në përputhje me nivelin minimal të raportit.

Një tjetër synim i rëndësishëm i Basel II është të forcojë disiplinën e tregut duke zhvilluar një sërë kërkesash për dhënien e informacionit. Në ekonomitë në zhvillim ka mjaft vend për përmirësim në drejtim të lejimit të pjesëmarrësve të tregut në vlerësimin e informacione kyçe në ekspozimin ndaj riskut, procedurat e vlerësimit të riskut dhe mjaftueshmërisë së kapitalit. Sidoqoftë, në periudhen afatshkurtër, dhënia e informacioneve mund të ketë edhe disa implikime negative sidomos në ekonomitë në zhvillim si Maqedonia ku reagimi i publikut ndaj informacioneve të ndryshme mund të jetë mjaft i ashpër. Publiku në Maqedoni reagon veçanërisht keq ndaj lajmeve të ashpra për sektorin bankar ose për një bankë të veçantë dhe tenton të injorojë çfarë ka positive për to. Kjo tregon se nxitja e dhënies së informacionit bankar sipas standarteve të kërkuara nga Basel II mund të bëhet problematike nëse nuk mbështetet nga një kuptueshmëri e përshtatshme nga publiku. Një metodë më graduale mund të jetë më e nevojshme. Kjo metodë mund të marr formën e një standarti të përkohshëm ndërmjet Basel I dhe Basel II që mund t'i ofrojë bankave në ekonomitë në zhvillim disa nga përfitimet e Basel II pa u përballur me kosto frenuese shtesë. Vlen të theksohet se Basel II është një pasues logjik dhe i përshtatshëm i Basel I. Ai merr shembull nga mësimet e kaluara e të tashme dhe jep udhëzime të shkëlqyera për sistemin financiar dhe autoritetet mbikëqyrëse për të ecur përpara. Nga ana tjetër, zbatimi i tij mund të konsiderohet mjaft ambicioz dhe një detyrë e vështirë për vendet në zhvillim. Prandaj është e rëndësishme për të gjetur mënyrat për ta bërë atë sa më të përshtatshëm për nevojat e vendeve përkatëse duke ndjekur një qasje graduale dhe jo duke rrezikuar suksesin e saj nëpërmjet një adoptimi të painformuar.

1.2 Maqedonia dhe qasja ndaj Bazel II. Po Bazel III?

"Roadmap" (hartat e rruges) së Maqedonisë (pra e Bankës Popullore të Maqedonisë), është ajo graduale drejt përafritimit me Bazel II dhe direktivat europiane, për veprimtarinë e institucioneve të kreditit dhe mjaftueshmërinë e kapitalit, si një qasje e zgjedhur nga autoriteti mbikëqyrës e që konsideron zhvillimin dhe nevojat e sistemit bankar maqedonas. Kjo qasje do të nisë fillimisht me adoptimin e metodave standarte të matjes, vlerësimit dhe monitorimit të rrezikut, duke vijuar në periudhën afatmesme edhe me modelet e brendshme dhe ato të avancuara të matjes, vlerësimit dhe monitorimit të rreziqeve. Banka e Maqedonisë, ka lançuar së fundi (shkurt 2013) për diskutim në industrinë bankare, projektin e rregullores së re "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit", si rishikim tërësor të rregullores ekzistuese, nën dritën e Bazel II. Projekti synon përshtatjen e metodave standarte për rrezikun e besueshmërisë dhe rrezikun e tregut, si dhe të metodës së treguesit të thjeshtë dhe asaj standarte për rrezikun operacional për llogaritjen e kërkesave për kapital nga bankat, me qëllim adresimin më të mirë të nevojave të tyre për kapital për monitorimin kryesisht të këtyre rreziqeve, duke siguruar në çdo rast nivelet e kërkuara të këtij raporti (12 për qind). Projekti është asistuar nga Banka e Italisë, në kuadrin e një programi dy-vjeçar binjakezimi, krijon mundësinë për një qasje më të përafërt të kuadrit të rregullativ mbikëqyrës. Po kështu, projekti lançohet në këtë periudhë, që gjykohet si një periudhë e përshtatshme, pas së cilës ky standard (marrëveshje e kapitalit) kaloi testimin në vendet dhe bankat që janë aktive në tregjet ndërkombëtare dhe për të cilat ai ishte dizenuar, duke krijuar një pamje të plotë me të gjitha anët pozitive dhe negative të dëshmuara nga zbatimi në praktikë të tij.

Projekti shihet si mundësi për bankat, për përsosjen e mëtejshme të sistemeve të administrimit të rrezikut dhe llogaritjes së nevojave me të kalibruara të kapitalit (ekonomik). Qasja që sjell në këtë projekt Bazel II siguron një lidhje racionale të kapitalit të bankës me profilin e rreziqeve të saj, e konkretisht trajton kërkesa e rregulla të autoritetit mbikëqyrës, kryesisht lidhur me të.

- metodën standarde të llogaritjes së kërkesës për kapital për rrezikim të besueshmërisë dhe rrezikun e palëve të treta (kundërpartisë);
- prezantimin e konceptit të Institucionit të Jashtëm të Vlerësimit të Kredisë (ECAI) Agjencisë së Kreditimit të Eksporteve (ECA) dhe përdorimin e vlerësimeve të tyre sipas klasave përkatëse të ekspozimit;
- prezantimin e një numri më të zgjeruar klasash ekspozimi si dhe parimet dhe rregullat për llogaritjen e ekspozimeve të peshuara me rrezik, për secilën klasë ekspozimi;
- parimet dhe metodat e njohjes së teknikave të zbutjes së rrezikut të besueshmërisë;
- metodën e treguesit të thjeshtë dhe metodën standarde të llogaritjes së kërkesës për kapital për rrezikun operacional (të patajtuar më parë në kërkesat e autoritetit);
- metodën standarde të llogaritjes së kërkesës për kapital për rrezikun e tregut;

- kërkesat e autoritetit mbikqyres per procesin e vlerësimit të brendshem të mjaftueshmërisë së kapitalit, bazuar në strategjitë për administrimin e rreziqeve;
- publikimin nga ana e bankës, te informacionit, që lidhet me mjaftueshmërinë e kapitalit për të siguruar përputhshmerine me kërkesat e disiplinës së tregut.

Aktualisht, mesimet e krizës së vitit 2008 nxorën në pah nevojën për rishikimin e Bazel II, që sot ne termat e një kuadri të rishikuar njihet si Bazel III (ose direktiva IV e kapitalit) dhe që kryesisht mbart rishikime të kërkesave të kapitalit për qëllime të monitorimit të rrezikut të likuiditetit, të kërkesave më të kujdesshme per njohjen e elementeve përbërës te kapitalit mbikeqyres (rregullator), etj. Banka e Sliqiperisë, me lançimin e **direktivës së IV** të kapitalit do mundesoje pështatjen e kërkesave për kapitali mbikqyrës (rregullator), në kuadrin mbikëqyrës që fokuson këtë element të rëndesishem të raportit të mjaftueshmerise së kapitalit, si dhe të përfshirjes së disa elementëve të tjerë, që lidhen me monitorimin e rrezikut të likuiditetit.

1.3 Maqedoniadhe vendet e Rajonit ne implementimin e Basel II

Në vitin 2012, FSI ka kryer një studim mbi zbatimin e Bazel II, në juridiksionet që nuk janë as anëtarë të Komitetit të Bazelit mbi Mbikëqyrjen Bankare (BCBS) dhe as anëtarë të Bashkimit Evropian. Metodologjia e përdorur në këtë studim është e ngjashme me atë të miratuar nga BCBS në tetor 2011 për raportin e tij mbi përparimin e Basel II.

Mbeshtetur ne te dhenat e raportit te inspektimit te realizuar ne kete periudhe mbi implementimin e Basel II ne rajonin e Ballkanit perkatesisht ne shtetet : Shqiperi, Kosove, Maqedoni, Mal i Zi, Serbi dhe Bosnje Hercegovine, duket qarte qe vendi qe i ka dhene me shume perparimi implementimit te rregullave dhe standarteve te Basel II eshte Serbia me vleresim 4 (rregullore ne fuqi). Me pas renditen vendet e Maqedonise dhe Malit te Zi te cilat shfaqin te njejten ecuri zbatimi ne lidhje me elementet e inspektuara kryesisht me vleresimin 3 (rregulla te publikuara) dhe 4 (rregullore ne fuqi).

Per sa i perket shteteve si Bosnja Hercegovina dhe Maqedonia kane te njejtet tregues statusi ne nivelin 1 (drafte rregulloresh te pa publikuara).

Referuar elementit P3, “Disiplinimi i Tregut / Berja Publike” (shtylla 3), Maqedoniaka tregues statusi 4 (rregullore ne fuqi - Rregullorja "Për kërkesat minimale, të jepet informacioni nga bankat dhe degët e bankave të huaja "), miratuar me vendimin No.60, datë 29.08.08 të Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Maqedonisë, e cila përcakton kërkesat minimale , metodat dhe afatet kohore lidhur me informacionin që duhet të publikohet në raportet periodike të bankave dhe degëve te bankave të huaja. Sipas kësaj Rregulloreje, bankat duhet të publikojne raporte periodike të cilat përmbajnë informacion në përputhje me gjashtë kategorite kryesore të përcaktuara nga Komiteti i Bazelit dhe Direktiva e BE 2006/48/EC (Kapitulli 5 , Aneksi XII) dmth performancën financiare dhe aktivitetet e tyre, profilet e rrezikut, praktikat dhe strategjitë në menaxhimin e riskut, Raporti CAR, cilësia e portofolit të

kredisë, politikat kontabël, etj. Kjo rregullore është pjesërisht në përputhje me Direktiven e lartpërmendur të BE- rregullore në fuqi e cila ka të bëjë me Shtyllën 3 dhe është paraparë të rishikohet gjatë periudhes 2013 – 2014.

Me dobet paraqitet Kosova, ku ne pjesen me të madhe të elementeve të inspektuar treguesit e statusit kanë vlerësimin N/A (jo të aplikueshme – referuar: SA, FIRB, AIRB). Kosova është në fazën e implementimit të akordit të Basel I mbi Riskun e Kredive.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

1. Implementimi i Basel II në vendet në Zhvillim është duke u implementuar nga Banka Qendrore. Rasti i Shqipërisë është në implementim të siper.

2. Politika për zhvillimin e strukturës së Bazel III pothuajse është kompletuar. Reformat janë domethënëse dhe sjellin bashkëleksione mikro dhe makro të krizës. Tashme ndodhemi në fazën tjetër atë të implementimit në vendet e zhvilluara. Një nga mësimet e krizës : është vendimtare se si të gjitha vendet e botës ndjekin procesin global të implementimit.

3. Ritmi i rritjes së investimeve në vend ka rënë, duke reflektuar ngadalësimin e kreditimit nga sektori bankar dhe të shpenzimeve kapitale të politikës fiskale. Bizneset kanë ngadalësuar ritmin e vendosjes së depozitave pranë institucioneve financiare (në formën e depozitave) dhe detyrimeve të tyre ndaj këtyre institucioneve (në formën e huasë së marrë).

4. Në lidhje me rrezikun e tërthortë nga kursi i këmbimit, bizneset paraqesin një pozicion financiar shumë më të thelluar në valutë krahasuar me pozicionin debitor neto në lekë. 41% e tepricës së kredisë totale për individët të marrë pranë bankave, përbëhet nga kredi e pambuluar nga rreziku i kursit të këmbimit, duke treguar se ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit është i pranishëm.

5. Cilësia e portofolit të kredisë ka shënuar rënie për sektorët kryesorë të ekonomisë. Ajo ka shënuar rënie edhe në termat e kapitalit, duke rezultuar në një mbulim më të ulët me kapital të vlerës së huave me probleme nga sektori bankar.

6. Përgjithësisht reforma financiare pati të njëjtat karakteristika në të gjithë Evropën Juglindore sepse: - Të gjitha vendet trashëguan probleme të ngjashme të krijuara në fillimet e zhvillimit të ekonomisë së tregut nisur nga një ekonomi e centralizuar si sisteme financiare të tilla si: kuadër ligjor e rregullator i pamjaftueshëm, besim i pakët në institucionet financiare, akumulim i një numri të madh kredish të këqija nga bankat shtetërore, nivel i ulët i ndërmjetësimit financiar, shkalla e lartë e përqendrimit të bankave si dhe problemi i pastrimit të parave etj.

Të gjitha vendet e rajonit u këshilluan nga institucione financiare ndërkombëtare dhe adoptuan eksperiencën bashkëkohore përëndimore dhe standartet ndërkombëtare. Kështu që edhe Maqedonia nuk bëri përjashtim.

7. Krijimi dhe forcimi i autoritetit mbikëqyrës në Maqedoni është një pjesë e rëndësishme e kësaj reforme si garantuesi kryesor i qëndrueshmërisë së sistemit bankar e financiar. Në këtë aspekt kemi;

8. Me përkufizim është e vështirë të përcaktohet shkaku i krizës tjetër. Shumë risqe duken turbull në horizont dhe të gjitha vendet duhet të vazhdojnë procesin e ndërtimit të kapacitetit të tyre për të absorbuar shokun pavarësisht burimit. Kapaciteti i absorbimit të shokut duhet të jetë më i fortë se çka qëndër më përpara dhe implementimi i standarteve duhet të jetë më konsistent dhe më i fuqishëm.

9. Reformën në aspektin rregullativ;

Është e rëndësishme të përmendim këtu hartimin e rregulloreve, rishikimin e përmirësimit e herëpashershme të tyre, vendosjen e normave të mbikëqyrjes bankare për bankat e nivelit të dytë për të reflektuar zhvillimet e tregut dhe përafrimin e vazhdueshëm të tyre me standartet ndërkombëtare të Komitetit të Bazelit.

10. Përmirësimi i sistemit të raportimit dhe analizës

U realizua standartizimi i analizave në mënyrë të tillë që ato të shërbenin në unifikimin e vlerësimit të bankave dhe si sisteme paralajmëruese të hershme të fenomeneve negative me të cilat mund të përballen bankat e veçanta apo sistemi bankar në tërësi.

11. Standartizimi i inspektimeve në vend

Vlen të theksohet standartizimi i procedurave, zhvillimi dhe standartizimi i fazave e përmbajtjes së raportit të ekzaminimit, zhvillimi i planeve për të nxitur efikasitet në procesin e inspektimit, rritja e cilësisë së inspektimeve duke futur sistemin CAMELS. Ky sistem shërben për vlerësimin e mbarëvajtjes së bankave mbi një bazë të njëjtë dhe për të identifikuar ato banka, që kërkojnë një vëmendje të veçantë nga mbikëqyrja bankare. Vlerësimi pasqyron gjendjen e përgjithshme të bankës, respektimin e anës ligjore e rregullative si dhe aftësinë drejtuese të manaxhimit të bankës.

12. Mbikëqyrja e orientuar drejt vlerësimit të riskut

Ndryshimi i perceptimit të programit të inspektimit, duke u orientuar më shumë në inspektimin e fushave, të cilat paraqesin rrezik për bankat, sesa në revizionimin e thjeshtë të aktivitetit bankar, duke krijuar një fushë më të specializuar e të ndryshme kontrolli në krahasim me kontrollin e kryer nga kontrollorët e jashtëm.

13. Sfidat e rikonceptimit të funksionit mbikëqyrës

Zhvillimi i sektorit financiar e ka ballafaquar funksionin e mbikëqyrjes me dilemën e të qënurit i unifikuar apo jo, brenda apo jashtë bankës qëndrore. Ky mbetet një debat i hapur që do të orientohet për t'i shërbyer sa më mirë mbikëqyrjes së sistemit financiar. Në stadin aktual që ndodhet Maqedonia arsyet që flasin në favor të ushtrimit të funksionit të mbikëqyrjes bankare brenda Bankës së Maqedonisë janë më të shumta. Për të rritur efikasitetin e tij, është e nevojshme që ky funksion të konceptohet me më shumë autonomi. Hapi i parë drejt unifikimit

të mbikëqyrjes është marrëveshja midis Bankes së Maqedonisë, komisionit të letrave me vlerë dhe autoritetit mbikëqyrës të sigurimeve, por gjithçka do të varet nga zhvillimi i sistemit financiar.

14. Nje aspekt tjetër i rëndësishëm, është dhe qëndrueshmëria e regjimit të politikës monetare. Në Shqipëri është e vështirë parashikimi i kërkesës për para, dhe lidhja ndërmjet variablave makroekonomik, kjo për shkak të shkallës së lartë të informalitetit. Euroizimi përballë këtij fenomeni mbetet një alternative, e cila nuk kupton kulturën e stabilitetit të çmimeve.

15. Perfitimet dhe kostot që do të ketë Maqedoniane rastin e një zëvendësimi monetar, do të jenë të shumta: perfitimet në këtë aspekt janë: siguri ndaj kursit të këmbimit, qëndrueshmëri më e madhe e politikave qeveritare, ulje e normës së inflacionit, kosto të ulta transaksioni, stabilitet makroekonomik. Kostot janë: humbje e të ardhurave nga senjorazhi, humbje e sovranitetit të politikës monetare, humbje e rolit të huadhenesit të fundit.

Referenca

- Costs and benefits of unilateral Euroisation in Central Eastern Europe (CEE), Working Paper series: Russian – European Center for Economic Policy
- Committee of European Banking Supervisors (CEBS) (2010) Results of the comprehensive quantitative impact study.
- -Basel Committee on Banking Supervision (2010). Results of the comprehensive quantitative impact study. USAID – Funded Economic Governance II Project, CAMELS Ratings
- -Working Paper No.47 / 2008 – The Implementation and the Consequences of Basel II – Slovenia, Russia, Albania. – Silvia HELMREICH and Johannes JAGER.
- *Inflacioni, kurset e këmbimit dhe roli i politikës monetare në Maqedoni.*- Marta Muço, Peter Sanfey dhe Anita Taci (2003)
- -Ardian Fullani: Basel II, its implications, opportunities and challenges ahead for Albania and Southeastern Europe - by Mr Ardian Fullani, Governor of the Bank of Albania, 11 November 2005.
- Bank of Albania, Supervisory Report of Banking Sector,
- European Council, (1993), Council Directive 93/6/EEC on the Capital Adequacy of Investment Firms and Credit Institutions.
- European Council, (1989), Council Directive 89/299/EEC on the Own Funds of Credit Institutions
- Buletini zyrtar i Bankes së Shqipërisë për miratimin e “Politikë operacionale të mbikëqyrjes” (raporti i Mbikëqyrjes 2012,)
- -Publikimi për miratimin e rregullores për administrimin e rrezikut të kredise.
- -*Strategjia e zhvillimit të mbikëqyrjes bankare për periudhën afatmesme 2009 – 2014*” – Bank of Albania Pdf.

SUSTAINABLE ECONOMIC DEVELOPMENT IN GJIROKASTRA REGION

MSc. Dorina Ciko

“Eqrem Çabej” University, Economic Department, Gjirokastra, Albania

E-mail: dorinaciko@yahoo.com

Abstract

The challenges facing our country in general and in particular the region of Gjirokastra have in their attention the sustainable economic development. Recently, sustainable development represents one of the most studied problems. Sustainable development can not be thought if all areas of a country are not developing at the same rates so, the main goal is giving opportunity for an all-round development, but rational and efficient use of resources in general.

The Regional Development in Albania should be addressed in internal needs and efforts, fulfilling the requirements in order to be integrated in the European Union. So what we need to achieve is not simply copying the structures and European models, but we should adapted to the specifics of the Albanian reality. This adjustment will allow analyzing these models and understanding which errors should not be repeated and what lessons can be drawn.

The purpose of this paper is an analysis of the factors affecting social and economic development of this region where despite the potentials offered problems remain evident and continues to be one of the least developed areas of the country.

In particular, the paper will focus on initiatives that will be taken for improving the local economy, providing a sustainable growth and improving the quality of life for all residents. Local economic development is a process in which the public sector, private sector partners and nongovernmental must work together to improve local economies.

This paper will be achieved through methods of qualitative and quantitative empirical research focusing specifically in Gjirokastra region. Finally the paper will close with some conclusions and recommendations.

Keywords: regional development, sustainable development, factors, challenges.

I. FACTORS THAT AFFECTING IN THE SUSTAINABLE DEVELOPMENT

I.1 The evolution of the concept of sustainable development

The concept of sustainable development was born in the late 1980s as a response to economic development which did not consider the protection of natural resources and the environment. Although, there is no universally accepted definition, the World Commission on Economic Development (WCED) suggested, in the Brundtland Report, that sustainable development is *“development that meets the needs of the present without compromising the ability of future generations to meet their needs”* (WCED 1987). The Brundtland Report is the first research report which highlighted three essential components of sustainable development: environmental protection, economic growth and social equity. With concern for the environment the term of sustainable development became a common theme for many research in 1990. The notion of sustainable development is expanded being implemented in many areas of economic activity. Thus, according to (WTO, 1993) the sustainable development is *“a process which requires the occurrence of development without degradation and wastage of resources which enable the development, doing that in this way the resources to enable future generations as well as current generations”*.

suada.ajdarpasic@unhz.eu

Abstrakt

Ka kohë që globalizimi i tregjeve dhe i produkteve ka ndikim esencial në këmbim tregtar mes shteteve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim, ku rajoni, si Ballkani Perëndimor, ballafaqohet me një diferencë marramendëse në të gjitha fusha të jetës, e sidomos në atë ekonomike. Pasojat e globalizimit jo vetëm se janë evidente por edhe të dëshmuara, pasi që fuqitë industrialisht më të zhvilluara janë ato që dominojnë duke krijuar disproporcion global. Si rrjedhojë nga kjo, shumë polemika i adresohen pikërisht këtij raporti të pabarabartë mes shteteve të pasura dhe të varfëra.

Për realizimin e këtij punimi është përdorur metoda e anketimit për të treguar se si disa ndërmarrje nga vendet në zhvillim janë ndikuar nga fenomeni i globalizimit, e sidomos atij të tregjeve dhe të produkteve në raport me vendet e zhvilluara.

Cili është ndikimi i konkurrencës së huaj? Çfarë pasojash sjellin në vendet në zhvillim? Cilat mjete i përdorin për ta kundërshtuar këtë kërcënim? A mund të garojnë me ndërkombëtarët? Cilat janë ato anët pozitive që mund ti sjellin me vete?.... janë çështjet të cilat do të diskutohen në vazhdim të këtij punimi.

Fjalët kyçe: *Vendet në tranzicion, Globalizimi, Tregjet, Produktet, Efektet, Konkurrenca....*

1. Hyrje

Ekonomia si një disiplinë është një prej fushave më të rëndësishme me të cilën njeriu operon dhe nga e cila ka benefite të mëdha. Me një fjalë ekonomia është element kyç me të cilin shteti prosperon dhe depërton në botën ekonomike. Qëllimi kryesor i këtij punim është që të tregoj se cili është ndikimi i konkurrenca ndërkombëtare globale në vendet në tranzicion.

Duke u bazuar në realitetin, e dim se fenomeni i globalizimit të tregut, pothuajse brenda një nate, është bërë çështja më urgjente e kohës sonë, për të cilën debatohet vazhdimisht si nga njerëzit të nivelit të lartë ashtu edhe nga ata të shtresave më të ulëta, ku destabiliteti i krijuar nga ky fenomen sjell disproporcion marramendës mes rajoneve në zhvillim dhe atyre të zhvilluara.

Vendet në tranzicion, siq është Kosova, ballafaqohen me trazira dhe probleme të shumta, jo vetëm ekonomike, por edhe politike dhe shoqërore. Përmes këtij punimi do të paraqesim

aftësitë e ndërmarrjeve të Kosovës për tu përgjigjur tregut global, si dhe faktorët të cilët ndikojnë në suksesin e tyre.

Teoria e tregut si një ndër faktorët më esencial në ekonomi, në vete gërthen kompleksitete të shumta. Për të arritur deri tek një treg ndërkombëtar kërkon shumë punë, përkushtim, dhe aftësi. Bizneset kosovare ndikohen nga shumë faktorë, duke filluar nga Qeveria e tyre, e deri tek konkurrenca ndërkombëtare. Ky punim tregon se si ndërmarrjet kosovare i luftojnë këto dukuri.

Për pasurimin dhe realizimin e këtij punimi është përdorur pyetësori me të cilin janë anketuar tri ndërmarrje të Pejës. Pyetësori është i përbërë prej shtatë pjesëve, ku janë të përfshira informata gjithëpërfshirëse të ndërmarrjeve.

Në vijim të këtij punimi pjesa e parë mbulon informata në lidhje me kompaninë dhe produktet kryesore të saj, pjesa e dytë informata themelore për strukturën e tregut të Kosovës, pjesa tretë informata për formimin e çmimit për produktet kryesore të ndërmarrjes, pjesa katërt informata për mënyren e shqyrtimit të çmimeve egzistuese të produkteve, pjesa pesët informata për faktorët që ndikojnë në vendimin për ndryshimin e çmimeve të produkteve kryesore, pjesa gjashtë informata për ndryshimin e çmimeve egzistuese të produkteve kryesore, dhe pjesa shtatë informata për formimin e çmimeve të produktit kryesor për tregjet eksportuese (të huaja).

2. Ndikimi i konkurrencës globale në funksionalitetin e vendeve në tranzicion

Rast studimi – Kosova

Globalizimi nuk është thjesht një fenomen bashkëkohor. Ai në fakt ka evoluar me kalimin e kohës duke hapur mundësi të shumta për një zhvillim të gjërë anë e kënd botës, i cili paraqet procesin e intensifikimit të lidhjeve mes ekonomisë ndërkombëtare përmes tregtisë ndërkombëtare, si dhe investimeve të huaja direkte nga firmat multinacionale dhe investimeve financiare ndërkombëtare²¹. I implikuar në të gjitha fusha të jetës sonë, ai megjithatë nuk është duke sjellur zhvillim të barabartë, sepse disa qarqe janë duke u integruar në ekonominë globale më shpejt se të tjerët.

Pasojat e thellimit të globalizimit, çoftë ai pozitiv apo negativ, mund të përballojnë padyshim vetëm vendet me ekonomi dhe teknologji më të zhvillur si përfituesit më të mëdhenj. Ky përfitim vjen nga fuqia e tyre për të determinuar marrëdhëniet me shtete të tjera dhe vetë procesin e globalizimit²². Po çfarë ndodh me shtetet që janë në procesin e zhvillimit apo tranzicionit? Pa pasur alternativ, ato shtete thjesht duhet të ju përmbahen rregullave, kushteve dhe diktaturës së lojtarëve të mëdhenj!!!

²¹ Vjollca V. Hasani, Rëndësia e globalizimit në zhvillimin ekonomik, rasti i Kosovës, Prishtinë, ABB, 2012, Thesis, nr. 1.

²² Joseph E. Stiglitz, Globalization and its Discontents, First Edition, USA, Published by Norton paperback, 2003, ISBN: 97 9951-479-02-8.

Rasti i Kosovës është çështje e ndjeshme dhe njëkohësisht shembull adekuat për ti krahasuar marrëdhëniet ndërkombëtare tregtare mes vendeve të fuqishme me ato ekonomisht më të dobëta.

Kosova është një vend mjaft tërheqës për investim, ka pozitë të mirë strategjike dhe gjeografike, është vend në Eurozonë, është e pasur me burime natyrore, që e ka një popullat më të re në Evropë, dhe e gjithë kjo do të mjaftonte për një zhvillim të pavarur shtetëror po të mos egzistonte implikimi i faktorëve negativ si; korrupsioni, mungesa e njerëzve të kualifikuar dhe profesional, sistemi i dobët ligjor, ambient i pafavorshem biznesor, si dhe shumë faktor të tjerë ndikues. Prandaj, edhe aftësia e shtetit të Kosovës për tu përballuar me fenomenin e globalizimit është mjaft e vështirë, pikërisht për shkak të mungesave esenciale që i përmendëm më lartë.

Mund të themi se parakushti minimal që një shtet të zë rrënje në procesin e globalizimit dhe të jetë i dobishëm, një vend duhet të përfshijë sistemin bankar që gjeneron procesin ekonomik përmes ndër – financimit efektiv, sistemin liberal, sinjeritetin dhe praktikat demokratike, sektori privat i fuqishëm, qytetarët vigjilent që mbajnë qeverinë në gishtërinjë dhe një ekonomi pozitive apo në rritje²³.

Efektet e globalizimit karshi vendeve në tranzicion shpeshherë janë negative sepse i prek në pikën e tyre më të dobët, e që është sistemi i dobët ekonomik . Në përgjethësi, globalizimi i tregjeve paraqet një kërcënim dhe sfidë serioze, jo vetëm për Kosovën, por edhe për të gjitha vende të sistemit të tillë. Andaj, e vetmja mënyrë që këto vende të kenë fuqi për ti kundërshtuar kësaj sfide është që të realizohen si shtet në vete.

Përdnryshe, tregtia ndërkombëtare është mjaft domethënëse. Efektet e saj në jetën ekonomike të njerëzve janë esenciale, për vet faktin sikur shteti amë të mos bëj tregti fare me shtete tjera do të ishte e dëmshme për shtetin. Është vështirë të paramendohet, pasi që nuk do të kishim pasur shumë alternativë të blejm në një shtet të tillë, e sidomos në vend i cili ndodhet në fazën e formimit.

Globalizimi i tregjeve është faktor kryesor në zgjidhjen e dilemave dhe pyetjeve të tilla. Nevojat konsumatore si dhe synimet e larta ekonomike të vendeve të zhvilluara paraqesin variablen kryesore në këmbimet tregtare globale, ku sot ky këmbim është bërë shumë më i lehtë sesa në kohën kur teknologjia e sofistikuar nuk ka egzistuar. Janë në fakt forcat ndërkombëtare të ofertës dhe të kërkesës, variablat të cilat i determinojn rregullat e tregut²⁴, duke e bërë atë treg global, ku e gjithë popullata e globit mund të ketë qasje.

Mund të themi se firmat multinacionale dhe lokale të cilat eksportojnë në shtete të zhvilluara si dhe në shtete në zhvillim, në përgjethësi janë firmat më të mëdhaja në glob, që i kanë produkte dhe shërbime me cilësi shumë të lartë, e që i paguajnë punëtorët më mirë sesa firmat tjera.

²³ Vjollca V. Hasani, Rëndësia e globalizimit në zhvillimin ekonomik, rasti i Kosovës, Prishtinë, ABB, 2012, Thesis, nr. 1.

²⁴ Michael Parkin, Economics, Fifth Edition, University of Western Ontario, Published by Addison-Wesley Publishing Company, Inc, 1999, ISBN: 0-201-68025-4.

Ndërmarrjet botërore të cilat kanë qasje në gjithë tregun botërore janë firmat të cilat posedojnë besimin e konsumatorëve në çdo kënd të botës. Ato firma arrijnë që me anë të produkteve dhe shërbimeve të tyre të pushtojnë botën çdo ditë e më shumë duke depërtuar shumë thellë në shtete të ndryshme, si të zhvilluara ashtu edhe atyre në zhvillim. Egzistenca e konkurrentëve, edhe sipas teorisë paraqet kërcënim, në raste të disa firmave, si të Coca Cola-së, Eviol, Boeing 777...., ajo nuk mund të jetë penges vdekjeprurëse, sepse me posedimin e cilësisë, konsumatorëve potencial, emrit global... konkurrenca mund të evitohet shumë lehtë.

Nese flasim për ndërmarrjet e Kosovës, mund të themi se ato janë shumë larg konkurrentëve të tyre ndërkombëtare, si nga ana e cilësisë, emrit, brendit, besimit konsumatorë, ashtu edhe nga ana e aftësisë konkurrionale. Forcat ndërkombëtare tregtare janë aq të fuqishme sa që ndikojnë shumë negativisht në tregun kosovar dhe produktet e tyre, dhe si pasojë kemi të bëjm me një deficit tregtar i cili me globalizimin e tregjeve dhe produkteve të huaja ky deficit vazhdimisht rritet dhe shënon rramje të ekonomisë.

Produkte të cilat do ti përdorim si shembull në këtë punim janë:

- ✓ pije natyrale të ndërmarrjes “Ujë Rugove”,
- ✓ pije alkoholike të ndërmarrjes “Birra Peja”, si dhe
- ✓ pije të gazuara të ndërmarrjes “Bibita”.


3. ANALIZA E TË DHËNAVE

3.1. Ndikimi i tregjeve globale në tregun kosovar

3.1.1. Ndërmarrja “Ujë Rugove” dhe ndikimi i konkurrencës globale

Ndërmarrja “**Ujë Rugove**” është një nga ndërmarrjet më të suksesshme në regjionin e Pejës e sidomos të Kosovës, me gjithsej 7 konkurrentët, si kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar. Me një numër prej 51-199 të punësuar, në vitin 2013 arriti të realizojë 1.000.000 e më shumë të ardhura nga shitja e përgjithshme e produkteve kryesore. Në suazat e veta i përmbanë 6 lloje të produktit kryesor, e që janë:

Graf 1. Llojet e produkteve sipas sasisë



Kjo ndërmarje nuk e ka karakterin eksportues pasi që pjesëmarrjen totale prej 100% e realizon vetëm në tregun e Kosovës, ku 50% të shitjes së produktit kryesor e realizon vetëm me anë të konsumatorëve të rregullt, kurse 50% tjera nga konsumatorët e rastit dhe jo-konsumatorët. Vendosjen e çmimit final e bëjnë kryesisht në varësi nga: kostot e punës dhe lëndëve të para. Mirëpo, në ndryshimin e çmimit ndikojnë shumë faktorë, dhe çdo rishikim i çmimit bëhet në bazë të ndryshimit të kushteve në treg. Faktorët që ndikojnë në ndryshimin e çmimit janë:

- ✓ Ndryshimet në koston e punës,
- ✓ Ndryshimet në çmimet e energjisë dhe karburantit,
- ✓ Ndryshimet në çmimet e lëndëve të para,
- ✓ Ndryshimi në koston e financimit,
- ✓ Ndryshime në çmimin e konkurrentëve,
- ✓ Ndryshime të tjera në koston e prodhimit.

Tabela 1. Çmimet e produkteve me njësi dhe copa

Çmimi i shitjes me njësi			Çmimi i shitjes me më shumë njësi	
Nr.	Lloji i produktit	Çmimi i shitjes në €	Sasia e shitjes	Çmimi i shitjes në €
1	0,5 L	0,15	12 copa	1,90
2	0,25 L	0,27	24 copa	6,50
3	0,75 L	0,60	12 copa	7
4	1 L	1	6 copa	6
5	1,5 L	0,28	6 copa	1,70
6	10 L	1	12 copa	1

Kjo ndërmarje ka rezultuar mjaft e qëndrueshme me vite të tëra. Ofron produkte të cilat i përbushin të gjitha kriteret e tregut. Konsumatorët kosovar shohin këtë ndërmarje si shumë cilësore, ku blerja e produkteve të saj, sipas tyre është efektive.

Përparësia e kësaj ndërmarrje në raport me konkurrentët kombëtar veçohet në bazë të burimit të saj natyral, apo burim nga bjeskët e bukura të Rugovës. Sa i përket konkurrentëve ndërkombëtar, mund të themi se nuk është aq e dobët karshi tyre. Arma më e mire me të cilën lufton kundër ndërkombëtarëve, është në fakt besimi i konsumatorëve potencial kosovar. Me të kuptuar cilësinë dhe kualitetin e ujit, konsumatorët kombëtar vështirë se do blejnë nga të huaj.

Nga konkurrentët më të dalluar mund të veçojmë:


Tabela 2 . Konkurrentët potencial “Ujë Rugove“

Konkurrentët kombëtar	Konkurrentët ndërkombëtar
Ujë Akull	Prolom voda
Ujë Peja	Evia
Miros	Rosa
Dea	

3.1.2. Ndërmarrja “Birra Peja” dhe ndikimi i konkurrencës globale

Një ndërmarrje tjetër e cila është poashtu e suksesshme në territorin e Kosovës është “**Birra Peja**”, e cila për dallim nga ndërmarrja e mëparshme eksporton në vendet e huaja dhe e cila realizoi të ardhura më shumë se 1.000.000€ brenda vitit 2013. Me 200 e më shumë të punësuar gjatë vitit 2013 arriti që 80% të produktit kryesor të eksportojë në vendet e rajonit, 10% në vendet e Eurozonës si dhe 10% në vende të tjera duke përfshirë edhe Kosovën.

Graf 2. % e të ardhurave totale nga shitja e produkteve kryesore në tregjet e caktuara



Për dallim nga ndërmarrja “Ujë Rugove”, “Birra Peja” nuk e ka asnjë konkurrentët kombëtar, por vetëm ndërkombëtar, ku numri i përgjithshëm arrin 7, e ata janë:

Tabela 3. Konkurrentët potencial “Birra Peja“

Konkurrentët ndërkombëtar
Heineken
Laško pivo
Beck’s
Jelen pivo
Efes Pilsen
Skopsko
Nikšičko pivo

Prezenca e konkurrentëve ndërkombëtar mund të paraqet rezik afatshkurtër por jo edhe afatgjatë. Për vet faktin se shteti kosovar është duke bërë të pamunduren që të mos importoj produkte nga Serbia, e që në realitet numri më i madh i konkurrentëve është nga ky shtet. Përparësia e kësaj ndërmarrje është njohja e kualitetit të saj edhe në shtete të huaja, ku eksporti jashtë vendit ka dëshmuar cilësi dhe kualitet të lartë, ku % e pjesëmarrjes në treg arrin nga 51-99%.

Produkti kryesor është I paraqitur në sasi të ndryshme dhe njëkohësisht edhe çmime të ndryshme.

Figura 1. Llojet e produkteve – “Birra Peja”




Tabela 4. Çmimet e produkteve – “Birra Peja”

Nr.	Lloji i Produktit	Sasia e produktit	Çmimi i produktit në €
1	Birra Pilsner	0,33 L	0,45
2	Birra Pilsner	0,60 L	0,50
3	Birra Pilsner	2 L	1,80

Tabela 5. Shitja e produkteve në pako – 0,33 L

Birra Peja 0,33 L pako	
Copë në komplet	24 x 0,33 L
Përmasat për komplet	240x360x240 mm
Numri i shisheve në paletë	1296
Pesha bruto për paletë	825 kg
Numri i paletave në një kamion	29
Afati i qëndrueshmerisë	6

Çmimin e caktojnë në bazë të kostos së shpenzimeve të prodhimit dhe të gjitha procedurave të tjera për arritjen deri në pikën e fundit (tregun). Çmimi caktohet për të gjithë konsumatorët njëjtë. Shqyrtimin e çmimeve e bëjnë disa here në vit, kryesisht në intervalet e caktuar, por ndonjëherë në përgjigje me ndryshimin e kushteve në treg si p.sh.


- ✓ ndryshimet në çmimin e lëndëve të para,
- ✓ kërkeses,
- ✓ çmimit të produkteve konkurruese.

Zakonisht, mundohen që mos i ndryshojnë çmimet, pasi që klientët e tyre preferojnë çmime të qëndrueshme, dhe sepse ndryshimet e shpeshta mund të ndikojnë në marëdhënie biznesi me klientët e tyre. Eksportin e realizojnë me valutën euro dhe sipas tyre konkurrencë më të lartë shohin në tregun e huaj.

3.1.3. Ndërmarrja “Bibita” dhe ndikimi i konkurrencës globale

Ndërmarrja e cila për dallim nga dy të mëparshmet, e të cilat kishin të ardhura shumë të larta, realizoi të ardhurat shumë më të ulëta në vlerë prej 100.000€ në vitin 2013. Me një numër nga 51-199 të punësuar, arrin ti prodhojë 23 produkte dhe ti shesë ato në Kosovë 40%, Shqipëri 25%, Maqedoni 18% dhe në Zvicër 22%.

Graf 3. Llojet e produkteve sipas sasisë “Bibita”



Ndërmarrja “Bibita” çmimin e përcaktonë kryesisht në bazë të shpenzimeve, si dy ndërmarrjet e mëparshme, ku çmimet janë të njëjta për të gjithë konsumatorët. Çmimi rishikohet disa here në vit dhe kryesisht në interval të caktuar, por ndonjëherë në përgjigje të ndryshimit të kushteve të tregut si: ndryshimet në çmimet e lëndëve të para, kërkesës ose çmimit të produkteve konkurruese etj.

Si faktorë të cilët ndikojnë në ndryshimin e çmimit ata veçuan:

- ✓ Koston e punës dhe të lëndëve të para,
- ✓ Ndryshimet në çmimet e produkteve konkurruese,
- ✓ Ndryshimet në cilësinë e produktit kryesor,
- ✓ Preferencat e konsumatorëve,
- ✓ Përceptimi i gabuar,
- ✓ Mungesa e produktit,
- ✓ Mungesa e lëndës së pare për prodhim.

Numri i konkurrentëve të saj arrin në më shumë se pesë, dhe pjesëmarrja e së cilës në treg përfshinë nga 5% - 20%, ku 50% i përkasin konsumatorëve të rregullt, kurse pjesa tjetër konsumatorëve të rastit. Nga konkurrentët potencial global mund të veçohen:

Tabela 6. Konkurrentët ndërkombëtar “Bibita”


Konkurrentët ndërkombëtar
Coca Cola
Pepsi
Sprite
Schweppes
Fanta

Konkurrenca me të cilën përballet ndërmarrja “Bibita” paraqet një kërcënim mjaft të madh për egzistencën e saj. Kompanit e lartëpërmendura posedojnë konsumatorët global, andaj dhe sukcesi i tyre është shumë më i veçuar sesa të ndonjë ndërmarrje tjetër rreth globit. Është shumë e qartë se me konkurrentë të till nuk mund të garohet, përpos nëse cilësia, emri dhe kualiteti janë afër tyre.


Reziku për egzistencën e kësaj ndërmarrje nuk mbetet me kaq. Reziqet e mundëshme si për këtë ndërmarrje ashtu edhe për të gjitha ndërmarrjet të tjera janë:

- ✓ Zvogëlim i kërkesës për disa nga produktet e tyre
- ✓ Mungesa e ujit dhe cilësia e dobët mund të ndikojnë negativisht në koston e prodhimit të sistemit dhe kapacitetit të ndërmarrjes,
- ✓ Ndryshimet në bizneset që prodhojnë pijet joalkoolike mund të ndikojnë në rezultatet financiare,
- ✓ Rritja e konkurrencës mund të dëmtojë biznesin e tyre,
- ✓ Nëse ndërmarrja nuk është në gjendje për të zgjeruar operacionet e tyre në tregjet e zhvilluara, norma e tyre e rritjes mund të ndikohet negativisht,
- ✓ Lulahatjet në këmbimet e huaja dhe normës së interesit mund të ndikojë në rezultatet e tyre financiare,
- ✓ Nëse ndërmarrja nuk është në gjendje për të mbajtur marrëdhënie të mira me partnerët e tyre, biznesi i tyre mund të dështojë.
- ✓ Rritja në shpenzimet e energjisë elektrike mund të ndikojë në përfitimin e tyre,
- ✓ Ndryshimet në ligj dhe rregullore, mund të rrisin shpenzimet dhe të reduktojnë kërkesën për produktin e tyre,
- ✓ Kushte të pafavorshme ekonomike dhe politike në tregjet ndërkombëtare mund të dëmtojë biznesin e tyre,
- ✓ Kushtet e këqija të motit mund të zvogëlojë kërkesën për produktet e tyre,
- ✓ Ndryshimet në standardet e kontabilitetit dhe kërkesat tatimore mund të ndikojë në rezultatet e tyre.....

Graf 4. Të ardhurat e ndërmarrjeve në vitin 2013



Graf 5. Rëndësia e ndikimit të konkurrentëve në ndryshimin e çmimeve



4. Konkluzioni

Në bazë të asaj që u tha më lartë mund të themi se egzistojnë element të ndryshë të cilët mund të ndikojnë negativisht në funksionimin e biznesit, kushteve financiare apo rezultateve në të ardhmen, në shtete që ndodhën në tranzicion.

Rasti i ndërmarrjeve të Kosovës dallon, sepse disa kanë konkurrentë të fuqishëm e disa jo, si kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar apo global. Mirëpo, pavarësisht asaj se kanë konkurrentë ndërkombëtar, firmat kosovare mund të mos ndikohen apo ti kundërpërgjigjen sfidave globale, përderisa shteti i stimulon dhe ofron grante në fusha të ndryshme duke u ndihmuar bizneseve kombëtare të zhvillohen dhe avansohen, me çka rritet edhe ekonomia e vendit.

Mund të themi se roli i shtetit apo Qeverisë ka elemente që të ketë rol të rëndësishëm në zhvillimin e bizneseve, e mbi të gjitha zhvillimin ekonomik në tërësi. Me përdorimin e të gjitha mjeteve dhe resurseve që i posedon shteti kosovar, fusha e ekonomisë mund të avansohet dhe të fitoj aftësi konkurruese. Fokus i shtetit do duhet të jetë konkurrenca kombëtare, ku me krijimin e bizneseve shtetërore, zhvillimi ekonomik mund të jetë më i lartë, e kështu edhe stabiliteti dhe fuqia e shtetit.

Politika kombëtare e konkurrencës së Kosovës, si objektivi kryesor duhet ta ketë zhvillimin ekonomik të vendit, si dhe objektivat e përgjithshme zhvillimore që para se gjithash janë:

- ↪ Mbrojtja e lirisë së veprimtarive ekonomike të të gjitha vendeve pjesëmarrëse në treg,
- ↪ Reduktimi i çfarëdo bariere të mundëshme për hyrje në treg,
- ↪ Krijimi i një mjedisi të përshtatshëm për nxitjen e investimeve në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme,
- ↪ Të ruaj ndershmërinë dhe korrektësinë në marrëdhënjet me bizneset vendore dhe të rajonit.

Përfundimisht, tregtia ndërkombëtare dhe globalizimi i tij ka sjell me vete si rezultate pozitive ashtu edhe negative. Shtete të zhvilluara të cilat tregtojnë me shtet të nivelit të njëjtë, krijojnë efekte pozitive anasjelltas. Mirëpo, kur shteti i zhvilluar eksporton në shtet në tranzicion (rasti i Kosovës), benefite do të ketë vetëm ai shtet që eksporton, sepse shteti pranues nuk ka fuqi të mjaftueshme që ti kundërvihet. Andaj, krijimi i raporteve të mira finjësore, jep përparësi për krijimin e raporteve globale, dhe kështu shtete të botës së zhvilluar do ta kuptonin Kosovën si shtet në zhvillim, më seriozisht.

5. Referencat

- Campbell R. McConnell and Stanley L. Brue, Economics, Principles, Problems, and Policies, Sixteenth Edition, New York, Published by McGraw-Hill Irwin, 2005, ISBN 0-07-281935-9.
- Charles W.L. Hill, International Business, Fifth Edition, New York, Published by McGraw-Hill Irwin, 2003, ISBN: 0-07-287395-7.
- Charles W.L. Hill, International Business, Fourth Edition, New York, Published by McGraw-Hill Irwin, 2003, ISBN: 0-07-121683-9.
- Dani Rodrik, One Economics Many Recipes, Globalization, Institutions, and Economic Growth, First Edition, 41 William Street, Princeton – New Jersey 08540, Published by Princeton University Press, 2007, ISBN-13: 978-0691-12951-8.
- David Begg, Stanley Fischer, and Rudiger Dornbusch, Economics, Sixth Edition, England, Published by McGraw-Hill Company, 2000, www.BeggEcon.com
- Dennis R. Appleyard, Alfred J. Field, JR. And Steven L. Cobb, International Economics, Fifth Edition, Published by McGraw-Hill Irwin, 2006, ISBN-13: 978-0-07-287737-3.
- International Chamber of Commerce (The world business organization), Standing up for the global economy, Key facts, figures and arguments in support of globalization, 75008 Paris – France, 38 – Cours Albert 1, www.iccwbo.org
- Jeffrey A. Frankel, Globalization of the economy, Cambridge – England, Published by National Bureau of Economic Research, 2000, www.nber.org/papers/w7858.
- Joseph E. Stiglitz, Globalization and growth in emerging markets, New York – NY 10027/USA, Published in Journal of Policy Modeling, Department of Economics, Columbia University, 2004.

- Joseph E. Stiglitz, Globalization and its Discontents, First Edition, USA, Published by Norton paperback, 2003, ISBN: 978-9951-479-02-8.
- Michael Parkin, Economics, Fifth Edition, University of Western Ontario, Published by Addison-Wesley Publishing Company, Inc, 1999, ISBN: 0-201-68025-4.
- Raport vjetor, Zhvillimi i NVM-ve në Kosovë, Prishtinë, RIINVEST, 2004, www.riinvestinstitute.org
- Rawi Abdelal and Richard S. Tedlow, Negotiations, Organizations and Markets, Research Papers, Harcard NOM Research Paper No. 03-20, (Social Science Research Network Electronic Paper Collection).
- Thomas A. Pugel, International Economics, Twelfth Edition, Published by McGraw Hill Irwin, 2004, ISBN: 0-07-248748-8.
- United Nations Conferences on Trade and Development, Trade and Development Aspects of Insurance Services and Regulatory Framework, New York and Geneva, 2007, www.unctad.org/tradenegotiations, www.unctad.org/dispute
- Vjollca V. Hasani, Rëndësia e globalizimit në zhvillimin ekonomik, rasti i Kosovës, Prishtinë, ABB, 2012, Thesis, nr. 1.

Methods used in foreign language learning

Shqipe Husaj

Lecturer at the University “Haxhi Zeka” Peje – Kosovo
Shqipe.husaj@unhz.eu

Abstract

Since we all learn in different ways and since some methods might be more suitable to some students than others languages might need to be learned in different ways, depending on students' learning style and on students' ability to acquire and understand new grammatical structures and language systems. So, this paper aims to bring some analysis on various methods used in foreign language learning, what are the most preferable and easier methods and books both for the students and teachers. There will also be described the current use and the impact of different technology equipments in language learning. The use of some technology tools, YouTube programs, video recorders etc, enable teachers to differentiate instruction and adapt classroom activities by giving learners the chance to hear pronunciation directly by native English speakers, thus enhancing language learning experiences. Regardless of where we live there is an enormous number of materials and resources available to us in language-learning opportunities.. There will also be a brief description of different theoretical orientations, strategies and learning activities designed to reach the specified goals and achieve the learning outcomes of the teaching and learning processes. Since there is never a single method or style for language learning, each student has to find his own method, his own way of learning because what is good for one person isn't good for the others, but students still have to check it out and try it and use it in their best way.

Key words; student, language, methods, strategies.

Introduction

Teaching a language is a process that starts from the early schooling of a child till they finish school, therefore, may be considered as a long life learning process, since non-native English speakers (speakers of other languages) no longer can study only in their mother tongue. Higher education requires an L2 knowledge to search materials in certain fields of study written in different languages. So, some learners start learning second language in the community being surrounded by speakers of a certain foreign language, others learn at school but do not find it sufficient and take extra courses, hire private teachers, travel to L2 country etc. All these above mentioned ways of learning a L2 are conducted in a certain age and require a certain cost which for some parents / students can be affordable but for some not.

Considering the best age in acquiring L2, Hyltenstam (1992) found that the age of six or seven seemed to be a cut-off point for bilinguals to achieve native-like proficiency. After that

age, L2 learners could get *near-native-like-ness* but their language would, while consisting of few actual errors, have enough errors to set them apart from the L1 group. The inability of some subjects to achieve native-like proficiency must be seen in relation to the *age of onset* (AO). “The age of 6 or 8 does seem to be an important period in distinguishing between near-native and native-like ultimate attainment. More specifically, it may be suggested that AO interacts with frequency and intensity of language use” (Hyltenstam, 1992, p. 364). Later, Hyltenstam & Abrahamsson (2003) modified their age cut-offs to argue that after childhood, in general, it becomes more and more difficult to acquire native-like-ness, but that there is no cut-off point in particular. When it comes to the relationship between age and rate L2 acquisition, “Adults proceed through early stages of syntactic and morphological development faster than children (where time and exposure are held constant)” (Krashen, Long, Scarcella 573). But, as for the fluency, it is better to do foreign language education at an early age, but being exposed to a foreign language since an early age causes a “weak identification”. Such issue leads to a “double sense of national belonging,” that makes one not sure of where he or she belongs to. However, it must be remembered that the younger the learner, the easier the language is learnt. If started in early age learns become fluent in the secondary school.

Methods used in L2 learning

There are many methods of learning a second language, but first we must understand the meaning of the method. A **method** is a plan we make for presenting the language material to the students to be learned based upon a selected approach. An **approach** is a set of assumptions about the nature of language and language learning, but does not involve procedure or provide any details about how such assumptions should be implemented into the classroom setting. In order for an approach to be translated into a method, an instructional system must be designed considering the objectives of the teaching/learning, how the content is to be selected and organized, the types of tasks to be performed, the role of students, and the role of teachers. Each student has to find his own method, his way of learning. We know some things work and some don't, but to find out exactly what does work isn't that easy. Some methods can be good, but used wrongly, therefore produce bad results and on the contrary, hard methods used correctly and produce good results.

The best method, the fastest way, the easiest path to mastering a second language is learning from **immersion** (Baker, C. (1993), a way of listening and speaking only in a certain L2. Options of this way of learning are:

- Learners attend a language course where everything is conducted in a certain L2. In this course, the teacher is a native speaker of that L2.
- Learners go to a preschool conducted in a certain L2.
- Learners visit the country of that L2 for six months or more depending how quick they pick up a language.
-

Learning from travelling

Learners visit the country of that L2 for a certain period of time depending how quick they pick up the language. **Visits can be organized in private or as group of learners.** Being

immersed in a foreign country for a certain period one can learn a language in the shortest time. Discussions about real-life language, the use of authentic texts and authentic materials, feeling the accent, etc can be defined as an authentic language consumed in an authentic environment . Adults are the ones who usually travel on a purpose of learning a language either as students living in a family or as students working in that country.

Traditional language classrooms

Traditional classroom is another way of learning an L2 that have also resulted to be successful. If the instructor of a L2 is a native speaker is much more effective than a nonnative instructor. Discussions about real-life language, the use of authentic texts and authentic materials, Dr. Garza defines authentic language as "language produced by native speakers for native speakers to be consumed in a native environment." But this leads to further questions about the appropriate use of authentic texts in a foreign language classroom. After all, the classroom is not to be confused with the "native environment." In traditional language classroom learners can interact with the teacher and classmates, learn better through cooperative activities, group work, they have possibility to ask questions and receive immediate answers, be corrected in their mistakes, etc. Moreover, many students need to have on what they do and keep them moving. Traditional language classrooms are considered also as more motivating environment which keeps learners focused on a learning process all the time.

Online courses

Schools, courses and travelling are not always the best way to learn L2. We have witnessed many children at an early age who speak a foreign language regarding TV programs for children, watching CD and video games .There also many free online language courses, workshops, different videos and games for adults, enabling learners to connect, collaborate, inspire, discover and create through myriad technologies, and at the same time save money. Learners should find the best computer programs or online books , containing many pictures and soundtracks to see and hear at the same time, since seeing and hearing is much better than reading a word only. One of the advantages of online courses is that shy and reticent learners are offered the opportunity to participate in class discussions or chats more than in the traditional classroom having to face other learners. Some learners find online courses easier to concentrate in because they are not distracted by other learners and classroom activities.(OEDB- 2012).

- Four language skills

The four language skills of listening, speaking, reading, and writing are all interconnected, therefore proficiency in each skill is necessary to become a good communicator in a language be it native speaker or a foreign one.

- L2 Reading

Reading is a complex cognitive process of decoding symbols in order to construct or derive meaning . It is a means of language acquisition, of communication, and of sharing information and ideas. Like all language, it is a complex interaction between the text and the reader which

is shaped by the reader's prior knowledge, experiences, attitude, and language community which is culturally and socially situated. The reading process requires continuous practice, development, and refinement. In addition, reading requires creativity and critical analysis. **Literacy** is the ability to use the symbols of a writing system. It is the ability to interpret what the information symbols represent, and to be able to re-create those same symbols so that others can derive the same meaning. **Illiteracy** does not have the ability to derive meaning from the symbols used in a writing system. **Dyslexia** refers to a cognitive difficulty with reading and writing. It is defined as brain-based type of learning disability that specifically impairs a person's ability to read.(NINDS Dyslexia Information Page , 2011)

There are several types and methods of reading, with differing rates that can be attained for each, for different kinds of material and purposes:

- **Subvocalized** reading combines sight reading with internal sounding of the words as if spoken
- **Speed reading** is a collection of methods for increasing reading speed without an unacceptable reduction in comprehension or retention
- **Proofreading** is a kind of reading for the purpose of detecting typographical errors

L2 Writing

Writing is a process of communicating letters or symbols on a surface, representing the sounds or words of a language. The work of a writer involves anything expressed in letters of the alphabet, especially when considered from the point of view of style and effect. Writing is a complex process that requires the author to be aware of and combine various components of a language successfully. A writing strategy can take many forms. It can be a formal plan a teacher wants students to follow to write a book report, or it can be something as simple as a trick to remember how a word is spelled. Writing in L2 becomes a conscious process for the learners, especially if the L2 orthography is different from the learners' L1, and if the rhetoric style of the L2 is vastly different from that of L1 (Silva 1993). To counter this, L2 instruction should include time for planning both content and form, for generating ideas as well as for improving accuracy. The instructor should be creative with their words, make writing simple and to the point. The reader does not have to guess what you mean while you write, if the writing is too advanced for the level of learners it may distract them from fully understanding the message. Instructors should know the readers and grab their attention with an attractive title.

L2 Listening

L2 listening involves interpersonal and interpretive mode of communication, since it requires the learner to assume either participative role in face-to-face communication or non-participative role listening to other people speak or present. It involves different levels of language from beginner speakers of L2 to academic lectures, which causes a kind of anxiety and stress among listeners.

Listening is important because it:

- occupies a lot of our time we spend communicating in the language, the time we spend listening to others speak or listening to songs, news, lectures, YouTube, etc.
- provides input that can be very significant for second language acquisition in general and the development of the speaking skill in particular.
- promotes non-linear processing of language and encourages learners to develop "holistic" strategies to texts.

Language teachers need to think of how to incorporate listening into teaching and provide opportunities both inside and outside the classroom for the learners to be exposed to significant listening input

L2 Speaking

Learners often think that the ability to speak a language is the product of language learning, but speaking is also a crucial part of the language learning process.

In the course of learning L2, learners will frequently encounter communication problems caused by a lack of linguistic resources. **Communication strategies** are strategies that learners use to overcome these problems in order to convey their intended meaning (Richard & Shmit 2009). Strategies used may include paraphrasing, substitution, coining new words, switching to the first language, and asking for clarification (Ellis, 1997 pp.60-61) These strategies, with the exception of switching languages, are also used by native speakers. Good instructors correct learners when making a mistake , then take notes of these corrections and write down new vocabulary .

Speaking clearly and confidently can gain the attention of the audience, providing a golden opportunity for the speaker to make the message known. Wise is the speaker who gains and then holds the attention of the audience, with well-chosen words in a well-delivered presentation, forming a message that is effective, informative, and understood.

Conclusion

Most people have to study for years before they become fluent in any second language. In order to reach the fluency in L2 both learners and instructors have to search for the best and easier methods of learning. In fact, there is no good or bad method. Good methods when used wrong can produce poor results while methods found hard for the students can really work and produce good results. It depends on learners and teachers commitment and if can follow the method properly. Notice that there is NEVER a single method for language learning, just find the best one. Those who are familiar but not proficient in a foreign language don't need to spend money to increase their vocabulary. They can self-teach by reading materials such as dictionaries, books, newspapers and magazines. Reading and listening is an inexpensive way to learn a new language.

*"The superior teacher has regularly gotten superior results regardless of the method."
from William E. Bull's Spanish for Teachers: Applied Linguistics, c. 1965*

References;

- Patricia Meyer Spacks (2011). *On Rereading*, Harvard University Press. ISBN 978-0-674-06222-1

- **Jump up** ^ Rob Waugh. "[Reading a book really is better the second time round - and can even offer mental health benefits](#)", *Daily Mail*, 15 Feb 2012.
- <http://www.gse.buffalo.edu/>
- 4. Russell, V. (2009). "Corrective feedback, over a decade of research since Lyster and Ranta (1997): Where do we stand today?" *Electronic Journal of Foreign Language Teaching*, 6 (1), 21-31.
- Richards, Jack C.; Theodore S. Rodgers (2001). *Approaches and Methods in Language Teaching*. Cambridge UK: [Cambridge University Press](#). ISBN 0-521-00843-3.)
- Baker, C. (1993). *Foundations of Bilingual Education and Bilingualism*. Clevedon: Multilingual Matters.)

SHKAQET E PAPUNËSISË NË KOSOVË 2008-2012

Lirim Lani

Kolegji Evropian Dukagjini, Pejë, Kosovë

lirimlani_1994@hotmail.com

Abstrakt

Papunësia si problemi me peshë dhe kosto mjaft të lartë për shoqërinë dhe ekonominë ka shkakuar direkt dhe ato indirekt, që e mundësojnë këtë llojë problemi të jetë një barrier për zhvillimet e mëtutjeshme ekonomiko-sociale. Kosova për dallim nga vendet e tjera të ish-FSJ-së ka trashëguar një gjendje kolosale shkatërruese të objekteve ekonomike, duke e bërë gati të pamundur një zhvillim normal ekonomik. Punimi do të trajtojë shkaqet e papunësisë nga viti 2008 deri në vitin 2012, pra pas shpalljes së pavarësisë, kur institucionet e Kosovës kanë kompetencat e plota ligjore të funksionimit normal të shtetit të Kosovës.

Elementet ekonomike që e shkaktuan një shkallë mjaftë të lartë të papunësisë në Kosovë janë trajtuar në dy segmente makroekonomike të shkaktimit të papunësisë, e para elementet e drejtpërdrejta ekonomike, dhe elementet indirekte ekonomike. Privatizimi në Kosovë, i cili do të përmbyllet në vitin 2016, me likuidimin e mbi 600 ndërmarrjeve shoqërore ka shkaktuar një fluks të madh të të papunëve në Kosovë. Poashtu, shkalla e lartë e korupcionit në institucione publike dhe private, mungesa e investimeve të huaja direkte, që janë më të ulëta në rajon, pagat e ulëta në sektorin privat dhe publik, mosfunksionimi i politikës monetare dhe asaj fiskale, janë elemente që sollën një shkallë të papërballueshme të papunësisë për ekonominë e varfër dhe në tranzision të Kosovës.

Punimi do të i trajtojë këto elemente ekonomike, që e shkaktuan këtë situatë makroekonomike, me qëllim që të ofrohet një pasqyrë reale e gjendjes së papunësisë në Kosovë nga prizmi shkencor-profesional.

Fjalët Kyçe: *Papunësi, Privatizimi, Korupcioni, Investimet e Huaja Direkte*

Hyrje

Papunësia është njëra prej problematikave të cilat e shoqëron çdo vend në botë, e sidomos vendet që janë të pazhvilluar dhe vendet të cilat janë në zhvillim e sipër. Trajtimi i këtij problemi makroekonomik kërkon kohë dhe plan zhvillimorë të qëndrueshëm, duke e mbështetur në politika të favorshme fiskale e monetare, në funksion të ndihmës së kalimit nga cikli i recenzionit në ciklin e rekuperimit apo këndelljes ekonomike.

Lufta e fundit në Kosovë (1999)²⁵, bëri që ekonomia të dalë e shkatërruar në tërësi me dëme të paparamendueshme dhe të pamatshme, e që sot e 14 vjet pasojat e saj janë evidente dhe që e përcjellin pas. Gradualisht, Kosova është duke e krijuar një treg, i cili do të sjellë

²⁵Sipas Bankës Botërore nga lufta e fundit në Kosovë "u shkatërruan 124.000 shtëpi pjesërisht, ku prej tyre 84.000 u shkatërruan tërësisht, pasuria bujqësore e shkatërruar ishte 700 deri 800 milion\$, 95% e fabrikave ishin jashtë funksionit të punës".

gjithnjë të papunë, dhe njerëz që qëllim kryesorë dhe primar në jetë e kanë largimin nga Kosova. Problem tjetër në Kosovë, që e shoqëron papunësinë është numri i saktë i të papunëve, ngase të dhënat e ndryshme, qoftë të vendorëve dhe të institucioneve ndërkombëtare nuk përputhen, ngase personat e papunë në Kosovë nuk regjistrohen në institucionet përkatëse për këtë fushë, sepse nuk besojnë që do të ju mundësohet që të punojnë me regjistrimin në këto institucione dhe ky fakt bënë që politikat zhvillimore ekonomike të kalkulohej gabim në mungesë të të dhëna të sakta.

Trajtimi i papunësisë është njëra prej sfidave edhe të vendet që janë të zhvilluara dhe që kanë një ekonomi stabile dhe funksionale, ngase sado që norma e papunësisë është e vogël, ajo prapëprapë shkakton probleme. Kosova, si vendi me papunësinë më të lartë në Europë dhe njëherit problemet e tjera të ndryshme, bëjnë që kësaj problematike mos ti kushtohet një vëmendje e duhur, por të mbetet vetëm si një diskutim që ndodh një herë në vitë. Kosova, si vendi me një ekonomi në tranzicion duhet që të përqëndrohet në eksploatimin e burimeve nëntokësore e mbitokësore, ku theks të vaçantë duhet ti kushtohet punësimit të popullatës së re, ngase ajo paraqet shpresën e vetme për një konvergjencë ekonomike, duke i arsimur për treg të punës, e jo sikurse që është duke ndodhur tani, që të krijohen vetëm për statutin e të papunësuaritë, ngase niveli akademik nuk ja mundëson që të jetë i aftë për të punuar në mënyrë të denjë për profesionin që e ka studiuar.

1.Shkaqet e Papunësisë në Kosovë

Papunësia si problemi me peshë dhe kosto mjaft të lartë për shoqërinë dhe ekonominë ka shkaktarët direkt dhe ato indirekt, që e mundësojnë këtë llojë problemi të jetë një barrier për zhvillimet e mëtutjeshme. Kosova për dallim nga vendet e tjera të ish FSJ-së ka trashëguar një gjendje kolosale shkatërruese të objekteve ekonomike, duke e bërë gati të pamundur një zhvillim normal ekonomik. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008, kompetencat e cinguara për vendime ekonomike kaluan tek organet shtetërore të Kosovës. Mirëpo, kjo nuk pati efektin e pritur, dhe si rrjedhojë ajo gjendje para shpalljes së pavarësisë nuk ndryshojë, por ishte një vazhdimësi e punës së UNMIK-ut.

Duke ditur faktin se Kosova ka 35-40%²⁶ normën mesatare të papunësisë, ku 90% prej tyre janë papunësi afatgjate²⁷(MPMS, *Puna dhe Punësimi 2012*), kjo e bënë një problem madhor, ngase papunësia afatgjate sjell problem për shtetin e Kosovës, duke krijuar një borxh kombëtar që gjeneratat e ardhshme do të ngarkohet për ta shlyher atë.

1.1.Privatizimi

Para se të hymë në analiza më të thella të procesit të privatizimit në Kosovë, së pari kërkohet të ndajmë procesin e zhvillimit të saj, ngase ajo u zhvillua në dy faza, që nuk dalluan në koncepte, mirëpo u dalluan vetëm nga kontrolli i drejtimit të saj. *Faza e parë*, është faza në

²⁶ Normë e papunësisë për vitin 2012, sipas ASK-së

²⁷ Papunësia afatgjate është personi i cili është më shumë se 12 muaj i papunë

të cilën UNMIK-u themelojë AKM-në²⁸ në vitin 2002, ku kontrollin kryesor e kishte UNMIK-u dhe *faza e dytë*, kalimi i kontrollit tek vendorët pas shpalljes së pavarësisë më 2008, ku më 15 qeshor 2008 në mënyrë formale u themelua AKP-ja²⁹.

Numri i përgjithshëm i NSH-ve³⁰ të përfshira në privatizim/likuidim që nga fillimi i procesit e deri më sot është 313, ndërsa numri i kompanive të reja të tenderuara prej këtyre NSH-ve është 696³¹, 675 kontrata të shitjes janë përfunduar, ndërsa vetëm tri NSH-re janë likuiduar. Nga 25 NSH-re të privatizuara me spin-of special, janë punësuar 7,108 punëtorë krahasuar me 8,340 të zotuar (Kurtishi, 2012). Sa i përket tokave bujqësore deri më tani janë privatizuar 28,842 ha dhe në proces janë 17,303 ha tjera nga gjithsej 46,145 ha (Kurtishi, 2012).

Nga procesi i privatizimit dhe likuidimit deri në vitin 2012 janë arkëtuar 632,606,224€ (Kurtishi, 2012), e që sot e tutje këto fonde mbesin të ngrira nëpër bankat e Kosovës dhe bankat jashtë vendit, në vend që të investohen në investime kapitale për të krijuar më shumë të hyra për shtetin e Kosovës.

Sipas përlllogaritjeve të AKP-së, NSH-re janë diku mbi 600 të cilat do të përfundojnë së privatizuar deri në vitin 2016 në tërësi, ndërsa paradoks ekonomik është fakti se prej të gjitha ndërmarrjeve të privatizuara numri i punëtorëve të punësuar pas privatizimit është për rreth 80% më i vogël sesa numri i punëtorëve që kanë punuar aty.

Fakt tjetër që e bënë privatizimin si njërin prej shkaktarëve kryesorë të papunësisë në Kosovë është mënyra e privatizimit, ngase këto ndërmarrje të privatizuara, përpara se të privatizohen kanë realizuar 90% të prodhimit industrial në Kosovë, ndërsa sot ato janë shëndruar në pishina, restorante, hotele etj., pa pasur një kriter fundamental të privatizimit, që i kuzhtëzon pronarët që pas blerjes së ndërmarrjes të vazhdojnë veprimtarinë ekonomike përkatëse, që ka pasur ndërmarrja para privatizimit.

Gradualisht, ky proces është duke e ngulfatur zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe është duke e bërë të pamundur dhe vështirë të realizueshme këndelljen ekonomike të Kosovës, ku këto ndërmarrje kanë qenë katalizator të prodhimit vendor, e sot janë shëndruar në makina të prodhimit të njerëzve të papunë.

1.2.Korupsioni

Shkalla e lartë e korupsionit bënë që investimet direkte nga investitorët e huaj të bien, ngase nga korupsioni rrjedh burokracia, ndërsa kjo formë është pengesë reale e rritjes dhe zhvillimit ekonomik.

Përceptimi për korupsionin në bizneset në Kosovë, sipas sondazhit të organizatës Gallup, është 83%, dhe ky fakt bënë që investimet të zvogëlohen dhe nga kjo ka më pak të punësuar dhe më shumë njerëz të koruptuar, që janë një barrier serioze për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

²⁸ Agjencia Kosovare e Mirëbesimit

²⁹ Agjencia Kosovare e Privatizimit

³⁰ Ndërmarrje Shoqërore

³¹ Numri i kompanive të reja të tenderuara nuk do të thotë edhe numri i kompanive të shitura, sepse tenderimi mund të përfundojë pa shitje për arsye të ndryshme.

Poashtu, korupsioni bënë që njerëzit e kualifikuar mirë dhe të aftë për një vend pune mos të punësohen dhe të punësohen njerëzit të cilët kanë të afërm në atë proces të punësimit, ku në Kosovë kjo është bërë një dukuri normale shoqërore, që njerëzit e aftë të migrojnë në ato vende, ku ka deficit të kuadrit profesional, e kjo Kosovës është duke i shkaktuar njëherit një papunësi të madhe dhe një punësim jo silëcor.

Tabela 1. Tregon Indeksi e korupsionit në vendet e Ballkanit

	2010	2011	2012
Kroacia	62	66	62
Mali i zi	69	66	75
Maqedonia	62	69	69
Seribia	78	86	80
Bosnia & H.	91	91	72
Shqipëria	87	95	113
Kosova	110	112	105


Burimi: UNDP, (2013)

1.3.Mungesa e Investimet të huaja direkte

Problematika e investimeve të huaja në Kosovë është gradualisht duke u bërë një shqetësim për gjithë spektrin ekonomik, ngase si ekonomi e vogël që jemi dhe me një ekonomi në tranzicion, investimet e huaja janë esenciale për këndellje, mirëpo investimet çdo vitë e më shumë janë duke rënë dhe atë në mënyrë drastike.

Sipas CIPE-së, shaktarët e uljes së investimeve në Kosovë janë të shumëta, por më kryesorët janë:

Grafiku 1. Tregon pengesat kryesore të investitorëve të huajë në Kosovë




Burimi: Riinvest, Investimet e jashtme direkte në Kosovë (2002)

Sot, çdo vend në botë është në garë për thithje të investimeve nga jashtë, sepse ato janë një shtyllë e fuqishme për uljen e papunësisë dhe se çdo investim ka edhe anën tjetër që rritet besimi për investitorët e tjerë.

Sipas BQK-së, investimet e huaja kanë rënë dukshëm ndërvite dhe si pasojë e saj Kosova në vitet e ardhshme do të ketë të vështirë të kthejë investitorët ka tregu i Kosovës, të cilët kanë humbur besimin në të.

Grafiku 2. Investimet e Huaja sipas BQK-së




Burimi: BQK, Buletini Mujor Statistikor (2013)

Dallimi nga viti 2011 dhe 2012 është 158,800,000€ më pak dhe shprehur në përqindje është 0.25% të GDP-së vjetore të Kosovës, edhe pse kjo është vlerë e vogël, për Kosovën kjo do të thotë mjaftë, ku ajo varet nga këto llojë burimesh.

1.4.Pagat e ulëta në sektorin privat dhe shtetëror

Aktualisht pagat në Kosovë janë të ulëta për standartin në të cilën jemi, Kosova si vend që ka një deficit të lartë tregtar bënë që çmimet të jenë shpesh të luhatëshme dhe jo në propozion të drejtë me pagat aktuale. Gradualisht është rritur paga mesatare, por ajo është rritur diku rreth 60€ në vitë, e në disa vite vetëm 4€.

Grafiku 3. Paga Mesatare e Punonjësëve në sektorin Publik³²



Burimi: ASK, (2013)

Ndërsa, në sektorin privat kjo pagë ndryshon dhe është shumë herë më e vogël dhe kjo shkakton edhe pasoja për shoqërinë në përgjithësi, ngase nga ky sektor ekonomia Kosovare arkëton një pjesë të buxhetit të saj, ndërsa fitimet janë të mëdha, e pagat e punëtorëve janë të vogëla, dhe për këtë arsye ose nuk punojnë ose emigrojnë për ekzistencë. Paga mesatare në sektorin privat varion nga 150-220€, në disa raste mund të jetë edhe më e madhe, në disa raste edhe më e vogël.

1.5.Mos funksionimi i Politikës Monetare

Kosova në vitin 2002 pranojë si valutë zyrtare euron(€) dhe hyri në një treg financiar të madh të shumicës së vendeve anëtare të BE-së, ku në atë kohë Kosova sapo kishte marrur hapat e parë të këndelljes ekonomike. Pas luftës së fundit në Kosovë (1999), autoritetin apo rolin e bankës qendrore e luajtën Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës dhe ABPK-ja³³, ndërsa më 27 korrik 2008 u themelua BQK-ja, që ishte pasardhëse e AQBK-së.

Roli i BQK-së është tejte i kufizuar për kryerjen e qëllimeve të saj dhe si e atillë Kosova është duke u bërë shikuese e ndryshimeve të mëdha financiar, në vend që të jetë përcaktuese për të. Politika monetare moderne varet nga normat bazë të interest, që bankat qendrore vendosin për të ndikuar në normat e tjera të interest (*Politika të stabilitetit Monetar dhe Financiar*, 2009). Aktualisht politika monetare në Kosovë është tepër jofunksionale e kjo për 2 arsye kryesore:

- 1) BQK-ja, nuk ka mundësi që të kontrollojë sasinë e parave në qarkullim, që do t'i mundësonte asaj që të ndikojë në shkallën e inflacionit. Kjo shpjegohet pjesërisht nga

³² Sipas ASK-së në sektorin publikë janë të punësuar 78,068 punonjës


³³ Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës

fakti se Kosova ka varshmëri më të lartë ndaj importeve. Mirëpo, një shpjegim tjetër është se shtetit të Kosovës i mungon instrumenti i politikës monetare për të zbutur efektet e inflacionit, duke shtuar likuiditetin e ekonomisë (me rritjen e sasisë së parave).

- 2) Politika monetare do t'i jepte mundësi BQK-së që gjithashtu të ndikojë në normat e interesit bankar. Përveç, se ka inflacionin më të lartë në rajon, bankat kosovare kanë gjithashtu disa nga kamatat më të larta në rajon dhe në Evropë. Kjo është pengesë e jashtëzakonshme për nxitjen e investimeve dhe për zhvillimin ekonomik. Në kohën kur ekonomitë evropiane, amerikane por edhe ajo kineze, po stimulohen me uljen e normave të interesit, rritja e kredive në Kosovë e vështirëson praninë e likuiditetit që do të nxiste investimet private në biznese, në patundshmëri dhe në konsum. Duke marrë kontrollin e politikës monetare, BQK-ja do të mund të kishte ndikim më të fuqishëm në uljen e normave të interesit dhe stimulimin e investimeve.

Mungesa e kontrollit nga BQK-ja për normën e interesit, bënë që investimet të zvogëlohen dhe me këtë shkallë e papunësisë vetëm ngritet, por edhe më e vështirë për ekonominë e varfër të Kosovës është fakti se bankat komerciale në Kosovë caktojnë normën e interesit sipas nevojave të tyre për të rritur kapitalin e tyre vetanak, e jo ti shërbejnë ekonomisë vendore. Sipas BQK-së, norma e interesit në Kosovë nga bankat komerciale është:

Grafiku 4. Norma e Interesit nga bankat komerciale në Kosovë sipas BQK-së



Burimi: BQK, *Buletini Mujor Statistikor (2013)*

Nga tabela shohim një ulje të normës së interesit prej 2010 në rreth 2%, mirëpo kjo normë është tejet e lartë, kur të shtojmë faktin se investimet janë duke u zvogëluar dhe se deri sa BQK-ja të merr rolin determinues në përcaktimin e normës së interesit, bankat komerciale janë duke fituar më shumë sesa imagjinata e tyre.

1.6.Politika fiskale jo e favorshme për bizneset

Politika fiskale mund të jetë në shërbim të bizneseve vendore, duke krijuar politika të tilla që janë në favor të tyre, e jo në disavantazh të bizneseve. Aktualisht, politika fiskale është në shërbim të mbulimit të deficitit buxhetor të Qeverisë së Kosovës, që bënë që biznesi vendor të ngarkohet me taksa të llojëllojshme, e që për ATK-së janë objektiva kryesore

mbledhja e tyre, e që në fakt objektivë i tyre do të duhej të ishte stimulimi i bizneseve nëpërmjet zvogëlimit ose heqjes së taksave, e jo ngarkimit enorme tatimor.

Politikat fiskale në Kosovë konsiderohen të favorshme sa i përket normave tatimore, megjithatë të gjitha asociacionet biznesore raportojnë se ka probleme në implementim të politikës fiskale. Përveç, kapaciteteve të kufizuara brenda Administratës Tatimore e cila shpesh shkakton paqartësi në interpretimin e ligjit dhe vlerësimin e bazës tatimore, si rezultat i së cilës bizneset të cilat paguajnë taksat shpesh përfundojnë duke paguar gjoba, sepse ata nuk kanë qenë në gjendje t'i llogarisin mirë detyrimet e tyre tatimore. Për më tepër, paqartësitë në implementim rrisin koston (në kohë dhe para) dhe mundësitë për korupsion.

Dhënia e licencave dhe lejeve (nga niveli qendror dhe lokal) konsiderohet si një burim tjetër për korupsion dhe konkurrencë të padrejtë (p.sh. në qoftë se ato lëshohen më shpejt dhe/ose më lehtë për disa firma). Numri i licencave dhe lejeve, procedurat e komplikuar dhe kostoja (në kohë dhe para) është cekur si problem serioz në Kosovë në raportin Doing Business të përpiluar nga Banka Botërore(*Friedrich Ebert Stiftung & Riinvest*, 2011).


Çdo vitë në Kosovë shuhet afro 2000 biznese kryesisht të vogla për shumë arsye, por më kryesore tatimet tejet të mëdha, ligjet që ndryshohen shpesh, taksa që ndryshon %-en e saj çdo 6 muaj, e arsye të tjera të formës fiskale.

Tabela 2. Ndarja e Kompanive të regjistruara në bazë të klasifikimit sipas madhësisë

<i>Klasifikimi sipas madhësisë</i>	<i>Numri i Punonjësve</i>	<i>Numri i Ndërmarrjeve</i>	<i>Përqindja e Totalit</i>
<i>Mikro</i>	1-9	54,411	96.0
<i>Të vogla</i>	10-49	1,303	2.3
<i>Mesatare</i>	50-249	504	0.9
<i>Të mëdha</i>	>250	448	0.8
<i>Totali</i>	-	56,666	100

Burimi: UNDP, (2013)

Grafiku 5. Shpërndarja e formës juridike të kompanive të regjistruara në Kosovë



Burimi: UNDP, (2013)

Konkluzione dhe rekomandime

Privatizimi tejet jo funksional për të mirën e ekonomisë kosovare, ku në vend që të jetë shtyllë e zhvillimit ekonomik, u bë pengesë e saj, ku atë e shoqërojë edhe korupsioni tejet i lartë si në institucionet shtetërore, poashtu edhe në ato private. Mungesa e investimeve të huaja direkte, që çdo vitë janë duke u zvogëluar në mungesë të sigurisë ekonomike. Poashtu, mungesa e një politike të mirëfilltë fiskale, ku ajo në vend që ti shërbejë bizneseve i shërben mbulimit të deficitit buxhetore dhe në anën tjetër mos funksionimi total i politikës monetare, dërguan deri tek një shkallë e lartë e papunësisë në Kosovë.

Papunësia përveç pasojave ekonomike ka edhe pasojat indirekte në fushën sociale, ngase Kosova sot është duke humbur shumë shkakun e papunësisë në fushën sociale, ku problematika më e madhe që po shkakton papunësia është emigrimi i shumë kuadrave të shkolluara dhe të cilët kanë kualifikime për deficitet shkencore në Kosovë, poashtu fusha sociale po i sjell një humbje të madhe ekonomisë kosovare, ku arteria e vetme për një të ardhme të sigurt ekonomike, rinia, është duke u larguar nga Kosova.

Shkalla e lartë e papunësisë mbi 40% po shkakton dëme të mëdha ekonomisë vendore, ku politika zhvillimore ekonomike është drejtpërdrejtë e ndikuar nga papunësia, e cila po përqëndrohet më shumë në shpenzime fizike ekonomik, ndërsa arsimit dhe bujqësisë kanë një ndarje jo propozionale me nevojat e tyre, ku për këto 2 fusha ndahen rreth 5% e buxhetit të përgjithshëm të QK-së. Nevoja e madhe e shtetit për ta ulur normën e lartë të papunësisë ka krijuar një deficit të lartë buxhetor e tregtar, e cila ka ndikuar drejtpërdrejtë në uljen e GDP-së për kokë banori.

Për fund disa rekomandime për fushat e shtjelluara në punim:

- Faza e shitjes së ndërmarrjeve të ketë një çmim minimal, ku ndër këtë çmim nuk lejohet ofertimi dhe se ky çmim minimal është vlera e tregut të asaj ndërmarrje përkatëse, ngase ofertimi pa pasur një çmim minimal sjell zhvlerësim të aseteve të ndërmarrjeve dhe se krijon korupsion indirekt për blerjen e asaj ndërmarrje nga personat përgjegjës të shitjes, sikur që është duke ndodhur tani me këtë mënyrë të privatizimit;

- Fondi aktual i privatizimit që është diku rreth 632,606,224€ të mos mbetet peng i politikave ditore Kosovare, por të investohet jashtë vendit në investime kapitale, ku gjenerohen kapitale shtesë për shtetin e Kosovës;
- Mund të krijohet një mekanizëm ose ministri e veçantë për investime të huaja direkte, ku ato shqetësimi të investitorëve të adresohen në mekanizmi të lartë vendimarrës shtetëror, e jo sikur tani ku është një departament, i cili kryen vetëm rolin e ndërtimit të statistikave për investimet, në vend që të jenë përkrahë tyre;
- Çdo investitorë i huaj mund të ketë statut të veçantë të personit i cili ka privilegje ligjore në gjitha fushat ku ai dëshiron të investojë;
- Për të funksionuar politika monetare e BQK-së, së pari të ndryshohet ligji për BQK-në, ku rregullohet fushëveprimtaria e saj dhe rregullohen mekanizmat monetar, së dyti duhet që shteti të krijoj rezervë shtetërore, të krijoj kapital BQK-së për japjen e kredive bankare për bankat komerciale në Kosovë, së treti për bankat komerciale të krijojnë kushte për uljen e normës së interesit, ku nga këta të fundit kërkohet që qështjet që dërgohen në gjykatat nëpër Kosovë të zgjidhen në një afat sa më të shpejtë dhe kushtet e tjera që ata kërkojnë;
- Shteti mund të krijoj politikë fiskale të veçantë për bizneset e vogla, ashtu që të mos i ngarkuar ato me taksa të llojllojshme dhe burokratike, ngase nga bizneset e vogla krijohet potenciali real për rritjen e madhësisë së veprimtarisë ekonomike, ku shteti nga ato gjeneron më shumë të hyra dhe se ky zvogëlim duhet të mbulohet nga ulja e shpenzimeve qeveritare deri në atë masë sa e plotëson kornizën e afatmesme të shpenzimeve.

Lista e Referencave:

- Qeveria e Republikës së Kosovës. *Puna dhe Punësimi (2012)* Prishtinë: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- Kurtishi, Sh. (2012) “Material diskutues për ndërmarrjet shoqërore dhe publike në Republikën e Kosovës”. *Ekonomia, Financa dhe Statistika*;
- Friedrich Ebert Stiftung & Riinvest (2011) *Sfidat ekonomike 2011 plus*. Prishtinë;
- Riinvest(2002) *Investimet e jashtme direkte në Kosovë*. Prishtinë;
- Qeveria e Republikës së Kosovës. *Buletini Mujor Statistikor (2013)* Prishtinë: Banka Qëndore e Kosovës;
- “Politika të stabilitetit Monetar dhe Financiar”, “Konferenca e 8^{-të} Ndërkombëtare e Bankës Qëndrore të Shqipërisë”. 17 Shtator 2009. Tiranë;
- UNDP (2013) *Raporti i zhvillimit njerëzor në Kosovë 2012*. Prishtinë;
- Qeveria e Republikës së Kosovës. *Raporti Vjetor (2013)* Prishtinë : Agjencia e Statistikave të Kosovës;

COMPETITIVENESS OF THE REGION AS A BASIS SUSTAINABLE REGIONAL DEVELOPMENT

Kabir Saubanov

22 Gavrilova St., Apt. 82, Kazan 420133,
Republic of Tatarstan, Russian Federation
ksaubanov@mail.ru

Kazan University, 18 Kremlyovskaya St., Kazan 420008,
Republic of Tatarstan, Russian Federation
public.mail@kpfu.ru

Abstract

The purpose of this study is to determine the basic principles of sustainable regional development of the area as part of the country. Was used scientific methods based on the writings of Russian and international researchers studying the competitiveness of

territories, including the writings of Michael Porter. The study shows how the orientation of the regional economy in the production of one product (for example, oil) reduces the stability of its development. The main result of the study is that the key challenge in achieving sustainable regional development should be to ensure the competitiveness of the territory. Therefore, governments should focus their action in this direction.

Keywords: *competitiveness of the territory, region, regional development, sustainable development, improving the competitiveness of the region*

Problems of competitiveness in Russia began to deeply engage only in the early 90-ies. XX century. Meanwhile, the question of competitiveness is one of the most talked about in modern economics over the past decades.

Despite the enormous importance of this fundamental element of a modern market economy, which is the competitiveness, so far there is no unambiguous interpretation of the concept. This also proves himself M. Porter, whose work provided the impetus for writing a large number of works devoted to the study of competitiveness and competitive advantages in various fields of social and economic systems, including at the regional level.

In our view, competitiveness is a state of the object, its individual elements, which provides a stable advantage over similar objects, pursuing the same goal. This definition is, in our opinion, can be used both at the level of individual enterprises, as well as from the perspective of regional development.

According to Y. Savelyev [2], in the present conditions of globalization and liberalization of markets, based on economic relations between countries and regions is, on the one hand, competition for promising markets and attracting factors of production, on the other hand, mutually beneficial cooperation and partnership in order to ensure competitiveness on a global scale. These seemingly contradictory, but, nevertheless, complement each other trends that are considered as derivatives of competitive relations between countries and regions, require detailed and multilateral research. First of all, due to the fact that their development determines the modern reproductive structure of the global, national, and, in many respects, the regional economies.

Striving micro and macroeconomic subjects to create a sustainable competitive advantage in a highly dynamic changes in the environment lead to significant structural changes and the emergence of market relations as a result of the new processes and institutional actors. At the level of firms and industries (micro level) - this process intercompany integration and internationalization of production, leading to the formation of a vertically and horizontally integrated structures, all kinds of strategic alliances, as well as sectoral and inter-corporate associations, actively advocating and lobbying for the interests of its members. At the country level (macro level) - this regional integration processes leading to the formation of regional groupings of countries, the conclusion of preferential trade agreements. Economic internationalization at the micro and macro level should be considered, on the one hand, as an objective result of globalization, on the other hand, the processes, in some way, opposing globalization and to develop mutually beneficial

cooperation between a limited number of subjects in order to obtain long-term competitive advantages [2].

L.N. Chainikova [1] believes that the purpose of managing the strategic competitiveness of the region set image of the future state of regional competitiveness and the way to achieve it. In determining the management objectives of strategic competitiveness of the region must be considered from two perspectives: from the perspective of consumers' needs, ie satisfaction of social and other needs of the population in the territory of the future new products and services, and from the standpoint of solving the problem of sustained development of the region.

For the formation of the general objective of the fundamental region is the presence of the regional authorities (regional administration) vision, ie presentation on how the region is now and what it should become in the future, to aspire to. Vision - an ideal representation, the desired image of the region, a comprehensive understanding of the events and the strategic situation of the future. The strategic vision is changing the traditional approach to the development of the region, ie, not "from the past to the future", and to a more efficient - "from the future to the present." That vision is located at the apex of the pyramid strategy. Each region produces its strategic vision, taking into account their specific features [1].

In the context of the global financial and economic crisis that had swept the global economy in 2008, much more strongly intensified competitive processes due to the struggle for economic entities fallen effective demand and limited resources. This competition takes place not only at the micro level, but also at the level of individual regions, which compete to attract highly skilled labor force, foreign and foreign investment, tourist flows, the establishment of mutually beneficial foreign relations, etc. It is obvious that in these conditions, achievement of competitiveness is the key to survival and progressive development.

Meanwhile, in the Global Competitiveness Report [3], published annually by the World Economic Forum, in 2012, Russia ranked 67th out of 144 countries (involved in the rating) by the integral competitiveness index. In this case, the level of development of public management institutions Russian Federation is 133 in the world, on the development of financial markets - 130 place on the development of the business environment - 119 place on the development of innovative technologies - 85 place for the development of the national labor market - 84 place on development of health and education - 65 place in the technological readiness - 57 place, infrastructure development - 47 place.

Thus, the need to improve the competitiveness of Russia is currently one of the most pressing problems, both from the point of government, as well as from the perspective of businesses and regions.

Tatarstan is one of the leading subjects of the Federation in the level of industrial development. The region's share in production mining industry in Russia is about 5%, in manufacturing industries - 4%. However, investments in fixed capital of Tatarstan industry reaches 3% of Russia's total.

Thus, in the region formed a highly industrial territorial-production complex, which produces a large volume of industrial production, and inevitably come (in the face of

regional enterprises) in a competitive relationship with the manufacturers of other countries and other regions of Russia.

The Republic of Tatarstan during the whole period of market reforms carried out in Russia, is one of the fastest growing of the Federation. In this case, the main specialization of the region is oil production and petrochemistry. Oil-producing and (adjoint) petrochemical complex, both in terms of planning and administrative system, and in a market economy, has traditionally been the engine of industrial production in the region. In this case, our calculations show that the dependence of the Tatarstan economy from oil production and exports is higher than in the Russian Federation as a whole. This can be seen from the data presented in Table 1.

Table 1: Comparative characteristics of dependence Economy of the Republic of Tatarstan and the Russian Federation from oil

No	Indicator	Republic of Tatarstan	Russian Federation
1	Oil production in 2010 in per capita, tons	8,5	3,5
2	The share of mineral products in total exports, %	79,4	68,4
3	The share of the mining industry in the sectoral structure of gross value added, % (2009)	22,9	9,7

Source: Federal State Statistics Service

As can be seen from Table 1, if the Russian Federation in 2010, oil production averaged 3.5 tons per capita, the same indicator of Tatarstan - 8.5 tons (almost 2.5 times more).

If the share of mineral products, which are based on oil, Russia's exports in 2010 was fixed at 68.4%, while the same figure in the Republic of Tatarstan has reached 79.4%. That is 11 percentage points higher than in the Russian Federation as a whole.

It should also be noted that if the share of the mining industry in the sectoral structure of gross value added of Russia in 2009 amounted to only 9.7%, while that of the Republic of Tatarstan - 22.9%. That is, almost 2.5 times more than in Russia whole.

Results of the development of the Republic of Tatarstan in terms of so-called first wave of the global economic recession has shown that in the region there are serious systemic problems that reduce its competitiveness. One of these problems - the weak diversification of the regional economy.

Structural features are as Tatarstan industry specialization in industrial production by mining (predominantly hydrocarbon materials), production of petrochemicals, transport engineering, instrumentation, pharmaceutical and food industry. In this case, as shown by our calculations, the five largest industrial enterprises in the region ("Tatneft", a group of organizations "KAMAZ", "Nizhnekamskneftekhim", "Kazanorgsintez" and "Kazan Helicopter Plant") account for more than half of the regional industrial production. This indicates a lack of diversification of industrial production in the region (typical for Russia as a whole) and, in our opinion, lays some problems in the future development of the regional economy.

Oil orientation of Tatarstan exports³⁴ contributed to the collapse of world oil prices that occurred in 2009³⁵, had a negative impact on regional production and export of Tatarstan (in value terms) in January-September 2009 decreased by 46.1% compared to the same period of the previous year. The result was a chain reaction and the macroeconomic situation in the region has deteriorated sharply: the income tax in January-November of 2009 decreased by 45.1% from the same period in 2008, budget expenditures on the national economy fell by 25.8%, the index of industrial production amounted to 91.5% of the 2008 level, housing construction fell by 9.6%, road freight transport decreased by 10.2%.

In this regard, the Republic of Tatarstan are highly relevant questions of growth and remain competitive, especially as it concerns the industry a key sector of the regional economy.

Only on the basis of increase of competitiveness can provide stable and balanced development of the region in the long term. It should be noted that regional competitiveness is a complex and multifaceted category and, in our opinion, characterizes the ability of the regional government and manufacturers to create competitive advantage and manage them.

As one of the objectives of the Programme of socio-economic development of the Republic of Tatarstan for 2011-2015 indicated by increasing the competitiveness of the economy. This, of course, is correct and timely decision fixing a key priority of regional economic policy.

As indicated by the Programme said that today in the Republic of Tatarstan, formed three major center of attraction - Naberezhnochelninskaya agglomeration, metropolitan areas and Southeast agglomeration centers in the cities of Naberezhnye Chelny, Nizhnekamsk, Kazan and Almetjevsk. However, in the existing areas of specialization of the Republic of Tatarstan allocated agricultural areas to the centers of gravity of the second level - the territory of the agro-industrial profile. Actively working on the industrialization of the national agro-industrial complex. Tatarstan has created 14 educational clusters, which will form the center of attraction in the field of scientific and educational activities. Education Cluster - a collection of research and education centers led by the higher education institution, which includes the innovative small businesses and research centers set up around the institution of higher education. In addition, in the educational institutions

³⁴ In 2008, 81.2% of the hydrocarbons had export sales in value terms

³⁵ The average price of Urals oil in the world markets in January-September 2009 amounted to 56.5 dollars per barrel, which is 52.4% from the same period in 2008 (107.9 dollars per barrel)

cluster includes secondary and primary education. Thus, a chain of integrated education programs. The functioning of such a cluster based, inter alia, on the state order for specialists in this field for each of the clusters created with the needs of economic and social development that provides tight integration between employers and the education system.

Creating in Tatarstan Education Cluster, provided for in the regional targeted program planning, in our opinion, is one of the initial conditions for the formation of competitive industries in the region, based on internal and external markets. It is obvious that it is with the reorganization and improvement of the quality of the educational system needs to begin a large-scale work on the formation of competitive regional economy.

Given the limited amount of fuel and energy resources, their inevitable exhaustion, and an active search for oil importing countries of alternative energy sources in the long term (10-15 years) is necessary to reorient the economy of the Republic of Tatarstan with the raw model of development - on diversified. In this regard, it is necessary:

- Increase the tax burden on the oil and gas sector of the economy of the region;
- To form the regional budget spent on education, health, fisheries and agricultural sector of the economy of Tatarstan;
- Implement a program for the development of fishery industry of the region and the health system.

References

- Chainikova, L.N. (2010) *Formation control strategic competitiveness of the region*. Tambov University.
- Savelyev, Y.V. (2010) *Management of competitiveness of the region: from theory to practice*. Petrozavodsk: Karelian Research Centre of RAS.
- Schwab, K., Sala-i-Martin, X. (2012) *The Global Competitiveness Report 2012-2013*. ftp
http://www3.weforum.org/docs/WEF_GlobalCompetitivenessReport_2012-13.pdf (2014, November 10).

RËNDËSIA E MARKETINGUT NË AVANCIMIN E BIZNESEVE NË KOSOVË

Prof.Dr.Afrim Loku¹, Prof.Dr. Vehbi Ramaj², Prof.Dr.Hysen Lajqi³

¹Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj

E-mail address: afrim.loku@uni-pr.edu

²Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti Ekonomik

E-mail address: vehbiramaj@yahoo.com

³Kolegji ISPE, Fakulteti Ekonomik, Prishtine

E-mail address: hysen.lajqi@gmail.com

Abstract

Many small, medium and large states, economic development and their success they achieved through marketing. Through marketing enterprises know better the needs of customers to develop products or services that will be preferred by customers. Marketing as a whole is vital in today's economy, whether in relation to the domestic market or global market. Marketing as a whole is applied in enterprises throughout the shooting process flow and tools starting from introductory element and ending with the product. Marketing in the development of Kosovo's economy from a consumer standpoint is more important, he was made the first business to achieve the final results. Marketing is so present in our daily life so that greatly affects our life style by constantly transform him and society as a whole. Although there tend to adapt our economy and society of Kosovo, marketing ultimately change our lives and our behavior. Enterprise is connected to the market, and this link provides marketing. Marketing is essential to the success of enterprises and for the economy in our country. And in this sense he provides the realization of major goals, namely the survival of enterprises, growth and economic development of Kosovo. Marketing enables better identify consumer behavior, to explore the market, to present ideas, to communicate with the public. Depending on the method of promoting products and services will depend on customer demand due to the final result of the company. The importance of marketing in the enterprise application is generally analyzed in many cases, because marketing is vital to the Kosovo Company, which means that to exist authentic country's economy, should be applied and organized marketing. Whereas marketing planning application makes it possible for businesses and the economy of Kosovo to develop a strategy that enables adapting the business to the constant changes in the market and thereby achieving success and realizing the goals in many enterprises.

Abstrakt

Shumë shtete të vogla, të mesme dhe të mëdha zhvillimin ekonomik dhe suksesin e tyre e kanë arritur në përmjet marketingut. Me anë të marketingut ndërmarjet i njohin më mirë nevojat e konsumatorëve për të zhvilluar produkte ose shërbime që do të preferohen nga konsumatorët. Marketingu si tërësi është jetësorë në ekonominë e sotme, qoftë në raport me tregun e brendshëm ose me tregun botërorë. Marketingu si tërësi aplikohet në ndërmarrje gjatë gjithë procesit të xhirimit të mjeteve xhiruese duke filluar nga elementi hyrës dhe duke mbaruar me produktin. Marketingu në zhvillimin e ekonomisë kosovare nga pikëpamja e konsumatorit është shumë i rëndësishëm, ai është bërë biznesi i parë nga këndvështrimi i rezultatit përfundimtar. Marketingu është aq prezentë në jetën tonë të përditshme sa që në masë të madhe ndikon në stilin tonë të jetesës duke transformuar vazhdimisht atë dhe shoqërinë në tërësi. Ndonëse ka tendencë t'i përshtatet ekonomisë dhe shoqërisë tone kosovare, marketingu në instancë të fundit ndryshon jetën tonë dhe sjelljet tona. Ndërmarrja është e lidhur me tregun, ndërsa këtë lidhje e siguron marketingu. Marketingu është esencial për suksesin e ndërmarrjeve si dhe për ekonominë e vendit tone. Dhe në këtë kuptim ai siguron realizimin e qëllimeve madhore, gjegjësisht mbijetesën e ndërmarrjeve, rritjen dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës. Marketingu mundëson që më mirë të identifikohen sjelljet e konsumatorëve, të hulumtohet tregu, të prezantohen idetë, të komunikohet me publikun etj. Varësisht nga mënyra e promovimit të produkteve dhe shërbimeve do të varët kërkesa e konsumatorëve si rrjedhojë edhe rezultati i firmës. Rëndësia e aplikimit të marketingut në ndërmarrje në përgjithësi është analizuar në shumë raste, sepse marketingu në ndërmarrjet kosovare është jetësor, që do të thotë se për të ekzistuar ekonomia e mirefillët e vendit duhet aplikuar dhe duhet organizuar edhe marketingu. Kurse aplikimi i planifikimit të marketingut bën të mundur që bizneset dhe ekonomia e Kosovës të zhvillojë strategji e cila i mundëson përshtatjen e afarizmit në ndryshimet e vazhdueshme të tregut dhe në këtë mënyrë arritjen e sukseseve dhe realizimin e qëllimeve.

Fjalë kyçe : Marketingu, Planifikim, Tregu, Produkti,

1. RËNDËSIA E MARKETINGUT NË AVANCIMIN E BIZNESEVE NË KOSOVË

Marketingu në zhvillimin e ekonomisë kosovare është shumë i rëndësishëm, ai është tërë biznesi i parë nga këndvështrimi i rezultatit përfundimtar, nga pikëpamja e konsumatorit. Rëndësia e marketingut është më se e qartë sot. Marketingu është aq prezentë në jetën tonë të përditshme sa që në masë të madhe ndikon në stilin tonë të jetesës duke transformuar vazhdimisht atë dhe shoqërinë në tërësi. Ndonëse ka tendencë t'i përshtatet ekonomisë dhe shoqërisë tone kosovare, marketingu në instancë të fundit ndryshon jetën tonë, sjelljet tona. Ndërmarrja është e lidhur me tregun, ndërsa këtë lidhje siguron marketingu. Marketingu është esencial për suksesin e ndërmarrjeve si dhe për ekonominë e vendit tone. Dhe në këtë kuptim ai siguron realizimin e qëllimeve madhore, gjegjësisht mbijetesën e ndërmarrjeve,

rritjen dhe zhvillimin ekonomik te Kosoves. Marketingu mundëson që më mirë të identifikohen sjelljet e konsumatorëve, të hulumtohet tregu, të prezantohen idetë, të komunikohet me publikun etj. Varësisht nga mënyra e promovimit të produkteve dhe shërbimeve do të varët kërkesa e konsumatorëve për ato dhe rezultati i firmës.

Ndermarrjet e medha jan ato te cilat prijne sa i perket realizimit te planit buxhetor vjetor te marketingut. (Jakupi, Ali, 2000)

Tab.1 Realizimi i planit buxhetor per marketing:


Sa keni arritur te realizoni planin tuaj buxhetore per marketingun?		Deri në 50%	Prej 50% deri në 80%	Plotësisht 100%	Ka deshtuar krejtesisht
Kategorizimi I Kompanisë	Ndermarrjet e medha	0	4	10	0
		0.0%	28.6%	71.4%	0.0%
	Ndermarrjet e mesme	9	6	11	1
		33.3%	22.2%	40.7%	3.7%
	Ndermarrjet e mesme	34	40	11	0
		4.0%	47.1%	12.9%	0.0%
Mikro ndermarrjet	70	108	10	8	
	35.7%	55.1%	5.1%	4.1%	

Kjo është e kuptueshme pasi qe edhe nga pyetjet e tjera shihet qarte se ndermarrjet e mdha kushtojne rendesi te madhe marketingut per kompanit e tyre. Ne kete raste 71.4% e ndermarrjeve te medha; 40.7% ndermarrjet e mesme kan realizuar plotesish planifikimin buxhetor . Ndersa sa ju perket ndermarrjeve te vogla dhe ndermarrjeve mikro mund te themi se ato kan hasur ne problem serioze gjate realizimit te planit buxhetor vjetor per marketing.


1.1. Aplikimi i planit të marketingut

Rëndësia e aplikimit të marketingut në ndërmarrje në përgjithësi është analizuar në shumë raste, sepse marketingu në ekonominë kosovare eshte jetesor, që do të thotë që të ekzistoj ekonomi e mirefillit e vendit duhet aplikuar dhe duhet organizuar marketingun. Kurse aplikimi i planifikimit të marketingut bën të mundur qe ekonomia e Kosoves të zhvillojë strategji e cila i mundëson përshtatjen e afarizmit në ndryshimet e vazhdueshme të tregut dhe në këtë mënyrë arritjen e sukseseve dhe realizimin e qëllimeve. Elementet kyçe për planin e marketingut dhe planin interaktiv të marketingut janë:


- **Produkti , Çmimi, Promocioni dhe Shpërndarja**




Tab.2



Tab.3



Tab.4



Tab.5

2. ANALIZA E TREGUT TË MARKETINGUT NË KOSOVË

Ne baze te nje analize që është bërë ne Kosove kemi ardhur ne perfundim se televizionet kombetare jan perzgjedhur nga 44% te ndermarrjeve te intervistuar si burime mediale me te preferuara per reklamim . Gazetat si forme e marketingut jan perzgjedhur nga 11% e ndermarrjeve.

Televizionet locale rangohen sit e tetat e medimeve me te preferuara per marketing me 10%. Radiot locale nga 9% e ndermarrjeve .

Radiot kombetare nga 8% e ndermarrjeve. Ndersa 18% e ndermarrjeve preferojn dhe ndajn buxhet per forma te tjera te marketingut, p.sh: ofruesit e shrbimeve kabllore, web faqet e medimeve etj.







Fig.6

Fig.7


Megjithate, duke pasur parasysh se ky hulumtim ka perfshire vetem 360 kompani, mund te konkludohet se tregu i marketingut ne Republiken e Kosoves eshte shumefish me i madh duke bere qe shteti jone te kete nje ekonomi me te zhvilluar. Si rezultat, 50% e ndermarrjeve te medha I preferojne mediumet e cekura per shkak te audiences me te gjere, dhe 20.8% per shkak se ato preferohen me shume nga konsumatorët e tyre. (Reshidi,Nail) Ndermarrjet e mesme I kushtojn rendesi te madhe audiences me te gjere, mirepo per to eshte me e rendesishme edhe qasja me e leht ne ato medium. Po ashtu 29.3% e ndermarjeve te vogla dhe 30.8 % e atyre mikro i kushtojn me se shumti rendesi audiences me te gjere qe piketojn mediumet e caktuara. Grafikonet ne vijim paraqesin arsyet e preferencave te caktuara nga ndermarrjet:




Tab.8




Tab.9



Tab.10



Tab.11



Tab.12

3. DETYRAT, FUNKSIONET DHE DOBITE E MARKETINGUN PËR EKONOMINE KOSOVARE

Detyra themelore e marketingut në ekonomine kosovare është që të thjeshtësoj raportin midis produktit dhe konsumatorit deri në atë masë që produkti ta shesë veten. Produkti, çmimi, shpërndrja (distribuimi), janë të sinkronizuara dhe formojnë sistemin e marketingut. Disa nga funksionet dhe dobitë e marketingut të suksesshëm prodhojnë efekte të menjëhershme për kompanitë kosovare si:

- Rritja e shitjeve
- Bërja e njohur e produktit ose kompanisë që e ofron atë
- Ndërtimi i Markës
- Bindja e blerësve
- Prezantimi i një produkti të ri
- Mundëson lidhësinë në treg
- Përballjen me konkurrencën
- Informon mbi ndryshimet
- Kundërvepron ndaj reklamës së konkurrencës
- Spikat Emrin e mire

4. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Analiza e tregut të marketingut, ka përfshirë ndërmarrje të mëdha, të mesme, të vogla dhe mikro ndërmarrje.

- Si element kyç që e përcakton preferencën kompanive lidhur me mendimet është audience që targeton.
- Televizionet kombëtare preferohen më së shumti nga ndërmarrjet e mëdha dhe të mesme për shkak të audience me të gjera dhe shikueshmëri me të madhe.
- Mediumet lokale janë përzgjedhur si medium më të preferuara nga ndërmarrjet e vogla dhe mikro.
- Ofruarit e shërbimeve janë përzgjedhur si medium më pak të preferuara nga të gjitha kategoritë e intervistuar.

Çmimi luan rol të rëndësishëm në preferencat e ndërmarrjeve të vogla dhe mikro ndërsa ndërmarrjet e mëdha dhe të mesme i kushtojnë më shumë rëndësi edhe përiferimit të preferencave të tyre me ato të konsumatorëve.

Mosha 19-30 vjeçare është më e piktuar gjatë marketingut sepse kjo mosha konsumon më shumë produktet/ shërbimet, që kompanitë i ofrojnë. Hulumtimet e tregut në të ardhmen të fokusohen në sektorët specifik si p.sh.: në sektorin bankar, industrial, teknologjik, dizajnim etj. Organizimi i seminareve dhe debateve me kompanitë, vecmas në secilin sektor në mënyrë që të identifikohen sfidat e tyre në plasimin e produkteve/shërbimeve në treg.

5. Bibliografia

- Prof. Dr. Ali Jakupi “Bazat e Marketingut”, 2000, Universiteti i Prishtinës,
- Prof. Dr. Nail Reshidi “MENAXHIMI I STRATEGJIVE TE MARKETINGUT”2010
- <http://www.slideshare.net>
- <http://www.albaniapress.com>
- Statistikat : Komisioni i pavarur per media (hulumtim).2008
- Philip Kotler „Marketing”,2010

MANAXHIMI I PROJEKTIT NËPËRMJET PARTNERITETIT BIZNES-ORGANIZATË E SHOQËRISË CIVILE (OSHC)

Msc. Ina SEJDINI

Universiteti “Aleksander Xhuvani”

Elbasan, Shqiperi

E-mail: ina_sejdini@live.com

Abstract

Partnership and cooperation between civil society organizations and businesses in the implementation of projects in Albania, today is on the first steps and forms of organization, but actually is being paid a growing attention from several directions. The aim of this study is to examine the way our country's civil society organizations define the needs and priorities in projects as well as analyzing the possibilities of such partnerships. By giving an overview of theoretical possibilities for partnerships, will then pass to a study conducted in the city of Elbasan in which it is seen that the most common form of this partnership is the philanthropic activity.

Keywords: partnerships, projects, philanthropy, business-civil society organization

1. Hyrje

Hartimi dhe implementimi i projekteve nëpërmjet partneritetit dhe bashkëpunimit ndërmjet disa organizatave po bëhet kusht i domosdoshëm në realizimin e projekteve të fushave të ndryshme. Partneritetet, të cilat në literaturë por edhe në përvojën e deritanishme i gjen të formatuara në forma të ndryshme, kanë potencial që të mund të përmbushin sfida, por dhe krijojnë mundësi të cilat nuk do të ishin të njëjta jashtë këtyre partneriteteve. Partneriteti OSHC³⁶-Organizatë biznesi, përbën në fakt një kombinim unik në realizimin dhe implementimin e projekteve, një kombinim unik midis bizneseve të cilat udhëhiqen nga fitimi, që e mbështesin në përmirësimin e produktit, teknologjinë e re dhe inovacionin, dhe OSHC-të të cilat plotësojnë misionin e tyre në varësi të statutit që kanë, mision që shkon në lehtësim të problemeve apo sfidave që ka sot për sot shoqëria apo mjedisi. OSHC-të duke bashkuar forcat me sektorin privat mund të kenë akses në zgjidhje të cilat kontribuojnë në përmbushjen e misionit të tyre. Bizneset nëpërmjet partneriteteve me Oshc-të, arrijnë të kapin probleme mjedisore dhe sociale, të cilat janë të vlefshme për to jo vetëm për të tashmen por dhe për të ardhmen. Sfidat e ditëve të sotme janë shumë komplekse që të mund të zgjidhen apo të adresohen nga secili sektor i vetëm (Kompakti Global, Kombet e Bashkuara 2007³⁷) dhe vihet re një ndërgjegjësim në rritje si i sektorit privat ashtu edhe i Shoqërisë Civile për rolet e rëndësishme që ato kanë në gjetjen e zgjidhjeve (Samiti Botëror për Zhvillimin e Qendrueshëm, 2002)³⁸. Bizneset në ditët e sotme nuk vlersëohen vetëm mbi

³⁶ CIVICUS, IDM dhe PNUD (korrik 2010)

³⁷ <http://www.unglobalcompact.org/>

³⁸ <http://www.un.org/events/wssd/>

performancën financiare, pasi investitorët shikojnë dhe performancën në fusha të tjera si psh. çfarë kontributi jep kompania për shoqërinë; si ka qënë impakti tek Stakeholder-at; dhe kush janë risqet e reputacionit të tyre. (Heap, 2000; Bovaird dhe Loffler 2003). Si rezultat, bizneset vazhdojnë të rrisin ndërgjegjësimin e tyre mbi problemet e shoqërisë, pjesë e të cilave janë dhe ata, si dhe janë duke ndryshuar sjelljen e tyre në përgjigje të këtyre sfidave dhe problemeve. OSHC-të janë sot aktorë të rëndësishëm në mjedisin ekonomik, social, politik dhe tek bizneset (Heap, 2000). OSHC-të punojnë sot në fusha të ndryshme, duke vënë në përdorim shërbimet dhe kompetencat e tyre. Në fushatat e ndryshme të realizuara nga OSHC, ata kanë kërkuar të influencojnë qeveritë, bizneset apo institucionet e tjera mbi politikat që ndjekin për shoqërinë. Interesi në rritje për partneritete në realizimin e projekteve, në përmbushjen e misionëve, të cilat i përgjigjen sfidave të kohës shihet, si një hap shumë i rëndësishëm drejt një shoqërie më të qëndrueshme dhe më të mirë (Warhurst, 2000)³⁹. Këto partneritete sot promovohen nga shumë drejtime dhe më e ndieshmja në vendin tonë është kërkesa e organizatave dhe donatorëve të ndryshëm në kërkesat për aplikime të projekteve nga PNUD, Keshilli i Europës, Banka Botërore dhe sigurisht nga interesi në rritje i vetë OSHC-ve dhe Bizneseve për të krijuar partneritete. Partneritetet e vërteta strategjike në manaxhim dhe zbatim projektsh ndërmjet Organizatave të Shoqërisë Civile dhe Bizneseve janë të rralla dhe të panjohura në Shqipëri. Në intervistat e zhvilluara në Elbasan dhe në raportin e PNUD, gjejmë të shprehur se forma e vetme e këtyre partneriteteve në vendin tonë është aktiviteti filantropik. Por zbatimi dhe implementimi i projekteve në kuadër të partneriteteve strategjike është një potencial i madh në realizimin dhe plotësimin e nevojave të komunitetit.

2. Metodologjia

Objektivi i këtij studimit është krijimi i një panorame të përgjithshme teorike në lidhje me partneritetet, llojet e tyre, si dhe formën më të përhapur të tyre në vendin tonë, duke zhvilluar intervista me 45 biznese të Elbasanit. Këto intervista u organizuan të formatuara me një pyetësor, qëllimi i të cilit ishte jo vetëm të analizohej forma e partneriteteve OSHC-Biznes që ekziston, por të hidhet vështrim mbi faktorët mbështetës dhe pengues në zhvillimin e partneriteteve, me qëllim krijimin e një baze për ndërgjegjësim dhe zhvillim të mëtejshëm të tij në të ardhmen. Vëzhgimi është i tipit përshkrues, një kombinim i metodologjisë sasore e cilësore, si dhe materiale të mbledhura nga burime primare e sekondare. Partneritetet Oshc-Biznes në vendin tonë janë të limituara dhe në fakt duke qënë në hapat e para, literatura përkatëse në lidhje me këtë temë është e kufizuar në vendin tonë, por burime të shumta gjenden në literaturën e huaj duke e konsideruar këtë si një element shumë të rëndësishëm në realizimin e projekteve të sukseshme, si dhe në fillimin e zbatimit të partneriteteve Oshc-Biznes.

3. Tipologjite e partneriteteve Biznes-OSHC

³⁹ Warhurst, A. (2005).

Ka shume menyra bashkepunimi midis OSHC-Biznes dhe ne fakt çdo menyre ka karakteristika te ndryshme. PNUD paraqet nje sinteze te tipologjive te partneriteteve OSHC-Biznes, te cilat ne menyre permbledhur do ti paraqesim me poshte. Partneritetet OSHC-Biznes nuk jane statike, ashtu si dhe ne organizata te tjera partneritetet jane dinamike dhe mund te ndryshojne ne kohe. 1. Filantropia- Eshte forma baze dhe me tradicionalia e bashkepunimit midis bizneseve dhe OSHC-ve dhe eshte forma me e perhapur. Ky lloj partneriteti perfshin transferimin e burimeve nga Biznesi tek OSHC-te. Aktiviteti filantropik eshte i limituar persa i perket bashkepunimit dhe nuk perfshijne burimet e organizatave. Partneritetet filantropike jane te thjeshta dhe ne fakt nuk perfshijne perfshirjen e plote te organizatave, por jane nje lidhje periferike me aktivitetin e biznesit (Gogins dhe Rochlin, 2000). 2. Shkembimi Reciprok- Perfshin partneritetet, ne te cilat bashkepunimi i nje biznesi me nje OSHC behet ne baze te shkembimit te burimeve per nje aktivitet specifik si psh. ne nje fushate marketingu. Ne keto raste kompania bie dakort te jape nje shume parash ne varesi te shitjes se nje produkti te vecante me logon e partnerit Oshc. 3. Krijimi i vlerave te vecanta- Kjo tipologji perfshin metodene e te punuarit sebashku te oshc-ve dhe biznesit per te arritur ne vleren e dëshiruar duke patur objektiva individuale te vecanta. Ky partneritet kerkon angazhime te medha nga partneret ndryshe nga dy tipet e meparshme te partneriteteve. 4. Partneritetet Strategjike- Ne keto partneritete, partneret punojne sebashku strategjikisht per nje problem te perbashket te cilat te dyja palet duan ta zgjidhin. Keto jane partneritetet me te forta, te cilat sjellin vlere te medha ne perfitimin dy palesh dhe ne shkembim idesh, burimesh dhe perpjekjesh. Ne keto partneritete kerkohet bashkepunim i forte me qellim implementimin me sukses te projekteve.

4. Rëndësia e bashkëpunimit Organizatë jo fitimpruresë-Biznes

Me qëllim që të kuptohet arsyeja pse do të krijohet partneriteti ka rëndësi të kuptohet forca motivuese për të hyrë në bashkëpunim. Motivimi i një biznesi për të implementuar një projekt me një OSHC, të çon në pyetjen se çfarë do të përfitojë ky biznes nga ky bashkëpunim. OSHC-te shpesh janë poseduese të njohurive, aftësive dhe informacionit, i cili mund të jetë i një rëndësie jetësore për bizneset. Këto mund të përfshijnë njohuritë teknike, informacion në lidhje me zgjidhjen e problemeve, të cilat lidhen me mjedisin në të cilin një biznes i caktuar ushtron aktivitet. Bizneset të cilat kanë mundësi të përfitojnë nga kjo eksperiencë bëhen më të fortë në adresimin e çështjeve që shqetësojnë stakeholders-at e tyre. OSHC-të duke qenë se punojnë në rrjete me organizata apo institucione të tjera janë në gjëndje të grumbullojnë informacion më të madh. OSHC-të gëzojnë një nivel më të lartë besimi nga aktoret e ndryshëm në komunitet, se sa e gëzojnë bizneset, kështu që kjo mund të përbëjë një mënyrë se si bizneset mund të rrisin besueshmërinë e tyre. Nje tjetër mënyre se si bizneset mund te përfitojne nga partneriteti me organizatat e shoqërisë civile, është ajo e të qenit një hap përpara në lidhje me problemet për të cilat OSHC-të munden të jenë dhe agentë të ndryshimit. Për një biznes, partneriteti me OSHC mund të jetë një mënyrë e bashkimit të forcave për të ndikuar si legjislacionin ashtu dhe disa standarte të cilat mund të jenë në interes të të dy partnerëve. Nga ana tjetër, për OSHC, te paturit e një partneri nga biznesi, sjell jo vetëm ndikim për ndryshimin e sjelljeve të bizneseve në përmirësim dhe lehtësim të sfidave

globale, por organizatat e shoqërisë civile gjejnë një partner, i cili i krijon një akses financiar dhe akses në burime të tjera. Zgjedhja e partnerit të duhur konsiderohet esenciale si për OSHC ashtu dhe për biznesin. Duke gjetur partnerin e duhur kemi arritur të gjejmë dhe ekspertizën, kompetencën, sjelljen e duhur, të cilat janë elementë të nevojshëm për suksesin e një partneriteti. Rruga më e mirë në fazën e parë të fillimit të partneritetit do të konsiderohej shpenzimi i një kohe të nevojshme për njohjen sa më të mirë të partnerëve me njëri – tjetrin. Në implementimin e projekteve nëpërmjet partneriteteve, përcaktimi i një qëllimi afatgjatë dhe më pas përcaktimi i objektivave të qarta për çdo projekt do të shërbejë si bazë për suksesin apo dështimin e partneritetit në të ardhmen. Një tjetër element me rëndësi do të ishte përcaktimi i qarte i përfitimeve të përbashkëta dhe deri diku në të njëjtin nivel si te organizatës biznesit ashtu dhe të OSHC, nga zbatimi i projekteve.

5. Rezultate te intervistave te zhvilluara me disa biznese te qytetit te Elbasanit


Në dallim nga shumë qytete të tjera të Shqipërisë, Elbasani është prekur thellësisht nga ndryshimet strukturore të tranzicionit, për shkak të ndërprerjes së punës dhe daljes jashtë funksionit të pothuajse të gjitha ndërmarrjeve industriale të mëdha, të përqëndruara në këtë qytet. Kjo situatë ka dhënë disa pasoja kryesore në tregun lokal të punës, të cilat janë lehtësisht të dallueshme: Numri i ndërmarrjeve të mëdha e të mesme aktive është shumë i vogël, ndërmarrjet prodhuese të mëdha e të mesme nuk përbëjnë më sektorin kryesor, si nga pikëpamja e numrit të ndërmarrjeve aktive, ashtu edhe për nga numri i të punësuarve.

Numri i bizneseve sipas viteve


	Lloji i biznesit	Viti	Viti	Viti	Viti
		2000	2005	2010	2014
1	Biznes i vogël	2486	2783	3263	2732
2	Biznes i madh	204	293	677	786
3	OJF&ndërmarrje shtetërore	47	51	88	80
	Gjithsej	2737	3127	4028	3518

Për të parë nëse ekzistonte ndonjë formë bashkëpunimi apo partneriteti midis bizneseve të perzgjedhura me OSHC, bizneseve ju drejtua një pyetje nëse kishin mbështetur ndonjëherë Organizatat e shoqërisë Civile. Edhe pse nga 25% e bizneseve të pyetur, 15% e tyre nuk i kishin mbështetur ndonjëherë Organizatat e Shoqërisë Civile, 55% besonin se mbështetja e OSHC-ve do ta bënte biznesin e tyre më të suksesshëm, 23% e tyre shfaqën dyshime në lidhje me efektivitetin e kësaj mbështetje dhe 8% e tyre shprehën se nuk e dinë efektin që do të kishte mbështetja e OSHC-ve. Nga intervistat e zhvilluara ra në sy fakti që 14% e bizneseve nuk e gjykonin si mjet për sukses mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile.


Fushat më të rëndësishme për mbështetje rezultojnë: ndihmat humanitare, katastrofat natyrore dhe shendeti



Arsyet e listuara si më të rëndësishme për dhurimin janë detyrim moral dhe përmbushja e nevojave njerëzore. Dhe më pas vinin tradita dhe imazhi i kompanisë.



Fushat kryesore të mbështetjes së dhënë nga biznesi:



Sipermarrjet deri tani mbështetjen për shoqëri civile e kanë realizuar në mënyrë sporadike dhe në varesi të kërkesës së ardhur dhe gjendjes financiare në momentin e kërkesës. Duke e konsideruar si një element që ndihmon në berjen të sukseshëm biznesin e tyre, sipermarrjet e intervistuar u pyeten dhe mbi mbështetjen që i nevojitet për të bashkëpunuar me organizatat e shoqërisë civile për të aplikuar projekte të përbashkëta. Format e mbështetjes që kërkonin prioritet sipas renditjes ishin (i) Incentiva që sjellin reduktim taksash (ii) Informim rreth programeve dhe projekteve ku mund të përfshihesh (iii) Informim në lidhje me organizatat dhe fushën e veprimit të tyre (iv) Shembuj të kompanive të tjera (v) Ndarje info dhe përvojë me kompani të tjera (vi) Mbështetje për publikim dhe promovim të këtyre aktiviteteve (vii) Mbështetje për identifikim dhe organizim të aktiviteteve (viii) Asistencë për stafin e kompanisë në lidhje me këto aktivitete.


Filantropia, si forma më e përhapur e partneritetit Biznes-OSHC

Bizneset në Elbasan i mbështesin organizatat e shoqërisë civile në formë sporadike apo në

varësi të kërkesës që bëjnë organizata të ndryshme të shoqërisë civile. Forma e mbështetjes është ajo e dhurimit, dhe kryesisht realizohet nëpërmjet mbështetjes financiare dhe produkte dhe shërbime në natyrë, pra bizneset zhvillojnë kryesisht aktivitet filantropik dhe kjo është forma e vetme e realizimit deri tani të partneritetit biznes –organizatë e shoqërisë civile. Më shumë se gjysma e sipërmarrjeve të intervistuar mendojnë që aktiviteti filantropik e bën biznesin e tyre më të sukseshëm. Aktiviteti filantropik realizohet kryesisht nëpërmjet ndihmave humanitare, mbështetjes në raste katastrofash natyrore dhe për përmirësimin e shëndetit. Bizneset e intervistuar kryejnë aktivitetin filantropik sepse e konsiderojnë atë detyrim moral (70%) e tyre dhe sepse ai përmbush nevojat njerëzore. Veprimtaria filantropike e sipërmarrjeve influencohet në shkallë të lartë nga pronarët dhe administratorët. Sipërmarrjet nuk e planifikojnë mbështetjen për aktivitete filantropike, ato më së shumti e kryejnë ato në mënyrë spontane. Format kryesore të mbështetjes që kërkohen për të zgjeruar aktivitetin filantropik janë: Shtypsa financiare nga ulja e taksave; Informim rreth programeve në të cilat mund të kontribuohet me buxhet të limituar dhe procedura më të thjeshta rimbursimi.

Sipërmarrjet që kryejnë aktivitet filantropik e kanë renditur si mbështetjen e parë për nga rëndësia, krijimin e shtysave nga ulja e barrës së taksave për sipërmarrjet që realizojnë veprimtari filantropike. Kjo kërkon një rishikim të Ligjit mbi Sponsorizimet, por dhe të akteve të tjera ligjore dhe nenligjore perkatase. Sipërmarrjet që nuk kryejnë aktivitet filantropik kanë identifikuar procedurat e vështira të rimbursimit si një prej arsyeve kryesore për mos kryerjen e aktivitetit filantropik. Ndërkohë ato që kryejnë aktivitet, e kanë renditur këtë si fushën e tretë që kërkohet të përmirësohet, me synim zhvillimin e mëtejshëm të aktivitetit filantropik. Hartimi i dokumentave strategjik për përgjegjshmërinë sociale të biznesit do të ishte një element baze për fillimin e partneriteteve biznes –OSHC. Njohja me praktikën më të mirë dhe trajnimet për hartimin e dokumentave strategjik mund të shërbejnë për të rritur numrin e sipërmarrjeve që punojnë me vizion dhe plane për kryerjen e aktivitetit filantropik.

Format e mbështetjes



Konkluzione

Partneritet e vërteta strategjike në menaxhim dhe zbatim projektsh ndërmjet Organizatave të Shoqërisë Civile dhe Bizneseve janë të rralla në Shqipëri. Nga intervistat e zhvilluara në Elbasan dhe në raportin e PNUD gjejmë të shprehur se forma e vetme e këtyre partneriteteve në vendin tonë është aktiviteti filantropik. Por zbatimi dhe implementimi i projekteve në kuadër të partneriteteve strategjike është një potencial i madh në realizimin dhe plotësimin e nevojave të komunitetit. Bizneset mendojnë se kryerja e aktivitetit filantropik ndihmon në suksesin e tyre por forma e vetme e konsideruar deri tani ka qënë dhurimi, ndërkohë që partneritetet strategjike duhet të motivohen nga nevojat e brendshme dhe të jashtme të biznesit. Organizatat e shoqërisë civile zotërojnë kompetenca të cilat mund të jenë të një rëndësie strategjike për bizneset. Nderkohë që shumica e sipërmarrjeve rrjetin e saj e ka me blërësit, furnizuesit, konkurrencën, për Organizatat e Shoqërisë Civile ky rrjet është më i thellë, shkon tek ndërveprimi me organizata të tjera, përfituesit, donatorët, ligjvënësit dhe lobimet në interes publik. Aksesit tek informacioni dhe rrjetet mund të jetë një motivim i përbashkët për kompanitë e biznesit në partneritet me OSHC. Organizatat e Shoqërisë Civile që përfshihen në partneritete me bizneset i shikojnë këto të fundit si një mundësi mbështetje jo vetëm financiare por dhe si pjesë të zgjidhjes së problemeve dhe sfidave globale dhe të komuniteteve të cilat shkojnë përtej interesave financiare. Ky partneritet përbën një rrugë efektive për ndryshimin e sjelljeve nga ana e biznesit drejt praktikave më të qëndrueshme, produkteve dhe shërbimeve (Googins dhe Rochlin, 2000). Partneritetet strategjike ndërtohen në bazë të interesave të përbashkëta për zgjidhjen e sfidave strategjike. Këto partneritete mund të ekzistojnë vetëm në rast se organizatat (biznesi dhe Oshc) kanë objektiva të përbashkëta. Në realizimin e projekteve të përbashkëta partnerët krijojnë vlera të përbashkëta duke përfituar më shumë nga çdo të përfitonte më vete. Bashkëpunimet dhe partneritetet për të qënë të suksesshme duhet të mundësojnë përfitim të përbashkët për partnerët. Në rastin e studimit tonë u vu re se bizneset përmendin kryesisht dhurimin financiar, ndërkohë që ndarja e njohurive është kyç në realizimin me sukses të projekteve nëpërmjet partneritetit OSHC-Biznes. Për realizimin e projekteve në partneritetin strategjik kërkohet angazhim i plotë i niveleve menaxheriale të kompanisë së biznesit. Komunikimi dhe dialogu i vazhdueshëm është një kërkesë e rëndësishme për realizimin e projekteve. Në rastin e aktivitetit filantropik dhe intervistave u kërkua kryesisht komunikim në lidhje me eksperimentat e tjera të ngjashme në realizim projektsh, në partneritete strategjike komunikimi, dialogu dhe mbledhjet duhet të realizohen në bazë të një axhende paraprake dhe të vazhdueshme, për të siguruar realizimin e projektit. Edhe pse literatura dhe njohuritë në partneritetin strategjik janë në hapat e para, këto partneritete janë potenciale të mëdha nga të cilat përfitojnë OSHC, bizneset dhe shoqëria. Kombinimi i Organizatave të Shoqërisë Civile, të cilat veprojnë si ruajtësit e shoqërisë dhe natyrës dhe i bizneseve, si udhëheqësit e rritjes ekonomike dhe novacionit, krijojnë mundësi unike për bashkëpunimin jo vetëm në realizimin e projekteve por edhe në ndërveprimin midis sektorëve. Nga këto bashkëpunime jo vetëm janë përfitues sektorët e ndryshëm, por është edhe shoqëria si rezultat i adresimit të sfidave të kohës.

Referenca

- Bovaird T and Loffler E. 2003 “Project management and governance”
- Bendell, Jem. “Self-Regulation: An Introduction to Business-NGO Relations and
- Bendell, Jem (2000), Teams for Endearment: Business, NGOs and Sustainable Development.
- Elkington, John, and Fennell, Shelly. “Partners for Sustainability.” Greener Management International 24 (Winter 1998): 48-60
- Freeman, R. (1984). Strategic Management: A Stakeholder Approach. Boston: Pitman.
- Freeman, R., & Reed, D. L. (1983). Stockholders and stakeholders: A new perspective on corporate governance. California Management Review, 25(3), 88-106.
- Friedman, M. (1970). The Social Responsibility is to Increase Its Profits. The New York Magazine.
- Googins, B. K., & Rochlin, S. A. (2000). Creating the Partnership Society: Understanding the Rhetoric and Reality of Cross-Sectoral Partnerships. Business and Society Review, 105(1), 127-144.
- Heap. (2000). NGO-Business Partnerships. Project Management Review, 2.
- Richard Holme & Phil Watts (2000) “Corporate social responsibility: making good bussines sense”.
- Panariti S (2009). “Manaxhim projekti”
- Sustainable Development.” Greener Management International 24 (Winter 1998): 3-9.
- Turner H, Hulme D 2000 “Governance, administration and development”, Macmillan press
- UN website: <http://www.unglobalcompact.org/>
- UNDP 2000/2004/2010 “Albania Human Development Report”
- World Summit website: <http://www.un.org/events/wssd/>

ENHANCING BUSINESS ETHICS IN ALBANIAN ENTERPRISES AFTER THE GLOBAL FINANCIAL CRISIS

Dr. Imelda Sejdini

“Aleksandër Xhuvani” University,
Rr.Rinia, Elbasan, Albania
Email: imelda.sejdini@yahoo.com

Prof.Asoc.Dr. Evis Kushi

“Aleksandër Xhuvani” University,
Rr.Rinia, Elbasan, Albania,
Email: eviscaku@yahoo.com

Abstract

Business ethics derives from transparency, objectivity, reliability, honesty and prudence and reflects the strength of a market economy. Considering these values as important means to conduct businesses, managers in Albania need to gain the basic elements of well functioning of market and society. The economy of Albania, as a developing country, is characterized by Small and Medium Size Enterprises. According to the vast literature of business ethics, managers in small and medium size enterprises have the ability to influence the ethical climate in the organization to a great extent. The current study investigates the ethical views of these managers in Albania, to gain the trust of stakeholders after loss or misplacement due to the global financial crisis. It also seeks to build material in this area in order to establish enterprise views on ethical issues. A questionnaire is conducted on both groups, small and medium size enterprises and the results are statistically tested. The research findings indicate that a range of ethical considerations are important to Small and Medium Size Enterprises. Being law abiding, enterprises reinforce in the publics' view that they are sound businesses to deal with, but business ethics goes further. In order to restore the trust is needed to be built a more robust regulatory framework. A good way to prove the reliability is, through an enhanced multilateral co-operation, especially between government and businesses and the sound international rules and regulators. This paper sets out findings that are useful to practitioners and researchers who are trying to evaluate the underlying premise by which Small and Medium Size Enterprises operate. The expansion of further research to cover the full country business enterprises and at the same time replication in other countries would provide a broader and more wide ranging view of the underlying stance on ethical issues.

Keywords: *ethics, management, enterprise, crisis, incomes*

1. Introduction

The global financial crisis had an ethical dimension, but in general it was not an ethical crisis. There are arguments that this crisis was a crisis of leadership and governance in many

institutions, which reflects the failure of an economical and social model, based on ethical assumptions.

At the beginning of the crisis, it was the lack of transparency and the doubts about solving problems in many US companies that affected rapidly the international financial system. It was first a liquidity crisis, than a solvency crisis that was quickly spread to other markets and countries. It became a loss of confidence in the soundness of the institutions involved.

As a complex phenomenon, this crisis had economic, psychological, social, political and ethical causes, independent from each other. According to different analysts, the blame is of governments and central banks, as well as the regulators and controllers of the financial system, rating agencies, managers of financial institutions, mortgage sellers, home buyers, developers and builders, etc.

Moral errors may explain why economic and political failures can lead to situations of crisis and this is why it has often been argued that this was an ethical crisis. Owners and managers of private activities, bankers and financiers, economists and journalists, politicians and public sector people in Albania, must be more conscious than ever, about the risk, the higher degree of economic destitution and the immediate need for technical and professional management of these situations. In this paper, our analysis is developed in the organizational level, with the focus on recovery and stakeholders trust gaining after loss due to the crisis.

2. Methodology

In order to investigate the ethical view of managers in Albania, finding the best ways to gain the trust of stakeholders after loss or misplacement due to the global financial crisis, a questionnaire is conducted on both groups of small and medium size enterprises and the results are statistically tested. The selection of the 200 surveyed businesses is conducted considering sectors that were affected more by the economic crisis, mainly construction firms, fason and firms with commercial activity, mainly import - export. The main questions to understand are about trust on the firm or the sector, the regulatory framework and the business outcomes related to trust and managers actions. The answers to the questionnaires were completed: 50% by the direct interview, 30% by e-mail and 20% by telephone interviews, according to the location of businesses, shown in Table 1.

Table 1. Location of businesses

SME-s Sectors	Location in Albania			Total (%)
	Center	North	South	
Construction	50	20	30	100
Fason	40	30	30	100
Comercial	60	20	20	100

3. Economic outlook of enterprises in Albania

The private sector in Albania, generates 75% of GDP and employs 83% of the workforce. This sector is steadily increasing and is characterized by small and medium-size enterprises. The classification of these enterprises is performed based on the number of employees, annual turnover and / or annual balance sheet. The classification based on the number of employees is as follows: Micro enterprises: up to 9 employees; Small enterprises: 10-49 employees; Medium sized enterprises: 50-249 employees.

This division is made according to European Union legislation that considers small and medium enterprises, all the enterprises that have fewer than 250 employees, with an annual turnover not exceeding EUR 50 million and/or a total balance sheet not exceeding EUR 43 million. Every year, is conducted by INSTAT, the structural survey of enterprises, that aims to provide information on the economic, financial structure, and key characteristics of the enterprises registered in the statistical business register by economic activity that is still active. According to the last survey, for the year 2012, the number of economic enterprises is 80.722, and based on the economic activity, enterprises that operate in trade sector comprise 46.8 percent, while enterprises with 1-4 employed are those which prevail with 91 percent (INSTAT, 2014).

Most of the enterprises, 84 percent operate in the service activities and mainly in trade sector (including trade of vehicles, wholesale and retail trade). In trade sector operate 46.8 percent of enterprises which have contributed with 48.9 percent in the realization of total turnover realized by all enterprises together.

Enterprises of producers of goods, including industry and construction sectors, have contributed approximately 36.2 percent of the total turnover realized. In industry and construction sectors are 15.6 percent of enterprises which provide employment for about 41.1 percent of the workforce.

Even though the number of enterprises had a decrease of 7.3 percent in 2012 compared to 2011, the number of employed had a slight increase by 0.2 percent and a significant increase of 7 percent in turnover. The situation differs for construction sector where the number of enterprises decreased 12 percent is associated with the decrease in the number of employed by 3.9 percent. This sector has the lowest contribution to the realization of the total turnover, 4.2 percent, reducing the value of investments by 3.5 percent.

According to these official data on economic enterprises, we focused our survey on the sectors that were affected more by the economic crisis, mainly construction firms, fason and firms with commercial activity, mainly import - export. These sectors show decreasing figures for the period after crisis.

The crisis in Albania is noted in some directions. First, we mention the significant decline in household consumption. Considering the opinions and assessments of institutions and specialists, people always think about the future and focus mainly on savings. Increased deposits of households and businesses in banks is a parameter that indicates that on the one hand banks have more liquidity available, but they also have more obligations to depositors who seek interests. This posture puts pressure on banking institutions and requires that the monetary capital employed, used, go to the service of lending. On the other hand the economy is characterized by a decreasing economic growth, accompanied by less need for funds, and began to manifest decline in turnover. Consequently, decreases the reliability of banks to businesses. Secondly, the decline in remittances is another important indicator for the

economic stability of our country. This decline worsens the familiar balances and is reflected in low consumption. On the other hand this decline worsens the balance of payments. Thirdly, is the decline in economic growth, rising unemployment, the decline in investment and the increase of inflation.

In Albania, as in other countries of Balkans, the economic financial crisis is the first year had a low influence, because of the relatively low level of capital market development. These countries had an economic growth in group, by approximately 3.6%, which continued to decline in 2011 (OECD, 2012).

An important figure that shows the difficulties of the economy is the increase of the percentage of outstanding loans on time. The data from the sector show a very clear message, families, businesses and individuals, have lost the full ability to return normally the loans because of economic and financial difficulties.

Considering other factors, like public debt, the deepening of budget deficit provoked by the economic decline, the influence of other economies like Greek or Italian economy, political factors and the poor communication with the electorate, we can evaluate the crisis panorama of our country. For a better evaluation, we can consider the number of businesses that operate in Albania, relative to the previous years. In the year 2009 are closed 30010 businesses and in the year 2011, are closed about 29000 businesses. It is difficult to understand if these businesses stopped the activity or stopped to be legal, but their closure reflects the difficulties to cover the expenses for their activity. One reason for this bankruptcy is that businesses have more difficulties in repaying bank loans. Especially the construction sector represents liquidity problems as a result of the contraction of lending to the economy in general, as well as consumer waver to invest. Even the export sector manifests liquidity problems due to delay in payments by foreign partners. Another reason is that banks are likely to be more careful in analyzing and give selected loans, while the interest rate has increased, particularly in euro. Significant rates of lending, has been associated with increased risk of credit default by customers. Regarding the conditions of lending, banks have tightened credit standards applied by the increasing demand for collateral, in relation to the size of the loan. Now businesses will need to possess larger amounts of real estate to enable the disbursement of credit by banks.

These are new challenges to afford by managers or business owners, in order to provide financial resources for investment. They must be reliable partners to banks, to customers, to suppliers and to all the other stakeholders, and this is why they have to afford ethical challenges, especially after losses, in order to be competitive and lucrative.

4. Ethics in Albanian SME-s

The role of ethics is incredibly important in the economy as a whole and particularly in the business activity. Ethics makes enterprises more responsible and enhances the performance of enterprises in the market. It also helps in building its social capital in the economy and helps the collaboration with other entities like government, civic society and other enterprises as well.

Public trust is increasingly crucial to business and society. The recovery from global economic crisis, in which the lack of trust has weakened the world financial system, highlights the importance of addressing the public trust in business. It is the interaction that

conveys to others the willingness on the part of one person to do something that is to the benefit of another person's health and well-being (Lyman, 2012). In this case, it is through the enterprises action and interaction that others can assess whether its activity is credible, reliable and fair.

Although individual firms may be free from such distrust, the general distrust of business hurts all companies, and, indeed, all participants in the global economy. So, concrete actions may be taken to address and improve public trust in business, considering both opportunities and threats in order for these actions to be effective. The concept of trust has attracted a good deal of attention and debate more broadly in the economy and thus the role of trust in commercial exchange has been considered widely in the literature (Nooteboom, 2002). It has been argued that trust can reduce transaction costs (Andaleeb, 1992), is a source of competitive advantage (Barney and Hansen 1994) and limits uncertainty and opportunism (Achrol, 1997). The three core dynamics of trust that managers must understand are: mutuality based upon shared values or interest; balance of power, sharing risks and opportunities by parties; trust safeguards that limit vulnerability.

From different studies, we have found that high-trust organizations have a strong sense of shared purpose; have employees who work together to support the same purpose; create positive cultures with high tolerance and cooperation; have coaching rather than managing leaders; have high participation in the decision making process.

Trust increases profitability and helps attracting and keeping qualified employees. The lack of trust lowers profitability, job satisfaction and commitment of employees.

The questionnaire conducted on small and medium size enterprises in Albania, underlies identified problems from outside and inside of the organization. From inside of the organization, the ethics in the workplace underlies an erosion of trust after the recent negative financial effects experienced by all these organizations. The managers of these companies, in 45% of the cases, have noticed hidden endeavors to find a new job, by the most qualified employees and in 65% of cases, the managers have approved that there have been a lack of transparent communication with employees during crisis. The reason for the lack of the transparency has been mainly not to panic about a potential business bankruptcy. Only 10% of SME-s managers have accepted to have lost qualified employees, especially in the construction sector. All these firms have laid off workers to reduce costs, averagely 20% of the overall workforce.

Form outside the organization, the reputation created is important for the other stakeholders which are the customers, suppliers, creditors, government, community and society at large. Reputation is now more important than ever as a result of an increasing number of laws that regulate the business, higher expectations from customers and the public in general about the way SME-s do business, and a business environment characterized by global expansion, technological advances, and increased competition. 85% of the enterprise managers in the focus of our study accept that they have conducted their businesses in compliance with all applicable laws and regulations but not completely in accordance with the highest ethical standards. They both claim to have used double balance sheets and have hidden income in order to pay less taxes to the state, taking into account the financial difficulties as a result of the crisis. Only 5% of these enterprises have a code of ethics and a clear policy to conduct the business according to the principles of the code. 95% of these managers do not have a clear

idea about why they are partners of choice and why they are locally accepted by the community. In 97% of cases, they do not have an ethical program that contributes to the enterprise's reputation for integrity and helps them increasing access to capital and credit.

Through a business ethics program, can be provided transactions cost reduction, which endows employees with clear guidelines on how to conduct their business in compliance with laws and ethic. It provides employees with clear guidelines on a host of daily transactions and everyone in business knows it is far easier to retain a loyal customer than to win one. During the last 5 years, the average loss of customers in all these SME-s is 45%. The full cost includes management effort to allocate time to work with officials, to maintain a second set of books, and to deal with the threat of extortion and blackmail. The real cost is the risk to reputation and pride in the enterprise and the reduced prospects for participating in a market economy.

Risk in all these businesses, even if it strives to comply strictly with the law, is subject to such as: Being exposed to criminal prosecution for bribing a government contracting officer in 90% of cases; Being debarred from government contracting or a strategic partnership for an inappropriate gift or gratuity in 30% of cases; Having to recall products for failure to follow quality standards and procedures in 10% of cases; Dealing with lost employee time for health and safety problems in 20% of cases.

The managers of these enterprises do not assess the above risks, establishing adequate standards and procedures, training, and monitoring and auditing systems. These processes can help owners and managers to plan, organize, and control the daily operations of an enterprise to minimize risks to its capital, earnings, and reputation. They include management of risks associated with accidental losses, as well as operational risks such as those arising from financial mismanagement, fraud and embezzlement, corruption, and loss of reputation.

5. Practices to be adopted by SME-s in Albania

Challenges to be afforded by SME-s in order to enhance business ethics are a lot. Enterprises must develop an ethical program, to help them giving adequate guidance to employees and agents, to ensure that they know what is responsible business conduct. By helping form reasonable expectations among its stakeholders, it minimizes disputes with customers and other stakeholders and increases stakeholder satisfaction. A business ethics program institutes procedures to detect and to prevent violations of the law and ethics.

A business ethics program is designed to establish standards and procedures to prevent and detect violations of the trust put in employees. Among these standards and procedures are processes to protect enterprise assets. These specific processes may include establishing standards and procedures, monitoring and auditing systems, and reporting mechanisms.

However, at the heart of a business ethics program is the desire of owners and managers to foster the commitment of their employees to the welfare of the enterprise as a whole. Fostering this sense of loyalty and commitment among employees and agents may be the most effective way in which a business ethics program protects the enterprise from disloyal employees.

Collaboration increases effectiveness and efficiency by enabling all stakeholders to work together closely on the basis of respect, shared values, and mutual trust. After a business

ethics program becomes a part of operations, many of the costs of monitoring and supervision can be reduced. Product quality may improve and transaction costs, such as contracting, may decline. Since, in the minds of most employees, ethics are essentially a matter of fairness a business ethics program often increases employee morale. Better morale leads to increased productivity and innovation. It strengthens the enterprise's competitive position in the market. The average SME, in general is closely identified with its owners and managers. Thus SMEs must be particularly alert to designing a well-balanced business ethics program. Often they will be tempted to work out the program on their own and to simply present it to employees and other stakeholders. They have limited resources and staff, and, after all, it is *their* enterprise. Though in many cultures workers expect to be told what to do and even what to think. A program is more quick to succeed where workers are involved enough in its design to feel committed to it and where workers are willing to use individual judgment to apply its standards to the issues they face. Owners and managers should, therefore, resist this temptation and engage their employees and other stakeholders as much as possible.

The essential function of any business is to identify and meet the most important needs of its customers. In a free market, it is only by serving customers well that the enterprise will survive and prosper over time. A good judgment must be used in evaluating the social impact of goods and services on customers and the community as a whole. The socially responsible business works hard and competes fairly. It does not abuse the public trust or degrade the environment, which we all rely on. As a participant in markets and a member of its community, the socially responsible business expresses its needs and concerns to government when appropriate. It avoids using its economic power to gain competitive advantage through political means.

6. Conclusions

To build and sustain trust at the most basic level, a business must manufacture and market quality products or services that are reasonably priced; provide steady jobs in safe and healthy environments; support community institutions serving employees and customers; and provide reasonable return on their investments.

Managers must create a set of values that define and clarify what is the enterprise and its people, and work to ensure that these values are adhered to consistently across your enterprise; Build and manage strong relationships based on mutual trust with mediating institutions; Embrace transparency; Work within the business sector to build trust in the sector; Re-invest in the trustworthiness of the business by making a commitment to enhance the core contribution that the firm makes to society;

Responsible business conduct addresses the issues of ethics, compliance with laws and regulations, and social responsibility. Businesses face these issues every day in a market economy. A business ethics program helps owners and managers ensure that their employees and agents comply with applicable laws and regulations. It also helps them minimize risk to the enterprise, enhance the enterprise's reputation, and bring value to stakeholders by adapting emerging global standards of responsible business conduct and best practices.

Small to medium-sized enterprises have an additional incentive to adopt the discipline of responsible business conduct: to create a wider commercial network. Where owners and

managers embrace the global language of responsible business through a business ethics program, a network of business enterprises and based on shared values is possible. Such a network allows the individual SME to develop some of the synergies and economies of scale that only larger enterprises can afford.

A good way to prove the reliability is, through an enhanced multilateral co-operation, especially between government and businesses and the sound international rules and regulators.

Bibliography

1. Achrol, R.S., (1997), "Changes in the Theory of Inter organizational Relations in Marketing: Toward a Network Paradigm", *Journal of the Academy of Marketing Science*, 25 (2): 56–71.
2. Andaleeb, S.S., (1992), "The Trust Concept", *Research Issues for Channels of Distribution*, *Research in Marketing*, 11: 1–34.
3. Barney, J.B. and Hansen, M.H. (1994), "Trustworthiness as a Source of Competitive Advantage", *Strategic Management Journal*, 15: 175–90.
4. Carroll, Archie and Buchholtz, Ann Thomson, (2003), "Business & Society: Ethics and Stakeholder Management", South-Western.
5. Ferrell, O.C. and Fraedrich, John Houghton, (2005), "Business Ethics" 6th ed., Ferrell Mifflin Company
6. INSTAT, (2014), "The structural survey of enterprises, 2012".
7. Johnson, Craig , (2007), "Ethics in the Workplace", Sage Publications.
8. Lyman, A., (2012), "The trustworthy leader: leveraging the power of trust in the human resource management profession", MIT Institute for Work & Employment Research, Cambridge:MA.
9. McAlister, Debbie and Ferrell, O.C., (2005), "Business and Society", Houghton Mifflin Company.
10. Nooteboom, B. (2002), "Trust: Forms, Foundations, Functions and Failures", Cheltenham: Edward Elgar Publishing.
11. OECD, (2012), "SME Policy Index: Western Balkans and Turkey 2012".
12. Trevino, Linda and Nelson, Katherine, (2007), "Managing Business Ethics" 4th ed., John Wiley & Sons.

**ROLI I AUDITIMIT NË ZBULIMIN E GABIMEVE NË PASQYRAT
FINANCIARE
THE ROLE OF AUDIT IN DETECTING ERRORS IN FINANCIAL
STATEMENTS**

Agim Kastrati¹, Bekim Berisha², Fatmir Mehmeti³

¹Universiteti Europian i Tiranës, Blv. “Gjergj Fishta”, Tiranë E-mail: akastrati7@hotmail.com

²Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti” Prizren, E-mail: b.bekimi@gmail.com

³Universiteti Europian i Tiranës, Blv. “Gjergj Fishta”, Tiranë E-mail:
fatmir_mehmeti@yahoo.com

ABSTRACT

One of the main objectives of the audit is to detect potential errors in the client's financial statements. This study aims to identify faults that are detected by auditors during auditing of financial statements. Ten audit firms are interviewed, in various cities of Kosovo, for the purpose of collecting data for errors found during the audit of the financial statements of their clients, for the period January-December 2012. The data obtained show that through the implementation of various audit procedures are found different type of errors which occur for various reasons ranging from lack of experience of clients personnel, insufficient knowledge of accounting principles and negligence.

Data from this study provide empirical support to previous studies. Researches undertaken by Hylas and Ashton (1982) have shown that the audit affects the detection of errors in the financial statements, which have occurred for various reasons.

The study provides knowledge that audit helps companies to eliminate errors which affect the accuracy and reliability of financial statements.

Keywords: Audit, Financial statements, Disclosure of errors

PËRMBLEDHJE

Ndër objektivat kryesore të auditimit është zbulimi i gabimeve të mundshme në pasqyrat financiare të klientit. Ky studim ka për qëllim të identifikojë gabimet të cilat zbulohen nga audituesit me rastin e auditimit të pasqyrave financiare. Kemi anketuar dhjetë firma audituese në qytete të ndryshme të Kosovës me qëllim të mbledhjes së të dhënave për gabimet e gjetura gjatë auditimit të pasqyrave financiare të klientëve të tyre për periudhën Janar-Dhjetor 2012.

Të dhënat e fituara tregojnë se përmes zbatimit të procedurave të ndryshme audituese janë gjetur gabime të natyrave të ndryshme të cilat kanë ndodh për shkaqe të ndryshme duke filluar nga mungesa e përvojës së personelit të klientit, mosnjohja e parimeve të kontabilitetit e deri te pakujdesia.

Të dhënat nga ky studim ofrojnë mbështetje empirike të studimeve të mëhershme. Hulumtimet e bëra nga Hylas dhe Ashton (1982) kanë treguar se auditimi ndikon në zbulimin e gabimeve në pasqyrat financiare, të cilat kishin ndodhur për shkaqe të ndryshme.

Studimi ofron njohuri se auditimi ndihmon ndërmarrjet në përmirësimin e gabimeve duke ndikuar kështu në paraqitjen e gjendjes së saktë dhe të besueshme në pasqyra financiare.

Fjalët çelës: Auditimi, Pasqyrat financiare, Zbulimi i gabimeve

HYRJE

Objektivi kryesor i auditimit të pasqyrave financiare të klientëve është dhënia e një opinionit në lidhje me pasqyrat financiare nëse ato paraqesin realisht, në të gjitha aspektet materiale, gjendjen financiare të klientit. Kusht për të qenë këto pasqyra financiare reale duhet të jenë pa gabime materiale. Detyrë e auditorit është që duke zbatuar procedurat e nevojshme audituese të bëjë verifikimin e saktësisë së zërave të pasqyrave financiare në mënyrë që të bind veten se ato pasqyra janë pa gabime materiale. Për të arritur qëllimin e tij audituesi bënë planifikimin e punës së tij duke u bazuar në vlerësimet e tij që do të bëjë mbi funksionimin e kontrollit të brendshëm, në informatat që ka në lidhje me mënyrën e funksionimit të klientit si dhe në gjykimin profesional të audituesit e cila bazohet në përvojën e audituesit bazuar në punën e tij profesionale me klientët e lëmisë së njëjtë. Njohurit që i merr nga biseda me stafin e klientit gjithashtu shërbejnë si pikënisje se ku mund të gjenden gabimet eventuale në pasqyrat financiare të klientit. Të gjitha këto i shërbejnë audituesit që të përcaktojë procedurat dhe teknikat audituese në mënyrë që të përfitojë informata të duhura se pasqyrat financiare janë të pastra nga gabimet materiale.

Në këtë punim janë analizuar gabimet e gjetura nga audituesit në raste të ndryshme të raportuara nga auditimet e njësisë ekonomike të bëra me ç'rast janë raportuar gabimet e zbuluara në pasqyra financiare. Pyetëtori ynë ka qenë i konceptuar ashtu që për të gjitha gabimet e zbuluara të përshkruhen ngjarjet inicuese që ka ndikuar në zbulimin e gabimit dhe

zërin e pasqyrave financiare ku është gjetur gabimi. Gjithashtu janë raportuar edhe procedurat audituese të cilat janë përdorur me rastin e zbulimit të gabimit si dhe në çdo rast është përshkruar edhe shkaku i gabimit të ndodhur.

Studime në këtë lëmi kanë bërë Hylas & Ashton (1982), dhe kanë arritur në përfundim se pritjet e auditorëve bazuar në gabimet e gjetura në auditimet e viteve të mëparshme mundësojnë zbulimin e një numri të konsiderueshëm të gabimeve në pasqyra financiare.

Chen & Leitch (1999) dhe Dzeig (1994), kanë përfunduar se procedurat analitike sinjalizojnë audituesin në drejtim të gjetjes së gabimeve në pasqyrat financiare të klientit. Austen, Elifsiën & Messier (2003) në studimin e tyre gjithashtu kanë arritur në përfundim se problemet e personelit si mungesa e përvojës, jo kompetenca, pakujdesia etj. kanë ndikim signifikant në shfaqjen e gabimeve në pasqyra financiare.

1. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E STUDIMIT

Objektivi i parë ka qenë që të krijohet një evidencë empirike në lidhje me ngjarjet inicuese që ndikojnë në zbulimin e gabimeve në pasqyra financiare të njësisë ekonomike të audituara.

Të krijohet një evidencë empirike në lidhje me procedurat audituese të cilat janë zbatuar me rastin e zbulimit të gabimeve në pasqyrat financiare të klientëve të audituar.

Të bëhen të dituar shkaqet të cilat kanë ndikuar në ndodhjen e gabimeve në pasqyrat financiare të klientëve të audituar duke u ndalur natyrisht në gabimet e paqëllimta sepse nëse ato janë të qëllimshme atëherë kemi të bëjmë me mashtrime.

Të kontribuoj në përgjithësi sensibilizimin e opinionit në lidhje me rolin e auditimit në rritjen e besueshmërisë së pasqyrave financiare të audituara.

2. PYETJA KËRKIMORE DHE HIPOTEZAT E PUNIMIT

Hipotezat e këtij studimi bazohen në gjetjet e studimeve të mëparshme nga kjo lëmi si dhe në përvojën tonë në fushën e studimit. Këto hipoteza janë si në vijim:

H1=Pritjet nga auditimet e mëparshme dhe procedurat analitike a kanë rol të rëndësishëm në sinjalizimin e gabimeve?

H2=Problemet me personelin a kanë ndikim direkt në shfaqjen e gabimeve në pasqyra financiare?

Bazuar në këto hipoteza është hartuar pyetësori i cili është dërguar në adresë të dhjetë firmave vendore të auditimit në Kosovë për auditimet e vitit 2012 me ç'rast audituesit janë lutur të përgjigjen në pyetësorin e përgatitur në lidhje me gabimet e zbuluara gjatë auditimit.


Me anë të pyetësorit është kërkuar që të jepen përgjigje në këto grupe pyetjesh:

- a) ngjarja inicuese që ka ndikuar në zbulimin e gabimit,
- b) procedurat audituese të zbatuara në atë rast,
- c) zëri i pasqyrave financiare ku ka ndodhur gabimi,
- d) shkaku i gabimit si dhe
- e) të dhënat lidhur me madhësinë e klientit, lëmin në të cilën operon, dhe shënime tjera lidhur me klientin, duke mos zbuluar me këtë rast identitetin e klientit të audituar.

Nga dhjetë firma audituese gjashtë prej tyre janë përgjigjur kërkesës sonë të cilat kanë raportuar nga 54 auditime të bëra në të cilat në 32 prej tyre janë gjetur gabime, duke raportuar 68 gabime të zbuluara në pasqyrat financiare të klientëve të tyre.

Njësitë ekonomike të audituara nga të cilat janë raportuar gabimet janë nga lëmi të ndryshme dhe janë paraqitur në figurën në vijim:

Fig. 1



Nga njësitë ekonomike të audituara 8 (tetë) prej tyre janë të angazhuara në lëmi prodhuese, 7 (shtatë) sosh janë të angazhuara në ndërtimtari, shtatë (7) në shërbime, 6 (gjashtë) në tregti dhe lëmi të tjera 4 (pesë) sosh.

3. ANALIZË, INTERPRETIM TË DHËNASH

Procedurat audituese, ngjarjet inicuese apo rrethanat të cilat kanë ndihmuar audituesit për të zbuluar gabimet në pasqyrat financiare janë klasifikuar si në vijim: (1) pritjet nga auditimet e mëparshme, (2) procedurat analitike, (3) informatat nga klienti, (4) testet thelbësore, (5) konfirmimet dhe (6) procedura tjera.

Gjykimi profesional i audituesit bazohet në përvojën e tij dhe njohuritë që ka në profesion si dhe në pritjet e gjetjeve nga vitet e kaluara të cilat ndikojnë që audituesi të orientohet më lehtë aty ku mund të gjenden gabimet në pasqyra financiare.

Procedurat analitike janë procedura audituese të cilat bëhen në fazën e planifikimit të auditimit si dhe në fazat e mëvonshme të cilat i japin informacione audituesit se ku mund të ketë gabime eventuale. Këto procedura kanë të bëjnë me krahasimin e zërave të pasqyrave financiare të vitit vijues me vitin paraardhës si dhe krahasimin e të dhënave financiare me mesataren e industrisë në të cilën vepron klienti.

Informatat nga klienti të cilat fitohen nga biseda me stafin lidhur me ecurinë e afarizmit, problemet e klientit me të cilat ballafaqohet gjatë punës etj. ndikojnë që audituesi të ketë sinjale se ku mund të gjenden gabimet eventuale

Faktorët të cilët kanë ndikuar në paraqitjen e gabimeve në pasqyrat financiare të klientëve të audituar janë ndarë si në vijim: (1) pamjaftueshmëria e njohurive profesionale në fushën kontabilitetit, (2) vlerësim apo gjykim i gabuar, (3) gabimet akruale, (4) kontrolli i brendshëm joadekuat, (5) gabimet teknike, (6) problemet tjera

Kategoria e parë përfshin gabimet e bëra për mungesë të njohurive profesionale të stafit si rezultat i ngritjes së pamjaftueshme profesionale të personelit të angazhuar në kontabilitet. Kjo ka ndikuar në njohuritë e kufizuara të parimeve kontabël dhe aplikimin e gabuar të politikave kontabël me rastin e regjistrimeve kontabël dhe gjatë përpilimit të pasqyrave financiare të tyre. Në këtë kategori kanë hyrë edhe gabimet nga pakujdesia e stafit të angazhuar në punët e kontabilitetit

Kategoria e dytë e gabimeve që ka të bëjë me gabimet në vlerësim apo gjykim, ka të bëjë me gabimet rreth vlerësimit të llogarive të arkëtueshme të pa mbledhshme, shlyerjes së inventarit dhe detyrimeve kontingjente.

Gabimet akruale kanë të bëjnë me gabimet e prerjeve të fundvitit me të cilin rast transaksionet nuk janë paraqitur në periudhën në të cilën kanë ndodhur. Këtu para së gjithash bëhet fjalë për shpenzimet e parapaguara të cilat duhet të shpërndahen në periudha kur kanë ndodhur.

Gabimet për shkak të mungesës së procedurave adekuate të kontrollit dhe të rishikimit kanë të bëjnë me gabime në rikoncilime, në llogaritjen e vjetërsisë së llogarive të arkëtueshme etj.

Gabimet teknike kanë të bëjnë me gabimet gjatë kalkulimeve dhe llogaritjeve të ndryshme të bëra nga stafi i punësuar në punët e kontabilitetit.

Gabimet e raportuara nga auditimet e bëra janë paraqitur në Tab.1 dhe nga 54 auditime janë raportuar gjithsej 68 gabime materiale.

Tab 1
Gabimet materiale të raportuara*

Nr.	Nr i auditimeve	Nr. i gabimeve	Kumulativi	%
1	22	0	0	40.74
2	16	1	16	29.63
3	6	2	12	11.11
4	4	3	12	7.41

5	3	4	12	5.56
6	2	5	10	3.70
7	1	6	6	1.85
	54		68	100.0

*Gabim material është gabimi vlera e të cilit ka ndikim në vendimmarrjet e shfrytëzuesve të informatave nga pasqyrat financiare të klientëve të audituar.

Në 16 raste të auditimeve apo në 29.63% të auditimeve të raportuara janë gjetur nga një gabim për secilin rast të auditimeve të raportuara.

Gjashtë auditime kanë rezultuar me nga dy gabime për secilin auditim që paraqet gjithsej 11.11% të totalit të auditimeve të raportuara.

Katër auditime të raportuara kanë rezultuar me nga tre gabime materiale për secilin që në total paraqesin 7.41% të totalit të auditimeve të raportuara.

Janë gjithsej gjashtë auditime të raportuara me nga 4-6 gabime materiale të raportuara që në total paraqesin mbi 11% të auditimeve të raportuara.

Nga numri i tërësishëm i auditimeve në 22 prej tyre nuk janë gjetur gabime materiale që gjithsej paraqet 40.74% të totalit të auditimeve të raportuara.

Procedurat audituese, ngjarjet inicuese apo rrethanat të cilat kanë ndihmuar audituesit për të zbuluar gabimet në pasqyrat financiare janë paraqitur në tabelën vijuese:

Tab.2

Nr.	Përshkrimi	Gabimet e gjetura	%
1	Pritjet nga auditimet e mëparshme	22	32.35
2	Procedurat analitike	18	26.47
3	Informatat nga klienti	5	7.35
4	Testet thelbësore	12	17.65
5	Konfirmimet	4	5.88
6	Procedurat tjera	7	10.29
	Gjithsej	68	100.00

Nga tabela shihet se ngjarjet që kanë ndihmuar audituesin të zbuloj gabimet në përqindje më të madhe janë gjykimi profesional i audituesit lidhur me pritjet nga auditimet e mëparshme dhe procedurat analitike të aplikuara nga audituesit të cilat në total paraqesin 58.82% të të gjitha gabimeve të zbuluara. Nga sa u tha më lartë mund të konkludojmë se është vërtetuar hipoteza e parë:

H1=Pritjet nga auditimet e mëparshme dhe procedurat analitike a kanë rol të rëndësishëm në sinjalizimin e gabimeve?

Në Tab 3 janë prezantuar gabimet e raportuara sipas fushave të auditimit në të cilat janë gjetur gabimet materiale dhe sipas lëmisë në të cilin vepron klienti i audituar.

Tab 3

N r.	Fusha audituese	Nr. i gabimev	%	Prodhuese %	Ndërti more %	Shërbi me %	Tregtare %	Tjera %
1	Pasuritë fikse	9	13.24	8.33	14.29	20.00	12.50	20.00
2	Stoqet	5	7.35	16.67	0.00	0.00	12.50	0.00
3	Llogarit e arkëtueshme	8	11.76	12.50	9.52	10.00	12.50	20.00
4	Cash-i	11	16.18	8.33	14.29	30.00	25.00	20.00
5	Te hyrat	12	17.65	20.83	19.05	10.00	12.50	20.00
6	Shpenzimet e parapaguara	7	10.29	12.50	14.29	0.00	12.50	0.00
7	Tatimet	8	11.76	8.33	14.29	10.00	12.50	20.00
8	Blerjet	6	8.82	12.50	9.52	10.00	0.00	0.00
9	Detyrimet kontingjente	2	2.94	0.00	4.76	10.00	0.00	0.00
	Gjithsej	68	100.0	100.00	100.00	100.00	100.00	100.0
	Nr. i gabimeve			24	21	10	8	5
	Nr. i auditimeve			8	7	7	6	4

Në zërin e të hyrave janë raportuar 20.83% të gabimeve të gjetura nga gjithsej 24 gabimet e raportuara në këtë fushë industriale. Ndërmarrjet shërbyese kanë përqindjen më të madhe në pjesëmarrje në grupin e tyre në gabimet e gjetura në zërin e parasë së gatshme (30%).

Gabimet e raportuara sipas fushave të auditimit dhe madhësisë së klientëve të audituar janë prezantuar në Tab 4 si në vijim:

Tab 4

Nr.	Fusha audituese	Nr. i gabimeve	Kompanitë sipas madhësisë		
			Të hyrat < 2.1	Të hyrat 2.1 - 4	Të hyrat > 4
1	Pasuritë fikse	9	4	3	2
2	Stoqet	5	1	2	2
3	Llogarit e arkëtueshme	8	3	2	3
4	Cash	11	4	4	3
5	Te hyrat	12	5	4	3
6	Shpenzimet e parapaguara	7	3	2	2
7	Tatimet	8	2	3	3
8	Blerjet	6	3	1	2
9	Detyrimet kontingjente	2	0	1	1
	Gjithsej gabimet	68	25	22	21
	Auditimet me gabime të gjetura	32	10	11	11
	Auditimet pa gabime të gjetura	24	9	8	7

Nga tabela vërehet se kompanitë më të mëdha kanë numër më të vogël gabimesh në proporcion me kompanitë e mesme dhe të vogla me numër të përafërt auditimesh.

Faktorët të cilët kanë ndikuar në paraqitjen e gabimeve në pasqyrat financiare të klientëve të audituar janë prezantuar në Tab 5 si në vijim:

Tab 5

Nr.	Përshkrimi	Nr. i gabimeve	%
1	Mungesa e njohurive profesionale	21	30.88
2	Vlerësim /gjykim i gabuar	8	11.76
3	Gabimet akruale	14	20.59
4	Kontrolli i brendshëm joadekuat	12	17.65
5	Gabimet teknike	7	10.29
6	Problemet tjera	6	8.82
	Gjithsej	68	100.00

Mungesa e njohurive profesionale të personelit paraqet përqindjen më të madhe të shkaqeve të gabimeve të gjetura nga ana e audituesve të pasqyrave financiare (30.88%), dhe pasohen me gabimet akruale të cilat janë raportuar në 14 raste ose 20.59% të gabimeve të raportuara.

Nga sa u tha më lartë vijmë në përfundim se është vërtetuar hipoteza e dytë:

H2=Problemet me personelin a kanë ndikim direkt në shfaqjen e gabimeve në pasqyra financiare?

DISKUTIM

Të dhënat e këtij studimi vërtetojnë se pritjet e audituesit nga auditimet e viteve të mëparme që bazohen në përvojën profesionale të tij paraqesin orientimin kryesor në drejtim të zbulimit të gabimeve në pasqyrat financiare të klientit të audituar. Mbi 32% e gabimeve të raportuara janë iniciuar nga pritjet e audituesit nga auditimet e viteve të mëparme me klientin ekzistues. Kinney (1979), ka gjetur se pritjet nga vitet e kaluara paraqesin sinjal të besueshëm në drejtim të gabimeve të mundshme. Hylas & Ashton (1982), kanë ardhur në përfundim se pritjet e

auditorëve bazuar në gabimet e gjetura në auditimet e viteve të mëparshme të klientit mundësojnë zbulimin e një numri të konsiderueshëm të gabimeve në pasqyra financiare.

Procedurat analitike gjithashtu kanë një rol të veçantë në sinjalizimin e gabimeve në pasqyra financiare dhe sipas raportimeve nga auditimet e raportuara ato kanë mundësuar zbulimin e mbi 26% të gabimeve të raportuara. Studimet e mëparshme e mbështesin këtë konstatim, ashtu që Chen & Leitch (1999) dhe Dzeig (1994), kanë përfunduar se procedurat analitike sinjalizojnë audituesin në drejtim të gjetjes së gabimeve në pasqyrat financiare të klientit. Austen, Elifisien & Messier (2003) në studimin e tyre kanë ardhur në përfundim se procedurat analitike, diskutimet me personelin dhe pritjet nga vitet e kaluara, së bashku kanë mundësuar zbulimin e 29% të gabimeve të raportuara që është përqindje më e vogël se sa zbulimi i gabimeve përmes testeve thelbësore.

Procedurat tjera që kanë mundësuar zbulimin e gabimeve janë sipas radhës testet thelbësore dhe se ato sigurisht se nuk duhet anashkaluar me rastin auditimit të pasqyrave financiare në drejtim të kërkimit të gabimeve të mundshme në pasqyra financiare.

Lidhur me shkaqet e gabimeve gjetjet nga ky punim tregojnë se mbi tridhjetë përqind e gabimeve të raportuara kanë të bëjnë me mungesën e njohurive profesionale në fushën e kontabilitetit. Studimet e mëhershme kanë përfundime të ngjashme, ashtu që Mautz, Reilly & Maher (1979), kanë gjetur se problemet me personelin janë shkaqet kryesore të gabimeve në pasqyra financiare. Austen, Elifisien & Messier (2003) në studimin e tyre gjithashtu kanë ardhur në përfundim se problemet e personelit si mungesa e përvojës, jo kompetenca, pakujdesia etj. kanë ndikim signifikant në shfaqjen e gabimeve në pasqyra financiare.

Zëri i pasqyrave financiare në të cilin janë raportuar më së shumti gabimet e gjetura nga audituesit është zëri i të hyrave si dhe më pastaj sipas numrit të gabimeve pasojnë paraja e gatshme dhe pasurit e prezantuara në pasqyrat financiare të klientëve të audituar. Studimet e mëhershme gjithashtu kanë përfundime të ngjashme pasi që të hyrat janë zëri i pasqyrave ku më së shumti hasen gabimet. Kështu Hulas & Ashton në studimin e cituar më lartë, kanë ardhur në përfundim se më së shumti gabime janë zbuluar në sferën e të hyrave (16% e gabimeve totale).

PËRFUNDIM / REKOMANDIME

Rezultatet e këtij punimi tregojnë se shumica e auditimeve rezultojnë me gjetje të gabimeve në pasqyra financiare. Procedurat fillestare të cilat i kanë sinjalizuar audituesit për ekzistimin e gabimeve në pasqyra financiare janë pritur nga vitet e kaluara, biseda me personelin dhe procedurat analitike. Nuk duhet anashkaluar edhe rolin e testeve thelbësore në zbulimin e gabimeve materiale në pasqyra financiare.

Të hyrat si fushë e auditimit paraqesin sferën ku më së shumti janë raportuar gabimet dhe kemi të bëjmë me të hyra më të vogla të raportuara por ka raste edhe me gabime duke raportuar të hyra më të mëdha se ato që kanë qenë reale. Më pastaj sipas gabimeve të raportuara paraja e gatshme dhe pasuritë e klientëve paraqesin zërat e pasqyrave financiare ku më së shpeshti raportohen gabime të gjetura me rastin e raportimit financiar të njësive ekonomike.

Lidhur me hulumtimin e shkaqeve të gabimeve në pasqyra financiare rezultatet e këtij punimi në rend të parë kanë gjetur problemet lidhur me personelin i cili është i angazhuar në profesionin e kontabilitetit. Këtu para së gjithash paraqiten problemet me njohuritë e mangëta të personelit në fushën e kontabilitetit, jo kompetenca dhe mungesa e përvojës etj. Si rezultat i kësaj janë paraqitur gabimet e shumta edhe gjatë regjistrimit të akrualeve në kontabilitetin e klientëve të audituar.

Rekomandojmë që shoqatat profesionale të organizojnë trajnime për kontabilistët e njësive ekonomike ashtu që stafi profesional të merr njohuri të nevojshme në lidhje me standardet e kontabilitetit dhe njohuritë tjera në fushën e kontabilitetit.

Rekomandojmë që menaxhmenti i subjekteve ekonomike të punësojë staf profesional të duhur në punët e kontabilitetit dhe ti mundësojë atij stafi pjesëmarrje në trajnime nga fusha e kontabilitetit në mënyrë që të përcillen rrjedhat aktuale në këtë lëmi dhe stafi të jetë në vazhdimësi i njoftuar për legjislacionin në fuqi dhe të rejtat në fushën e kontabilitetit.

REFERENCAT

- Mautz, R. K., Reilly, R. R. & Maher, M. V. (1979) "Personnel Failure: The Weak Link in Internal Control" *Financial Executive*, pp 22-25.
- Hylas, R.E. & Ashton, R.H. (1982) 'Audit detection of financial statement errors', *The Accounting Review* (October), pp. 751-65.
- Kreutzfeldt, R.W. & Wallace, W.A. (1986) 'Error characteristics in audit populations: Their profile and relationship to environmental factors', *Auditing: A Journal of Practice & Theory* (Fall), pp. 20-43.
- Wright, A. & Ashton, R.H. (1989) 'Identifying audit adjustments with attention-directing procedures', *The Accounting Review* (October), pp. 710-28

- Entwistle, G. & Lindsay, D. (1994) 'An archival study of the existence, cause, and discovery of income-affecting financial statement misstatement', *Contemporary Accounting Research*, 11 (Summer), pp. 271-96.
- Bell, T. & Knechel, W.R. (1994) 'Empirical analyses of errors discovered in audits of property and casualty insurers', *Auditing: A Journal of Practice & Theory*, 13 (Spring), pp. 84-100.
- Maletta, M. & Wright, A. (1996) 'Audit evidence planning: an examination of industry error characteristics', *Auditing: A Journal of Practice & Theory* (Spring), pp. 71-86
- Chen, Y. and R.A. Leitch (1998) "The Error Detection of Structural Analytical Procedures: " *Auditing: A Journal of Practice and Theory*, Vol. 17, No. 2, Fall 1998, 36-70.
- Kinney, Jr., W.R. (2000) 'Discussion of "Research on the nature, characteristics, and causes of accounting errors: The need for multi-method approach"' *Journal of Accounting Literature* 19, pp. 93-101.
- Eilifsen, A. & Messier, Jr., W.F. (2000) 'The incidence and detection of misstatements: A review and integration of archival research', *Journal of Accounting Literature*, 19, pp. 1-43.
- Caster, P., D.W. Massey, & Wright, A.M. (2000) 'Research on the nature, characteristics, and causes of accounting errors: The need for a multi-method approach', *Journal of Accounting Literature* 19, pp. 60-92.
- Austen, L. Eilifsen, A. & Messier, Jr. W. F. (2003)" Auditor detected misstatements and the effect of information technology" Institute of Accounting, Auditing and Law. Norwegian School of Economics and Business Administration
- Bunget, O. C., (2009), "The role of financial auditor in detecting and reporting fraud and error" MPRA Paper No. 12888.

DISTRIBUIMI DHE SHITJA E VERËRAVE NË TREGUN TURISTIK NË KOSOVË

Dr.Sc.Hamëz Rama
Profesor në kolegjin ISPE,
UÇK p.n
21010 Rahovec, Kosovë,
hamezrama@hotmail.com

Abstrakt

Kosovën viteve të fundit e vizitojnë një numër të madhë turistësh me një kulturë të lartë në konsumin e verërave. Rritja e vazhdueshme në zgjerimin dhe ngritjen e kultures në konsumin e verërave bëhet gjithnjë e më e kërkuar nga mysafirët, shitja dhe ofertat e verërave në Kosovë është gjithnjë në zhvillimin kreativ duke i plotësuar kërkesat e mysafirve në turizmin e verërave. Kosova njihet me trashigimi kulturore në kultivimin e hardhisë së rrushit dhe prodhimit të verërave, e cila i ka parakushtet e shkëlqyeshme pedologjike dhe klimaterike në kultivimin e rrushit dhe prodhimin e verërave. Vlenë të theksohet se në Kosovë është rritur për lakmi prodhimi i verërave, si në aspektin sasior poashtu edhe në aspektin cilësor. Prandaj , qëllimi dhe objektivi i këtij punimi është hulumtimi i prodhimit dhe oferta e verërave , prezantimi, promovimi, distribuimi i verërave në tregun turistik kosovar. Prandaj në këtë kontekst do të vendosim hipotezën që do të pretendojmë për të arritur efekte të mira, në vendosjen e korrelacionit midis aplikimit e formave të reja të distribuimit si instrument i marketingut MIX dhe shitjes së verërave. Hipoteza e cekur më sipër hulumton në rastin, në distribuimin dhe shitjen e verërave në tregun turistik në Kosovë. Për qëllim të këtij studimi janë shfrytëzuar metodat e anketimeve, intervistave , metodat statistikore , etj. Përmes anketimit dhe intervistave janë hulumtuar qëndrimet, idetë dhe mendimet e të anketuarve në prodhimtarinë , ditribuimin dhe shitjen e verërave në tregun turistik në Kosovë. Me metodat statistikore janë hulumtuar veqanarisht tendencat, rregullsinë dhe respektimi i ligjshmërisë në fushën e distribuimit dhe në shitjen e verërave në tregun turistik në Kosovë.

Fjalët kyqe: *distribuimi, shitja, vera, turizmi, tregu turistik në Kosovë.*

1. HYRJE

Vera si produkt në Kosovë çdoherë është konsideruar si pije të cilën asnjëri nuk ka mundur ta përballoj, dhe është konsideruar si pije që i ka takuar shtresës së lartë aristokrate marrë parasysh kushtet ekonomike, fuqia blerëse e konsumatorve, pozita shoqërore e individve, etj.Me zhvillimin e shoqërisë brenda kohësh kjo çështje ka evalouar, do të thotë, prodhimi dhe konsumimi i verës shëndrohet në pjesë përbërse e jetës një pjese relativisht të

madhe të popullates dhe shoqërisë kosovare nëpërgjithësi , dhe, çdo individ i justifikon nga ajo gota e tij e mbushur me verë se ka shije dalluese. Verërat klasifikohen si pas performancave bazë të përcaktuara. Mund të klasifikohen si verërat në kuptimin e ngushtë dhe verërat speciale. Verërat në kuptimin e ngushtë të fjalës, ndahen : në verërat e pazazuara(verërat e qeta), verërat shkumbëzuese, verërat margaritare(kulminante), dhe verërat e pazazuara. Verërat speciale janë : verërat deserte, verërat të aromatizuara dhe verërat të likerizuara. Verërat si pas ngjyrës ndahen: verërat e bardha, verërat rose, verërat e kuqe. Si pas cilësive të tyre, verërat ndahen : në verërat të tryezës, verërat cilësore me prejardhje gjeografike, verërat kulminante me prejardhje gjeografike.

Nga vera kërkohet që të jetë e pastër e shëndosh dhe ekologjike , e pastër në aspektin toksikologjik dhe e pastër natyrale , ndërsa për konsumatorin të jetë me një shije të këndshme. Në kontekstin e dëshirave dhe kërkesave nga ana e konsumatorve , kërkesat vazhdimisht porriten për krijimin e shijes nga më të ndryshme të verërave të cilat do të ishin shumë interesante, si për konsumator poashtu edhe për adhuruesit të verërave. Vlen të theksohet se në trend janë verërat gjysëm të ëmbla dhe të ëmbla të cilat kanë shenuar kërkesat dhe rritje e madhe në konsum gjegjësisht në shitje në Gjermani, që tradicionalisht konsumohet birra me të madhe. Njohësit e tregut dhe ekspertët të verërave në Kosovë në bazë të hulumtimeve, analizave dhe diagnostifikimit të tregut të verërave në Kosovë, konstatojnë se përkundër rënjes së importit të verërave në Kosovë , konkurrenca vazhdimisht punon me metodat më profesionale dhe bashkohore të marketingut, arrinë të mbajnë prezencën e verërave të tyre në theks të veçantë janë verërat nga plantacionet e “13 Juli” nga Mali i Zi , si: Vranac, Prokordia, etj pastaj nga Maqedonia, si “ Skovin” , “ Bovin”, “ Tikvesh “, etj. pastaj nga Slovenia “ Vipava”, pastaj Franca, Italia, Spanja, etj. Nga vitet paraprake shenohen trendet e rritjes së prodhimit të verërave, si pas indikatorve nga MBPZHR dmth rreth 16 mil. litra verë të cilat janë nga të dy sektorë, ai formal dhe informal, ndërsa vlen të ceket se në rajonin jug të Kosovës egzistojnë edhe mjaftë prodhuesit të vegjel(mini bodrumet) nga sektori jo formal që nuk janë të licencura të cilat me metodat dhe format e tyre të shitjes mundohen të plasojnë në treg të brishtë të Kosovës ku mundësia është shumë e vogël e absorbimit të produkteve të verërave në raport me kapacitetet prodhuese dhe prodhimin vjetor. Me këtë logjik kjo veprimtari paraqet hulumtimet dhe mnyrat për logjistik, format e shpërndarjes gjegjësisht distribuimit dhe shitjen e verërave kosovare në tregun turistik në Kosovë ku po shenohen trendet e rritjes së shitjes në këtë segment të tregut.

2. HISTORIKU DHE PRODHIMI VERËRAVE NË KOSOVË

Vera në kohën e mesjetës dhe në kohën iliro-pellazge është prodhuar në mënyrë shumë primitive, rrushi është ndrydhë me këmbë dhe vera është bartur nga një vend në tjetër me enë që janë punuar nga lëkura dhe prej dheut.

Historia e zhvillimit të vreshtarisë është bashkudhëtare e historisë së zhvillimit të shoqërisë njerëzore. Duke filluar nga koha iliro-pellazge, kur njeriu i rajonit vreshtar u vendos në vendbanimin e tij të përhershëm, hardhia ishte ndër bimët e para që i u afrua pranë shtëpisë.

Rajoni vreshtar – verëtar jug i Kosovës, i njohur për rrush e verë cilësore, ngërthen një territor që shtrihet midis gjerësisë gjeografike veriore 42 shkallë e 17 minuta e 42 shkallë e 29 minuta dhe 20 shkallë e 31 minuta e 23 shkallë e 21 minuta, gjatësisë gjeografike lindore, në Pellgun e Prizrenit të Rrafshit të Dukagjinit. Ky rajon i njohur në Antikë dhe në tërë Mesjetën, sipas listës së emrave gjeografikë të Zetës mesjetare, zë hapësirën përreth rrjedhës qendrore të lumit Drini i Bardhë; prej fshatit Kramavik nëpër të gjitha fshatrat e anës së majtë të rrjedhës së Drinit kah Ura e Fshejtë e Ura e Landovicës deri te fshati Korishë, në drejtim të Suharekës, rrëzë Podgurit e së andejmi kah fshatrat: Peçan, Semetisht, Dobërdelan, Samadragjë, bri fshatit Shkozë , Zatriq, Guri i Kuq e Kaznik deri te Kramaviku.⁴⁰

Ndërsa, në gjithë territorin e Kosovës vlerësohet se janë 4965 vreshtarë (fermerë), të cilët e kultivojnë rrushin në një sipërfaqe prej 3170.27 hektarë, ku varietetet për prodhimin e verës kultivohen në një sipërfaqe prej 2455.82 ha., rrushi i tryezës në një sipërfaqe prej 712 ha. dhe rrushi për tharje në një sipërfaqe prej 2.45 ha., si dhe 7.7 mil. litra verë më 2013.

Nr. Rend.	P ë r s h k r i m i	Nj.matëse	Fermer 2013	Sipërfaqe 2013	Prodhimi verërrave 2013
1.	Vreshtarët	Ek. familjare	4965		
2.	Vreshtat me varietete për verëra	ha		2455.82	
3.	Vreshta me varietete për tryezë	ha		712	
4.	Vreshta me varietet për tharje	ha		2.45	
5.	Prodhimi vjetor i verërave 2013	lit.			7.682.425
	T o t a l :		4965	3170.27	7.682.425

Potenciali prodhues i fermerëve, sipërfaqet me vreshta dhe prodhimi i verërave në Kosovës⁴¹

3.QASJET SHKENCORE NË TREGUN TURISTIK NË KOSOVË

Duke pasur parasysh resurset dhe kapacitetet prodhuese në Kosovë, prodhimi i verërave tejkalon konsumin në Kosovë, dhe si refleksion i kësaj është e domozdoshme që të zhvillohen disa teknikat ose metodat më bashkohore të cilat stimulojnë rritjen e shitjes së verërave sidomos në tregun turistik në Kosovë. Në bazë të disa informatave shkencore mund të konkludohet se konsumi i verës në Evropë, sidomos në Mesdhe nuk është zhvilluar sa duhet, pavarësisht historisë së gjatë të prodhimit të verës. Edhe pse Kosova nuk ka një traditë të gjatë në turizmin e verërave, tani është e pashmangshme dhe përcaktuese e imazhit e saj në turizëm për shkak të rritjes së konkurrencës dhe trendet e reja në shitjen e verërave në Kosovë .

⁴⁰ Prof. Dr. Sabahudin Cena, Përmbledhje punimesh nga simpoziumi i V dhe VI në Kosovë, Prishtinë, 2005 f 15

⁴¹ Burimi:Enti i V.V, MBPHR Prishtinë , Shënimet Statistikore Rahovec, Janar 2014

Bota gjithnjë bëhet më e vogël dhe egziston një akses i lehtë në informata . Sot turistët kanë ndrrshuar, kjo vlen edhe për turistët perendimor poashtu edhe turistët tonë vendor. Paratë e veta do të shpenzojnë atje ku ofrohet diçka më interesante dhe më ndryshe. Diçka ku nuk ka në vendin e vetë apo në shtëpinë e tij. Pikërisht këtu lind diçka për zhvillimin e turizmit të verërave dhe formave më specifike të turizmit, diçka lokale,që ka trashigimi kulturore, tradicionale, dhe kulminante !Pra , Verën ?³

Prodhuesit e vegjel europian të cilët shesin verërat konsumatorve të drejtpërdrejt nga pronsia e tyre , nuk mendojnë që edhe ata janë të kyqur në turizmin e verës dhe konsiderojnë që kjo veprimtari është e rezervuar për prodhuesit e mëdhej të cilat mund të organizojnë pritjet – turat për visitor gjegjesisht turistat , ekspozitat , panairret dhe eventet e ndryshme që lidhen me verën. Ky supozim meriton hulumtimet e mëtutjeshme . Psh. Hulumtimet në Francë flasin për prezantimin e regjioneve shfrytëzohet lidhjet në mes të ushqimit dhe verës që janë më shumë të shprehura se sa vera me aktivitetet turistike.⁴

Edhe në Kosovë prodhuesit e vegjel në kantinat e tyre duhet të kenë parasysh se janë pjesë e turizmit të verërave . Në strategjinë gjithëpërfshirëse të pozicionimit të ushqimeve tradicionale dhe verës , imazhin që ka ushqimi tradicional mund të shfrytëzohet për përdorimin me qëllim për të theksuar specifikat e destinacioneve turistike në tregun e turizmit e verërave në Kosovë.

Turistët për verërat nuk kërkojnë vetëm knaqësitë për verërat, ata i interesojnë edhe atraksionet tjera që janë të lidhura me trashigiminë kulturore , mjedisin , historinë dhe artin, etj.⁵

³ <http://casopisvino.co.rs/vinski-turizam/vinski-turizam-hrvatska>, Lada Radin.

⁴ Hall, C.M.& Mitchell, R.Wine tourisam in the Mediteranenana: A tool for the restructuring and development, Thunderbird Internacjonal Busnisses Review, 2000, f aq. 445

⁵Carlsen J, A review of global wine tourism resurces , 2004, faqe 6-7.

4. QASJET METODOLOGJIKE

Për të bërë identifikimin e problemeve momentale e distribuimit dhe shitjes së verërave në tregun tguistik në Kosovë , kamë zhvilluar hulumtimin , të cilin do ta interpretojmë më tej. Objektivi dhe qëllimet e hulumtimit është përcaktimin e vëllimit të këtyre marrëdhënieve dhe fenomeneve në prodhim, distribuimit dhe shitjes së verërave e cila po zhvillohet në kantinat prodhuese , degustimet dhe konsumi i verës. Për këtë qëllim është përgatitur një pyetësor me pyetje të ndara në grupe. Grupi i parë i pyetjeve është e lidhur me prodhimin e verërave dhe shtijes nëpërgjithësi. Grupi tjetër i pyetjeve është e drejtuar në kantinat gjegjesisht në sallat e degustimeve të verërave dhe konsumit. Gjatë hulumtimit janë përfshin dy grupe e të

anketuarve , përkatësisht grupet cak duke bërë zgjedhjen tone të lirë , që janë në të vërtetë fermerët, prodhuesit e verës.

Studimi është kryer në periudhën nga marsi deri në nëntori 2013 , pyetësor i realizuar me ndihmën e anëtarëve “ ENOLOGJIA” , Shoqata e Verëtarve të Kosovës . Mostrat janë vlerësuar nga prodhues të verës të cilët janë intervistuar gjatë përgatitjes dhe mbajtjes së festivalit të të përvitshëm tradicional të Rrushit, Verës Ushqimit dhe Kultures i cila mbahet më 7 shtator në Rahovec në rajonin vreshtar në jug të Kosovës.

5. OFERTA E VERËRAVE KOSOVARE NË TREGUN TURISTIK

Në Kosovë viteve të fundit vreshtaria po shenon progress në ngritjen e sipërfaqeve me rrush të varieteteve për verërat duke ndikuar në ngritjen e prodhimit të verërave kualitative. Në Kosovë si pas indikatorve nga MBPZHR prodhohet mesatarisht 16 mil.litra verë. Viti më i mirë pas luftës që është prodhuar vera është shënuar më 2008 që është prodhuar 8.9 mil.lit.verë. Në Kosovë kryesisht prodhohen këto varietete të verërave. Verërat të bardha: Schardonay, Reasling raine, Reaisling, Pinot blank. Prodhen verërat rose shumë cilësore. Nga verërat e kuqe prodhen: Kabernet sauvignon, Merlo, Pino Noire, Vranac, Shiraz, Sheshi i Zi, si dhe verërat të ndryshme kuqe si pas kërkesës së konsumatorve. Pjesmarrja në shitjen e verërave me përshkrimet e origjinës, rajonit, zones, etj. të këtyre produkteve , pastaj , markat e mbrojtura me prejardhjen gjeografike, po shenon gjithnjë trendin e rritjes në tregun turistik në Kosovë edhe pse simbolik. Në kontekstin e tregtis së lire dhe konkurrencës parimore tregu me mekanizmat e veta ka bërë trysni ata prodhues të cilët nuk janë në gjendje të përcjellin këto trende. Ky trend është shumë i dukshëm në të gjitha hotelet dhe restorantet më të mira në Kosovë , pastaj në shitjet me pakic, zinxhoret tregtare , etj. në këtë mënyrë kjo ofertë me produktet e veta po jep një kontribut të pa kontestueshëm në begatgimin e asortimentit të verërave , edhe në përgjithsi në konsumin e përgjithshëm në turizmin kosovar.

Tabela 1. Llojet e verërave që prodhohen dhe që ofrohen në Kosovë⁶

VERËRAT E BARDHA	VERËRAT ROSE	VERËRAT E KUQE
Schardonay	Verërat rose	Kabernet Sauvignon
Reasling rigne		Merlo
Reasling		Pino noire
Pinot blanc		Vranac
Zhuplank		Shiraz

Rkacitel		Game
Semijon		Sheshi i zi
Smederevkë		Game
Zhillavkë		Zhametë
.....	

Nga kjo tabelë mund të konstatojmë se në Kosovë prodhohet rreth 20 varietetet e rrushit të verërave. Nga kjo kuptojmë se janë 9 llojet e varieteteve të bardha, kryesisht dominojnë si dhe rreth mbi 9 llojet e varieteteve të rrushit të kuq të verës si dhe vera rose tipeke e prodhuar nga varietetet e rrushit të verërave . Pjesmarrja e verërave të lartë cekura në prodhimin e përgjithshëm në Kosovë mund ti shohim në tabelën e dytë të paraqitur .

Tabela 2. Prodhimi dhe oferta e verërave në tregun turistik në Kosovë 2013

Llojet e verërave	% përqindja e pjesmarrjes në prodhimtari	
Vranac	30 %	1
Kabernet	24 %	2
Merlot	18 %	3
Pino Noire	10 %	4
Schardonay	10 %	5
Riesling	8 %	6

Burimi: Anketa e zhvilluar në teren tek prodhuesit e licencuar,

Nga tabela e mësipërme është e qartë se në bodrumet e verërave në Kosovë përqindja më e madhe e verës së prodhuar rangohet në pozitën e parë: Vranac me 30 %, pastaj përcillet në vendin e dytë me 24 % e prodhimin të Kabernet Sauvignon, ndërsa në vendin e tretë të prodhimin merrë pjes Merlot me 18 % ndërsa me 10 % në vendin e katërt rangohet Pino Noire nga verat e kuqe dhe vendi i pesti verë e bardhë Schardonay , ndërsa nga vera e bardhë Reasling në pozitën e gjashtë me 8 %. Do të thoja , këto janë kryesisht verërat cilësore dhe kulminante që posedojnë vlerë që prodhohen dhe ofrohen në tregun turistik kosovar.

⁶ Burimi: Anketa e zhvilluar në teren tek prodhuesit e licencuar, Rajoni ekonomik jug, Kosovë , korrik 2014

Tabela 3. Prodhimi dhe oferta e verërave me shenjën “ E mbrojtur gjeografike”⁷

Verërat e kuqe	Verërat e bardha
Kabernet Sauvignon	Schardonay
Merlo	Reasling rigne
Pino Noire	Reasling
Vranac	Pinot blanc
Shiraz	Zhuplank
Game thjeshtë	Rkacitel
Sheshi i zi	Semijon
Game me ngjyrë	Smederevkë
Zhametë	Zhillavkë

Burimi: MBPZHR, DVV, Korrik 2014

Duhet të theksohet se me rastin e theksimit të markës me "prejardhje të mbrojtur gjeografike" egzistojnë disa mundësi gjegjësisht raste. Vera e tavolinës me shenjën e kontrolluar gjeografike , është vera me një ose me më shumë varietete të cilat rrjedhin nga regjioni vreshtar i caktuar. Verërat cilësore me shenjën prejardhja e kontrolluar është vera e cila është e prodhuar nga një ose më shumë varietete të rrushit të cilat rrjedhin nga një nën regjion vreshtar me përmbajtje të theksuar të cilsisë organoleptike dhe domethënëse për kushtet ekologjike të varieteteve të paracaktuar të nënregjionit vreshtar , të vreshtave apo pozitës të cilët mbajnë shenjën dhe është kultivuar në atë nën rajon.


Verërat kulminante me shenjën e prejardhjes së kontrolluar është vera e prodhuar nga varietetet të caktuara ose grup të varieteteve të rrushit të cilat rrjedhin nga një apo më shumë pozitave vreshtare në kuadër, të, brenda një vreshti , veçanarisht me cilësit e theksuara , me përmbajtje specifike , kimike dhe organoleptike , që është domethënëse për kushtet ekologjike, të pozitës dhe varietetit gjegjësisht grupit të varietetit të rrushit. Ajo verë duhet të maturohet dhe të mbushen shishet nga ai vresht apo varietet i cili duhet të mbuloj pozitën e caktuar. Nëse vera mban shenjën e varietetit , patjetër duhet të jetë e prodhuar nga më së paku 70 % e varietetit të rrushit të cilën emrin e mban. Nga tabela e mësipërme mund të shohim varietetet e rrushit të verës të cilat janë të locuara nëpër rajonet dhe nën rajonet vreshtare në rajonin ekonomik jug të Kosovës të cilat nuk janë të ranguara si pas klasifikimit as sipas pjesmarrjes me % për faktin se në Kosovë është në process ligji mbi verërat me prejardhjen gjeografike , ndësa këto verërat përcillen vetëm si vera të kontrolluara gjeografike sepse dihet rajoni, nënrajoni, pozita , parcelat, etj.

⁷Burimi:Enti i V.V, MBPHR Prishtinë , Shënime Statistike Rahovec, Korrik 2014

6. FORMAT E DISTRIBUIMIT DHE SHITJA E VERËRAVE NË TURIZMIN KOSOVAR

Distribuími si aktivitjet afarist përfshin të gjitha ato veprime të cilat janë të nevojshme që produkti prej prodhuesit të arrijë deri te konsumatori në vend dhe kohë të caktuar. Përzgjedhja e kanaleve të distribuímit është një prej vendimeve kryesore për zhvillimin e strategjive kryesore. Si pas Philip Kotlerit janë të mundshme tri strategjit të distribuímit: 1.Distribuími intenziv, 2. Distribuími selektiv, 3. Distribuími eksklusiv.⁸

Kanalet e distribuímit është rruga prej prodhuesit deri te konsumatori. Ajo rrugë mundet me qenë direkte dhe indirekte(përmes ndërmjetësve). Dallojmë këto forma – kanalet të distribuímit dhe shitjen e verës në tregun turistik në Kosovë :⁹



⁸. Philip Kotler, Upravljanje Marketingom, Informator Zagreb, 1994, faqe 648-649

⁹.Nexhmi Rexha&Nail Reshidi, B.e Marketingut,Rexha Marketing Science Services, Prishtinë 2002, faqe 229-230

Nga se u tha më parë vetëm në formën e parë A shitja e produkteve të verës në Kosovë shitet në mënyrë direkte dmth, prodhuesi drejtpërdrejt lidhet me konsumatorin ndërsa format tjera si B, C, Ç, produktet konkretisht vera shitet nëpërmes ndërmjetësve që e lidhë prodhuesin përmes agjentit tregtar, shtitjes me shumic dhe në fund shitjes me pakic deri te konsumatori , është një rrugë që përshkon vera nga prodhuesi deri te konsumatori si destinacion të fundit. Prandaj duhet të konstatojmë , se kanalet apo formatat e ditribucionit janë grup subjektet të lidhura apo të mvarura në mes veti të involvuara në proces të cilat në këtë rast verërat i bëjnë disponibël për konsum, të cilat format e ditribucionit i përdorin prodhuesit e mëdhej të verërave gjegjësisht kantinat e mëdhaja .

Prodhuesit e vegjel të verërave , apo si që i quajmë ne mini podrumet e verërave që janë numerikisht më shumë, ato shpesh praktikojnë formën direkte të shitjes së verërave në tregun turistik në Kosovë. Forma direkte e shitjes së verërave është realisht “ blerëja e verërave nga shtëpia- bodrumi”, që nënkuptohet shitja e verërave pa ndërmjetësuesin . Këto shitjet e verërave realizohet edhe në shumë mënyrat dhe format tjera , të cilat janë:

- ❖ Shitja e verërave nga podrumi,
- ❖ Shitja mobile e verërave “prej derës në derë”,
- ❖ Shitja nga “pragu i shtëpis”,
- ❖ Shitja nëpër ekspozitat e ndryshme dhe nëpër panairt,
- ❖ Shitja one-line (tregtia elektronike),
- ❖ Shitja përmes porosisë me telefon (tele marketing),
- ❖ Shitja përmes postës.

Tabela 4: Distribuimi dhe plasmani i verërave në Kosovë¹⁰

Kanalet e distribuimit dhe shitja	% e përgjithshme në distribuim dhe shitje	Pozita
Eksporti	35	1
Restorante	20	2
Zinxhoret tregtare	18	3
Tregtia me pakic	15	4
Butiqet e verërave	6	5
Degustimet e verërave në bodrume	3	6
Tjera	3	7

Burimi: Hulumtimi anketues bodrumeve të licencuara. **100 %**

Nga tabela e më sipërme shifet se më së shumti vera eksportohet jashtë dhe merrë pjesë me 30 %, më pas plasohet me 20 % në restorante, 18 % në zinxhoret tregtare, më pas pason tregtia me pakicë me 15%, në enoteca shitet 6%, përmes degustimeve në bodrume me 3% dhe tjera me 3 %.

¹⁰ Burimi, Anketa e zhvilluar në teren tek prodhuesit e licencuar, Rajoni ekonomik jug, Kosovë, korrik 2014

6.1. FORMAT TJERA E DISTRIBUIMIT DHE SHITJA E VERËRAVE NË TREGUN TURISTIK NË KOSOVË.

Format tjera të veqanta dhe novatore e shitjes së verës në tregun turistik në Kosovë, janë ato që për ditë ideohen dhe tejkalohe nga aftësit creative të prodhuesve. Si në tregun global edhe në Kosovë janë identifikuar edhe disa format që përmes koncepteve të marketingut dhe të logjistikës janë të përpunuar, të orientuara në katër kategori: në ngjarje (psh. festivali tradicional i rrushit dhe i verës mbahet më 7 shtator), në edukimin (psh. ngritja e kultures së konsumit të verës përmes seminareve dhe ligjeratave të ndryshme), degustimet e hapura nëpër bodrume (psh. Degustimet e hapura të organizuar për konsumator, turista, etj.), dhe përmes turizmit të verës (psh. Shtigjet e verër që përshkojnë rrugën nëpër secilin prodhues-bodrum i verërave).¹¹

Si formë tjetër inovative mund të konsiderohet edhe shitja gjat ngjarrjes “ dita e hapjes së bodrumit” që janë mjaft sish, bodrumet të mëdhej dhe të vegjel që mund të regjistrohet si ditë e veqant në vit për secilin bodrum, në këtë mënyrë tradicionalisht edhe konsumatorët vendor apo edhe turistët të jashtëm do të planifikojnë ditën për ardhjen, vizitën, degustimet dhe blerjet e verërave në bodrumet e tyre të preferuara, në rajonin vreshtar verëtar në Kosovë që ka një traditë shumë të lashtë, por duhet theksuar se turizmi tani është në fazën fillestare të zhvillimit të tij.

7. KONKLUZIONI

Kosova nga viti 2010 e këndej po tenton që të bëhet një prej destinacioneve të dëshirueshme botërore. Tradita e prodhimit të verërave në rajonin ekonomik jug të Kosovës është me pamje imponante dhe madhështore me rafshnaltat e rajonit vreshtar të Kosovës që kultivohet në naltësi mbidetare prej mbi 600 m. Prodhimi i verës tradicionalisht prodhohet më tepër se sa mund të absorboj tregun turistik i Kosovës dhe tregun e konsumit nëpërgjithësi, dhe për këtë shkak prodhuesit e verërave në Kosovë janë të shtyer gjegjësisht të detyrueshëm që të perfeksionojnë shitjen dhe distribuimin edhe në format më specifike dhe inovative duke u përshtatur rethanave në tregun turistik në Kosovë, të bazuara në ngjarjet, në edukimin e ngritjes të kultures të konsumit të verës, degustimeve të verërave nëpër bodrumet dhe përmes turizmit të verës përmes shtigjeve të verës që tash më po shënon përparim dhe rritje të dukshme, që ofrohet me paketa turistike. Në produktin turistik në rajonin vreshtar ofrohen verërat si Kaberne Sauvignon, Merlot, Pino Noire. Vranac, Shiraz, Sheshi i Zi, Shardonay, Riesling Rajne, Riesling Italian, e shumë e shumë varietetet specifike. Si metod specifike shitet edhe përmes rrugës së verës, që turistët vizitojnë 12 bodrumet që përshkohet kjo rrugë

me ofrimin e atrakciveve të trashigimis kulturore e historike të rajonit verëtar vreshtar në Kosovë.

¹¹ Intervista me Shoqata e Verëtarve të Kosovës ” Enologjia” Rahovec, korrik, 2014

8. Rekomandimet

1. Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerzore për turizmin e verërave,
2. Trajnimi për ciceronë,
3. Ngritja e kapaciteteve akomoduese të bujtinave me sistemin “Bed and Breakfast “ ,
4. Zhvillimi i fushatave për ngritjen e kultures për konsumin e verërave,
5. Zhvillimin e guidës turistike.

LITERATURA-REFERENCA

- Carlsen J, A review of global wine tourism resurces , 2004, faqe 6-7.
- Cena,Dr.Sabahudin, Përmbledhje punimesh nga simpoziumi i V dhe VI në Kosovë, Prishtinë, 2005 f 15
- Hall, C.M.& Mitchell, R.Wine tourisam in the Mediteranenan: A tool for the restructuring and development.Thunderbird Internacional Busnisses Review, 2000, f aq. 445
- Enti i V.V, MBPHR Prishtinë , Shënimet Statistikore Rahovec, Janar 2014
- Philip Kotler, Upravljanje Marketingom, Informator Zagreb, 1994, faqe 648-649
- Nexhmi Rexha&Nail Reshidi, Bazat e Marketingut,Rexha Marketing Science Services, Prishtinë 2002, faqe 229-230
- Anketa e zhvilluar në teren tek prodhuesit e licencuar, Rajoni ekonomik jug, Kosovë , korrik 2013
- Intervista me Shoqata e Verëtarve të Kosovës ” Enologjia” Rahovec, korrik, 2014
- <http://casopisvino.co.rs/vinski-turizam/vinski-turizam-hrvatska>, Lada Radin.

NDIKIMI I ZHVILLIMIT EKONOMIK NË MIRËQENIEN SOCIALE (RASTI I KOSOVËS)

Msc. Valbona Hyseni¹ , Mr.sc. Refik Havolli² , Mr.sc. Beqir Halilaj³.

³Kolegji ISPE, Fakulteti i shkencave politike, Prishtine

E-mail address: valbonahyseni_4@hotmail.com

²Universiteti Nderkombetar i Struges Fakulteti Ekonomik, Struge

E-mail address : refik.havolli@yahoo.com

³Kolegji ISPE, Fakulteti Ekonomik, Prishtine

E-mail address: beqir.halilaj@gmail.com

1.0 HYRJE

Ky punim ka si qëllim të shtjellojë në mënyrë të përgjithshme ndikimin e zhvillimit ekonomik në mirëqenie sociale analizuar nga një këndvështrim teorik. Punimi fillon me pikpamjet e zhvillimit ekonomik , vazhdon me shqyrtimin e faktorëve që e bëjnë të nevojshëm qeverisjen e mirë dhe transparente si dhe rolin e tyre në mirëqenie sociale .

Ne jemi dëshmitarë se zhvillimi ekonomik është padyshim që ndikon në jetën e përditshme të aktiviteteve tona sociale dhe ekonomike. Ne jemi dëshmitarë se si ato ndikojnë në vendimet dhe politikat e qeverisjes ekonomike në jetën tonë të përditshme, si pozitivisht si dhe negativisht.

Por pyetja hulumtuese që do të rrjedhë logjikisht është : *Cili është ndikimi I zhvillimit ekonomik në mirëqenie sociale ?*

Zhvillimi ekonomik do të thotë një hap përpara të zhvillimit të sektorit ekonomik , për këtë një vëmendje të veçantë duhet t'i kushtojm politikave, strategjive dhe iniciativave për zhvillim të bizneseve me qëllim të rritjes së konkurrencës në biznes .

Ambienti ekonomik në Kosovë ka ardhur duke u përmisuar vazhdimisht , vihet re një stabilizim ekonomik si rezultat i politikave , liberalizimit të qmimeve dhe strategjive për arritje të një ekonomike të qendrueshme

Megjithatë roli i ndikimit të zhvillimit ekonomik në mirëqenie sociale ndryshon nga njëri vend në tjetrin, sidomos në vendet që kanë sisteme të ndryshme politike. Se *cili është ky ndryshim, si manifestohet dhe cilat janë dallimet do të mund, do të mundohemi të sqarojmë gjatë shtjellimit të kësaj teme .*

Fjali kyqe: Zhvillimi ekonomik, Mirëqenia Sociale, Politikat ekonomike , Strategjia, Zhvillimi

2.0.METODOLOGJIA

Për punimin e një teme të nivelit të tillë gjithmonë kërkohen të përdoren metoda adekuate të cilat do të ndihmonin në rrumbullaksimin e idesë e cila lidhet me temën adekuate.

Gjatë këtij punimi kamë përdorë metodën kualitative , perms kësaj metode kam tentuar ti vertetoj ose ti hedh poshtë hipotezat e paraqitura të cilat janë :

1) *Rritja ekonomike shton nivelin e mirëqenies materiale, duke shkaktuar njëherit edhe vetëdijesim dhe rritje pozitës social.*

2) *Shumica e vendeve në zhvillim, përveç urbanizimit kanë nivel të ulët të mobilitetit socio-ekonomik.*

3) *Zhvillimi ekonomik dhe social duhet ti paraprijë reforma ekonomike kohezioni social, zhvillimi i infrastrukturës lokale,arsimi dhe sundimi i legjislacionit vendor dhe atë ndërkombëtar.*

Ky punim bazohet në metodën kualitative që reflekton metodë bashkëkohore të shkencave sociale, duke përfshirë hulumtimin e literaturës përkatse e cila korrospodon me temën për të cilën jamë duke punuar ,analizimin e legjislacionit ekzistues, konsultimin e raporteve studimore të publikuara nga organizata të ndryshme vendore e ndërkombëtare; këndvështrimet e mbledhura nga autorë të ndryshëm , si dhe metoda të tjera.

Metodologjia e punës shkencore kërkimore në fushën e ekonomisë është përqëndruar në spektrin e metodave dhe qasjeve , me qëllim të operacionalizimit të çështjeve , si segmente që mund të gjurmohen dhe të fitohet rezultate dobiprurëse , përvetsimi i punës metodologjike është parakusht për ti vënë në spikamë ligjshmërit , të cilat ndikojn në zhvillim në begatimin e indikatorve kryesor ekonomik , në ndryshimin e sjlljeve të prodhuesve , konsumatorve si dhe institucioneve tjera financiare. Metodë ku përmes të cilës kamë pasur mundesin të sigurojë kuptimin dhe sqarimin e temës në mënyrë gjithëpërfshirë.

3. 0. ZHVILLIMI EKONOMIK

Objekivi i çdo shteti është zhvillimi i ekonomisë së tregut duke synuar rritje ekonomike të qëndrueshme, begatin, drejtësinë ekonomiko-shoqërore, rritjen e punësimit dhe përdorimin e barabartë të burimeve ekonomike. Meqenëse ekonomia dhe rritja e mirëqenies ekonomike janë një nga preokupimet e gjithë njerëzve në një bashkësi shtetërore, qytetarët me të drejtë kërkojnë nga qeveritë që ta drejtojnë shtetin në rrugën e zhvillimit të barabartë dhe të prosperitetit ekonomik. Këtë kërkesë e mbështesin në gjykimin se ekonomia e përcakton shkallën e zhvillimit dhe të qytetërimit të vetë qytetarëve, shkallën e demokracisë dhe lirisë. Zhvillimi ekonomik lokal dhe rajonal ka për qëllim primar të ndihmoj qytetarët të përmirësojnë pozitën e tyre sociale dhe ekonomike duke krijuar parakushte për një barazi ekonomike të gjithë qytetarëve, duke proklamuar një drejtësi shoqërore ekonomike dhe duke ngritur një qëndrim të përgjegjshëm ndaj mjedisit shumë etnik, pasi që të gjitha këto janë të rëndësishme për begatin e një vendi .(*Zeqiri, Izet,2010*) Zhvillimi ekonomik dhe social duhet ti paraprijë reforma ekonomike, kohezioni social, zhvillimi i infrastrukturës lokale, arsimi dhe sundimi i legjislacionit vendor dhe atë ndërkombëtar . (*Komisioni Evropian, Rruga Drejt Integrit – Bashkimi Evropian dhe Ballkani Përndimor , 2003*).

3.1. INTEGRIMI (EKONOMIK, POLITIK ,TEKNOLOGJIK)

Integrimi ekonomik është një ceshtje e cila ka marrë rëndësi me kalimin e viteve menjehere pas luftës së dytë botërore. Në diferencë nga integrimi botëror i ekonomive kombëtare ai është trajtuar si integrim ekonomik rajonal apo rajonalizem ekonomik. Megjithatë në trajtojme kryesisht integrimin ekonomik në Bashkimin Europian forma më pak të zhvilluara të integritit ekonomik mund të gjenden pothuaj në gjithë kontinentet. (DuaLibra ,Leksione I, Integrimi Ekonomik , 2010)Vendet në tranzicion si p.sh vendet ish-socialiste ndeshen me probleme lidhur me vendosjen e tregut të lirë dhe integrimin në ekonominë botërore . Zgjedhja e tyre kërkon ndihmën nga vendet e zhvilluara jo vetëm ndihmë humanitare , kapital apo asistenc teknike mirpo edhe një hapje dhe qëndrim më liberal ndaj këtyre vendeve . (Manqellari,Ahmet 2004) Bazat e kësaj teorie janë shkruar nga ekonomisti hungarez Bela Balassa në vitet 60. Bashkimi Europian dhe Zona Euro konsiderohen si ekonomia më e integruar midis shtetesh të pavarura. Integrim Ekonomik quhet eliminimi i kufijve ekonomike midis dy ose më shumë ekonomive. Integrimi ekonomik europian është i udhëhequr nga përpjekjet për të reduktuar ose eliminuar rolin e kufijve territorial si kufij ekonomike midis shteteve Europiane. Synimi i integritit ekonomik është rritja e konkurrencës aktuale dhe të ardhshme. (Manqellari,Ahmet 2004) Konkurrenca e lirë midis pjesëmarrësve të tregut sjell uljen e çmimeve dhe një mundësi zgjedhjeje më të gjere për mallrat ose shërbimet që ofrohen në zonën objekt të integritit, gjithashtu ajo shërben si një katalizator për ndryshimin dhe zhvillimin në zonë. Integrimi ekonomik paraprind integrimin politik. Balassa besonte se tregjet e përbashketa ndershtetërore, me levizjen e lirë të faktoreve ekonomik ndërmjet kufijve kombëtar, gjenerojn natyrshëm nevojën për integrim të mëtejshëm, jo vetëm ekonomik (bashkim monetar) por dhe politik. Rrjedhimisht bashkimet ekonomike transformohen në bashkime politike. Procesi i integritit ekonomik dhe atij politik në Bashkimin Europian ka qenë i lidhur që në fillimet e tij dhe kjo i paraprind edhe integritit teknologjik që ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin dhe përhapjen e informacionit dhe integrimin e diversitetëve kulturore .(DuaLibra ,Leksione I, Integrimi Ekonomik , 2010)

3.2. PIKËPAMJE TË NDRYSHME LIDHUR ME ROLIN DHE NDIKIMIN E EKONOMISË NË MIRËQENIE SOCIALE

Gjatë shekullit të kaluar dhe në fillim të këtij shekulli sunduan pikpamjet e ndryshme për rolin dhe ndikimin e shtetit në ekonomi , ku ndër pikpamjet që luajten rol më të rëndësishëm janë ato klasikë dhe neoklasike . Për ekonomistët klasik ,sipas tyre ekonomia , si rregull karakterizohet nga përdorimi i plotë i burimeve , ndërsa gjendjet e disekulibruarit ose mosëpërdorimit të plotë të burimeve kapërcehen shumë shpejt përmes mekanizmave përshtatës të tregut. Mirpo eksperiencia e këtij shekulli e në mënyrë të veçant ajo e Depresionit të Madh , dëshmuon kundër pikpamjes së mësipërme klasike. Në këtë periudhë zë fill një shkollë e re e mendimit makroekonomik , shkolla kejniane . Në vepren madhore të tij “ Teoria e Përgjithshme e Punzënies , Interesit dhe e Parasë “ (1936) , Kejnisi argumentonte mundësin e gjendjeve të ekuilibruara të ekonomisë në kushte të një mospërdorimi masiv të burimeve . (Manqellari,Ahmet 2004) Ai bëntë thirrje për politika më të efektshme qeveritare sidomos në kërkim të stimulimit të kërkesës agregate . Pikpamjet kejniane sunduan për afro

gjysëm shekulli në mendimin makroekonomik dhe rekomandimet e kesaj pikpamje qëndruan në baza të politikave makroekonomike qeveritare në vendet përëndimore. Nga mesi i vitev 70 nën kushtet egoditjeve të ndryshme ekonomike kjo pikpamje u ndodh para situatave të cilat nuk kishe mundsi si t'i shpjegonte . (Manqellari,Ahmet 2004)Në këto kushte morrën zhvillim rryma tjera të mendimit makroekonomik që përfaqsojn një ringjallje të mendimieve neoklasike . E përbashkta e këyre pikpamjeve si ajo e monetariste e përfaqsuar nga M.Frideman , apo shkolla e pritjeve racionale e përfaqësuar nga R.Barro, R.Llukas , spo shkolla e ofertes , është theksimi i afëtsive vetëpërshtatse të tregjeve dhe qëndrimi në përgjithsi negativ ndaj ndërhyrjes së shtetit në ekonomi . Keto rryma kanë një influenc në mendimin e sotëm makroekonomik të qeverive por nga fillimi i viteve '80 është vrejtur nja fuqizim i mendimit neokejnsian , ku sipas kësaj pikpamje ekziston mundësia e “ dështimeve “ të tregut dhe si rezultat ndërhyrja e shtetit paraqet nevojë të domësdoshme . Pra siq mund të kuptojm këto pikpamje paraqesin kategori të ndryshme makroekonomike ku shpesh i shohum përball njëra tjetres . (Manqellari,Ahmet 2004)

3.3. QEVERISJA E MIRË&SUNDIMI I LIGJIT NDIKIMI I TYRE NË MIRËQENIE SOCIALE

Objektiva strategjike është krijimi i një administrate efikase, profesionale, transparente në pajtim me parimet demokratike dhe e orientuar drejtë ofrimit të shërbimeve sa më të mira për qytetarët, me qëllim që të kemi një zhvillim të avancuar social. Reforma e administratës publike është një parakusht i cili duhet zbatuar përmes një procesi dhe kornize të definuar të planifikimit strategjik që ndër të tjera i kontribuon edhe zbatimit të obligimeve që dalin nga Partneritetit Evropian për Kosovën. (Raporti i Progresit 2013) Financat publike janë të definuar dhe të rregulluara përmes sistemit të aranzhimeve financiare të sektorit publik, në bazë të praktikave më të mira. Të gjitha të hyrat e buxhetit dhe shpërndarja e tyre janë të kanalizuar përmes “Llogarisë së vetme” të Thesarit, (Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ,2013)ndërsa kontrolli i menaxhimit të financave publike bëhet nga ana e sistemit të auditimit dhe raportimit i cili është bazuar në bazë të praktikave më të mira ndërkombëtare dhe Evropiane. Megjithatë, sistemi kërkon përmirësim sepse ekzistoj shumë sfidat para nesh. Kapaciteti për shpenzime të ndarjeve buxhetore të aprovuara ka nevojë të përmirësohet tutje. (Ministria e Ekonomisë dhe Financave ,Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2011-2013. Prishtinë 2010)

Ky kapacitet aktual për shpenzime është rezultat i shumë faktorëve që tashmë janë identifikuar. Pra, menaxhimi i financave publike me theks te veçante në politikat e prokurimit publik do të jenë në fokus te punës. Sigurimi i mbështetjes nga donatorët, që krijojnë bazë për rritje ekonomike është një faktor mjaft i rëndësishëm. Deri me tani Kosovës iu është ofruar një asistencë të konsiderueshme teknike nga ana e donatorëve (vlerësohet se rreth 80 për qind e ndihmës aktuale shkon për asistencë teknike). Kjo formë e ndihmës nga donatorët është e mirëseardhur, megjithatë ndihma e huaj duhet te orientohet me tepër ne përkrahje të prioriteteve qeveritare dhe përmes sistemin qeveritar. Për të realizuar këtë duhet të përkushtohemi të ngrisim llogaridhënien dhe kapacitetet tona administrative. Luftimi i korrupsionit do të vazhdojë të jetë një nga prioritetet e Kosovës në funksion te zbatimit te ligjit dhe ne kuadër të kornizës së përcaktuar me Strategjinë Kundër-Korrupsion dhe paraqet

njërën nga parakushtet e integritit të evropian përmes prioriteteve të partneritetit Evropian për Kosovën. (Ministria e Ekonomisë dhe Financave, *Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2011-2013. Prishtinë 2010*). Sundimi i ligjit apo shteti i së drejtës gjithashtu paraqet një fushë shumë të gjerë, ajo nuk paraqet vetëm pjesën e implementimit të ligjeve, por tërë procesin që nga krijimi i kornizës ligjore e deri tek implementimi. Përderisa sundimi i ligjit paraqet një proces më të gjerë se vetëm implementimi i ligjit, atëherë kemi të bëjmë me një varg institucionesh dhe organesh të cilat e bëjnë të mundur sundimin e ligjit në një shtet. (Instituti Ballkanik i Politikave, *Politika Publike në Fushën e Sundimit të Ligjit në Kosovë, Prishtinë, Kosovë, 2011*). Ndonëse një përparim i konsiderueshëm i zhvillimit ekonomik është bërë në Kosovë gjatë viteve të fundit, ende mbetet për tu bërë. bazuar në vlerësimet e panvarura dhe ndërkombtare, Kosova është ekonomikisht e qendrueshme bazuar në resurset e saj natyrore. Prapë se prapë situata është një ndër ekonomit më të varfra në Evropë. Kosova ka realizuar arritje substanciale në politikat fiskale dhe monetare duke regjistruar stabilitet buxhetor dhe inflacion të ulët.

Kjo arritje është bërë kryesisht për dy arsye: 1 rritja e të hyrave dhe zgjerimi i ult i harxhimeve, dhe 2 përdorimi i Euros që ka imponuar një stabilitet monetar

4.0. PËRFUNDIMI

Pra, nga ajo që u elaborua më lart mund të kuptohet se të gjitha fazat e mendimit mbi ndikimin e zhvillimit ekonomik në mirëqenies sociale në vendet të ndryshme dhe nga autorë të ndryshëm, vrehet qartë se kjo dukuri ka qenë vazhdimisht në qendër të vëmendjes, dhe si i tillë është provuar dhe kundërshtuar nga autor dhe rryma të ndryshme. Megjithatë mund të arrijmë në një përfundim ndoshta jo edhe aq shumë të knaqshëm, përderisa u përballëm me sfida të cilat po i bëjnë shoqëri politikave ekonomike dhe sociale Kosovare. Sfidat të cilat përveq faktorit kohë, ku siq e dim Kosova si një shtetë i ri i posaformuar ende me një politikë të brishtë si ekonomike ashtu edhe sociale do t'i duhet kohë për të arritur një ekonomi të qëndrueshme, gjë që është shumë e nevojshme, ekzistojnë edhe faktor tjerë siq janë korniza ligjore, qëndrueshmëria me furnizim me energji, qasja në financa, tatimet dhe doganat, standarde tjera me anë të të cilave do këtë një zhvillim të pozitës ekonomike dhe sociale, pra janë faktor pa të cilët nuk do të mundë të tejkalon këtë hendek të zhvillimit ekonomik dhe social.

Pra, gjatë gjithë punimit kam vërejtur një stabilizim ekonomik si rezultat i politikave, liberalizimit të çmimeve dhe strategjive për arritjen e një ekonomie të qëndrueshme. Zhvillimi ekonomik paraqet parakusht i cili do të ndikojë tek ngritja e pozitës sociale dhe si e tillë objektivi i çdo shteti është zhvillimi i ekonomisë së tregut duke synuar rritje ekonomike të qëndrueshme, begatin, drejtësinë ekonomiko-shoqërore, rritjen e punësimit dhe përdorimin e barabartë të burimeve ekonomike. Ekonomia e përcakton shkallën e zhvillimit të mirëqenies sociale dhe të qytetërimit të vetë qytetarëve.

Analizë hulumtuese e hipotezat që kam ngritur në fillim të punimit e që janë:

1) Rritja ekonomike shton nivelin e mirëqenies materiale, duke shkaktuar njëherit edhe vetëdijesim dhe rritje pozitës sociale, kjo hipotezë gjatë këtij punimi është vërtetuar si e sakt, marrëveshja e Kosovës me FMN, ka rezultuar me qendrueshmëri fiskale, Kosova është anëtarësuar në Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe është pranuar në programet e Bankës Investive Evropiane (EIB). Anëtarësimi në këta mekanizma

financiare ndërkombëtar do të ketë impakt pozitiv në zhvillimin ekonomik të vendit duke mundësuar qasje në kredi me kushte të favorshme për ekonominë e Kosovës. Duke pasë parasysh faktorët siq janë korniza ligjore, qëndrueshmëria me furnizim me energji, qasja në financa, tatimet dhe doganat, marrveshje ndërkombëtare standarde tjera me anë të cilave do të kemi rritje dhe zhvillim të pozitës ekonomike dhe sociale, pra janë faktor të cilët shtojn nivelin e mirëqenies materiale, duke shkaktuar njëherit edhe vetëdijësim dhe rritje pozitës sociale.

2) *Shumica e vendeve në zhvillim, përveç urbanizimit kanë nivel të ulët të mobilitetit socio-ekonomik*, gjithashtu edhe kjo hipotez është vertetuar e sakt sepse duke u bazuar në të gjeturat e punimit, sepse gati shumica e vendeve në zhvillim e këtë rast edhe Kosova, ka kaluar përmes procesit të tranzicionit proces ky i cili për vendet e sapo daluar nga lufta është i vështirë dhe dimë se vendet me pabarazi në të ardhura priren të kenë nivelin më të ultë të mobilitetit social, duke u bazuar në ekonominë e cila është shumë e brishtë, dhe kjo si rrjedhojë ka pasojë tek mobiliteti social apo tek ngritja e nivelit social

3) *Zhvillimi ekonomik dhe social duhet të paraprijë reforma ekonomike kohezioni social, zhvillimi i infrastrukturës lokale, arsimit dhe sundimi i legjislativës vendor dhe atë ndërkombëtar*, gjithashtu edhe kjo hipotez ka rezultuar të jetë e sakt sepse për pasur një nivel lartë të mirëqenies sociale duhet kemi gjitha këto parakushte me qëllim që kemi politika sociale të avancuar. Kemi përparim nga aspekti i krijimit të infrastrukturës ligjore që i përgjigjet legjislativës të Bashkimit Evropian. Ku këtë rast performanca ekonomike dhe ajo sociale kanë pasur një progres të zhvillimit duke marrë parasysh të gjeturat, Kosova ka krijuar rregulla e sajë duke u bazuar në praktikën më të mirë sociale evropiane si dhe zhvillimit ekonomik të sektorit privat dhe publik ku janë stimulues për zhvillim të këtij sektori, por që ende duhet të ketë një implementim sa më gjithëpërfshirës me qëllim që të gjeneroj zhvillim ekonomik dhe këtë ndikim tek pozita sociale. Gjithashtu valuta Euro ka bërë që të ketë rol të rëndësishëm stabilizues ekonomik dhe social. Mirpo me gjithë zhvillimin e arritur mbetet edhe shumë punë për tu bërë ku mund të kualifikojmë disa prej sfidave me të cilat do të përballim ku përfshin sfidat e vendeve që synojnë anëtarësim të plotë në BE (përfshirë edhe Kosovën) lidhen ngushtë me transformimin e ekonomisë/tregut si dhe pasojave nga këto transformime. Sfidat kryesisht rrjedhin nga kompleksiteti i organizimit të tregut mirëpo edhe nga nevoja për të harmonizuar këto politika me vendet e tjera të BE-së. Kosova duhet angazhuar që ta rrisin shkallën e punësimit, (Drejtorati për Punësim, Qështje Sociale dhe Përfshirje, 2011), të përkrahin ristrukturimin e ekonomisë përmes masave aktive në treg që mundësojnë punëtorëve adoptimin në ndryshimet ekonomike dhe transformimin nga ekonomi në rënie në industri moderne, investimi në burime njerëzore, fuqizimi i kapaciteteve administrative të nevojshme për të zhvilluar dhe zbatuar politikat e punës dhe punësimit, që është pjesë e strategjisë së gjithëpërfshirë ekonomike, me theks të veçantë në përgatitjet për zbatimin e Fondit Social Evropian (ESF); (Drejtorati për Punësim, Qështje Sociale dhe Përfshirje, 2011). Dhe në fund mund të them se gjatë gjithë punimit jam ballafaquar vazhdimisht me tendencën se si politikat ekonomike diktojnë jetën e njerzve, gjë që për shtresat sociale kjo do të ketë si avantazhe po ashtu edhe disavantazhet, të shoqëruara me politikat të cilat japin drejtimin e jetës dhe zhvillimin e kapitalit njerzror, gjë që luan rol në zhvillimin dhe demokratizimin e përgjithshëm të shtetit. Se si do të jetë situata në të ardhmen qfarë politikash duhet të ndjek për t'i arritur qëllimet e një shteti të zhvilluar, ku zhvillimi ekonomik dhe social duhet të paraprijë reforma ekonomike, kohezioni social, zhvillimi i infrastrukturës lokale, arsimit dhe sundimi i legjislativës vendor dhe atë ndërkombëtar na mbetet që të shihet në të ardhmen.

5.0. Bibliografia

- Paul R.Krugman , Maurice Obstfeld . “*Ekonomia ndërkombëtare teoria dhe politika ekonomike*” , Prishtinë, 2010
- Manqellari, Ahmet , “*Tregtia ndërkombëtare (Teori dhe Politika)*” ,Toena , 2004
- Skenderi,Nagip .”*Ekonomia dhe Politika Botërore*”, Universiteti Daradania ,Prishtinë, 2007
- Rosen, Harvey S. “*Financat publike*” Tiranë,2003
- Manqellari, Ahmet , “ *Hyrje në Ekonomi* “
- Prof.Dr. Kristo, Ilia, “ *Biznesi Ndërkombëtar* “ Tiranë 2004
- Eco, Umberto , “*Si shkruhet një punim diplome*”, SHB Dituria, 2006.
- Prof.Dr. Jakupi, Ali, “ *Metodologjia e Punës Shkencore Kërkimore* , Ligjerata të autorizuara , Prishtinë . 2005
- Oakes dhe Lipton, “*Teaching to Change the World*”, 2003.
- Klooster D., Preece A., “*Crafting a Pedagogy for Change*”, 2002 .
- Prof.Dr Zeqiri, Izet “*Organizimi Institucional dhe Planifikimi Sreategjtk I Zhvillimit Ekonomik Lokal*”,2010.
- Komisioni Evropian, *Rruga Drejtë Integrit – Bashkimi Evropian dhe Ballkani Përndimor*,2003.
- DuaLibra ,Leksione I, *Integrimi Ekonomik* ,2010.
- Ardian Civici “*Shteti apo tregu - Kush na e garanton zhvillimin?*” Gazeta Shqip 2006
- “*Perse është e nevojshme ndërhyrja e shteti në ekonomi*”, Shqip ,2012
- ” *Roli I Shtetit në Ekonomi*”, Kolegji Victori , 2010
- Ministria e Ekonomisë dhe Financave ,*Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2011-2013. Prishtinë* ,2010
- Instituti Ballkanik i Politikave , *Politika Publike në Fushën e Sundimit të Ligjit në Kosovë* , Prishtinë , Kosovë,2011
- Raporti i Grupit të Krizave për Europë Nr.204, *Sundimi I Ligjit në Kosovën e Pavarur* Raporti , 2010
- Disa anketa dhe studime, duke përfshirë edhe raportet e *Lajmërimit të hershëm të Programit për zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe raporteve të progresit të Komisionit Evropian për Kosovën i cikin këto dobësi të sistemit të gjykatave*
- KOSOVA “*Zhbllokimi i potencialit për rritje ekonomike: strategjitë, politikat, veprimet*” Memorandumi ekonomik i shtetit 29 prill 2010 Njësia për zvogëlimin e varfërisë dhe menaxhimin ekonomik Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore Dokument i Bankës Botërore
- Instituti Ballkanik i Politikave, *EULEX: Ende në kërkim të identitetit* (Raporti i dytë përcjellës mbi performancën e EULEX-it). 2010
- Raporti i Shoqërisë Civile në Kosovë, Raporti i Progresit- Made in Kosova (EULEX).
- 53. Raporti i Progresit i BE-së për Kosovën. 2009.
- USAID, “*Manuali i Prokurimit Publik*”, Shqipëri, Botimi i pare, Prill 2007
- Republika e Kosovës, Qeveria, *Plani i veprimit të Partneritetit Evropian 2012* , Prishtinë, 2011

- “*Intimidimi i Gjyqësorit; Siguria e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve*”, departamenti i komuniteteve dhe të drejtave të njeriut të OSBE-së, botimi tretë, prill, 2010.
- KIPRED, *Shqyrtimi i Sektorit të sigurisë së Brendshme të Kosovës*, 2006
- Ministria e Administratës Publike , *Strategjia e Reformës së Administratës Publike (2010-2013)*, Prishtinë,2010
- Agjencia për Promovimin e Investimeve në Kosovë Kosovë
- UNDP,Zhvillimi dhe tranzicioni,“ *Zhvillimi i sektorit privat Kosovë*” Kosovë , 2007.
- Qeveria e Kosovës, *Strategjia e zhvillimit të NVM në Kosovë 2012-2016 me Vizion 2020* , Prishtinë , 2011
- Rininvest , *Qëndrueshmëria Ekonomike e Kosovës (Sfidat, Politikat dhe Mundësitë)*,Prishtinë 2005
- UNDP, Qytetari . *Sfidat dhe Mundësit. Raporti I Zhvillimit Njërzorë*. Kosovë, 2004
- *Arsimi Bazik Cilësor në Funksion të Zhvillimit Njërzor* (Raport nga Hulumtimi) ,Prishtinë, 2006

NDIKIMI I KRIZES EKONOMIKE DHE FINANCIARE NE BISNESET KOSOVARE DHE MASAT E NDERMARRA NGA QEVERIA

Skender Hasani⁴²

University College “Vision for education”, Ahmet Kaqiku ,
70000 Ferizaj – Kosovo, skender_hasani@yahoo.com

Abstract

Ekonomia e vendeve te Ballkanit ne përgjithësi dhe Kosova ballafaqohen me sfida te mëdha dhe nevojiten ndërmarrja e reformave substanciale me qellim qe te rritet konkurrueshmeria e prodhimeve te vendeve ballkanike jo vetëm ne tregun Ballkanik por me gjere ne atë evropian dhe botëror. Krizat e ndryshme ekonomike dhe financiare kane ndikim te madhe ne zhvillimin e përgjithshëm prandaj vendet te cilat kane një ekonomi te brishte, sektor privat jo shume te zhvilluar, shkalle te larte te informalitetit ne ekonomi, mungese te investimeve te huaja dhe një numër te madhe dobësish te tjera duhet te jene shume vigjilente dhe qe te gjitha kapacitet e tyre ti angazhojnë ne përbalimin sa ma te lehte dhe ma te shpejte te këtyre vështërsive dhe qe nga këto kriza ciklike te dalin me sa pak dëme për ekonomin ne tërësi dhe bizneset vendore ne veçanti.

Si tek një numër i madhe i vendeve kriza ekonomike dhe financiare ka prekur edhe bizneset kosovare te cilat ballafaqohen me vështërsi te shumta siç janë mungesa e stimujve fiskal nga qeveria, mungesa e një infrastrukture ligjore për mbrojtjen e tyre nga rrethanat dhe situatat e pa parashikuara, konkurrenca jo e ndershme, norma te larta te kamatave kreditore, mos mundësia e shfrytëzimit te kuadrit profesional te dëshmuar ne bote dhe disa faktorë te tjerë te cilët kane ndikuar qe ende ekonomia kosovare është e varur shume nga importi e shume pak ka rritur prodhimtarin e vet.

Qeveria e Kosovës sado qe ka ndërmarrë disa reforma për tejkalimin e krizës ekonomike dhe ka tentuar qe te bej disa reforma qe do ti jepnin një frymëmarrje bizneseve kosovare prapëseprapë këto veprime mbeten te mangëta nga ato qe është dashur te bej dhe munde te bej shteti ne kushtet e tanishme ku biznesi ne Kosove ka nevoje jetike për reforma gjithë përfshirëse dhe dobi prurës. Prandaj ne me këtë punim dëshirojmë te potencojmë hapat qe janë ndërmarrë deri me tani dhe duhet ndërmarrë ne te ardhmen per krijimin e nje klime te favorshme dhe konkurruese për bizneset kosovare.

Keywords: ekonomia, bizneset, politikat fiskale, konkurrueshmeria, reforma

⁴² e-mail: skender_hasani@yahoo.com

HYRJE

Biznesi dhe ekonomit e vendeve te ndryshme kohe pas kohe kalojnë periudha te krizave te ndryshme te cilat kriza ndikojnë ne zhvillimin e përgjithshëm shoqëror te shteteve. Nisur nga fakti se tani bota ka ndryshime rrënjësore si rezultat i globalizimit ne te gjitha sferat e jetës e me këtë edhe ne ekonomi ku mundësit për transferim te kapitalit nga njeri vend ne vendin tjetër janë shume te mëdha atëherë edhe mundësitë qe rrjedhjet ciklike te ndonjë krize ne një hapësirë te caktuar ne bote te ketë ndikim edhe ne pjesën tjetër si rezultat i bashkëpunimit ne mes te ekonomive te vendeve te ndryshme është mjaft e madhe. Edhe Kosova qe karakterizohet me një ekonomi te brishte, pa tregje financiare, me një deficit te madhe tregtar sado qe munde te theksohet se nuk është prekur nga ndikimet e krizave te kohëpaskohshme ajo prapëseprapë ka pasur ngecje ne disa sektor si rezultat i këtyre krizave apo edhe si rezultat i mos marrjes se masave adekuate me qellim qe te zbutet efektet negative qe kane pasur ndikim ne ekonominë vendore.

Me rëndësi te madhe është qe te dihen apo te maten indikatorët e hershem te paraqitjes se krizave ngase sa me herët qe te munde te shihen ne sipërfaqe tendencat e paraqitjes se ndonjë krize atëherë edhe mundësitë për te ndërmarrë masat anti krize janë me te madhe. Prandaj munde te konkludojme se ne përgjithësi kKriza është një risk i karakterit sistematik që prek dhe cenon aktivitetin ekonomik të të gjitha subjekteve që ushtrojnë aktivitet prandaj edhe analizimi dhe zbulimi real i fakteve kërkon që të ndërjegjësojë të gjithë bizneset, korporatat, investitorët e mundshëm , kompanitë tregtare dhe prodhuese dhe te gjithë institucionet shtetërore dhe grupimet e ndryshme te bizneseve, shoqatave të biznesit dhe dhomave të tregtisë, se kriza është në një farë mënyre, një lloj epidemie, që prek në mënyrë sistematike të gjithë, pa përjashtim.

Normalisht mundësitë e ndikimit të krizave te kohëpaskohshme në aktivitetin ekonomik të një shoqërie tregtare apo korporate dhe intensiteti i ndikimit te saj është i ndryshëm ne korporata te ndryshme por ajo gjithsesi do te prek biznese te shumta . Se sa do te preket një korporate bisnesore nga efektet e një krize varet nga një numër i madh faktorësh që kanë të bëjnë me sektorin ku ushtron aktivitet një korporate , varet nga struktura e aktivitetit të korporatës, varet nga mundësia e korporatës qe te bej përshtatjen e veprimtarisë së saj me veprimtari të tjera, varet nga fakti se cfarë kapitali apo burimesh financimi përdor për te financuar aktivitetin e vet primar apo ndryshimet lidhur me përshtatjen e veprimtarisë se tyre si dhe nga një mori faktorësh tjerë te cilët munde te kenë impakt ne aktivitetin e përgjithshëm te korporatës.

Dihet se Kosova sikur edhe shtetet e tjera te rajonit te Ballkanit karakterizohet me mungese te tregjeve financiare siç është rasti i Kosovës apo me tregje financiare jo shumë të zhvilluara siç është rasti me disa vende te tjera te Ballkanit por edhe përkundër kësaj nuk munde te themi se rajoni i Ballkanit është rajon i mbyllur apo se ekonomia e Kosovës është një ekonomi e mbyllur. Ekonomia Kosovare karakterizohet me një shkalle te larte te importit te mallrave dhe shërbimeve nga vende e ndryshme prandaj munde te konstatojmë se sado qe kemi një deficit te madhe tregtar kanalet e komunikimit të ekonomisë se Kosovës me atë te rajonit, Evropës dhe më gjerë janë mjaft të shumta. Ekonomia e Kosovës sikurse ajo e vendeve te ndryshme të

Ballkanit karakterizohet me ekonomi të bazuara te bizneset e vogla te cilat nuk kane ndonjë baze te qëndrueshme për financimin e periudhave kur mund te paraqiten situata te krizave dhe aktiviteti i tyre nuk është imun ndaj krizave.

QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E STUDIMIT

Qëllimi i këtij punimi është qe te shqyrtohen hapat qe janë marre nga qeveria e Kosovës me qellim te ndihmëses se bere për bizneset kosovare me qellim qe ata te kalojnë me lehte ciklet e krizave te tyre biznese apo te krizave te cilat ato biznese munde te kenë nga ndikimi i faktorëve te jashtëm pasi qe ekonomia kosovare kryesisht bazohet ne importe prandaj edhe ndikimi i krizave nga vendet tjera munde te ketë ndikim për biznese te cilat afarojne me biznese te vendeve te regjionit dhe me gjere.

Sado qe thuhet se kriza financiare e vitit 2008 dhe ato te mëvonshme nuk kane pasur ndikim ne ekonomin Kosovare ngase ekonomia e Kosovës nuk ka tregje financiare dhe nuk ka pjesëmarrje te madhe te eksporteve Kosovare ne tregjet tjera prapëseprapë munde te konkludojme se kjo krize dhe krizat e tjera kane pasur dhe do te kenë edhe ne te ardhmen ndikim ne ekonomi dhe me te edhe ne bizneset Kosovare.

Derisa një pjese e vendeve te regjionit gjate periudhës se krizës kane qene ne recesion ne jemi kënaqur me rritjen ekonomike prej 2 – 5 % qe është sillur nga viti 2008 deri ne vitin 2013. Kjo rritje ekonomike marre parasysh shkallen e larte te papunësisë qe ekziston ne Kosove, shkalle te larte te varfërisë, mos konkurruesmerise se prodhimeve vendore me ato te regjionit dhe një mori pengesash te tjera nuk lejojnë një komoditet por kërkojnë nga qeveria nga njëra ane marrja e hapave drastik ne një mori sferash te ndryshme ekonomike duke kërkuar reforma strukture ne legjislacion, infrastrukture tjetër dhe ne një mori dikasteresh qeveritare te cilat do te ndihmonin bizneset Kosovare një rimëkëmbje te shpejtuar e cila do te kishte efekte zingjirore ne ekonominë Kosovare ne tërësi. Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë disa reforma biznese qe ka bere qe qe Kosova te ketë një ngritje ne ranglistën e te berit biznes por nuk ka bere reforma tjera apo thënë me mire kane qene te mangëta aktivitetet e tjera te cilat u mundësojnë bizneseve lehtësira te ndryshme për te bere biznes.

Njohja e krizës dhe vlerësimi i plotë i efekteve të saj është e lidhur me faktin që shpesh herë reagimi duhet të jetë në bllok. Bizneset që kanë vështirësi dhe rënie për shkak të ciklit të jetës së biznesit, sikurse është në përgjithësi sektori i ndërtimit në vendin tonë, kanë problematikë tjetër me problematikën e bizneseve që kanë aktivitet të fokusuar në sektorin ushqimor, apo me bizneset që janë të fokusuara në sektorin e turizmit. Gjithsesi reagimi dhe mbrojtja e interesave duhet të jetë në grup. Shpesh herë, njerëzit e politikës, ndonjëherë edhe të medias, dhe në ndonjë rast edhe të biznesit, i trajtojnë problemet e krizës si të shkëputura, ose si të njëanshme. Krizat dhe kapërcimi i tyre kërkojnë një shkallë të lartë ndërveprimi midis sektorit publik dhe atij privat. Politika publike të zgjuara janë ato që e konsiderojnë biznesin privat si partner të tyre. Një biznes privat aktiv dhe që zhvillohet e rritet shpejt është një bazë e shëndoshë dhe e fortë për një buxhet të konsoliduar të shtetit, dhe e kundërta një biznes në vështirësi ka nevojë për një klimë inkurajuese dhe për përkrahjen publike, fiskale apo administrative.

Disa nga elementet te cilat kane pasur ndikim ne bizneset Kosovare kane qene si ne vijim:

Së pari, rënia e ndjeshme e konsumit familjar mungesa e mjeteve financiare ne ekonomike familjare

Së dyti, normat e larta te kamatave kreditore kane pasur efekt negativ ne financimin e bizneseve

Së treti, përdorimi i mjeteve nga remitencat kryesisht për konsum por jo edhe për investime direkt ne kapacitete ekonomike.

Se katërti rritja apo mos zbutja e shkalles se papunësisë

Se pesti alokimi i një pjese te madhe te buxhetit te shtetit ne infrastrukturën rrugore por jo edhe ne alokime ne kapacitete prodhuese te cilat do te kishin pasur ndikim ne zhvillimin e përgjithshëm ekonomik

Së shtati, rritja e përqindjes së kredive të pakthyera në kohë, është një parametër që shpreh një shqetësim real dhe mat më mirë faktin që ekonomia është në vështirësi

Katër vitet e fundit (2008-2011) kanë qenë vitet më të vështirat për ekonominë ndërkombëtare dhe atë të Bashkimit Evropian, që nga kriza botërore e vitit 1939. Kriza ndërkombëtare e viteve të fundit ka qenë më e theksuar në BE, pasi që Evropa, përveç krizës financiare ndërkombëtare, u përball edhe me krizën e deficiteve buxhetore të vendeve anëtare, duke filluar nga Greqia, Italia, Irlanda, Portugalia, Hungaria, vendet baltike etj. Por gjate kësaj periudhe edhe pse kishim te bëjmë me një krize ne këto vende remitencat e Kosovareve nuk shënuan rënie. Me përjashtim të vitit 2009, kur remitencat shënuan një rënie simbolike, në vitet e tjera dërgesat në Kosovë vazhdimisht kanë shënuar rritje dhe ato silleshin mbi 500 milionë euro në vit, të dhëna të konfirmuara nga Banka Qendrore e Kosovës. Sipas Bankës Qendrore të Kosovës, dërgesat e emigrantëve në Kosovë kanë vazhduar të rriten me 1.2% edhe në gjashtëmujorin e parë të vitit 2011. Edhe në vitin 2010 remitencat në Kosovë janë rritur për 1.3%.

Këto dhe një mori faktorësh te tjerë janë përcaktues edhe për aftësin e bizneseve Kosovare për te bere biznes dhe disa nga këta faktor janë faktor ne te cilët qeveria nuk ka pasur mundësi te ndikoj si sasinë e remitencave por ka mundur te ndikoj ne kanalizimin tyre ne te mire te investimeve e jo ne konsum i cili kryesisht behet me mallra nga importi.

Qeveria nuk hap vende te reja pune por krijon mundësin për hapjen e tyre me qrast do te zvogëlohej shkalla e papunësisë dhe me te edhe zvogëlimi varfërisë dhe efektet tjera zingjyrore ne bizneset vendore. Kanalizimi i buxhetit ne disa projekte te mëdha infrastrukturore por jo edhe ne projekte qe do te ndikonin rritjen e kapaciteteve prodhuese te bizneseve Kosovare dhe me te edhe zvogëlimin e varshmërisë te prodhimeve nga importi janë disa elemente te cilat është dashur dhe duhet urgjent te merren nga institucionet relevante shtetërore. Kosova ka mundësi te mëdha për prodhime bujqësore dhe për ndërtimin e kapaciteteve përpunuese te këtyre produkteve me rast do te mundësonte jo vetëm zvogëlimin e importit te këtyre produkteve por rritjen e punësimit te një numri te madhe te popullatës duke përfshirë ato ne kapacitetet agrare dhe industriale.

Deri me tani disa nga hapat te cilët janë ndërmarre nga institucionet qeveritare janë si :

1. Subvencionimi i disa veprimtarive me theks ne bujqësi
2. Lehtësimi dhe shpejtimi i procedurave për regjistrim te bizneseve
3. Lehtësimi i disa procedurave doganore
4. Garantimi i depozitave deri ne 2000 Euro
5. Zvogëlimi i tatimit ne te ardhura bisnesore

Por ndërmarrja e këtyre hapave nuk ka pasur efektet e pritura ngase prapëseprapë prodhuesit Kosovar dhe me te edhe bizneset Kosovare janë ballafaquar me vështersi te shumta te cilat kane pasur rol përcaktues qe edhe pse janë bere disa veprime dhe reforma nga institucionet qeveritare ato prapëseprapë nuk kane luajtur efektin qe është menduar nga qeveria.

Nëse analizojmë vetëm efektet e reformave te paraqitura me larte munde te konkludojme se ata hapa nuk kane mjaftuar dhe kane qene te mangët ngase jemi ne një shtate ku:

1. Shkalla e subvencionimit te aktiviteteve bujqësore nuk ka krijuar kushte qe prodhimet vendore te jene konkurrenente ndaj atyre te importit si për nga çmimi ashtu edhe për nga cilësia.
2. Lehtësimi i procedurave te regjistrimit te bizneseve nuk është shoqëruar edhe me lehtësirat tjera ne marrjen e lejeve tjera te nevojshme për te zhvilluar aktivitetin për te cilën kane investuar kapitalin e tyre.
3. Lehtësimi i procedurave doganore nuk ka arritur te ndal ekonomin joformale e cila zhvillohet kryesisht nga mallrat e importit ngase raporti import eksport sot është 88 / 12.
4. Edhe pse ka garantuar depozitat deri ne 2000 ne ende kemi normat me te larta te kamatave ne regjion dhe me gjere e qe kjo drejtpërdrejte ndikon edhe ne veshtersit e financimit te projekteve te ndryshme nga ana e bizneseve Kosovare.
5. Zvogëlimi i tatimit ne te ardhura te korporatave nga 20 % ne vitin 2009 ne 10% nuk është shoqëruar edhe ne luftimin e ekonomisë joformale ku sipas statistikave te institucione te ndryshme kjo norme e ekonomisë sillet nga 28 – 33 % te bruto prodhimit te përgjithshëm qe ne Kosove për vitin 2013 ka qene 5,800,000.00 Euro

Kosova edhe përkundër këtyre masave te ndërmarra nga ana e Qeverise ballafaqohet me shkalle te larte te importeve ne krahasim me eksportet qe jep me kuptua se nevojit angazhime shtese me qellim te stimulimit te prodhimtarisë vendore.

Tabela 1: Eksportet dhe importet e Kosovës me të gjitha vendet

Viti	Eksport	Import	Diferenca	Përqindja e mbulimit
2004	56,567	1,063,347	-1,006,780	5.3
2005	56,283	1,157,492	-101,209	4.9
2006	110,774	1,305,879	-1,195,105	8.5
2007	165,112	1,576,186	-1,411,074	10.5
2008	198,463	1,928,236	-1,770,213	10.3
2009	165,328	1,935,541	-1,770,213	8.5
2010	295,957	2,157,725	-1,861,769	13.7
2011	319,165	2,492,348	-2,173,184	12.8
2012	276,100	2,507,609	-2,231,509	11.0
2013	293,919	2,450,363	-2,156,444	12.0

Burimi: MTI, Tregtia e Kosovës;2014; faqe 8

Por shtate me eksporte dhe importe e Kosovës nuk qëndron mire as me vendet e rajonit ku Kosova me te gjitha vendet ka deficite tregtar.

Me poshtë japim tabelat mbi eksportet dhe importet e Kosovës me vendet e rajonit për gjashte mujorin e pare te vitit 2012 dhe 2013.

Tabela 2: Eksportet e Kosovës, gjashtëmujori i parë 2012/2013 në vendet e Rajonit , Vlerat në 000 €

Viti	Janar - Qershor 2012	Janar - Qershor 2013
Shqiperia	18,850	20,412
Maqedonia	12,821	12,634
Mali i Zi	8,443	9,449
Serbia	6,890	5,897
B e H	992	1,632
Kroacia	1,266	1,562
Moldavia	9	7
Gjithsej Eksporte	49,271	51,593

Burimi:MTI, Raporti i shkëmbimeve tregtare janar - qershor 2013,faqe 6

Siç shihet nga tabela me larte Shqipëria është destinacioni më i rëndësishëm për eksportet e Kosovës, duke mbuluar mbi 13% të eksporteve të përgjithshme. Importet nga Shqipëria janë mbi dy herë më të larta se eksportet, por krahasuar me vendet tjera të rajonit, importet prej Shqipërisë janë ende në nivel të ulët.

Karakteristikë kryesore e shkëmbimeve tregtare të Kosovës me Shqipërinë është rritja e tyre nga viti në vit, si në importe ashtu edhe në eksporte.

Tabela 3: Importet në Kosovë, gjashtëmujori i parë 2012/2013 nga vendet e CEFTA-s, ku vlerat janë në 000 €

Viti	Janar - Qershor 2012	Janar - Qershor 2013
Shqiperia	42,851	54,131
Maqedonia	137,734	87,830
Mali i Zi	3,619	3,907
Serbia	117,710	126,005
B e H	35,970	33,503
Kroacia	31,985	47,426
Moldavia	35	40
Gjithsej Importe	369,907	352851

Burimi: MTI,Raporti i shkëmbimeve tregtare janar - qershor 2013,faqe 7

Në Raportin e Progresit të KE-së për Kosovën 2010 janë identifikuar tri barrier kryesore me të cilat përballen bizneset në Kosovë:

Barriera e parë ka të bëjë me furnizim jo të qëndrueshëm me energji elektrike dhe me ujë të cilat janë posaçërisht serioze për NVM-të prodhuese.

Gjithashtu, si një prej barrierave kryesore për zhvillim të shpejtë të NVM-ve është caktuar edhe qasja e kufizuar në financa.

Barriera e tretë është sundimi i pamjaftueshëm i ligjit, i cili ka ndikim të gjithë qytetarët e Kosovës.

PYETJA KERKIMORE – METODOLOGJIA E PUNIMIT

Qëllimi i këtij punimi është që të shihet se cilat hapa konkret kanë marrë institucionet shtetërore me qëllim që ekonomia Kosovare si tërësi dhe bizneset në veçanti jo vetëm të mos preken nga ciklet e krizave të ndryshme që përfshijnë bizneset por edhe të ndihmohet bizneseve në tejkalimin e vështërsive të tyre të kohëpaskohshme që janë si rezultat i atyre rrjedhave. Në jemi dëshmitar se si rezultat i krizës financiare të vitit 2008 jo vetëm në SHBA por edhe në shumë vende të tjera evropiane sado që kemi të bëjmë me një ekonomi liberale prapëseprapë u desh të ndërvoj shteti në sistemin bankar cofte duke ndihmuar financiarisht shumë banka të mëdha me qëllim të shpëtimit të tyre nga falimentimi apo të ndërvoj në krijimin e një legjislacioni të tillë në mënyrë që situatat e tilla të mos përsëriten në të ardhmen.

Nisur nga kjo edhe institucionet relevante Kosovare kanë tentuar që të ndërmarrin një mori hapash konkret që do të krijonin një klimë më të favorshme të biznesit, që të krijonin mundësinë që bizneset kosovare të jenë të barabarta me kushtet e të bërit biznes që u ofrohen bizneseve në vende të tjera por që nga përgjigjet e marra nga një mori biznesesh Kosovare munde të vlerësojmë se bizneset nuk janë të kënaqur me hapat e ndërmarrë nga institucionet dhe pengesat që paraqiten në afarizmin tyre qofte për shkak të mungesave në legjislacion apo edhe për shkak të moszbatimit të legjislacionit nga organet kompetente shtetërore.

Me qëllim të analizimit të këtyre hapave të ndërmarrë nga institucionet relevante dhe analizimit të situatës të bërit biznes në Kosovë në kemi përgatitur një pyetësor dhe kemi dërguar tek një numër i konsiderueshëm i bizneseve Kosovare nga të cilët kemi kërkuar që të përgjigjen në një numër pyetjesh të cilat kemi menduar se janë relevante dhe japin një pamje më të qartë të situatës së tyre dhe perceptimit të tyre për hapat e ndërmarrë nga qeveria. Nga numri i përgjithshëm prej mbi 10000 bizneseve të regjistruara në regjionin e Prishtinës dhe të cilat zhvillojnë afarizëm (informatat e marra nga Administrata Tatimore e Kosovës) në kemi analizuar informatat e kthyera nga 100 biznese të veprimtarive të ndryshme të cilët kanë dhënë përgjigjet dhe perceptimin e tyre mbi të bërit biznes, vështërsive të tyre dhe elementeve tjera që përcjellin aktivitetin e tyre të përditshëm.

ANALIZA – INTERPRETIMI I TË DHËNAVE

Me qëllim të realizimit të këtij punimi në kemi bërë intervistimin e 100 bizneseve të veprimtarive të ndryshme kryesisht nga Prishtina ngase ajo edhe është qendra më e madhe ekonomike e Kosovës ku drejtuesve të bizneseve iu kemi parashtruar disa pyetje në të cilat ata janë përgjigjur kryesisht me Po ose Jo

1. A mendoni se të bërit biznes në Kosovë është e vështirë ?

Po	98
Jo	2

2. A keni rritje të qarkullimit nga viti 2008 e këndeje?

Po	54
Jo	46
3. A keni rritje te punësimit nga viti 2008 e këndej?	
Po	32
Jo	68
4. A keni rritje te profitit nga viti 2008 e këndej ?	
Po	32
Jo	68
5. A mendoni se Qeveria ka ndërmarrë hapa te mjaftueshme për kalimin e vështersive biznesore ne Kosove?	
Po	7
Jo	93
6. A keni përfituar ndonjë subvencion apo grant nga Qeveria e Kosovës?	
Po	26
Jo	74
7. A mendoni se kushtet e te berit biznes ne Kosove janë me te favorshme se ne vendet e regjionit?	
Po	19
Jo	81
8. A mendoni se infrastruktura ligjore mjafton për mbrojtjen e investimeve te juaja ne Kosove?	
Po	34
Jo	66
9. Po te kishit pasur mundësi a do te transferonit afarizmin e juaj ne ndonjë vend te regjionit apo me gjere?	
Po	74
Jo	26
10. Ku mendoni se Qeveria duhet te ndërhyj ne mënyrë qe te krijohet një klime me e favorshme për biznese?	
Politika fiskale	29
Infrastruktura tjetër ligjore	20
Sistem kreditor	38
Te tjera	13

Nga informatat e marra nga intervistat e zhvilluara me një numër te konsiderueshëm te bizneseve munde te theksojmë se pjesa me e madhe e tyre nuk janë te kënaqur me kushtet qe ekzistojnë për te bere biznes ne Kosove dhe mendojnë se te berit biznes është mjaft e

vështirë dhe kjo nuk vjen si rezultat i një sistemi të taksimit në Kosovë që marrë në tërësi ngarkesat fiskale në Kosovë janë mjaftë të vogla por kjo vështërsi shkaktohet nga elementet tjera përcjellëse të aktiviteteve biznesore siç janë:

Shkallë mjaftë e lartë e ekonomisë joformale e cila ndikon në një konkurrencë jo lojale në krahasim me bizneset të cilat zhvillojnë aktivitetet e tyre në përputhje me rregullat dhe legjislacionin e zbatueshëm në Kosovë.

Mungesat e një sistemi gjyqësor efikas dhe të besueshëm në zgjidhjen e kontesteve të ndryshme ndërmjet bizneseve

Sistem kreditor jo të favorshëm për bizneset

Dhënia e subvencioneve dhe granteve për një ekonomi të qëndrueshme në baze të disiplinave që janë më se të nevojshme e jo në baze të parametrave jo të analizuar si duhet.

KONKLuzion - REKOMANDIM

Nga të dhënat e marruna si nga intervistat e zhvilluara me një numër të madhe biznesesh apo edhe të marruna nga institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë mundë të konkludojmë se hapat e ndërmarrë nga institucionet relevante shtetërore kanë qënë jo të mjaftueshëm për krijimin e një klime të qëndrueshme të bërit biznes në Kosovë prandaj edhe kjo situatë ka ndikuar që të kemi vështërsi të theksuara të bizneseve dhe kjo ka ndikuar që një pjesë e bizneseve të ndërprejnë veprimtarinë e tyre, një pjesë tjetër të transferojnë aktivitetin e tyre në vendet tjera të regjionit dhe një pjesë të punojnë më vështërsi të shumta të cilat mundë të ndikojnë që në të ardhmen të kenë fatin e disa bizneseve që janë mbyllur apo transferuar kapitalin e tyre jashtë shtetit.

Prandaj nisur nga këto mundë të konstatojmë se nevojiten ndërmarrja e disa reformave substanciale me qëllim të krijimit të kushteve që bizneset që zhvillojnë aktivitetet në Kosovë të jenë të barabarta me ato nga regjioni dhe më gjere e këto hapa që duhet ndërmarrë janë:

1. Reforme më të thelle strukturore nga ana institucioneve relevante – Shkurtimi i procedurave burokratike për marrjen e licencave të ndryshme
2. Luftimi i ekonomisë jo formale dhe korrupsionit
3. Krijimi i kushteve infrastrukturore jo vetëm në atë rrugore por furnizimi me energji, ujë dhe elemente tjera që janë të domosdoshme për krijimin e një stabilitetit për bizneset që zhvillojnë aktivitetet në Kosovë
4. Shfrytëzimi i kapaciteteve intelektuale dhe më përvojë nga fushat e ndryshme të bizneseve
5. Krijimi i kushteve për investime të huaja direkt

Bibliografia:

- Enti Statistikor I Kosovës „Statistikat Ekonomike Bruto produkti vendor në qasjen e shpenzimeve (2008-2013)”, Prishtinë , Shtator 2014

- *Tryeza Tematike Nr. 4 për Tregti, industri, dogana, tatime, treg të brendshëm, konkurrencë, mbrojtje të konsumatorit dhe atë shëndetësore, Nëntor 2012 Prishtine,*
- International Monetary Fond, Republika e Kosovës disa qeshtje te zgjedhura, 28 qershor 2013
- Strategjia për bashkëpunim e Usaidit për zhvillimin e vendit Kosove 2014 -2018,
- Qeveria e Kosovës, *Vizioni dhe Plani i Veprimit për Zhvillim Ekonomik (VPVZhE),* prill 2011
- Shyqyri Kelmendi, *Resurset Natyrore, Baza për Zhvillimin Ekonomik Kombëtar,* 2012
- USAID, *Studim mbi Efektin e Furnizimit të Parregullt me Rrymë Elektrike në Bizneset Kosovare, Nëntor 2012*
- 8 Moujaes, Chadi N.; Najjar, Mazen Ramsay; Shediak, Richard; Ghaleb, Joey, *Elastik,*
- *Stabil, i Qëndrueshëm: Përfitimet nga Diversifikimi Ekonomik,* Booz & Company, Maj 2011
- Banka Botërore, *Treguesit e Zhvillimit Botëror 2012*
- Banka Botërore, *Raporti i të Bërit Biznes 2013*
- USAID, *Diagnozë e Rritjes në Kosovë: Analizë e Pengesave,* Shtator 2012

KORRELACIONI I EKONOMISË SË KOSOVËS ME DISA EKONOMI TË TJERA ME TË CILAT KA INTENSITET MË TË LARTË MARRËDHËNIESH EKONOMIKE DHE TREGTARE

Mr. Azem Duraku

Adresa: Rr. Eqrem Qabej p.n., Prishtinë

azemduraku@hotmail.com

Hyrje

Me shpalljen e pavarësisë së shtetit në shkurt të vitit 2008 dhe me sigurimin e njohjeve nga shumica e shteteve të rajonit Kosova ngriti statusin edhe legjitimitetin e saj në rajon. Si rezultat, Kosova arriti që të veproj dhe bashkërendoj aktivitetet e saja ekonomike dhe politike në përgjithësi me shtete tjera të rajonit si e barabartë së paku me ato shtete që e njohën statusin e saj si të pavarur.

Madhësia ekonomike e Kosovës nuk përbën më shumë se 0.43% të ekonomisë së përgjithshme të rajonit. Kjo më shumë është për arsye të mungesës së zhvillimit të brendshëm ekonomik, gjegjësisht mungesës së sektorit të prodhimit, që nuk arrin as për së afërmi ta ngopë as konsumin e brendshëm, i cili mbulohet kryesisht nga importet të cilat për shkak që rrisin deficitin tregtar (që ka arritur në më shumë se 2.2 miliard Euro apo rreth 45% të madhësisë ekonomike) ajo ndikon edhe në zvogëlimin e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB)⁴³. Kjo ndikon që Kosova të jetë me një ekonomi shumë të vogël, por edhe një ekonomi e cila nuk merr pjesë me prodhim në këtë rajon por kryesisht konsumon nga ai.

Përpos sfidave të saja ekonomike dhe tregtare karshi rajonit, këto sfida bëhen edhe më të rënda për shkak se në rajon ka 5 shtete të cilat nuk e kanë njohur Kosovën si të pavarur (Serbia, BeH, Rumania, Greqia, dhe Moldavia)⁴⁴, dhe si rezultat kanë ashpërsuar qasjen e Kosovës në tregjet e këtyre vendeve të cilat përbëjnë (rreth 32% të popullsisë së rajonit dhe 33.44% të ekonomisë së saj, apo thënë ndryshe këto vende së bashku përbëjnë një ekonomi rreth 3 herë më të madhe se asaj të CEFTA-së në përgjithësi). Marrëdhëniet e cunguara politike të këtyre shteteve të rajonit që nuk e kanë njohur Kosovën, kanë pasur si efekt edhe në prishjen e marrëdhënieve të tyre ekonomike e tregtare me Kosovën. Edhe pse shtetet jo-njohëse kryesisht kanë pasur qasje pothuajse bllokuese ndaj Kosovës, sidomos në aspektin ekonomik e tregtar, Kosova përkundrazi nuk ka aplikuar ndonjë masë mbrojtëse apo edhe ndonjë pengesë në qasjen e këtyre shteteve në tregun e Kosovës.

⁴³ Vlera monetare e të gjitha mallrave të gatshme dhe shërbimeve të prodhuara brenda një vendi në një periudhë të caktuar. Ajo përfshin të gjithë konsumin privat dhe publik, shpenzimet qeveritare, investimet dhe eksportet, minus importet.

⁴⁴ Nga 5 shtetet e rajonit që nuk e njohin Kosovën si shtet të pavarur, tri prej tyre janë anëtar të CEFTA-së: Serbia, BeH, dhe Moldavia, ndërsa dy tjerë janë anëtar të BE-së në rajon, gjegjësisht Rumania dhe Greqia.

Fjalët Kyçe: Shkëmbimet tregtare, marredhëniet tregtare, barrierat tregtare, bilanci tregtar.

Kosova dhe karakteristikat ekonomike në rajon

Në vijim do të prezantohen disa të dhëna ekonomike, kryesisht bazike për qëllime krahasuese, në mes të Kosovës dhe vendeve të rajonit, duke përdorur disa indikator ekonomik. Ekonomitë e rajonit përbëjnë një madhësi ku Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) i përbashkët për vitin 2012 ishte diku përmbi 1.1 trilion Euro.

Shtetet	PBB për kokë banori (€)
Greqia	18,419.32
Sllovenia	17,693.50
Kroacia	9,980.94
Turqia	7,637.49
Rumania	6,101.69
Bullgaria	5,615.20
Mali i Zi	5,125.36
Serbia	3,976.27
Maqedonia	3,921.87
BeH	3,318.23
Shqipëria	3,209.21
Kosova	2,668.11
Moldavia	1,582.87

Burimi: "CIA – The World Factbook",
Central Intelligence Agency,
<https://www.cia.gov/>

Në krahasim me vendet e rajonit ë shënuara më lartë, Kosova përbën një ekonomi ë vogël, ku me madhësinë e saj ekonomike prej rreth 4.9 miliard Euro sa e kishte në vitin 2012, ajo përbën 0.43% të PBB-së së përgjithshme të rajonit, siç shihet në tableën 2. Ekonomia më e madhe në këtë rajon, dhe atë në mënyrë të theksuar, është Turqia e cila përbën më shumë se gjysmën e ekonomisë së përgjithshme të rajonit apo 53.71% të saj me PBB më të cilin shtet viteve të fundit Kosova ka rritur shkëmbimet tregtare si për nga importi dhe eskporti.

Kosova me fqinjët e saj (Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia) kanë një ekonomi prej rreth 55 miliard Euro dhe si të tilla përbëjnë vetëm 4.42% të ekonomisë së përgjithshme të rajonit, siç shihet më lartë në tabelën 2. Ekonomia e dytë me rend mes fqinjëve të Kosovës është ajo e Shqipërisë ku me PBB-në e saj prej rreth 9.6 miliard Euro përfaqëson 17.52% të ekonomive të vendeve fqinje. E treta me rend vjen Maqedonia e cila ka një ekonomi ku PBB-ja e saj për vitin 2012 ishte rreth 8.1 miliard Euro, duke përbërë kështu 14.85% të ekonomive të vendeve fqinje. Ndërsa Kosova me ekonominë e saj prej 4.9 miliard Eurove në vitin 2012, përbën diku rreth 9% të ekonomive të fqinjëve të saj.

Kosova dhe marredhëniet tregtare ma rajonin

Ballkani në tërësi është rajon neto importues, ku tregtia e përgjithshme e rajonit është rreth 658 miliard Euro, nga të cilat rreth 266 miliard Euro (40.42%) shënohen si eksport, ndërkaj rreth 392 miliard Euro (59.58%) shënohen si import, duke bërë bilancin tregtar negativ të rajonit në vitin 2012 prej rreth -126 miliard Euro. Rajoni kryesisht, karakterizohet me tregti mallrash, ku tregtia me mallra përbën 99.98% të tregtisë së përgjithshme, ndërsa tregtia me shërbime përbën vetëm 0.02% apo vetëm rreth 148 milion Euro nga rreth 658 miliard Euro të tregtisë së përgjithshme.

Ngjashëm me madhësinë e saj ekonomike dhe shpenzimet buxhetore, shkëmbimet e përgjithshme tregtare të Kosovës prej rreth 2.8 miliard Eurove përbëjnë vetëm 0.42% të vlerës së përgjithshme të shkëmbimit tregtar të rajonit. Megjithatë, për dallim nga vendet e tjera të rajonit, Kosova ka një bilanc më të çrregullt tregtar ku raporti eksport-import brenda periudhës 2008-2012 ka qenë më shumë në dëm të eksportit. Në vitin 2008 raporti eksport-import ishte 7.41% me 92.59%, ndërsa në vitin 2012 ky raport u rregullua shumë pak për t'u bërë 8.45% me 91.55%.

Tabela 2: Eksporti sipas vendeve (2008-2012), vlera (000 €), %

Vendet	Vitet									
	2008		2009		2010		2011		2012	
	Vlera	%	Vlera	%	Vlera	%	Vlera	%	Vlera	%
27 vendet e BE-së	93.974	47.4%	71.275	43.1%	131.811	44.5%	136.648	42.8%	107.424	38.9%
Italia	25.485	12.8%	46.218	28.0%	80.193	27.1%	83.924	26.3%	71.351	25.8%
Shqipëria	21.113	10.6%	26.182	15.8%	30.841	10.4%	34.566	10.8%	40.180	14.6%
Maqedonia	20.046	10.1%	17.355	10.5%	26.308	8.9%	30.949	9.7%	26.376	9.6%
Mali i Zi	3.77	1.9%	3.084	1.9%	3.92	1.3%	6.988	2.2%	16.759	6.1%
Zvicra	7.380	3.7%	10.510	6.4%	17.786	6.0%	17.611	5.5%	15.133	5.5%
Gjermania	7.205	3.6%	7.563	4.6%	15.587	5.3%	24.144	7.6%	14.995	5.4%
Serbia	9.893	5.0%	3.504	2.1%	3.941	1.3%	7.198	2.3%	14.968	5.4%
Turqia	3.044	1.5%	6.512	3.9%	9.357	3.2%	7.831	2.5%	11.380	4.1%
Kina	31	1.0%	1.596	1.0%	14.779	5.0%	28.268	8.9%	3.266	1.2%
Kroacia	793	0.4%	2.151	1.3%	2.744	0.9%	2.794	0.9%	2.359	0.9%
BeH	5.919	3.0%	1.206	0.7%	1.847	0.6%	612	0.2%	1.974	0.7%
Franca	247	0.1%	639	0.4%	1084	0.4%	1305	0.4%	1852	0.7%
Rumania	43	0.0%	232	0.1%	272	0.1%	987	0.3%	1265	0.5%
Sllovenia	6.304	3.2%	2.882	1.7%	6.203	2.1%	6.001	1.9%	1.417	0.5%
SHBA	286	0.1%	90	0.2%	116	0.0%	182	0.1%	254	0.1%
Greqia	10.851	5.5%	240	0.1%	222	0.1%	194	0.1%	331	0.1%
Të tjera										
Gjithsejt	198.463	100%	165.328	100%	295.957	100%	319.165	100%	276.100	100%

Burimi: Vjetari Statistikor 2014, Agjensia e Statistikave të Kosovës, 2014

Tabela 3: Importi sipas vendeve (2008-2012), vlera (000 €), %

Vendet	Vitet				
	2008	2009	2010	2011	2012

	Vlera	%	Vlera	%	Vlera	%	Vlera	%	Vlera	%
27 vendet e BE-së	701.982	36.4%	755.004	39.0%	825.745	38.3%	946.557	38.0%	978.14	39.0%
Gjermania	196.627	10.2%	246.12	12.7%	280.617	13.0%	293.441	11.8%	304.195	12.1%
Maqedonia	346.536	18.0%	291.387	15.1%	319.313	14.8%	365.961	14.7%	287.739	11.5%
Serbia	208.951	10.8%	210.901	10.9%	260.471	12.1%	254.917	10.2%	278.388	11.1%
Italia	74.385	3.9%	87.646	4.5%	100.603	4.7%	159.444	6.4%	213.469	8.5%
Turqia	128.249	6.7%	141.545	7.3%	150.36	7.0%	184.452	7.4%	199.881	8.0%
Kina	121.059	6.3%	128.318	6.6%	135.406	6.3%	170.285	6.8%	159.651	6.4%
Greqia	81.403	4.2%	79.107	4.1%	96.267	4.5%	103.179	4.1%	109.188	4.4%
Shqipëria	59.632	3.1%	58.385	3.0%	69.714	3.2%	96.400	3.9%	110.528	4.4%
BeH	38.747	2.0%	59.739	3.1%	82.986	3.8%	79.835	3.2%	85.309	3.4%
Kroacia	49.985	2.6%	58.544	3.0%	58.542	2.7%	64.063	2.6%	72.012	2.9%
Slovenia	7.159	3.5%	5.185	3.4%	5.693	3.0%	5.676	2.9%	6.149	2.7%
SHBA	23610	1.2%	26703	1.4%	35311	1.6%	42847	1.7%	46916	1.9%
Franca	37.505	1.9%	27.166	1.4%	33.635	1.6%	34.755	1.4%	24.077	1.0%
Zvicra	32.441	1.7%	21.949	1.1%	20.981	1.0%	22.194	0.9%	22.664	0.9%
Rumania	6.788	0.4%	9.494	0.5%	17.347	0.8%	19.936	0.8%	18.717	0.7%
Mali i Zi	13.789	0.7%	13.059	0.7%	11.454	0.5%	12.232	0.5%	10.510	0.4%
Të tjera										
Gjithsejt	1.928.236	100%	1.935.541	100%	2.157.725	100%	2.492.348	100%	2.507.609	100%

Burimi: Vjetari Statistikor 2014, Agjensia e Statistikave të Kosovës, 2014

Pra shihet se marrëdhëniet tregtare janë rritur më shumë në aspektin e importeve, ku Kosova është bërë vend më i hapur për shtetet jashtë rajonit sesa ato në të. Kjo shihet edhe nga rritja e shkëmbimeve tregtare të paraqitura në tabelën 3 dhe 4, importet janë rritur nga 1.9 miliard Euro në vitin 2008 në afro 2.5 miliard Euro në vitin 2012, ndërsa lehtësisht janë rritur eksportet nga 198 milion Euro në vitin 2008 në afro 276 milion Euro në vitin 2012.

Me gjithë trendin në rritje të këtyre shkëmbimeve tregtare brenda periudhës 2008-2012, vërehet një ulje e lehtë e trendit në vitin 2012 si në tregtinë e përgjithshme ashtu edhe në atë me rajonin. Kjo rënie e përgjithshme e shkëmbimeve tregtare në këtë vit sipas tablës 3 ka ndodhur më shumë për shkak të uljes së eksporteve të Kosovës se sa të importeve në Kosovë. Eksporti nga viti 2011 në vitin 2012 është ulur për -13.50% (nga rreth 319 milion Euro në rreth 276 milion Euro), ndërsa importi është rritur për vetëm 0.6% (nga 2.492 miliard Euro në 2.507 miliard Euro).

Shihet që baza e ulët e eksportit i lejon Qeverisë mundësi të limituara për të hyrë në borxh. Andaj, kjo analizë sugjeron që politikat e Qeverisë duhet të orientohen drejt reformave strukturore që do të ndikojnë në ngritjen e sektorit privat dhe rritjes së bazës së eksportit.


Marrëdhëniet tregtare me shtetin fqinj Shqipërinë janë rritur si për nga importet, po ashtu edhe nga eksportet. Importet janë rritur nga 59 milion Euro në vitin 2008 në afro 110 milion Euro në vitin 2012, ndërsa eksportet nga 21 milion Euro në vitin 2008 në afro 40 milion Euro në vitin 2012, sikurse janë prezentuar në grafikonin 1. Pjesëmarrja e Shqipërisë në shkëmbimet

tregtare të Kosovës u zgjerua për më shumë se 1.5% nga 3.80% sa ishte në vitin 2008 në 5.43% në vitin 2012. Pati po ashtu rritje të pjesëmarrjes së Serbisë dhe Kroacisë në shkëmbimet tregtare të Kosovës brenda kësaj periudhe 5 vjeçare, megjithëse ky shtim ishte i vogël.

Sa i përket shkëmbimeve tregtare të Kosovës me fqinjët e saj, ashtu si edhe me gjithë rajonin edhe në krahasim me fqinjët e saj, Kosova ka raport jo të mirë mes eksportit dhe importit ku brenda periudhës 2008-2012 ky raport ka qenë në dëm të eksportit. Megjithatë brenda kësaj periudhe ka pasur një rritje graduale por shumë të ulët në favor të eksportit.

Eksporti i mallrave dhe shërbimeve pritet të rritet me një normë mesatare prej 9.4% gjatë periudhës 2014-2015. Duke u bazuar në faktin që kompanitë eksportuese në Kosovë janë ende në fazën e ngritjes së kapaciteteve të tyre dhe kanë bazë të ulët të eksportit, në vitet vijuese këto kompani pritet të ngrisin eksportin e prodhimeve të tyre dhe të shoqëruara me lehtësira tatimore të ngrisin edhe pjesëmarrjen në nivelin e përgjithshëm të eksportit. Historikisht, eksporti i mallrave ka qenë i lidhur ngushtë me lëvizjen e çmimeve botërore të metaleve, kjo për arsye se pjesa më e madhe e eksportit përbehet nga metalet si dhe produktet që si lëndë të parë përdorin metalin. Andaj, parashikimi për lëvizjen e çmimeve botërore të metaleve si dhe të kërkesës për metale të vendeve në të cilat Kosova eksporton do të vazhdojë të ketë ndikim, edhe pse në masë të zvogëluar, në lëvizjen e eksportit të mallrave në Kosovë. Në anën tjetër, rimëkëmbja e vendeve të euro-zonës pritet të ndikojë pozitivisht edhe në eksportin e shërbimeve.

Grafikoni 1: Paraqitja grafike e tregtisë me Shqipërinë sipas viteve 2005-2012



Burimi: Vjetari Statistikor 2014, Agjensia e Statistikave të Kosovës, 2014

Nëse shikohet trendi i bilancit tregtar të Kosovës me vendet e rajonit është negativ, sepse është në përpjesëtim të drejtë me importin. Kjo do të thotë që rritja e shkëmbimeve tregtare të Kosovës gjatë kësaj periudhe është më shumë reflektim i rritjes së madhe të importit nga vendet e rajonit, i cili edhe pse nivelin e rritjes për këto 5 vite, rritja e importit në vlerë ka qenë shumë më e madhe se sa rritja në vlerë e eksportit.

Rrjedhimisht trendi i rritjes apo uljes së bilancit tregtar ndikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga rritja apo ulja e importit. Kjo ndodhë për shkak se, sado rritje të madhe të ketë niveli i

eksportit, baza shumë e ulët e vlerës së eksportit të Kosovës bënë që luhatjet në import, sado të vogla të jenë ato, të jenë faktor në përcaktimin e bilancit tregtar të Kosovës, dhe jo eksporti.

Tabela 4: Partnerët Kryesor të Kosovës në vitin 2012, vlera (000 €), %

Vendet	Vitet				Balanci Tregtar Vlera
	Eksporti		Importi		
	Vlera	%	Vlera	%	
Italia	71.351	25.8%	213.469	8.5%	-142.118
Shqipëria	40.180	14.6%	110.528	4.4%	-70.348
Maqedonia	26.376	9.6%	287.739	11.5%	-261.363
Zvicra	15.133	5.5%	22.664	0.9%	-7.531
Gjermania	14.995	5.4%	304.195	12.1%	-289.200
Serbia	14.968	5.4%	278.388	11.1%	-263.420
Turqia	11.380	4.1%	199.881	8.0%	-188.501
Kina	3.266	1.2%	159.651	6.4%	-156.385
Gjithsejt	267.100	71.6%	2.507.609	62.9%	-2.231.509

Burimi: Vjetari Statistikor 2014, Agjensia e Statistikave të Kosovës, 2014

Të dhënat në tabelën më lartë tregojnë se Kosova kryesisht tregon me dy grupe të shteteve, pra me shtetet e Bashkimit Evropian plus Zvicrën, si dhe me shtetet fqinje. Siç tregon Tabela 5, në vitin 2012 partnerët më të mëdhenj nga BE-ja ishin Italia dhe Gjermania. Italia ishte importuesi më i madh i mallrave të Kosovës, e pasuar nga Gjermania. Në anën tjetër, Gjermania është eksportuesi më i madh i BE-së në Kosovë, e ndjekur nga Italia. Sa u përket partnerëve rajonalë, për shkak të ndërtimeve infrastrukturore në të dyja anët e kufirit, Shqipëria po bëhet gjithnjë e më shumë një vendmbërritje e rëndësishme për produktet e Kosovës. Dy destinacione të tjera të rëndësishme në rajon janë Maqedonia dhe Serbia. Këto dy vende, së bashku me Gjermaninë, janë importuesit më të mëdhenj të Kosovës. Megjithatë, në vitet e fundit, vendet si Kina, Turqia dhe India gjithnjë e më shumë po bëhen partnerë të rëndësishëm tregtarë të Kosovës.

Më tepër se 90% e mallrave të eksportuar nga Kosova (rreth 40% e eksportit të përgjithshëm) drejt BE-së janë metalet bazë dhe mallrat e tjera minerale. Kjo përfshin gypat të çelikut, metalit të papërpunuar dhe produkteve të tjera të eksportuara kryesisht në Itali dhe Gjermani. Përveç kësaj, një përqindje e eksporteve u eksportuan në formën e gëzofit të papërpunuar, lëkurës dhe tekstilit. Vetëm një pjesë e vogël e eksporteve janë produkte të përfunduara të eksportuara.

Në anën tjetër makineria dhe pajisjet e transportit mbizotërojnë strukturën e importit nga BE-ja.

Kosova dhe barrierat tregtare në rajon

Masat Anti-dumping dhe Masat Kundërbalancuese janë masa të vendosja e bazës ligjore për vendosjen e masave anti-dumping ndaj produkteve që importohen nën vlerën e tyre dhe për vendosjen e masave kundërbalancuese ndaj një produkti që përfiton nga subvencionet në një

mënyrë që është në përputhje me rregullat dhe kërkesat e Bashkimit Evropian dhe Organizatës Botërore të Tregtisë.

Barrierat tregtare kanë qenë të pranishme në gjithë rajonin, varësisht nga blloku i shteteve dhe marrëdhëniet politike të Kosovës me këto shtete. P.sh duke qenë pjesë e CEFTA-së së bashku me 7 shtete tjera të rajonit, që nga viti 2006, kryesisht barrierat tarifore janë minimizuar mes këtyre shteteve, megjithatë, Kosova ka hasur në variante të ndryshme të barrierave edhe me disa shtete të CEFTA-së që kanë qenë të natyrave të ndryshme, si politike (pas shpalljes së pavarësisë më 2008) ashtu edhe praktike (pra për mbrojtjen e prodhimeve vendore të vendeve respektive). Po ashtu, duke qenë se BE-ja ka aplikuar masa preferenciale të tregtisë me shtetet e Ballkanit jashtë bllokut të BE-së që nga viti 2000 në përgjithësi, edhe Kosova ka përfituar nga ky veprim i njëanshëm i BE-së ndaj shteteve të Ballkanit.

Meqenëse është anëtare e CEFTA-së, Kosova ka tërhequr tarifën doganore prej 10% ndaj vendeve anëtare të këtij blloku të tregut të lirë në rajon, tarifë të cilën e aplikon për vendet tjera si barrierë tarifore. Megjithatë anëtarët e ndryshëm të CEFTA-së kanë shfrytëzuar raste të ndryshme për të vendosur barrierë tarifore dhe jo tarifore anëtarëve tjerë të bllokut kryesisht me qëllim të mbrojtjes së prodhimeve të tyre vendore, por edhe si rezultat i reciprocitetit që vendosja e barrierave nga një shtet ka nxitur tek shtetet tjera anëtare. Vendosja e barrierave brenda bllokut të CEFTA-së mundësohet edhe për shkak të fleksibilitetit që ekziston në marrëveshjen e CEFTA-së për ta bërë një gjë të tillë, e që si rezultat pengon tregtinë e mirëfilltë të lirë.

Sipas korrespondencës me tregtarë të Kosovës, aplikohen edhe masa tjera mbrojtëse nga vendet tjera si barrierë jo-tarifore në formë të kërkesës së dokumentacionit shtesë, pritjes së gjatë nëpër pika doganore, e që si rezultat ndikojnë në dekurajimin e përdorimit të njërës apo tjetrës pikë kufitare, e cila natyrisht rezulton edhe në vonesën e dërgimit të mallit në tregun e jashtëm, por edhe të kostos së transportit dhe përfundimisht rritjes së çmimit të mallit dhe humbjes potenciale të tregut jashtë. Raste të ngjashme që kanë të bëjnë me Serbinë konfirmohen edhe nga MTI e Kosovës. Serbia p.sh. ndalon përdorimin e territorit të vet si transit për kalimin e mallrave siç janë kafshët dhe mallrat tjera me origjinë shtazore. Po ashtu, sipas MTI-së ka pasur rast kur Kosova ka dashur të përdorë si transit territorin e Serbisë për mallra me origjinë Gjermane të destinuar për Sllovaki, mirëpo Serbia ka ndaluar përdorimin e territorit të vet si transit.

Për më shumë, Maqedonia po ashtu kishte vendosur barrierë tjera jo-tarifore në importin e ujit nga Kosova duke shtuar kështu kërkesa për analizimin e këtij produkti nga organet e Maqedonisë pavarësisht certifikatave të analizave të instituteve të Kosovës që posedonin eksportuesit kosovar në vitin 2011.

Konkluzion

Ka disa hapa që politikë-bërësit në Kosovë mund t'i ndërmarrin për të trajtuar sfidat kryesore që u identifikuan në këtë punim:

- ❖ Në shkëmbimet tregtare të Kosovës është evidente bilanci negativ tregtar ku dominon importi në krahasim me eksportin. Shpërpjestimet në tregtinë e jashtme gjenerojnë shpërpjestime makroekonomike me implikime në stabilitetin makroekonomik të Kosovës. Politikat ekonomike veçmas politikat fiskale duhet të orientohen në stimulimin e prodhimit vendor me qëllim të nxitjes së eksportit, rritjes së aftësisë konkurruese dhe zvogëlimit të varësisë nga tregu i jashtëm, duke përmirësuar bilancin tregtar në favor të ekporteve kundrejt importeve.
- ❖ Përgjatë kësaj periudhe pesë vjeçare (2008-2012) eksporti i Kosovës është rritur më së shumti me vendet fqinje⁴⁵, ku nga 27.62% me çka merrnin pjesë këto vende në eksportin e Kosovës në vitin 2008, pjesëmarrja e tyre u rrit në 36.23% në vitin 2012. Kjo rritje e eksportit të Kosovës me vendet fqinje më së shumti ka ndodhur për shkak të rritjes së eksportit me Shqipërin (nga 10.64% në vitin 2008 në 14.94% në vitin 2012) dhe Malit të Zi (nga 1.90% në vitin 2008 në 6.19% në vitin 2012). Ndërsa edhe rritja e eksporteve të Kosovës në tregun më të gjerë të CEFTA-së⁴⁶ është rritur nga 31.01% në vitin 2008 në 37.78% në vitin 2012. Megjithatë kjo ka ndodhë më shumë për shkak të rritjes së përfaqësimit të vendeve fqinje në eksportin e Kosovës, se sa ndonjë rritjeje të ndonjë vendi tjetër të CEFTA-së.
- ❖ Krijimi i mjedisit të duhur institucional (duke përfshirë institucionet për tregtinë dhe që kanë të bëjnë me tregtinë) është një faktor thelbësor për suksesin apo dështimin e politikave që kanë për synim rritjen e konkurrencës së industrive vendase.
- ❖ Rritjes së eksportit të mallrave pritet t'i kontribuoj edhe marrëveshja për Stabilizim dhe Asocim e Kosovës me BE-në e cila pritet të filloj të implementohet nga vitin 2016 si dhe marrëveshjes për tregti të lire me Turqinë. Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit (MSA) është krijuar për të udhëzuar reformat e shteteve kandidate potenciale për BE, me qëllim të adresimit të perspektivës së tyre evropiane, lehtësitë dhe mundësitë që ju krijohen përmes kësaj marrëveshje.
- ❖ Në marrëveshjen e MSA të përfshihen masat mbrojtëse për të mbrojtur prodhimin vendor të brendshëm nga importet që vijnë nga vendet e rajonit. Masat mbrojtëse duhet të jenë në përputhje me rregullat e Organizatës Botërore të Tregtisë. Kosova të mund të përdorin masat mbrojtëse për një periudhë maksimale prej pesë vjetësh (në raste të jashtëzakonshme për prodhimet senzitive për një periudhë prej 5 vjet maksimumi) në mënyrë që të mbrojnë prodhimin e brendshëm duke kufizuar rritjen e madhe të importeve nga tregun i shteteve në rajon.
- ❖ Për periudhën afatmesme të parashihet që vlera e importit të mallrave të rritet me një normë më të ngadaltë duke reflektuar deri në një masë rënien e çmimeve të produkteve të cilat kanë peshën më të madhe në total importin e poashtu edhe rënien e kërkesës për import si rezultat i zëvendësimit me produkte vendore.
- ❖ Duhet të ngritet përgjatë periudhës së planifikimit, përkushtimin për trajtimin e sektorit të bujqësisë si një prej sektorëve prioritar dhe me potencial për zhvillim, krijim të vendeve të punës dhe zëvendësim të importit. Të vazhdohet me mbështetjen

⁴⁵ Vendet fqinje të Kosovës janë Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia.

⁴⁶ CEFTA përbëhet nga 8 shtete anëtare: Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Serbia, Mali i Zi, BeH, Kroacia dhe Moldavia.

financiare për sektorin e vreshtarisë ku përmes, tregtisë së verës së rrushit dhe produkteve tjera nga rrushi dhe vera të bëhet ngritja e eksportit në vendet e rajonit.

- ❖ Synimi për të dalë nga tregjet nacionale dhe hyrë në ato rajonale duhet bërë përmes bashkëpunimit ekonomik mes Shqipërisë dhe Kosovës. Energjia, turizmi dhe bujqësia mbeten fushat prioritare në të ardhmen me interes të ndërsjelltë mes Shqipërisë dhe Kosovës. Tregtia midis Shqipërisë dhe Kosovës ka hapësira të mëdha për tu bërë komplementare, në produktet ku secili vend ka avantazh konkurrues dhe si pasojë, në prodhimin e të cilit duhet të specializohet.
- ❖ Turqia është i vetmi vend në rajon, me të cilin Kosova e ka rritur shkëmbimet tregtare si për importe ashtu edhe për eksporte. Në përgjithësi pjesëmarrja e Turqisë në shkëmbimet tregtare të Kosovës është rritur nga 6.17% sa ishte në vitin 2008, në 7.66% në vitin 2012. Pjesëmarrja e Turqisë në eksportin e Kosovës është rritur nga 1.53% sa ishte në vitin 2008 në 4.22% në vitin 2012. Një rritje e ngjashme ka ndodhur edhe me pjesëmarrjen e Turqisë në importin e Kosovës, ku nga 6.65% sa merre pjesë Turqia në import të Kosovës në vitin 2008, pjesëmarrja e Turqisë në importe u rrit në 8.04% në vitin 2012.
- ❖ Që nga viti 2008 e deri më 2012 Shqipëria është partneri i parë tregtar për eksportin e Kosovës, përtej nga Maqedonia (partneri i dytë), Mali i Zi (partneri i tretë). Përderisa Greqia ishte partneri i tretë me radhë për eksportin e Kosovës në vitin 2008, për shkak të bllokadës ajo listohet si partneri i 11-të në vitin 2012. Pra Kosova ka humbur treg të konsiderueshëm në Greqi.
- ❖ Ekziston nevoja për një qasje gjithëpërfshirëse për procesin e politikave tregtare. Politika tregtare kalon nëpër një cikël të veçantë të politikave: së pari ajo duhet të hartohet; pastaj duhet të vlerësohen instrumentet e politikave që ajo i propozon (vlerësimi ex-ante); më tej, ajo duhet të zbatohet; politikat duhet të vlerësohen ex-post dhe përfundimisht në bazë të vlerësimit ex-post ajo duhet të përshtatet. Ky proces do të duhej të ndodhë vazhdimisht. Në mënyrë që ky proces të funksionojë ashtu siç duhet, një faktor jetik është disponueshmëria dhe cilësia e të dhënave për tregtinë ndërkombëtare. Të dhënat dhe statistikat janë thelbësore për vendimmarrjen që mbështetet në prova. Çdo propozim i bërë nga lartë, duhet të filtrohet përmes thjerrëzave të modelimit dhe analizës së politikave. Analizat duhet të japin përgjigje në efektet e mundshme që politika tregtare mund të ketë në konsumatorët, prodhuesit dhe të ardhurat e qeverisë, si dhe në uljen e varfërisë, krijimin e vendeve të punës, rritjen ekonomike dhe mirëqenien e përgjithshme. Prandaj, në këtë kontekst, cilësia e të dhënave duhet të përmirësohet dhe duhet të jetë e njëtrajtshme përgjatë tërësisë së tregtisë ndërkombëtare, si dhe duhet ndërtuar kapacitetet në procesin e krijimit, përpunimit dhe modelimit të dhënave.

7. Literatura

- Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2014, Agjensia e Statistikave të Kosovës,

- Statistikat e tregtisë së jashtme 2008-2012, Agjensia e Statistikave të Kosovës,
- Korniza afatmesme e shpenzimeve 2015-2017, Ministria e Financave,
- Buxheti i vitit 2014, Ministria e Financave,
- Raportet fiskale, Ministria e Financave,
- <http://esk.rks-gov.net/>, Agjensia e Statistikave të Kosovës,
- <http://mf.rks-gov.net/>, Ministria e Financave të Kosovës,
- <http://www.mti-ks.org/>, Ministria e Tregtisë të Kosovës,
- The World Bank, “Doing business”, <http://www.doingbusiness.org/>,
- <http://data.worldbank.org/>,
- <http://ec.europa.eu> , “Who can join and When?”, European Commission - Economic and Financial Affairs,
- <http://www.instat.gov.al/>.

ROLI I MARKETINGUT NË SUKSESIN E NDËRMARRJES

MARKETING ROLE IN THE SUCCESS OF THE ENTERPRISE

Mr.sc Refik Havolli phd candidate¹.Prof.Dr. Abdulla Prebreza², MA. Ali Ahmeti³.

¹Universiteti Nderkombetar i Struges,

E-mail address: refik.havolli@passable-ks.com

²Kolegji ISPE, Fakulteti Ekonomik, Prishtine

E-mail address: abdullah_prebreza@hotmail.com

³Menagjer i marketingut ne kompanin Passable Prishtine

E-mail address: ali.ahmeti@passable-ks.com

Abstract

We are dealing with the role of marketing in the success of the enterprise, as in small medium and large. The role of marketing is the determining factor for an enterprise that wants to develop the market economy and the global economy. For every enterprise should think "Think globally act locally". Marketing is everywhere. Formally and informally, people and organizations engage in many activities that can be called marketing. Good marketing has become more and more vital to the success of a business. Marketing influences the depth of our daily lives. He is involved in everything we do - from our wardrobe Websites that we click on ads that look. Good marketing is no accident, but a result of careful planning and implementation. Marketing practices are improving in virtually all industries to increase chances for success. But perfection is rare marketing and difficult to achieve. Marketing is an "art" and "science" - there is a constant tension between its formulation marketing and creative part. It's easier to learn the formulation, which will occupy most of our care in this paper, but we will also describe how real creativity and passion operates in many companies. This paper will help improve your outlook on the role of marketing and your ability to make appropriate decisions in all enterprises whether economic or non-economic in Kosovo.

Keywords: *Marketing, enterprise, economy, market, customer.*

Abstrakt

Kemi të bëjmë me rolin e marketingut në suksesin e ndërmarrjes, si në ndërmarrje të vogla të mesme dhe të mëdha. Roli i marketingut është faktor përcaktues për një ndërmarrje e cila dëshiron të zhvillohet në ekonominë e tregut dhe ekonominë globale. Sepse çdo ndërmarrje duhet të mendojë "Mendo globalisht veprim lokalisht". Marketingu është kudo. Në mënyrë formale dhe jo formale, njerëzit dhe organizatat angazhohen në shumë aktivitete që mund të

quhen marketing.⁴⁷ Marketingu i mirë është bërë gjithnjë e më shumë një element jetësor për suksesin e një biznesi. Marketingu influencon në thellësi jetën tonë të përditshme. Ai përfshihet në çdo gjë që ne bëjmë – nga veshjet tona në Websitet që klikojmë, në reklamat që shohim. Marketingu i mirë nuk është i rastësishëm, por një rezultat i një planifikimi dhe zbatimi të kujdesshëm. Praktikrat marketing po përmirësojnë në mënyrë virtuale të gjitha industritë për të rritur shanset për sukses. Por, perfeksioni marketing është i rrallë dhe i vështirë për t'u arritur.⁴⁸ Marketingu është një “art” dhe “shkencë” – ka një tension konstant ndërmjet pjesës së formulimit të marketingut dhe pjesës krijuese.⁴⁹ Është më e lehtë të mësosh pjesën formuluese, e cila do të zërë pjesën më të madhe të kujdesit tonë në këtë punim, por ne do të përshkruajmë gjithashtu sesa kreativitet real dhe pasion vepron në shumë kompani. Ky punim do të ndihmojë të përmirësoni botëkuptimin tuaj mbi rolin e marketingun dhe aftësinë tuaj për të marrë vendimet e duhura në të gjitha ndërmarrjet qoftë ekonomike ose joekonomike në Kosovë.

Fjalët kyçe: Marketingu, ndërmarrja, ekonomia, tregu, konsumatori.

Çfarë është marketing ?

Fjala marketing rrjedhë nga fjala angleze ”market” që do të thotë treg e të cilës duke ia shtuar prapashtesën në anglishte “ing” dmth: proces, aksion, takim për të fituar të tjer andaj jepet termi marketing.⁵⁰ Edhe në linguistikën shqipe, por edhe në gjuhët e vendeve tjera, deri më tani, nuk ka mundur të bëhet ndonjë përkthim adekuat i fjalës marketing, për çka në mbarë botën është përvetësuar përgjithësisht për përdorim termi anglez marketing.

Marketingu identifikon dhe plotëson nevojat njerëzore dhe sociale. Një nga përkufizimet më të shkurtra të marketingut është “plotësimi i nevojave duke përfituar”.⁵¹ *Për të kuptuar më qartë se ç’është marketingu është i nevojshëm prezantimi i definicionit të marketingut nga autori shumë i njohur Philip Kotler, i cili thotë:*

”Marketingu është proces shoqëror dhe menaxhues përmes të cilit individët dhe grupet përfitojnë atë për çka kanë nevojë dhe çka dëshirojnë përmes krijimit, ofrimit dhe këmbimit të produkteve të vlefshme me të tjerët”⁵²

Rocco e përkufizon marketingun bashkohorë :Marketingu bashkohorë paraqet aktivitetin afarist ,i cili produktet i lidh me konsumin,kështu që në mënyrë maksimale dhe profitabile i plotëson nevojat e shoqërisë, të cilat në treg praqiten si kërkesa .

Marketingu është tërsi e aktiviteteve, me të cilat prodhimi optimalizohet për përmbushjen e nevojave dhe të kërkesave të konsumatorëve nga se tregu me mekanizmat e tij sygjeron për

⁴⁷ Drejtim Marketingu-Liljana Elmzi –Shaip Bytyci 2007.

⁴⁸ Marketing management 12th Edition, by Philip Kotler and Kevine Lane Keller

⁴⁹ Ma.Ali Ahmeti- Aplikimi i Marketingut Në Ndërmarrje-Rast Studimi Ndërmarrja "Passable "2013

⁵⁰ Prof.dr.Ali Jakupi – Bazat e marketngut - Universiteti i Prishtines

⁵¹ Philip Kotler&K.Keller „Menaxhimi I marketingut”

⁵² Kotler. Ph.Marketing Management, The Millenium Edition, Prentice Hall International, Inc, New Jercey, USA

mënyren e prodhimit, asortimanit, shprëndarjen ,çmimin, porositë dhe sjelljen e konsumatorëve (të individëve të organizatave dhe të shoqërisë)⁵³

Qëllimi dhe detyrat e marketingut

Për t'u bërë një manaxher marketingu ju duhet të kuptoni se çfarë është marketingu dhe kush e bën marketingun. Piter Drucker, një teorist lider i drejtimit, shprehet në këtë mënyrë: “Dikush mund të supozojë se do të jetë gjithmonë e nevojshme shitja. Por qëllimi i marketingut është ta bëjë shitjen të panevojshme. Qëllimi i marketingut është t'i njohë dhe t'i kuptojë konsumatorët aq mirë, sa produkti ose shërbimi t'i përshtatet dhe të shitet vetë. Në mënyrë ideale, marketingu duhet t'i shërbejë një konsumatori që është gati të blejë. Gjithçka duhet më pas është të bëhet produkti ose shërbimi i vlefshëm.” Kur Sony projektoi “Play Station”, kur Gillette hodhi në treg makinën e rrojes “Mach III” dhe kur Toyota bëri të njohur veturën me markë “Lexus”, këta prodhues kishin informacion të plotë sepse ata kishin projektuar produktin “e duhur” bazuar në kërkimin e kujdesshëm marketing.⁵⁴

Qëllimi i marketingut është plotësimi i nevojave të konsumatoreve, kurse në bazë të kësaj edhe plotësimi i nevojave të subjekteve ekonomike duke realizuar përfitime.

Detyrat e marketingut janë:

- ❖ *Zhvillimi i strategjive dhe planeve të marketingut,*
- ❖ *Identifikimi i konsumatorëve,*
- ❖ *Ngritja e reputacionit të ndërmarrjes,*
- ❖ *Arritja e depërtimit marketing,*
- ❖ *Lidhja me konsumatorët,*
- ❖ *Krijimi i markave të forta,*
- ❖ *Ndarja e ofertave të tregut,*
- ❖ *Joshja e konsumatorëve,*
- ❖ *Komunikimi i vlerës,*
- ❖ *Krijimi i rritjes aftëgjatë.⁵⁵*

⁵³ Prof.dr.Ali Jakupi – Bazat e marketingut Universiteti i Prishtines Faq.7

⁵⁴ Drejtim Marketingu-Liljana Elmzi –Shaip Bytyçi 2007.

⁵⁵ Marketing management 12th Edition, by Philip Kotler and Kevin Lane Keller

Rëndësia e Marketingut

Rëndësia e marketingut është më se e qartë sot. Marketingu është aq prezentë në jetën tonë të përditshme sa që në masë të madhe ndikon në stilin tonë të jetesës duke transformuar vazhdimisht atë dhe shoqërinë në tërësi. Ndonëse ka tendencë t'i përshtatet ekonomisë dhe shoqërisë së caktuar, marketingu në instancë të fundit ndryshon jetën tonë, sjelljet tona. Ndërmarrja është e lidhur me tregun, ndërsa këtë lidhje siguron marketingu. Marketingu është esencial për suksesin e ndërmarrjeve dhe në këtë kuptim ai siguron realizimin e qëllimeve madhore, gjegjësisht mbijetesën e ndërmarrjeve, rritjen dhe zhvillimin. Marketingu mundëson që më mirë të identifikohen sjelljet e konsumatorëve, të hulumtohet tregu, të prezantohen idetë, të komunikohet me publikun etj. Varësisht nga mënyra e promovimit të produkteve dhe shërbimeve do të varët kërkesa e konsumatorëve për ato dhe rezultati i firmës.⁵⁶ Suksesi financiar shpesh varet nga aftësitë marketing. Financa, operacionet, llogaritja dhe funksione të tjera marketing nuk do të kishin farerëndësi pa një kërkesë të mjaftueshme për produkte dhe shërbime, që kompania të nxirrte fitim. Shumë kompani kanë krijuar tani një Drejtor të Departamentit Marketing, pozicion që e vendos marketingun në të njëjtin nivel me nivelet e tjerate drejtimit ekzekutiv, të tillë si Drejtori i Departamentit Ekzekutiv dhe Drejtori i Departamentit të Financës.⁵⁷ Deklaratat në shtyp nga organizata të të gjitha llojeve –nga prodhuesit e të mirave në siguresit e shëndetit dhe nga organizatat joqeveritare në prodhuesit e produkteve industriale – trumbetojnë arritjet e tyre të fundit marketing dhe mund të gjenden në web sitet e tyre. Në shtypin e biznesit, artikuj të panumërt i kushtohen strategjive dhe taktikave marketing. Sidoqoftë, marketingu është i komplikuar dhe ka qenë thembra e Akilit për shumë kompani prestigjoze.⁵⁸ Biznese të mëdha, të njohura si Sears, Levi's, General Motors, Kodak dhe Xerox janë përballur me konsumatorë të rinj të fuqizuar dhe konkurrentë të rinj dhe i është dashur të rimendojnë për modelet e tyre të biznesit. Edhe liderat e tregut si Microsoft, Wal-Mart, Intel dhe Nike pranojnë se nuk i lejohet pushimi. Jack Welch, Drejtori i Departamentit Ekzekutiv, i bën të ditur kompanisë në mënyrë të vazhdueshme: "Ndryshim ose falimentim". Të marrësh vendimet e duhura nuk është gjithnjë e lehtë. Manaxherët e marketingut ndërmarrin vendime të mëdha mbi dizenjimin e produktit të ri, çmimin që duhet t'i ofrohet konsumatorëve, vendin ku duhen shitur produktet dhe sa duhet shpenzuar në reklamë apo shitje. Ata duhet të marrin gjithashtu vendime më të detajuara si fjalët apo ngjyrën për paketimin e ri.⁵⁹ Kompanitë më risikoze janë ato që dështojnë në monitorimin e konsumatorëve dhe konkurrentëve të tyre dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të vlerës së ofruar. Ata kanë një vështrim afatshkurtër të udhëhequr nga shitjet për biznesin e tyre dhe kohët e fundit ata dështojnë në kënaqjen e aksionerëve të tyre, punonjësve të tyre, furnitorëve të tyre dhe kanaleve partnere. Arritja marketing është një vazhdimësi pa limit.⁶⁰

⁵⁶ Rëndësia e marketingut për biznes dhe punësim - Albana Maloku Kosumi - Publikuar më 01 dhjetor, 2013

⁵⁷ Ma.Ali Ahmeti- Aplikimi i Marketingut Në Ndërmarrje-Rast Studimi Ndërmarrja "Passable " 2013

⁵⁸ Drejtim Marketingu-Liljana Elmzi –Shaip Bytyçi 2007.

⁵⁹ Marketing management 12th Edition, by Philip Kotler and Kevine Lane Keller

⁶⁰ Philip Kotler&K.Keller „Menaxhimi I marketingut“

Orjentimi i ndërmarrjeve drejt marketingut

Ndërmarrjet sot krejtësisht janë të orientuara kah tregu, kah konsumatori. Marketingu ka rolin kryesor në identifikimin e nevojave të tregut, në formulimin e strategjisë, prandaj mund të konkludohet se edhe vizioni i ndërmarrjes është ngushtë i ndërlidhur me tregun, me konsumatorin. Nëse ndërmarrja kuptohet si sistem, atëherë më mirë mund të kuptohet edhe roli i marketingut në ndërmarrje dhe lidhja e tij me të gjitha funksionet tjera të ndërmarrjes në drejtim të realizimit të qëllimeve. Aftësitë dhe shkathtësitë e marketingut të përhapura në organizatë janë të një rëndësie të veçantë në drejtim të realizimit të vizionit të ndërmarrjes sepse vetëm në këtë mënyrë të gjitha forcat mund të mobilizohen dhe të drejtohen kah realizimi i qëllimeve. Gjithashtu, rëndësi të njëjtë ka përvetësimi i aftësive dhe shkathtësive të marketingut nga ata të cilët synojnë të punësohen, sidomos në biznes, pasi që në radhë të parë do të kenë aftësi kryesore për pozitën apo punën, pastaj të njëjtat aftësi dhe shkathtësi mund t'i shfrytëzojnë për promovimin e vehtes në dritë më të mirë, gjë që rritë shansat për sukses.⁶¹

Roli i marketingut në suksesin e ndërmarrjes

Peter Drucker, ka theksuar shumë qartë rolin e marketingut për suksesin e ndërmarrjes. Edhe në kohën e sotshme koncepti i tij mbi marketingun ka vlerën dhe qëndrueshmërinë e pakontestueshme: "Nëse dëshirojmë të dijmë se ç'është puna jonë, atëherë duhet të fillojmë me misionin ... Ekziston vetëm një definicion i drejtë për misionin e ndërmarrjes: **kënaqësia e konsumatorit**. Ajo që ndërmarrja mendon të prodhojë nuk është e rëndësisë primare veqanarisht jo për ardhmërinë dhe suksesin e saj. Vendimtare është ajo që konsumatori mendon të blejë përkatësisht ajo që për të paraqet vlerë-kjo përcakton çka është ndërmarrja e juaj, çka të prodhojë ajo dhe se a do të prosperoj ajo".⁶² Sipas Dun&Bradstreet, 48 përqind e të gjitha deshtimeve të biznesit me të cilën merrni ju jeni në "biznesin e marketingut."

Ndërmarrjet gjatë zhvillimit të tyre, kanë zbatuar koncepte të ndryshme në afarizmin e tyre, varësisht nga koha, kushtet dhe mundësitë. Vetë kuptimi i konceptit të marketingut është një prej dimensioneve më relevante në biznesin e ndërmarrjes.⁶³

Për të kuptuar drejt konceptin kyç të marketingut, duhet theksuar se aktivitetet e ndërmarrjes pikënisjen dhe mbarimin e kanë të konsumatori. Ndërmarrja nëpërmjet marketingut e bënë identifikimin e nevojave dhe të kërkesave, i analizon dhe i ndjek ato deri në përmbushjen e tyre. Sipas konceptit të marketingut, në fokusin e të gjitha angazhimeve të ndërmarrjes është tregu, përkatësisht konsumatori. Ndërmarrja nuk do të jetë e suksesshme në biznesin e vet, nëse paraprakisht nuk i kryen punët hulumtuese, kërkimore-studimore për tregun dhe konsumatorin. Në kushtet e sotme të zhvillimit tekniko-teknologjik dhe nivelit të lartë të përsosjes zhvillimore është e mundur të prodhohet çdo gjë. Problem i veçantë është ku dhe si

⁶¹ Rëndësia e marketingut për biznes dhe punësim - Albana Maloku Kosumi - Publikuar më 01 dhjetor, 2013

⁶² Drucker, P.: The Practice of Management, Harper & Row, New York, , citat në faqën 37 të librit Evans, J.R.& Berman, B,:

Marketing, New York

⁶³ Principles of Marketing (14th Edition) by Philip Kotler and Gary Armstrong

do të plasohen produktet dhe shërbimet. Padyshim, marketingu ka rolin dhe funksionin e vet primar për zgjidhjen e këtij problemi.⁶⁴ Marketingu aktivitetet e veta i fillon në treg dhe i përmbyllë në treg⁶⁵ Aktivitetet fillestare të marketingut kanë të bëjnë me hulumtimin dhe kërkimet e tregut, identifikimin e konkurrencës dhe gjetjen e konsumatorëve.⁶⁶ Duke i shfrytëzuar informacionet relevante merren vendime: çka të prodhohet, me çfarë kostoje, për cilin treg dhe për cilën kohë? Në ndërmarrje nuk guxon të punohet me hamendje dhe pa gjykime të sakta që duhet të nxjerren në mbështetje të informacioneve që dalin nga tregu dhe konsumatori. Po të punohet pa këto të dhëna, ndërmarrja do të shkatërrohet shumë shpejt sepse nuk e ka të qartë se çka kërkon tregu, konsumatori dhe si vepron konkurrenca.⁶⁷ Nëpërmjet informacioneve përgatitjet e ofertës janë të qëndrueshme, në dobi të konsumatorëve por edhe në shërbim të realizimit të objektivave të vet ndërmarrjes. Duke mbetur i kënaqur konsumatori me atë që blenë, nuk do të harroj edhe herave tjera të blejë lloje të njejta apo të ngjajshme të produkteve apo shërbimeve nga se ka krijuar kënaqësi, bindje dhe besim për vlerat e blera më parë. Nuk është me rëndësi që konsumatori të blejë vetëm një herë, por për ndërmarrjen është e dobishme që ai të jetë blerës i rregullt dhe lojal për një kohë më të gjatë. Për këtë qëllim, ekspertët, specialistët e marketingut apo vet afaristët e ndjekin gjendjen e kërkesës në treg që të mund të bëjnë ndryshimet e nevojshme dhe të diktuar në cilësinë dhe begatimin e ofertës.⁶⁸ Nga fakti se kuptimi i konceptit kyç të marketingut përqëndrohet te konsumatori, çdo subjekt afarist që merret me prodhimin e produkteve dhe shërbimeve, për të qenë i suksesshëm asnjëherë nuk guxon të harroj se:

- Në ekonominë dhe tregun e lirë konsumatori është mbret,
- Duhet të kuptohen përfitimet e konsumatorit nga produkti apo shërbimi jonë,
- Duhet të shesim në bazë të nevojave dhe kërkesave të konsumatorëve e jo në bazë të nevojave tona, karakteristikave të produktit dhe vetive të tija,

Duke i plotësuar nevojat e konsumatorit pikësynim permanent është plotësimi i kënaqësisë së tij.

Megjithatë në ekonominë bashkëkohore është shumë vështirë që të arrihet plotësimi i të gjitha nevojave të konsumatorit dhe të krijohet ndjenja e satisfaksionit për ta. Aq më tepër, duhet pasur parasysh se dëshirat, nevojat dhe kërkesat e konsumatorit janë dukuri dinamike dhe të ndryshueshme e që nuk janë të dhëna njeherë e përgjithmonë. Në anë tjetër, deri tani nuk ekziston ndonjë rregullator i cili në treg do të mënjanonte paraqitjen e produkteve dhe shërbimeve të padëshiruara. Korelacioni në mes të marketingut dhe nevojave të konsumatorëve nuk është i thjeshtë por është ndërlikuar shumë e ndërlikuar. Është esenciale të bëhet dallimi i qartë në mes të nevojave, dëshirave dhe kërkesave të konsumatorëve. Ky dallim, domosdo, inicion shpeshëherë kritikën e njohur ndaj marketingut sipas të cilës marketingu i dizajnon dhe formëson nevojat apo se marketingu i shtynë konsumatorët të

⁶⁴ Ma.Ali Ahmeti- Aplikimi i Marketingut Në Ndërmarrje-Rast Studimi Ndërmarrja "Passable " 2013

⁶⁵ Marketing management 12th Edition, by Philip Kotler and Kevine Lane Keller

⁶⁶ Sales, Marketing, and Research-and-Development Cooperation Across New Product Development Stages-Holger Ernst, Wayne D. Hoyer, & Carsten Rübsaamen

⁶⁷ Prof.dr.Nail Reshidi - Manaxhimi i startexhive të marketingut 2007.

⁶⁸ Ma.Ali Ahmeti- Aplikimi i Marketingut Në Ndërmarrje-Rast Studimi Ndërmarrja "Passable " 2013


blejnë produkte apo shërbime që në të vërtetë nuk u nevojiten.⁶⁹ Marketingu, në realitet ndikon në kërkesën duke u përpjekur të krijoj produkt a shërbim që është atraktiv dhe i pranueshëm për konsumatorin, me çmim të levërdishëm dhe që është i lehtë që të arrihet deri te produkti i dëshiruar⁷⁰. Marketingu është aq i rëndësishëm, sa nuk mund të konsiderohet si funksion i veçantë. Ai është tërë biznesi i parë nga këndvështrimi i rezultatit përfundimtar, nga pikëpamja e konsumatorit. Në ekonominë moderne, afarizmi i ndërmarrjeve të cilat anashkalojnë filozofinë e biznesit të bazuar në postulatet kyçe të marketingut e që orientohen vetëm në shitje, u kërcënohet situata e palakmueshme financiare.⁷¹ Vetëm ndërmarrjet që pozicionohen në baz të një strategjie të mirëfillt të marketingut dhe përpilojnë plan të qartë të marketingut, mund të kenë:

- Identitet të qartë në treg,
- Klientelë lojale dhe biznes të vazhdueshëm,
- Shfrytëzim dhe përdorim efikas dhe të efektshëm të burimeve,
- Përfitime financiare të prekshme, dhe
- Vlerë të vërtetë që i shtohet bilancit të gjendjes.

Nga ky elaborim del konstatimi se "Marketingu udhëheqë ndërmarrjen".⁷²

Fazat e procesit të marketingut

Procesi i marketingut përbëhet nga disa faza : Analiza ,planifikimi ,zbatimi dhe kontrolli.



Analiza – Fillon me grumbullimin e të dhënave të ndryshme sasiore dhe cilësore të kërkimit të **marketingut. Burimet e të dhënave për kompaninë do të ndryshojnë nga sekondare në ato** primare, nga të brendshme në të jashtme dhe nga informale në formale. Të dhënat përdoren për të përcaktuar opsionet (Zgjedhjet) duke shoshitur mundësit e shumta të ambientit. Mundësit e kompanis mund të kontrollohen në krahasim me burimet e kompanisë për të gjykuar për aftësin mbijetuese të saj, duke vlerësuar si kriter bazë avantazhin konkurrus.

Planifikimi-Ka të bëjë me projektin e prodhimit për të kundërvepruar dhe për të shfrytëzuar mundësit në treg. Faza e planifikimit përfshinë si strategjitë afatgjata dhe teknikat afatshkurtëra. Plani i marketingut i shtjelluar për tregun e veçantë përfshinë analizen e situates, objektivat dhe qëllimet që duhet plotësuar, strategjitë, taktikat si dhe vlersimet e koston dhe të fitimit.

⁶⁹ ⁶⁹ Prof.dr.Nail Reshidi - Manaxhimi i startexhive të marketingut 2007.

⁷⁰ Principles of Marketing (14th Edition) by Philip Kotler and Gary Armstrong

⁷¹ Philip Kotler&K.Keller „Menaxhimi I marketingut“

⁷² Ma.Ali Ahmeti- Aplikimi i Marketingut Në Ndërmarrje-Rast Studimi Ndërmarrja "Passable " 2013

Zbatimi – Përbën kryrjen e aktivitet të planifikuar .Nëse planet e hartura pasqyrojnë kushtet e tregut dhe nëse ato bazohen në vlersime realiste që i përshtaten kompanisë në treg,procesi i zbatimit do të jetë i suksesshëm .Planet duhet të marrin parasysh ndryshimet e paparashikura brenda kompanis dhe efektin e forcave të mjedisit për të lejuar ndryshimet përkatëse në zbatimin e planit .

Mekanizmi i kontrollit – Vihet në zbatim në realizimin e planit .Shpesh tregu është dinamik dhe kërkon monitorimin e forcave të mjedisit ,të konkuresve të kanalve të pjesëmarrësve dhe të zgjuarsis së klientëve. Mjetet e kontrollit afatshkurtër përfshin kontrollin vjetor (të tilla si krahasimi i shitjeve në fakt me kuoten – planin), kontrolli mbi fitimin dhe kontrollin për efektshmëri. Kontrolli afatgjatë arrihet përmes revizionimeve bashkohore dhe funksionale për të bindur se" marketingu jo vetëm që realizon gjërat drejt, por edhe krijon gjëra të reja me vlerë".⁷³

Përfundim dhe Rekomandime

Nga analiza që i kemi bërë mund të përfundojmë se :

- Marketingu ka rol të veçantë për nxitjen e zhvillimit të ndërmarrjeve të çfardo lloji (të mëdha, të mesme dhe të vogla). Roli i marketingut është i pranishëm në të gjitha llojet e ndërmarrjeve sipas madhësis, si dhe sipas llojit të ndërmarrjeve si dhe sipas llojit të veprimtarive që ushtron. Është e natyrshme se në ekonominë e zhvilluara marketingu ka pozicion parësor, ndërsa në mjediset tjera bëhet imperativ për implementim të patjetersushem. Marketingu ka rol dhe vend të pashmangshëm në zhvillimin e ekonomisë së Kosovës. Aktualisht konceptet e marketingut nuk janë kuptuar sa duhet prandaj edhe nuk implementohen sa duhet .
- Marketingu nëse zbatohet në bazë të konceptit të marketingut dhe konsumatori të jetë pikënisje për ecje përpara çdo kompani do të ketë rezultate të mira, po ashtu Kosova do të ketë zhvillim dhe prespektivë.
- Shkenca e marketingut duhet të zërthehet në të gjitha llojet e ndërmarrjeve, madje pikërisht në ato ndërmarrje të pazhvillura dhe të vogla me qëllim që marketingu të aplikohet me synim që të kemi rritje dhe zhvillim të tyre. Vlersimi se efikasiteti i marketingut do të arrihet përmes përmisimit të aplikimit të mirëfillit të marketingut në të gjitha ndërmarrjet dhe marketingun mos ta konsiderojn si shpenzim por si investim. Rolë të rëndësishem në aplikimin e marketingut në ndërmarrje kan asociacionet e ndryshme të marketingut, si shoqatat e marketingut, shoqata për hulumtime të marketingut, shoqata për trajnime të marketingut etj. Analiza e faktorve makroekonomik, pestel, politik, ekonomik, social, teknologjik mjedisor dhe legal, analiza e forcave të porterit, fuqia furnizuse, fuqia blerse, kërcnimi nga konkurrentet e ri, kërcnimi nga produktet zavensuse, të tregu aktual. Strategjia e marketingut, duhet të jetë e lidhur me strategjin e ndërmarrjes.

⁷³ Gjokë Uldedaj –Arben Verçuni Marketingu Nderkombetar faq.18-19

- Në ekonomin e Republikës së Kosovës të gjitha ndërmarrjet duhet të gjejnë forma dhe të zbatojnë metodat dhe modelet e marketingut sepse marketingu është çelsi në zhvillimin e ndërmarrjeve në Kosovë shembull për këtë janë kompanitë më të fuqishme botërore.
- Ndërmarrjet në Kosovë duhet të eliminojnë parimin e familjarizimit dhe të rekrutojnë njerëz profesionistë në periudhë sa më të shpejtë kohore. Të zbatojnë planin e marketingut në mënyrë më të mirë duke u bazuar në marketingun njerëzë të marketingut. Plani i marketingut të harmonizohet me planin e biznesit të çdo ndërmarrjeje. Plani i marketingut duhet të mos ketë veç elementet produktit, çmimit, distribuimit, promovimit, por të gjitha elementet dhe format dhe metodat e marketingut duke u bazuar në kërkesat e tregut. Të bëjnë motivimin dhe trajnimin e stafit të shitjes.
- Ndërmarrjet në Kosovë duhet të ketë kujdes në menaxhimin e marketingut duke u bazuar në konceptin e marketingut të bazuar në vlerë.
- Logjistika duhet të jetë më efiçente me kosto më të vogla, në raport me konkurrencën. Të hartojnë një plan të mirëfillit dhe të detajuar për bashkëpunim më të mirë me pikat e shitjes. Kujdesë në analizën e konkurrencës, kush janë konkurrentët, sa janë të fortë, ku janë të fortë, çka duhet të bëjmë në raport me këta konkurrentë.
- Kujdesë në vërejtjet e konsumatorëve në rastë ankese të konsumatorëve, këto vërejtje të shqyrtohen me efikasitet, sepse humbja e një konsumatori do të na kushtojë 5 herë më shumë që të kemi një konsumator të ri. Pronarët e ndërmarrjeve në Kosovë duhet të jenë më koshientë në zhvillimin e ndërmarrjes, që në të ardhmen ti jepet një hapsirë më madhe njerëzëve që të rekrutohen truri nga jashtë ndërmarrjes pra njerëzët profesionistë sidomos të marketingut dhe zhvillimit .
- Të eliminohet parimi i familjarizimit, dhe të investohet në dije, pra në trajnime, seminare dhe këta njerëz të jenë të motivuar, por edhe ti ruajë këta njerëz. Të hulumtojnë tregun në mënyrë profesionale para se të vendosin për distribuimin e brendëve dhe produkteve. Në planin financiar duhet që për marketing të investohet aq sa duhet për marketing. Kontrolli të jetë më i madhë në realizimin e planit të marketingut dhe shitjes në të gjitha fazat me qëllim që të evitohen të metat eventuale dhe degradim nga plani.⁷⁴
- Gjatë aplikimit të marketingut në ndërmarrje, për të pasë një efekt maksimum në treg duhet të zbatohet thënja "**Mendo globalisht, vepron lokalisht**" bëhet një parim orientues i rëndësishëm, sa u përket klientëve, edhe ndërmarrjet në Kosovë duhet të jetë e orientuar në qasjen globale të zhvillimit, "**Mendo globalisht, vepron lokalisht**"

⁷⁴ Ma.Ali Ahmeti- Aplikimi i Marketingut Në Ndërmarrje-Rast Studimi Ndërmarrja "Passable " 2013

- Marketingu është si një busull në oqean që i jep drejtimin kapitenit të anijes, edhe marketingu e drejton ndërmarrjen nëpër rrugë që janë të mira për ndërmarrjen, Andaj unë rekomandaj që çdo ndërmarrje që të ketë sukses në treg duhet që marketingu të zbatohet në bazë të koncept të marketingut të bazuar në vlerë për konsumator.
- Matja e suksesit .

Bibliografia

- Prof.dr.Ali Jakupi Bazat e Marketingut ,Univesiteti i Prishtinës - 2000
- Liljana ELMAZI, Shaip BYTYÇI, Drejtim Marketingu, Prishtinë 2007
- Prof.dr.Nail Reshidi - Menaxhimi i startexhive të marketingut 2007.
- Ma.Ali Ahmeti- Aplikimi i Marketingut Në Ndërmarrje-Rast Studimi Ndërmarrja "Passable " 2013
- Principles of Marketing (14th Edition) by Philip Kotler and Gary Armstrong
- Prof.dr.Isa Tahiri Ndërmarrja dhe ekonomia e tregut Prishtinë 2006
- Prof.dr.Vaselike Kume ,Menaxhimi Strategjik 2010
- Prof.dr.Shyqri Llaci ,Menaxhimi 2010
- Prof.dr.Ali Jakupi Marketingut Ndërkombëtar 2008
- Prof.dr.Isa Mustafa ,Lidershipi,udhëheqja efiçenca dhe efektiviteti 2004
- Marketing management 12th, 13th Edition, by Philip Kotler and Kevine Lane Keller
- Prof.as.dr.Gjokë Uldedaj,Prof.as.dr.Arben Verçuni Marketingu ndërkombëtar

THE INSURANCE MARKET IN ALBANIA, A PANEL ANALYSIS.

Prof.As.Dr. Valentina Sinaj¹

¹Economics Faculty, Tirana Albania.

Email sinaj@yahoo.com

Erisa Rodhani²

²Economics Faculty, Tirana Albania.

Email erisa-rodhani@hotmail.com

Greta Kazia

³Economics Faculty, Tirana Albania. Email

greta-kazia@hotmail.com

Abstract

The insurance market plays an important role in the economy, as well as the prosperity and development of society. Insurance regarded as a very important pillar for the economy. The more developed insurance is the insurance culture in general are developed. Initially, offering various financial products to individuals and business insurance, can provide extensive coverage at a reasonable cost for a wide range of economic activities and the allocation of risk. Also, plays a key role in various economic activities through its function of financial intermediation. The purpose of this paper is to evaluate the factors affecting the profitability of insurance companies in Albania over the period 2008-2013. During the analysis of the insurance market factors are taken as part of the market, premiums and damages to the company that affect earnings of companies. To discover the links between these factors is used Granger causality test. For construction of models is regressive models using panel analysis. For the construction of models is used regressive analysis panel.

Keywords: Panel, Granger Casualty, FE, RE.

1.Hyrje

Tregu i sigurimeve është shumë i rëndësishëm sepse të lejon transferimin e riskut nga njëra palë tek tjetra. Individitët dhe bizneset të cilët nuk duan të mbajnë risk, mund t'ja kalojnë atë një kompanie sigurimi. Ky është një tipar thelbësor i një vendi që ka një treg financiar dhe një ekonomi që funksionon mirë. Praktikrat e sigurimit mbështeten në tre parime [Abraham, 2005]. Së pari, transferimi i riskut: risku transferohet nga risk individual - shmangës risku [Weller, 2005] në risk individual të siguruar - indiferent. Së dyti, mund të themi që në rast se është pranues risku, ai do të mbajë shumë polica sigurimi, duke bërë që pasugiria e individit të kalojë në sigurinë e sigurvecit, duke bërë kujdes në parashikueshmërinë e numrit të klientëve të cilët kanë të njëjtin risk. Së treti, shpërndarja e riskut: çdo prim i paguar reflekton riskun që mbart i siguruari. Ka një trend mes kostos së këtij klasifikimi dhe qartësisë së përfitimit i cili përcakton çmimet në proporcion me riskun.

2.Rishikim literature

Edhe pse përcaktuesit e përfitimit janë studiuar gjerësisht në sektorin e prodhimit (Ito (2010), Seelanatha (2011); Papadogonas (2007), [8,15,12]) dhe, në një masë të caktuar, në kontekstin e institucioneve bankare (Athanasoglous et al (2008); Ramlall (2009) [1,14]) nuk mund të gjenden punime të tilla empirike për industrinë e sigurimeve në përgjithësi dhe veçanërisht në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore (CEE).Disa nga studimet relevante së bashku me rezultatet e tyre kryesore do të paraqitet në paragrafët e mëposhtëm.

Shiu.Y (2004) kërkoi të identifikojë përcaktuesit e performancës së kompanive të sigurimit në Mbretërinë e Bashkuar. Autori përdori tre matje të performancës (të ardhurat nga investimi, përqindja e ndryshimit në fondet e aksionerëve dhe kthimi në fondet e aksionerëve) dhe zbuloi se likuiditeti, inflacioni i paparashikuar, niveli i normës së interesit dhe fitimet e nënshkruara ishin përcaktues statistikisht të rëndësishëm të performancës së siguruesit.

Hrechaniuk (2007) shqyrtoi ndikimin e aktiviteteve të ndryshme financiare në vite të ndryshme në të tre vende (Spanje, Lituanë dhe Ukrainë) dhe rezultatet e tij sugjeruan një lidhje të fortë midis performancës së fundit të siguruesit, rritjes së primeve të shkruara të sigurimit dhe performancës së siguruesit të vendeve anëtare "të vjetra", "të reja" të Bashkimit Europian si dhe vendeve jo- anëtare.

Nga rezultatet e analizës së bërë në Poloni, Kozak (2011) tregoi se rritja e GDP-së, rritja e përqindjes së tregut të kompanive në pronësi të huaj dhe ulja e peshës së sigurimit motorik në portofol ndikonin pozitivisht në përfitimin e kompanive të sigurimit të jo-jetës.

Ahmed (2011) hetoi mbi ndikimin e karakteristikave specifike në performancën e kompanive të listuara të sigurimit të jetës në Pakistan. Rezultatet e analizës së regresionit OLS treguan se madhësia dhe rreziku janë përcaktues të rëndësishëm të performancës së siguruesit të paraqitur nga ROA.

Pervan dhe Pavić Kramariq (2010) hulumtuan mbi variablat specifike të sigurimit, variablat specifik të industrisë dhe variablat makroekonomik si përcaktuesit e përfitimit të kompanive kroate të sigurimit të jo-jetës. Rezultatet sugjeruan ndikim negativ dhe të rëndësishëm të pronësisë, raportit të shpenzimeve dhe inflacionit, dhe ndikim pozitiv dhe të rëndësishëm të përfitueshmërisë të kaluar.

Ćurak (2011) konsideroi si karakteristikat specifike të firmës (të brendshme) ashtu dhe karakteristikat ekonomike (të jashtme) që ndikonin në përbërjen e kompanive kroate të sigurimit. Rezultatet e analizës panel të të dhënave treguan se madhësia, rreziku i nënshkruar, inflacioni dhe kthimi neto i kapitalit kishin ndikim të rëndësishëm në ROA-n e siguruesit si masë përfitueshmërie.

3.Historiku i sigurimeve në Shqipëri

Shoqëritë e sigurimit në Shqipëri janë krijuar duke filluar që nga viti 1991 deri në 2013, ku më poshtë do japim një listë të kompanive të sigurimit që operojnë në Shqipëri.

1. Në vitin 1991 në Shqipëri krijohet kompania e parë e sigurimeve, “INSIG” SH.A. Instituti i Sigurimeve INSIG u krijua me miratimin e ligjit nga Parlamenti Shqiptar për krijimin e Institutit të Sigurimeve, duke e ndarë atë nga Instituti i Arkave të Kursimit dhe Sigurimeve.

Më pas, u krijuan dhe kompani të tjera si Sigma, Eurosig, Interalbana, Intersig, SiCred dhe së fundmi Ansig.

2. SIGMA Sh.a, pjesë e Vienna Insurance Group, është shoqëria e parë private e sigurimeve në Shqipëri me të drejta të plota juridike për të konkuruar në treg. E liçensuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare për sigurimin e të gjitha kategorive të sigurimeve të Jo-Jetës, filloi aktivitetin e saj më 03.02.1999. Në këto 10 vjet të krijimit të saj kompania SIGMA aktualisht zë një pozicion të rëndësishëm në tregun shqiptar të sigurimeve. Si shoqëria e parë private e sigurimeve në vend, rruga nuk ishte aspak e lehtë, por e sigurtë dhe tani, pas një dekade, ajo e ndjen veten mjaft mirë për të vazhduar progresin edhe në të ardhmen. Themelimi i Shoqërisë së Sigurimeve Sigma Sh.a shënon edhe fillimin e procesit të liberalizimit të tregut të sigurimeve në Shqipëri, treg, i cili ka evoluar dhe është plotësuar përgjatë viteve si në gamën e produkteve që ofron, ashtu edhe në mënyrën e funksionimit të tij duke dhënë gjithashtu kontributin e saj si një ndër bizneset më të fuqishme. Sigma u shërben me cilësi të lartë rreth 100 mijë klientëve, ofron 20 produkte sigurimi, shtrihet me degët e saj në të gjithë territorin shqiptar dhe ka një prezencë rajonale në Kosovë e Maqedoni. Kompania zotëron një situatë financiare të shëndoshë duke i'u përgjigjur me shpejtësi klientëve të saj.

3. Eurosig sh.a është themeluar si një kompani Sigurimi të produkteve të Jo-Jetës në Shtator të vitit 2004. Në Dhjetor të vitit 2005, kompania shet aksionet 100 % dhe në Mars të vitit 2006 del në treg me emrin Eurosig Sh.a, tërësisht me kapital vendas dhe aksioner të rinj. Veprimtaria e kompanisë rregullohet në bazë dhe në zbatim të ligjit 9267 “Për Veprimtarinë e Sigurimeve, Risigurimit dhe Ndërmjetësimit në Sigurime dhe Risigurime” dhe akteve të tjera normative, të dalta në zbatimin e tij si dhe mbikqyret nga Autoriteti Mbikqyrës Financiar (AMF). Gjithashtu, udhëhiqet nga Statuti i Shoqërisë si dhe Rregullorja për funksionimin e Shoqërisë. Eurosig si kompania e konsoliduar në tregun e sigurimeve, është e shtrirë në tërë territorin e vendit me 17 Degë dhe mbi 210 Agjensi dhe pika shitjeje. Zgjerimi i rrjetit të shitjes, pozicionimi në tregun e sigurimeve me një rritje të ndjeshme dhe relativisht të shpejtë, ka ardhur si rezultat i një pune të vazhdueshme dhe i një stafi të kualifikuar. Eurosig sh.a për katër vitet e fundit është klasifikuar *si kompania me trendin më të lartë të rritjes* në tregun e sigurimeve.

4. Kompania e sigurimeve Interalbani është themeluar që prej vitit 2004. Ajo operon në tregun e sigurimeve të Jo-Jetës, me synimin kryesor që të ndihmojë klientët në realizimin e projekteve të tyre nëpërmjet produkteve të dizenuara posaçërisht në mbrojtjen e biznesit dhe familjes nga të papriturat e jetës. Klienti është në qendër të punës së tyre. Kjo kompani përpaket t'u paraprijë nevojave të tyre, duke ofruar shërbimin më cilësor, duke pasur gjithnjë parasysh standartet e larta morale, etike dhe ligjore. Ajo ofron besueshmëri dhe integritet, duke pasur garancinë e marrëveshjeve me Risigurues të klasit të parë, duke qënë pjesë e kompanisë Vienna Insurance Group.

5. Intersig u themelua në korrik të vitit 2001 nga 9 aksionerë vendas, të cilët u liçensuan për sigurimet e Jo-Jetës në Republikën e Shqipërisë. 10 vjet më vonë, Vienna Insurance Group bleu 75% të aksioneve të kësaj kompanie, duke e bërë Intersig pjesë të grupit më të madh në Europën Qendrore dhe Lindore. Ky proces i rriti kompanisë kapitalin, cilësinë dhe kualifikimet e stafit. Sot, INTERSIG VIG pozicionohet si kompania e dytë në tregun e industrisë të sigurimeve, e cila përbëhet nga 10 kompani. Ajo klasifikohet ndër të parat në Shqipëri në pagesën e dëmeve, të cilat realizohen brenda 20 ditëve pune me shërbim të shkëlqyer. Në fund të 2013, Intersig pozicionohet si kompania e tretë në tregun e sigurimeve.

Në vitin 2013 produkti “ Kasko” u rrit me 31.85%; pasuria 255.5%; shëndeti dhe aksidentet personale me 86.05%.

6. Shoqëria SiCRED sh.a është themeluar në 7 Tetor 2003, duke qënë kështu e para dhe e vetmja shoqëri sigurimi private në Shqipëri me kapital 100% vendas, e liçensuar për të vepruar në fushën e sigurimit të Jetës. Shoqëria operon në përputhje të plotëme kërkesat ligjore dhe kuadrit rregullator, në bazë të Autorizimit për të vepruar si shoqëri sigurimesh Nr.8 datë 19.07.2004 si dhe të lejës për Ushtrimin e Veprimtarisë në Sigurime, Nr.8/1 datë 10.09.2004.

7. Kompania e fundit, e liçensuar në vitin është ANSIG, e cila është futur në këtë treg në bazë të Vendimit nr.76, datë 22.06.2012, Botuar në Fletoren Zyrtare, nr. 74 datë 02.07.2012. Kjo është një shoqëri me kapital vendas, duke ofruar produkte për sigurimin e Jo-Jetës.

3.1 Vështrim i përgjithshëm i tregut të sigurimeve

Në tabelën nr.1 është paraqitur numri i kompanive të sigurimit të ndara në tipet e sigurimit për vitin 2009-2013. Vihet re që në sigurimet e Jo-Jetës është rritur numri i kompanive në krahasim me vitin 2011, duke e çuar në 8 numrin e këtyre kompanive që ofrojnë këtë shërbim, të cilat sollën rreth 88.12% të vëllimit të përgjithshëm të primeve të shkruara bruto. Nga ana tjetër, shoqëritë e sigurimit të Jetës janë në një numër konstant ndër vite në 2 kompani, të cilat sollën rreth 11.25% të vëllimit të përgjithshëm të primeve të shkruara bruto. Insigu është e vetmja kompani që ofron shërbimin miks, si sigurimin e Jetës dhe të Jo-Jetës.


Tabela nr 1: Numri i kompanive të sigurimit të ndara në tipet e sigurimit për vitin 2009-2013

Emërtimi	2009	2010	2011	2012	2013
Sigurim Jo-jetës	7	7	7	8	8
Sigurimi Jete	2	2	2	2	2
Mikse	1	1	1	1	1

Burimi : AMF, (2014)

Shqipëria karakterizohet nga një treg financiar sigurimesh relativisht i vogël nga pikëpamja e numrit të shoqërive që veprojnë në treg dhe vëllimit total të primeve të shkruara bruto. Gjatë vitit 2013, numri i shoqërive që kryejnë aktivitetin e sigurimit qëndroi i pandryshuar, ndërsa aktiviteti i tyre u tkurr. Primet e shkruara bruto për vitin 2013 kapën shifrën 8.54 miliardë lekë, duke u ulur me afro 4.63% krahasuar me vitin 2012 (AMF 2014).

Grafik 1. Ecuria prime/dëme bruto në vite



Burimi: AMF, (2014)

Metodologjia

Në punimin tonë kemi marrë në studim 8 kompanitë e sigurimit që operojnë në tregun e sigurimeve të Jo-Jetës në Shqipëri. Për analizën janë përdorur të dhënat financiare vjetore të 9 kompanive të sigurimit gjatë periudhës 2008-2013. Të dhënat janë marrë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) dhe nga faqet zyrtare në internet të kompanive përkatëse.

Është përdorur analiza panel, me të dhëna cross-sectional ku njësitë ekonomike vëzhgohen gjatë një periudhë të dhënë kohore. Gjatë analizave të tregut të sigurimeve kemi parë se si faktorë të tillë si pjesa e tregut, primet dhe dëmet e kompanisë ndikojnë mbi të ardhurat e kompanive.

Analiza do të përshkruajë etapat evlerësimit të modelit, ku si variabël të varur do të jenë të ardhurat e kompanive dhe si variabla të pavarur: pjesa e tregut, primet e sigurimeve dhe dëmet e kompanive të studiura në vite. Modeli i përgjithshëm ka trajtën e mëposhtme:

$$Tëardhurat = \alpha_i + \beta_1 pjesa\ e\ tregut_{i,t} + \beta_2 primet_{i,t} + \beta_3 dëmet_{i,t} + u_{i,t} \quad (1)$$

Ku indeksi i është për kompanitë e përfshira në studim dhe indeksi t merret për kohën.

4.1 Testi Granger

Shpesh në analiza, një problem që hasin studiuesit është përcaktimi i variablit të varur dhe atij të pavarur, pra cili variabël është shkaku dhe cili variabël është pasojë. Një problem të tillë e ka studiuar Granger (1969), i cili teorinë e vet e ka mbështetur mbi modelet VAR. Mbi modelin e ndërtuar, ai teston një grup hipotezash dhe jep përgjigje për lidhje shkakësore. Testi Granger përdoret për të përcaktuar nëse një seri kohore është e përshtatshme për të shkaktuar ndryshime në një seri tjetër. Sipas këtij testi nëse vlera e statistikës Fisher është më e madhe se vlera kritike e saj me nivel rëndësie 5%, atëherë hipoteza e ngritur bie poshtë.

Variblat e marrë në analizë janë të ardhurat e kompanisë (TR), Pjesa e tregut që ato mbulojnë (PT), primet (PR) si dhe dëmet (DM). Rezultatet e testit Granger për variablat tanë paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.2. Rezultatet e testit Granger të shkakësisë.

Null Hypothesis:	F-Statistic	Rezult	Null Hypothesis:	F-Statistic	Rezultati
PT does not Granger Cause TR	13.1612	bie	TR does not Granger Cause PT	2.38180	Qëndron
PR does not Granger Cause TR	12.0111	Bie	TR does not Granger Cause PR	1.12136	Qëndron
DM does not Granger Cause TR	1.37922	qendron	TR does not Granger Cause DM	6.92385	Bie

Burimi: Punimi i autorit, 2014

Sipas rezultateve, ekzistojnë lidhje të njëanshme midis variablave dhe pikërisht mund të themi se ndryshime të primet dhe të pjesa e mbulimit të tregut kanë ndikime të konsiderueshme mbi të ardhurat e kompanive.

4.2 Tipet e modeleve panel

Modelet ekonometrike që bazohen mbi të dhënat panel janë tre llojesh.

- Modelet me koeficiente constant, ku sipas këtij modeli supozohet se të gjithë koeficientët në regresion janë konstantë, domethënë janë të njëjtë për të gjitha kompanitë. Pra midis kompanive nuk ka ndonjë dallim të konsiderueshëm. Modeli i përgjithshëm është modeli (1) në paragrafët e mëparshëm.
- Modelet me efekte fikse (FE), të cilat janë modele ku intercepti i modelit mund të ndryshojë nga një kompani në një tjetër ose sipas serisë kohore ose sipas të dyjave njëkohësisht. Një gjë e tillë realizohet me përfshirjen në model të variablave cilësor.
Forma e përgjithshme e modelit me FE sipas cross-section është:
$$TR_{it} = \alpha_i + \beta_1 PT_{i,t} + \beta_2 PR_{i,t} + \beta_3 DM_{i,t} + a_1 K_1 + a_2 K_2 + \dots + a_7 K_7 + u_{i,t}$$

Ku variabli K_i merr vlerën 1 nese i përket kompanisë së i-të dhe merr vlerën 0 përndryshe.
- Modelet me efekte të rastit (FR). Për modelet me efekte të rastit është përdorur dhe testi Hausman për përzgjedhjen midis modelit me FE apo FR. Sipas këtij testi, nëse vlera e statistikës është më e madhe se vlera kritike, atëherë hipoteza bazë bie poshtë dhe për pasojë do të përzgjidhet modeli me FE.
Modelet e vlerësuara janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

Mngesat kryesore të këtij lloji të rrjetës janë për shkak që shërbimet e FR dhe ATM përmbliken jo shumë gjerë sikurse shërbime të ISP. Por, mundësit e ndryshimeve të FR dhe ATM mund të përdoren për sigurimin e nivelit të ndryshëm të kualitetit. Për këtë, shërbimet bazohen në përdorim, e kjo jep mundësi në reduktimin e çmimit dhe përdorimi i karakteristikave optimale. Gjithashtu, duhet njohuri për sigurimin e rrjetave publike për të pasur të drejtë implementimin. Disavantazhë shtesë mund të jetë që shpejtësia është jashtë kontrollit të përdoruesit, si dhe pamundësia e tunelimit të protokolëve tjerë përveç IP.

FR është bërë i popullarizuar dhe relativisht teknologji e lirë që është e përshtatshme për VPN. Për krijimin e VPN, FR mund të përdoret në dy mënyra:

- Krijimi i mesh, plotësisht të thurura në lidhjet FR në mes të lokacioneve. Këto lidhje point-to-point dhe të ngjajshme i kanë lidhjet e dhuruara. Të dhënat mbahen të ndara nga përdoruesit tjerë të FR kështu që secila lidhje e përdorë lidhjen virtuale të veçantë.
- Përdorimi i IP tunelit nëpërmjet FR lidhjes në mes të lokacioneve. Kjo lidhje janë pika kryesore e lidhjeve point-to-point dhe janë të ngjajshme me lidhjet e dhuruara. Secila lidhje i përdorë lidhjet e veçanta virtuale. Disa IP tunelë të ndarë mund të udhëheq nëpërmjet seciles lidhje dhe secili tunel mund të jetë i enkriptuar dhe i autentikuar që të sigurohen të dhënat. FR është protokol nga fundi në fund i cili mund të punojë nëpërmjet teknologjive të ndryshme, siç janë ISDN, DSL dhe POST dial up lidhjet. FR mund të ndërlidhet me ATM, duke e formuar në këtë mënyrë një nga shtrirjet e shërbimeve të rrjetës publike për shpërndarjen e të dhënave.

Rezultati i kësaj është që ata që i japin këto shërbime i kanë krijuar FR rrjetat globale të cilat janë më të shpaguara dhe ofrojnë shumë. Kur lidhem me tunell, enkriptim ose autentikim, këto attribute e bëjnë FR kandidat ideal për përdrimin global të shërbimeve VPN.

2. Shtresa e tretë e VPN rrjetës (IP VPN rrjeta) / Zhvillimi i internetit global ka krijuar mundësi për krijimin e VPN rrjetës duke u bazuar direkt në shtresën e tretë (IP) protokolit. Rëndësia kryesore e këtyre VPN rrjetëve ndaj VPN të shtresës së dytë është shkaku i karakterit të internetit global (Interneti është gjithkund në krahasim me Frame Relay dhe rrjetën ATM) dhe ofron reduktime shtesë të shpenzimeve. Rrjetat ndërtohen nga tunellët e enkriptuar të cilat i kanë të njëjtat funksione që i kanë pasur rrjetat e shtresës së dytë.

Rrjetat e shtresës së tretë ndahen në:

- Internet VPN
- IP VPN rrjeta

Të parat janë të realizuara duke e përdorur infrastrukturen e dy ose më shumë përdoruesve, ndërsa të dytat i përdorin resurset e vetëm njerëit (cila do, rrjeta private ose publike). Të dytat, e para dhe e dyta, janë kombinime të tunellit, kriptimit, autentikimit dhe autorizimit. Në këto rrjeta të shtresës së tretë VPN implementohet në tri kategori:

- Intranet (site-to-site)
- Extranet (business-to-business)
- Qasje e sigurt nga distanca

Intranet do të thotë lidhje në lokacionet e distribuimit (LAN) të një organizate, extranet është rezultat i duhur për ndërlidhjen varësisht nga organizata e cila i kupton ndryshimet specifike të llojeve të informatave (transakcione të sigurt monetare në mes të institucioneve financiare, lidhja e organizates me ëeb faqen e vet të cilat janë të mbledhura te ISP etj.). Çasja nga largësia është kategoria e tretë për qëllimin e të punuarit nga shtëpia ose për të punësuarit mobil. Kjo kategori i ka zvendësuar serveret RAS dhe zvogëlimin e dukshëm të kostos të thirrjeve telefonike (të gjitha telefonatat janë lokale) dhe mirëmbajtja e serveit bëhet nga dhënësi i shërbimit.

Nga realizimi konkret i VPN të shtresës së tretë ndahet në:

- Duke u bazuar në Hardware
- Duke u bazuar në Firewall
- Aplikacionet VPN

Shumë sisteme të bazuara në hardware janë realizuar nëpërmjet routerit i cili i kripton shënime. Ato janë të sigurt dhe të lehta për implementim dhe e garantojnë transferin më të madhë të shënimeve në rrjetë nga të gjithë VPN sistemet. Sistemet e bazuara në Firewall, i përdorin mekanizmat e firewallit siç janë: restriksionet e çasjes në internet, ndalimin e disa sistemeve të “pasigurt” duke shtuar siguri në VPN. Mbrojtja e sistemit operativ është më e rëndësishmja në këtë lloj të VPN sistemit. Disa prodhues të firewallit ofrojnë procesorë të veçantë për kriptim.

Sistemet e bazuara në softëare janë të përshtatshëm për VPN të cilat i përdorin organizatat e ndryshme për kontrollimin e lokacioneve të ndryshme ose kur në organizatë përdoren firewall dhe routera të ndryshëm. Shumica e këtyre VPN ofrojnë mundësi për tunellimin e trafikut në IP adresë ose në llojin e shënies, për dallim nga sistemet e bazuara hardwerike të cilët e tunellojnë të gjithë trafikun pa dallim të protokollit. Mungesa e VPN sistemit të bazuar në softëer qëndron në faktin që mirëmbajtja e tyre është komplekse në krahasim me sistemet e bazuara hardwerike.

3 Realizimi i IP VPN rrjetës

Tunellimi – Integriteti i shtresës së tretë të VPN rrjetës e garanton ndërtimin e tunellit të sigurtë nëpër komunikimit të IP publike duke i përdorur kanalet e shtresës së dtë (Tunneling Protocol - L2TP), përcjelljes së shtresës së dytë (Layer 2 Forwarding – L2F), Point to Point Tunneling Protocol PPTP ose IPSec protokolit. Tuneli bëhet nga fundi në fund, përkatësisht në mes të paisjeve (routerit ose paisjes) nëpër tërë rrjetën. Në dallim nga tri protokollët e parë, IPSec është përmbledhje e protokollëve dhe procedurave, mirëmbajtjen e komunikimeve të mbrojtura nga e cila IP rrjeta publike nëpërmjet shërbimit të autentikimit dhe kriptimit në nivelin e IP rrjetës (shtresës së tretë) ashtu që nga IP tunelli të kriptohen të dhënat. Jën të definuara katër mënyra për transmetimin e të dhënave nëpërmjet IP/Internet rrjetës.

- **In Place Transmission Mode** – Zgjidhjet që i specifikojnë prodhuesit e ndryshëm, e që i kriptojnë vetëm e nuk ka ndryshime të mëdha në paketë.

- **Transport mode** – I kriptojnë vetëm të dhënat, por e rrisin madhësin e paketës.

- **Encryptet Tunnel Mode** – IP kriptohet së bashku me të dhënat, e paketa ndahet një IP header të ri që e përdorë VPN. Kjo është një zgjidhje që e ofron mbrojtjen më të mirë të të dhënave.

- **Non-Encrypted Tunnel Mode** – Asgjë nuk kriptohet, por ipet një IP header i ri. Përderisa nuk ndodhë kriptimi në IP/Internet VPN rrjetën, më adekuat është përdorimi i termit Virtual Network (VN), për shkak që privaciteti është rëndësishëm në këto lloje të rrjetës.

- **Kriptimi** – Transmetimi i tekstit të paenkriptuar nëpërmjet internetit mund të jetë shumë i rrezikshëm. Të dhënat mund të lexohen përmes teknologjisë (sniffing).

- **Authentikimi** – Janë të ndarë dy autentikime: përdoruesi dhe shënimet. Autentikimi i të dhënave shpesh është në sisteme dhe e mirëmban identifikimin e VPN pajisjes e cila dërgon të dhëna si vërtetim që ato janë ndryshuar gjatë dërgimit. Sistemi për autentikim integrohen në VPN pajisje, pas autentikimit me sukses të përdoruesit mundësohet qasja në rrjetën VPN. Më së shpeshpi përdoret sistemi që e përmban RADIUS, TACACS/TACACS+ pse LDAP servisit për autentikim.

- **Autorizimi** – Pas vërtetimit të identitetit të personit që e përdorë VPN, definimi i mëhershëm i profilit i vendos shërbimet dhe aplikacionet që mund të përdoren, ashtu që ju mundësohet përdorimi i vetëm atyre resurseve të VPN për të cilat është i autorizuar. Autorizimi i

cili vepron në shërbim përmban: Shërbimet e internetit (Shfletuesin, mailin, FTP, Telnet e tj.), komplet familjen e TCP, të aplikacionet e bazuara në RPC ose UDP.

4. Rrjetat vpn të bazuara në MPLS / (multiprotocol label switching)

Karakteristika e të gjitha teknologjive të përshkruara për realizimin e VPN rrjetës është që ndërtimin e tre e bëjnë duke e përdorur modelin e ashtuquajtur “overlay” (nga dhënësi i shërbimeve të rrjetës ndërtohen lidhjet point-to-point në lidhjet virtuale ose IP tunellët që i lidhin lokacionet e përdoruesve). Disavantazhi i këtij modeli është zgjerueshmëria e vogël. MPLS teknologjia e parë që e mundëson qasjen e re në ndërtimin e VPN rrjetës në formën e modelit “peer”. Karakteristika kryesore e këtij modeli është që ka zgjerueshmëri të madhe që është rezultat që nga aspekti i routingut secili nga përdoruesit që lidhen në rrjetën publike mund të ndërtojnë lidhje në çfarëdo paisje në atë rrjetë.

VPN rrjetat të bazuara në teknologjinë MPLS janë kombinim i protokollit MPLS dhe disa routing teknologjive (BGP, OSPF, RIP). Tek VPN e bazuar në MPLS këto mekanizma ndërtojnë lidhje në mes të lokacioneve që quhen kufiri i informatës së distribuar.

4.1 Karakteristikat e rrjetës të bazuar në MPLS

MPLS VPN mundësojnë shërbime në ndërtimin e VPN të shkallëzuar dhe ofrojnë edhe këto mundësi:

- **Shërbimet pa krijimin e lidhjeve:** Kur formohen VPN pa krijimin e lidhjeve, nuk janë të nevojshme tunellët dhe enkriptimi i rrjetës për privacitet, e për këtë arsye zvogëlohet kompleksiteti i rrjetës.

- **Shërbimet e centralizuara:** Ndërtimi i VPN në shtresën e tretë të OSI modelit e lejon shërbime të grupuara që janë në VPN. Atyre mund të ju mundësohen shërbimet e IP, siç janë:

- Multicast
- Kualiteti i shërbimeve, QoS
- Mbështetja telefonike

- **Sigurimi:** MPLS VPN ofron të njejtën shkallë të sigurisë sikurse VPN të orientuar. Paketat nga një VPN nuk mund të shkojnë në VPN rrjetën tjetër pa kujdesje. Në shtypë, VPN është i ndarë. Ndërhyrja me qëllim të keq (spoofing) është praktikisht e pamundur për arsye që paketat refuzohen nga përdoruesi. Këto paketa duhet të pranojnë në interface të cakuar që të mund ta identifikojnë VPN.

4.2 Implementimi i VPN

Shoqëria moderne ka arritur përparim të madhë në fushëm e teknologjisë. Digjitalizimi dhe globalizimi janë domethënëse në kohën e re. Kur është në pyetje biznesi, ekzistojnë vetëm dy rregulla: të jeshë i shpejtë dhe më i mirë se të tjerët dhe të jeshë aty ku kërkohet. Për t'i arrir këto dy rregulla do të thotë të kemi fleksibilitet dhe sistemin e mirë të rrjetës. Për shpejtësi, besueshmëri, shkëmbim të informatave, nuk ka nevojë për posedimin e rrjetës private. Mënyra e realizimit të këtyre rrjetave në aspektin teknik vetëm janë të përpunuar. Ekziton një mundësi e madhe e lidhjeve private (lased line) nëpërmjet shtresës së dytë VPN rrjetës (frame relay dhe ATM), shtresës së tretë të VPN rrjetës (IP/Internet). Të gjitha nga këto zgjidhje i kanë të mirat dhe të këqijat e veta (rrjetat e shtresës së dytë: QoS të garantuar, shkallë të madhe të sigurimit, zgjerueshmëri të vogël, kufizim i hapsirës, rrjetat e shtresës së tretë: karakter global, qasje remote, sigurimi problematik dhe i zvogëluar). Zgjedhja e teknologjisë që do të përdoret në rrjetë, nvalet nga disa faktorë. Por në përgjithësi kërkesat të cilat paraqiten në këto rrjeta janë: sigurimi, besueshmëria, disponueshmëria, garantimi i QoS dhe natyrisht çmimi i ndërtimit dhe mirëmbajtjes. Të gjitha këto parametra i kanë faktorët dhe në nvarshmëri të tyre i zgjidhin teknologjitë për ndërtimin e VPN rrjetës.

5. Krahasimi i VPN-ve

Rrjetat private virtuale mund të ndërtohen në Frame Relay, ATM ose IP teknologjitë. Të gjitha nga këto i ka avantazhet dhe disavantazhet, qoftë nga mundësit ose nga ofrimi i shërbimeve. Implementimi i VPN në teknologji bazohet nga kërkesat e klientit. Gjithashtu, duhet të ceket që ka një rol të rëndësishëm edhe shpejtësia e qasjes në VPN teknologjinë. Tabela 1 e tregon krahasimin e VPN në teknologjitë e përmendura.

Tabela 1. Krahasimi i VPN teknologjisë

TIP	FR	IP	MPLS
Niveli punues	Shtresa e dyte e OSI Modelit	Shtresa e tretë e OSI Modelit	Shtresa e tretë e OSI Modelit
Prania	Nuk është shumë e pranishme	Shumë e pranishme	Nuk është shumë e pranishme, është teknologji në rritje
Llojet e të dhënave	Të përshtatshme për dërgimin e llojeve të ndryshme të të dhënave, zë, video dhe data	E përshtatshme për të dhëna, pak për video e shumë më pak për zë	E përshtatshme për dërgimin e llojeve të ndryshme të të dhënave

Teknologjia e bërthames apo periferike	Teknologjia e rrjetës periferike	Teknologjia e rrjetës periferike	Teknologjia e bërthamës së rrjetës
Siguria	Sigurohet duke e përdorur PCV ose SVC	Sigurohet gjatë tunelit	Sigurohet gjatë rrugës – LSP
Mbrojtja	Nuk ka nevojë për mbrojtje shtesë, enkriptimi i shenimeve për shkak të përdoruesit	Mbrojtjen me anë të enkriptimit dhe autentikimit, me mundësi përdorimi të firewallit	Nuk ka nevojë për mbrojtje shtesë
Klasa e shërbimit QoS	Nuk e përkrahë	Nuk e përkrahë	E përkrahë
Përdorimi në të ardhmen	Teknologji e vjetër e cila sot është mjaftë e shtrirë, por ngadale zëvendësohet me teknologji të re duke kaluar në IP	IP teknologjia shumë më tepër përdoret, ka shtrirje të madhe	MPLS si teknologji e re, e prezenton zhvillimin e ardhshëm të dërgimit të të dhënave IP+MPLS

Rast studimi

Menyra e përdorimit të VPN lidhjes në një ndërmarrje

Zhvillimet teknologjike perparimi i tyre me hapa te vullshem lind si nevojë që qdo ndërmarrje ta ketë sistemin e vete kompjuterik, sepse e gjithë kjo do ti mundësoj ndërmarrjeve apo kompanive që të jenë më efikas të përparojn dhe standardizojn proceset e tyre të biznesit dhe shërbimin ndaj klientit.


Zhvillimi i këtij sistemi do ti siguroj kompanisë automatizmin e procesit dhe rrjedhimisht do të qojë ne minimizimin e gabimeve dhe modernizimin e metejshem të procedurave që janë të lidhura me aktivitetet e qdo ndërmarrjes mvarësisht prej aktiviteti që e zhvillon.

Sistemet tona kanë arqitekturë modulare. Të gjitha veprimet specifike janë të ndara në module të cilat janë të vendosura në dritaren e parë me të cilën shfrytëuesi ndeshet. Kjo e bënë orientimin shumë të lehtë për shfrytëzuesin brenda aplikacioneve tona.

Përfaqësimi vizuel i thjeshtësuar dhe struktural i shënimeve të vendosura në librin kryesor gjatë veprimeve dhe operacioneve të përditshme të shfrytëzuesit të cilat kanë origjinën nga krijimi i dokumenteve nga modujt siç janë blerja, shitja, prodhimi etj.

Aplikacioni mundëson që shfrytëzuesi të kontrolloj duke shfrytëzuar infrastrukturën e Internetit për versione të reja të aplikacionit. Kjo veçori mund edhe të konfigurohet që kontrollera për versione të reja të bëhet në mënyrë automatike.

Qasja në pika tjera të shitjes



vet.

I terë sistemi është i lidhur neper servere i cili është i ngritur në bazë, secila pike ka nga një serverë te vetin, sistemi është online në qdo kohë ka qasje neper pikat tjera.

Sistemi është i lidhur permes rrjetit LAN kjo është mundesuar permes kompanisë ISP me instalimin e VPN. Qasja nëpër baza tjera dmth inkuadrimi në serverë tjerë bëhet përmes

Fig. 3. Modulet e programit REMOTE DESKTOP ku secila bazë e ka IP-në e



Fig.4. Remote kontroll

Avantazhet dhe disavantazhet e rrjetit ne ndermarrje

Ky sistem sigurisht qe ka shumë të mira perveq që të gjitha të dhenat si: shitja, blerja, financat kryhen në menyrë automatike gjë që ndihmon shumë punen e një kompanie e sidomos e shkurton kohen dhe në të njejten kohë dhe kryerjen e shumë punëve, sepse ne ditët e sotme koha vlenë para. Në sistemin e financave në menaxhim ndihmon shumë sepse tani përmes këtij sistemi

kryhen të gjitha punët si: kryerja e pagesave përmes E-Banking, menaxhimi i punëtorëve, menaxhimi i stokeve me një fjalë në çdo kohë je i informuar për të gjitha ato që ndodhin brenda dhe jashtë kompanisë.

Si disavantazh e që e mendoj që është problemi kryesor në tërë Kosovë është ndërprerja e energjisë elektrike e cila është shumë e shpeshtë e si pasojë e kësaj vije deri te ndërprerja e rrjetit e cila e pamundëson zhvillimin e punës.

Përfundimi

Sigurimi i kompjuterëve dhe rrjetës kompjuterike është tregim që nuk ka fund. Që ky tregim mos të ketë përfundim të keq, si fillim duhet ta instalojmë një antivirus në kompjuterin tuaj. Kjo është më së paku që mund të bëjmë.

Në qoftë se vetëm e keni të instaluar antivirusin, duhet që në mënyrë konstante ta mirëmbani dhe ta bëni update. Këto lloje të programeve zakonisht i kanë disa funksione automatike për zhkarkimin e të rejave dhe definimin e virusëve.

Sigurimi është brenga kryesore e secilit që e përdorë teknologjinë informative. Janë disa nivele të sigurisë që duhet të përdoren, në mënyrë që të jemi më të qetë.

Firewall shpeshherë ofrohet si opcioni i parë për sigurinë në rrjetë. Mund të jetë si pjesë e hardverit ose si pjesë e softëerit. Pas përdorimit të firewallit duhet të kemi kujdes edhe në përmbytjet që na vijnë ose shkojnë nga rruga e emailit, gjithashtu duhet të kemi kujdes edhe nga ëeb faqet të cilat mund ta përmbysin sigurinë në punë. Përveq kërcënimeve nga interneti me rëndësi është të kemi mundësi për mbrojtjen e punëtorëve dhe informatave të punëve.

Referencat

- Markus Feilner, Open VPN, Building and Integrating Virtual Private Networks, 2006.
- Ritika Kajal et al., International Journal of Advanced Research in Computer Science and Software Engineering 2(10), October- 2012, pp.428-432
- Ivan Misner, David Alexander & Brian Hitlard, Networking like a pro, January 1. 2010
- Measures Byeong and Maricel O. Balitanas, Vulnerabilities of VPN using IPSec and Defensive 2009
- Jeffrey Shapiro, Jim Boyce, Marcin Policht, Brian Patterson i Scott Leathers,
- Windows Server 2003 Biblja, Mikro Knjiga: Wiley Publishing, Inc. Beograd 2003
- Dr. Chiarella Anthonu, Umrezovanje pomocu Cisco i Microsoft tehnologija, Kompjuter Biblioteka, Cacak, 2005.

- Dr. Kurose Jim & Dr. Ross Keith, Computer Networking, A Top-Down Approach, fifth edition, Pearson Education, 2009.
- Casad Joe & Newland Lee Daniel, Networking Essentials, New Riders Publishing, Indianapolis USA.
- Barrie Sosinsky-Networking Bible, ISBN-13: 978-0470431313, 2009
- Ivan Misner, David Alexander & Brian Hitlard-Networking like a pro, January 1. 2010

BASHKËPUNIMI I KOSOVËS ME SHTETET FQINJE KUNDËR KRIMIT TE ORGANIZUAR

Mr. Lulzim SERÇA

Abstrakt

Hyrje

Bashkëpunimi i Kosovës me shtetet Ballkanit Perëndimor dhe sidomos me vendet fqinje, që kanë aderuar apo janë kandidatë për në BE, është jetësor për zhvillimin e një mirëkuptimi të përbashkët në çështjet policore, si edhe për një përjasje të përbashkët në trajtimin e dukurive të veçanta ndërkufitare, për tepenguarkrimin e organizuar.

Kriminaliteti është një rrezik serioz për shoqërinë. Ai përbën rrezik për konsolidimin e një shteti ligjor dhe demokratik. Regjionalizimi apo ndërkombëtarizimi i krimit të organizuar, rritja e trafikut të drogës, të armëve, trafiku i qenieve njerëzore, pastrimi i parave, të kushtëzuara dhe të përlyera me korrupsion, e bëjnë domosdoshmëri shkëmbimin e përvojave dhe informacioneve të Institucioneve perkatese të Republikës së Kosovës me shtetet fqinje.

Lufta kundër kriminalitetit të organizuar duhet të jetë një aktivitet i mirëfilltë ligjor i strukturave qeveritare të Republikës së Kosovës dhe pushtetit gjyqësor, në bashkëpunim me strukturat e NATO-s dhe të BE-së, që ngrisin domethënien e vërtetë në luftën kundër kriminalitetit- një aktivitet që doemos duhet të ngrihet edhe në bashkëpunim ose koordinim rajonal me vendet fqinje.

Fjalët kyçe: Krimi, kriminaliteti bashkëpunimi, ndërkufitar, integrimi, EULEX, Agjencitë.

1. DISA KARAKTERISTIKA TË KORRUPSIONIT NË KOSOVË DHE PARANDALIMI I TIJ

1.1.Kuptimi i korrupsionit

Korrupsioni është njëra ndër format më të rënda si një paraqitje e përhapur në shoqëritë moderne, por fatkeqësisht, disa forma të korrupsionit janë bërë përditshmëri brengosëse për vendin tonë. Korrupsioni si vepër penale nuk mund të identifikohet me krimin e organizuar, por ai vepron në bashkëpunim të ngushtë me të, si me marrëveshje të hapura, edhe duke nxjerrë përfitime nga njëri-tjetri, sidomos në mbrojtjen e organizuar të veprimtarisë kriminale. Kjo rrezikshmëri shoqërore është edhe shkaku që jo rrallë korrupsioni dhe lufta kundër tij në botë trajtohen në një plan me luftën kundër krimit të organizuar duke e konsideruar atë në përbërësit kryesore të tij.⁸⁵

Korrupsioni është kthyer në një rrezik serioz për shoqërinë. Ai përbën rrezik për konsolidimin e një shteti ligjor dhe demokratik. Ndërkombëtarizimi I krimit të organizuar, rritja e trafikut të drogës, të armëve, trafiku i qenieve njerëzore, e sidomos trafiku i fëmijëve dhe grave për prostitucion, pastrimi i parave, të kushtëzuara dhe të përlyera me korrupsion, e bëjnë domosdoshmëri dypalëshe dhe shumëpalëshe të shteteve shkëmbimin e përvojave dhe informacioneve, si dhe bashkëpunimin ndërmjet organeve të policisë dhe organeve të tjera shtetërore. Kuptohet, gjithë kjo duhet të trajtohet shkencërisht duke e përshtatur luftimin e korrupsionit në praktikë.⁸⁶

1.2.Ndërkombëtarizimi i korrupsionit

Në shumë shtete ekzistojnë hulumtime dhe vlerësime mbi korrupsionin dhe mbi efektet e tij negative. I përkufizuar thjeshtë, korrupsioni është keqpërdorimi i fuqisë së besuar për përfitim material. Nuk jemi shumë larg nga koha kur kjo fjalë ishte plotësisht një tabu në ambient politik dhe profesional. Ajo fjalë shfaqej rrallë nëpër gazeta dhe përmendej rrallë nga ekonomistët, megjithëse shkencëtarët politikë kishin filluar të shfaqin interes akademik për të.

⁸⁵ Shih, Prof. Dr. Vesel Latifi, Kriminalistika, Prishtinë, 2004, fq. 182

⁸⁶ Shih, Prof. Dr. Luan Gjonça, Korrupsioni, Tiranë, 2004, fq. 13

Në dokumentet dhe marrëveshjet ndërkombëtare ndeshen formulime nga më të ndryshmet, të cilat herë i përmbahen kuptimit të ngushtë të tij, ndërsa sidomos ato para vitit 1990 diku e trajtojnë në kuptim më të gjerë. Kohëve të fundit po vihen re përpjekje për afrimin e formulimeve drejt një përcaktimi të saktë e të unifikuar juridik. Asambleja e OKB-së, në seminarin ndërrajonal të Havanës, me temën kundër korrupsionit, të mbajtur më vitin 1990, korrupsionin e përcaktonte si “shpërdorim të detyrës për arritjen e përfitimeve personale apo të grupit, si dhe përfitim i nëpunësve shtetëror i rrjedhojë e pozitës së tyre zyrtare që e kanë ata”.⁸⁷

Nga ky përcaktim evidentohet fakti se bëhet fjalë vetëm për përfitime materiale që janë karakteristike për veprat penale të ryshfetit. Në dokumentin e përpiluar në sesionin e 8-të të OKB-së të mbajtur po në vitin 1990, korrupsioni përsëri trajtohet disi në kuptim të ngushtë, në vazhden e përkufizimeve të mësipërme, por e veçanta e këtij dokumenti ndërkombëtar qëndron te zbërthimi i elementeve karakteristike dalluese të tij dhe në ndryshimin që ekziston në konceptimin ndërmjet fenomenit të korrupsionit dhe veprimeve kriminale të nëpunësve shtetëror. Në të gjithashtu evidentohen dhe saktësohen kuptimet për paligjshmërinë e veprimeve korruptive, si dhe format e shfaqjes së saj te nëpunësit shtetëror. Shumë autorë theksojnë se nuk ka shoqëri në të cilën nuk është i pranishëm korrupsioni dhe, për këtë arsye, kjo dukuri kriminale ka zgjuar interesim të madh. Disa autorë dallojnë forma të ndryshme të korrupsionit. Kështu flitet për korrupsionin politik i cili ka të bëjë me marrjen e funksioneve të pushtetit politik ose me mbajtjen e privilegjeve të caktuara politike duke dhënë ryshfet, mitë etj. Më pas bëhet fjalë për korrupsionin administrativ i cili ka të bëjë me administratën shtetërore, ku duke i shfrytëzuar kompetencat e veta në administratë, prej asaj lokale deri te ajo qendrore, nëpunësi merr mitë, ryshfet, d.m.th. korruptohet duke u dhënë leje, certifikata e dokumente dhe akte të tjera individëve, grupeve dhe firmave për realizimin e interesave të ndryshme materiale dhe financiare për grumbullimin e pasurisë që shpeshherë nuk u takon atyre.⁸⁸

Korrupsioni tjetër është i ashtuquajtur i korrupsion gjyqësor i cili qëndron në dhënien dhe marrjen e ryshfetit dhe mitës prej punonjësve të gjykatave, me qëllim që kështu të pengohet

⁸⁷ Dr. L. Gjonça, Korrupsioni, veprat penale përbërëse - krimi i organizuar, Tiranë, 2004, fq. 59

⁸⁸ Dr. R. Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2002, faqe 193

procedura penale me qëllim që të nxirren vendime gjyqësore të favorshme, me qëllim që të shmangët shqiptimi i dënimeve dhe sanksioneve tjera.⁸⁹

1.3.Disa karakteristika themelore të korrupsionit

Faktorët që e mundësojnë dhe ndikojnë në shfaqjen e korrupsionit më së shpeshti janë:

- mungesa e një baze të fortë ligjore
- moszbatimi i ligjeve ekzistuese
- mungesa e përvojës dhe aftësisë profesionale për ta luftuar korrupsionin
- reformat në administratë etj.⁹⁰

Korrupsioni nuk është kriminalitet i thjeshtë, që kriminalitetin dhe grupet kriminale t'i përzëmë diku nëpër rrugë. Korrupsioni për nga natyra e punëve paraqitet dhe kryhet përmes pushtetit, pavarësisht nga cila anë fillon iniciativa, ndërsa lloji i lartë i korrupsionit, sipas etiologjisë së saj dhe prirjes së saj ligjore merret si *eo ipso i ipso facto*.⁹¹

1.4.Disa masa në parandalimin e korrupsionit

Korrupsioni është një fenomen që, në rast se nuk frenohet në kohën e duhur, karakterizohet me përhapje të shpejtë të tij në formë të një epidemie sociale. Sipas disa autorëve, nisur nga tiparet dhe karakteristikat e përbashkëta të masave frytdhënëse që qëndrojnë në luftën e organizuar kundër korrupsionit, për efekt të këtij studimi ato masa do t'i grumbullonin në këto bashkësi:

- masa të karakterit legjislativ;
- masa organizative;

⁸⁹ Po aty

⁹⁰ Dr. L. Gjonça, Korrupsioni, veprat penale përbërëse - krimi i organizuar, Tiranë, 2004, fq. 59

⁹¹ Po aty

- rritja e informacionit publik dhe inkurajimi i shoqërisë civile;
- promovimi i transparencës dhe integritetit në operacionet e biznesit;
- menaxhimi i financave publike;
- bashkëpunimi ndërkombëtar, promovimi i transparencës dhe integriteti në operacione.⁹²

Korrupsioni është një fenomen që e minon stabilitetin politik, besimin e njerëzve në sistemin politik dhe atë gjyqësor, në shtetin e së drejtës, zhvillimin ekonomik, investimet e huaja dhe integrimin e vendit. Pra, synimi kryesor I vendeve është parandalimi, kontrolli dhe lufta kundër korrupsionit, me qëllim të reduktimit deri në maksimum të efekteve të tij minuese mbi besimin e publikut në sistemin politik dhe gjyqësor, në shtetin e së drejtës, në zhvillimin ekonomik, në investimet e huaja dhe në integrimin europian.⁹³

Disa nga masat e preferuara në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit janë:

- Legjislacioni në sferën ekonomiko-financiare jo vetëm që i rregullon marrëdhëniet që krijohen në administratën përkatëse, por edhe e zvogëlon maksimalisht mundësinë e shfaqjeve dhe zhvillimeve korruptive në sektorë të tillë financiarë që infektohen lehtësisht nga korrupsioni, si: tatimet dhe doganat, sektorët e shpërndarjes së mjeteve buxhetore, tenderët, ai i zhvillimit të ekonomisë joformale etj.;
- Përmirësimi i kushteve të punës dhe rritja e pagave në administratë, arsim, shëndetësi e gjyqësi padyshim se do ta zvogëlonte korrupsionin etj.⁹⁴

2. PROBLEMET E ZBULIMIT DHE TË LUFTIMIT TË KORRUPSIONIT

Shumë vende, veçanërisht në Europën Juglindore, kanë miratuar ligje kundër korrupsionit të cilat i lehtësojnë ekonomitë e reja të tregut që po zhvillohen duke e eliminuar kështu konkurrencën e pandershme ekonomike në nivelet kombëtare ose ndërkombëtare të tregtisë. Po

⁹² Arben RAKIPI, KORRUPSIONI DHE EVAZIONI FISKAL, Tiranë, 2003, fq. 37-38.

⁹³ Dr. M. Laboviq, Makedonska revija za kazneno pravo i kriminologija, Skopje, str. 154

⁹⁴ L.Gjonca, Korrupsioni, Tiranë 2004, faqe 10.

ashtu, duke i pranuar rrënjët socialiste dhe periudhën e egër të tranzicionit të rritjes së krimit dhe të ardhurave të ulëta kombëtare, po bëhen përpjekje legislative për të siguruar ndershmëri edhe në shërbimet e nevojshme sociale.⁹⁵ Programi Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në Europën Juglindore nga Këshilli i Europës, përveç tjerash, rekomandon:

a. Legjislacionin specifik kundër korrupsionit: Qëllimi i miratimit të ligjeve të veçanta kundër korrupsionit është që të rritet ndërgjegjja politike dhe publike në luftën kundër korrupsionit. Këto ligje të veçanta përkufizojnë sjellje të cilat janë subjekt i ndalimit të korrupsionit dhe të fushave shoqërore që janë tejet të ndjeshme ndaj korrupsionit. Një nga tiparet më të zakonshme të këtij lloj legjislacioni është ai që kryesisht parashikon: përgjegjësi dhe detyrime prej personave zyrtarë për t'i deklaruar të ardhurat dhe pasuritë e tyre; ndalimi i konfliktit të interesave; parandalimi i çdo lloj mundësie korrupsioni në procesin e prokurimit në qeveri; sanksionet e veçanta administrative dhe metodat hetimore janë përgjithësisht të njohura nëpërmjet këtyre ligjeve, ndërsa në disa raste policia speciale dhe organet e tjera kundër korrupsionit ose komisionet parlamentare krijohen me qëllim që ta monitorojnë veprimtarinë e organeve të zbatimit të ligjit dhe veprimtarinë gjyqësore si dhe për të propozuar strategji të reja të parandalimit.

b. Mjetet e veçanta hetimore: është një situatë e përgjithshme në ligjin procedural të Europës kontinentale që autoritetet hetimore, pasi të kenë filluar procedura penale formale kundër një të pandehuri, kanë të drejtë t'i përgjojnë komunikimet, t'i kontrollojnë banesat, lokalet dhe personat, si dhe t'i konfiskojnë provat e nevojshme dhe të ardhurat nga krimi, nëse autoritetet gjyqësore (në fund të gjykimit) vendosin kështu; në situata urgjente, aktivitete të tilla nga krimi, ka hyrë në fuqi më 1 shtator 1993.

Njëra nga konventat europiane e lehtëson bashkëpunimin ndërkombëtar dhe ndihmën reciproke në hetimin dhe zbulimin e krimit, si dhe në sekustrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga ky krim. Konventa synon t'u ndihmojë vendet të arrijnë një shkallë efikasiteti

⁹⁵ Instrumentet ligjore të Këshillit të Evropës dhe tekste të tjera bazë lidhje me antikorrupsionin, 2002.

edhe në kushte të mungesës së harmonisë së plotë ligjore.⁹⁶ Palët angazhohen në veçanti që ta penalizojnë pastrimin e të ardhurave nga krimi dhe t'i konfiskojnë mjetet dhe të ardhurat (ose pronën - vlera e së cilës korrespondon me këto të ardhura).

c. Për qëllime të bashkëpunimit ndërkombëtar, kjo konventë parashikon: forma të ndryshme hetimore (për shembull, ndihmë në grumbullimin e provave, dhënie të informacionit një vendi tjetër pa pasur kërkesë nga ky vend, zbatimi i teknikave të përbashkëta hetimore, heqja e sekretit bankar etj.); ngrirja e llogarive bankare, sekuestrimi i mallit për ta parandaluar

transferimin e tij; masa për t'i konfiskuar të ardhurat e siguruar nëpërmjet krimit - zbatimi në një vend i një kërkesë konfiskimi të bërë nga një vend tjetër, fillimi në një vend i procedurave që shpjen në konfiskim në bazë të një kërkesë të një vendi tjetër etj. Megjithatë, ndonjëherë, masat dhe metodat e tilla nuk janë shumë efikase kur hetuesit përballen me aktivitete terroriste, krim të organizuar ose korrupsion të gjerë. Duhet theksuar se Konventa e Organizatës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit ekskluzivisht parasheh se të gjitha shtetet janë të detyruara ta parandalojnë korrupsionin dhe domosdoshmërinë e bashkëpunimit të ndërsjellë. Në njëërën nga dispozitat e kësaj konvente përkufizohen kuptimet e disa termave, si: “punonjës shtetëror” (çdo person që ka mandat ligjvënës, ekzekutiv, administrativ ose gjyqësor në ndonjë shtet, i cili ka qenë i emëruar ose i zgjedhur në kohë të caktuar ose të pacaktuar, i paguar ose pa pagesë, pavarësisht nga niveli hierarkik; çdo person tjetër që kryen funksion publik, përfshirë këtu edhe organin shtetëror ose organizatën publike ose atë që e ofrojnë shërbime publike, ashtu siç definojnë këto terma në të drejtën nacionale dhe çdo person tjetër i definuar si “punëtor shtetëror” në të drejtën nacionale të ndonjë shteti.), “punonjës i huaj shtetëror” (çdo person i cili ka mandat ligjor, ekzekutiv, administrativ ose gjyqësor të ndonjë shteti të huaj, që e ka emëruar ose zgjedhur dhe çdo person që ushtron funksion publik për ndonjë vend të huaj, përfshirë këtu edhe organin shtetëror ose organizatën publike), “funksionari i organizatës ndërkombëtare publike” (funksionar ndërkombëtar ose çdo person i autorizuar nga organizata e këtillë për të vepruar në emër të saj), “të ardhurat nga krimi” (çdo pasuri që e ka prejardhjen e drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga ndonjë vepër ose që është fituar me kryerjen e drejtpërdrejtë ose të tërthortë

⁹⁶ **Konventa (e Këshillit të Evropës) mbi pastrimin, zbulimin, sekuestrimin dhe konfiskimin të ardhurave.**

të këtij krimi), “konfiskimi” (marrja e përhershme e fitimit në bazë të vendimit të gjykatës ose nga organi tjetër kompetent etj.), “dërgesat e kontrolluara” (metodë që mundëson daljen nga territori, kalimin nëpër territor ose hyrje në territor të një apo më shumë shteteve, në mënyrë të palejuar ose të dyshuar, por nën kontrollin e organeve kompetente të këtyre shteteve, me qëllim të zbatimit të hetimeve për ndonjë vepër, si dhe për identifikimin e personit të inkuadruar në kryerjen e tyre etj.). d. Krijimi i mekanizmit të antikorrupsionit: si pasojë e rritjes së ndërgjegjësimit ndaj korrupsionit, shumë vende kanë zhvilluar ose janë akoma në fazën e zhvillimit, të autoriteteve të veçanta të antikorrupsionit dhe programeve të veçanta me qëllim që ta përforcojnë, ta parandalojnë dhe ta koordinojnë luftën kundër korrupsionit, duke e përfshirë edhe bashkëpunimin ndërkombëtar kundër korrupsionit. Njësitë e specializuara janë pjesë e reformës legjislativë dhe institucionale të cilat kanë si qëllim zbatimin e detyrave/masave të tilla sipas iniciativave të antikorrupsionit që janë marrë nga çdo autoritet qeveritar.⁹⁷

Ndër elementet më themelore të luftës kundër korrupsionit mund të veçohen:

- Përcaktimi dhe vendosja e paluhatshme e udhëheqjes politike të vendit dhe e të gjithë organeve të tyre kundër korrupsionit;
- Organizimi dhe bashkëpunimi institucional në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar kundër korrupsionit;
- Sigurimi i dhënies së përgjegjësive të të gjithë atyre që punojnë në administratën shtetërore, në qeveri a parti, por që implikohen në korrupsion;
- Reformimi i policisë dhe gjyqësisë në drejtim të organizimit të organeve të specializuara për luftimin e krimit të organizuar e, në veçanti, të korrupsionit etj.

⁹⁷ Mihajlo MANEVSKI, Korupcijata vo Republika Makedonija, Preventivni I kazneni merki za spre~uvawe, Skopje, 2005, fq. 21. Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit u miratua më 09.12.2003. në Meridë - Meksikë, në konferencën e mbajtur prej 09-12.12.2003 dhe me pjesëmarrjen e 120 shteteve.

3. KORNIZA NDËRKOMBËTARE JURIDIKE E LUFTËS KUNDËR KORRUPSIONIT

Analiza e kornizës ndërkombëtare juridike për pengimin e korrupsionit, e përmbajtur në elaborimin e mëtejshëm, ka për qëllim ta demantojë besimin iluzionist se me miratimin e zgjidhjeve të reja ligjore edhe vërejtjet e këtilla të arsyeshme janë bërë të pabaza. Përkundrazi, është e pakontestueshme se për strategji bashkëkohore të pengimit të korrupsionit janë të rëndësishme disa postulate bazike. Së pari, bëhet fjalë për aktivitet kompleks, preventiv dhe represiv, ndërkombëtar dhe nacional, që realizohet në më shumë rrafshë: legjislativ, institucional, si dhe në fushën e zbatimit të së drejtës. E dyta, zbatimi i normave penalo- juridike (materiale dhe procedurale) supozon një sistem të zhvilluar juridik, gjegjësisht akte të tjera ndaj të cilave ndalesat penalo-juridike do të mund ta realizonin funksionin e tyre *ultima ratio*. Dhe, e treta, koncepti juridik kundër korrupsionit supozon orientim kundërkorrupsional të të gjitha faktorëve në shoqëri, para së gjithash të atij politik, që janë të thirrur dhe të detyruar të krijojnë një ambient të shtetit demokratik të së drejtës, gjegjësisht të krijojnë kushte për zbatimin e instrumenteve juridike në luftën kundër korrupsionit.

3.1.Pengimi i korrupsionit në UE

Lufta kundër korrupsionit është ndër prioritetet më të larta të UE-së, sepse këtu bëhet fjalë për "formë të re" të kriminalitetit që i dëmton vetë mekanizmat institucional mbrojtëse dhe i paralizon orvatjet për një vendosje anti-kriminale të sistemit të drejtësisë dhe të punëve të brendshme! Për këtë shkak, pengimi i korrupsionit me Traktatin e Mastroitit është ngritur në shkallë të interesit të përgjithshëm (neni 29). Përcaktimi për politikë konsistente kundër korrupsionit është përfshirë në *Programin aksionar për shkatërrimin e krimit të organizuar* të vitit 1997, në *Planin aksionar të Vjenës* të vitit 1998 dhe *Qëndrimet programore të Samitit të Tampesës* të vitit 1999, të zhvilluara më vonë në *Strategjitë për shkatërrimin e krimit të organizuar* të Këshillit të Europës të vitit 2000.

3.2. Legjislacioni i antikorrupsionit në vendet e zhvilluara dhe në vendet në tranzicion

Lufta kundër korrupsionit kudo në botë zhvillohet në dy dimensione: në planin preventiv dhe në planin represiv.

Plani preventiv në vete i përmban dy qasje:

E para, lufta kundër korrupsionit duhet të zhvillohet dhe të organizohet me anë të programeve të veçanta qeveritare dhe me formimin e agjencive nacionale;

E dyta, lufta kundër korrupsionit kërkon vendosjen e një sistemi juridik të bashkërenditur, me anë të zgjidhjeve të koordinuara në më tepër degë të së drejtës: në të drejtën administrative, në të drejtën e punës, në të drejtën civile, në të drejtën financiare e të ngjashme, që së bashku përbëjnë sistemin ligjvënës të antikorrupsionit.

Në këtë drejtim parashihen edhe sanksione përkatëse për ata që i shkelin këto ndalesa, si: konfiskimi i pasurisë dhe i fitimit nga transaksioni kundërligjor.⁹⁸

4. BASHKËPUNIMI RAJONAL DHE LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Në shpjegimin e shkaqeve dhe të faktorëve që i përcaktojnë dukuritë e korrupsionit dhe pengesat që paraqiten në luftën kundër tij, te shumë autorë të cilët merren me këtë temë paraqiten mendime të ndryshme. Disa nga ata përcaktuesit e paraqitjes dhe zhvillimit të kësaj dukurive i kërkojnë te: faktorët politikë, ekonomikë, te faktorët e sigurisë, të periudhës institucionale tranzitore etj. Ndërkaq pengesat në luftën kundër korrupsionit i shohin në burokratizimin e aparatit shtetëror, partizimin e administratës shtetërore, të gjyqeve, të nepotizmit etj.

⁹⁸ Prof. D-r Kambovski V., D-r Naumoski P., vep. e cituar, fq. 35-36.

Edhe shoqëria jonë në shkallën e tashme të zhvillimit nuk është immune nga korrupsioni si dukuri devijuese sociopatologjike, të cilat kanë shprehje negative jo vetëm ndaj individëve, por edhe më gjerë në marrëdhëniet e caktuara shoqërore, duke shkaktuar situata negative shoqërore. Nga kjo edhe priten angazhime dhe rezultate që mund t'i arrijnë institucionet shtetërore: hetuesia, prokuroria, gjykatat, mediat dhe shoqatat joqeveritare, që të shërbejnë në kundërvënien të suksesshme kundër korrupsionit deri në çrrënjosjen ose sjelljen në suaza të normales.

Nga shumë hulumtues të kësaj dukurie me të drejtë paraqitet edhe dilema që sot aq shumë flitet për korrupsionin edhe në nivel shtetëror e lokal në raport me marrëdhëniet ndërshtetërore, si dhe bashkëpunimin regional dhe ndërkombëtar. Duke e pasur parasysh se kjo dukuri i rrënon vlerat institucionale, vlerat morale, kuptohet se është më se i nevojshëm interesimi që të debatohet, të pranohen rregulla, të propozohen koncepte dhe strategji konkrete për luftën kundër korrupsionit.⁹⁹

4.1. Bashkëpunimi regional i Kosovës në luftë kundër korrupsionit

Për t'i hapur dyert e shteteve për anëtarësim, BE-ja promovojë një mënyrë që përmes procesit të anëtarësimit vendet candidate t'i plotësojnë kushtet, standardet dhe vlerat universale evropiane, siç janë: *demokracia, raportet e mira ndëretnike, stabilizimi brendshëm, shteti i së drejtës, respektimi i të drejtave të njeriut, reformat në administratën publike, në strukturat e mbrojtjes dhe të policisë, të drejtat e pakicave kombëtare, ekonomia e tregut, bashkëpunimi regional dhe ndërfqinjësor etj.*

Po ashtu në kontekst të luftës kundër korrupsionit në OKB janë aprovuar një mori rezolutash të cilat kanë të bëjnë me punën e doganave, të tregtisë të palejueshme me njerëz etj. Pikërisht për këtë Komisioni Ekonomik i OKB-së për Europën në vitet e fundit i përkushtohet

⁹⁹ Cituar sipas ekspozesë së V. Kamboskit "Shteti juridik dhe krimi i organizuar", cituar sipas J. Spasevski - P Aslimovski "Siguri, mbrojtje, siguri" f. 90, Kosta Abarash, Ohër 2000

luftës kundër korrupsionit në shtetet në tranzicion, ngase vendet e rajonit paraqiten si hapësirë më e përshtatshme për paraqitjen e korrupsionit dhe të dukurive të tjera devijuese.

Shumë autorë që merren me këtë dukuri konstatojnë se korrupsioni nuk mjafton të vlerësohet vetëm nga këndi moral (ndërgjegjja) dhe përmes hartimit të programeve (që nuk implementohen) dhe formimit të komisioneve të ndryshme (sa për të ekzistuar formalisht), por përkundrazi ai duhet të luftohet nga këndi i shtetit të së drejtës. Gjithë kjo na detyron të kuptojmë se në bashkëpunimin regjional të shteteve të përfshira nga korrupsioni, përveç luftës së brendshme kundër korrupsionit, po aq është i rëndësishëm edhe bashkëpunimi regjional në koordinimin "e aktiviteteve institucionale në luftën kundër korrupsionit".

Nëse i analizojmë rrethanat politike, ekonomike dhe të sigurisë, si dhe politikat integruese të shteteve të Ballkanit, parashtrohet pyetja se a mund të jetë e suksesshme lufta kundër korrupsionit nëse e kemi parasysh se këto shtete akoma nuk mund të dalin nga gëzhoja e periudhës së tranzicionit ose e konsolidimit ligjor. Nëse bazohemi në Studimin në Bankës Botërore dhe të Bankës Europiane, me siguri mund ta konstatojmë nevojën e luftës të pakompromistë kundër korrupsionit përmes aktiviteteve të koncentruara në pesë lëmenj:

- Përgjegjësia politike që të jetë publike dhe transparente;
- Forcimi i institucioneve shtetërore: parlamentit për përgjegjësi publike; gjyqësisë dhe gjyqtarë të pavarur në zbatimin e njëmendtë të masave dhe zbatimit të dënimeve; qeverisë dhe shërbimeve publike duke mos u munguar asnjëherë kontrolli financiar dhe i pasurisë publike;
- Veprimi i shoqërisë civile në jetën publike dhe roli i mediave në punët publike të cilat duhet të përhapin informacione për korrupsionin, të propozojnë aksione dhe të organizojnë ballafaqime publike. Këtu veçmas potencohen mediat e pavarura me punën e tyre kërkimore me rol të posaçëm në luftën kundër korrupsionit;
- Ndërtimi i sektorit privat të suksesshëm me transparencë për pasurinë dhe punët e tyre afariste;
- Dhe, në fund, në këtë studim thuhet se lufta kundër korrupsionit paraqet domosdoshmëri për reforma në administratën publike, e cila duhet t'u nënshtrohet rregullave të

mbikëqyrjes përmes revizorëve të punës së tyre financiare; të krijohet një administratë publike të mbështetur në parimet e meritave, d.m.th. me zyrtarë të aftë që kanë aftësi larta profesionale dhe të jenë të paguar mirë.

Këto rekomandime ishin të bazuara në veprime konkrete, si:

- Zgjedhja e njerëzve të pakorruptuar;
- Forcimi i përgjegjësisë;
- Promovimi i aksionit të përbashkët me gjithë potencialin njerëzor dhe teknik në luftën kundër korrupsionit;
- Nxitja e transparencës në financimin e partive politike në fushatat zgjedhore;
- Sendërtimi i plotë i reformave ekonomike;
- Krijimi i potencialit të qëndrueshëm me shoqëritë civile si faktor shumë i rëndësishëm për dhënien e informacioneve për korrupsionin dhe luftën kësaj dukurie devijuese.¹⁰⁰

Përkufizimi i krimit të organizuar

Krimi i organizuar nuk njihet kufij.¹²⁶ Organizatat kriminalistike të këtij lloji përpiqen të përfshihen në sistemin ekzistues të pushtetit shtetëror. Deri tani në literaturën penalo-juridike dhe kriminalistike nuk ekziston ndonjë definicion i pranuar përgjithësisht. Bartësit e kriminalitetit të organizuar, veprimtarinë e tyre e bëjnë duke instaluar njerëz të tyre në organet më të larta të pushtetit, duke korruptuar funksionarë të ndryshëm që kështu të krijojnë hapësirë të përshtatshme për aktivitetet e tyre (kjo mund të ndodhë sidomos në shtetet e vogla). Kështu, ekzistojnë përpjekje të ndryshme që secili në vetvete të vendosë elemente të caktuara. Sipas Spasevskit, për

¹⁰⁰ Nazmi Maliqi, Shpallorje, faqe 86, IADC- Klubi Demokratik, Shkup, 2001

ta kuptuar drejtë këtë problem aktual mund të veçohen këto elemente: Së pari, përcaktimi përshkrues i krimit të organizuar mund të tregohet përmes theksimit të karakteristikave të tij që duken kështu:

- organizimi i një grupi për të bërë veprë penale;
- raportet hierarkike në grup duke ia bërë të mundshme drejtuesit të saj që ta kontrollojë atë;
- kërcënimet me forcë dhe me korrupsion si mjete për realizimin e profitit ose për t'i kontrolluar tregjet;
- larja e fitimeve të arritura në mënyrë ilegale dhe infiltrimi në ekonominë legale;
- aftësi për ekspansion në çfarëdo aktiviteti jashtë dhe në kuadër të kufijve Nacional.¹⁰¹

4.2.Parandalimi dhe ndalimi i krimit të organizuar

Kriminaliteti i organizuar¹³⁰ edhe më tej mbetet kureshtje dhe brengosje me të cilën ballafaqohen edhe shtetet më të organizuara se R. e Maqedonisë dhe shtetet e Ballkanit Perëndimor, duke e pasur parasysh se korrupsioni ka depërtuar në shumë segmente të shoqërisë dhe tanimë po kalon në nivel të kriminalitetit të organizuar, ashtu siç është i definuar edhe nga

¹⁰¹ Tradicionalisht, komuniteti ndërkombëtar e ka evituar përfshirjen në diskutimet për korrupsionin. Tani problemi është i hapur jashtë kufijve. Tabuja u thye. Korrupsioni hyri në vëmendjen politike mjaft dukshëm atëherë kur drejtues të Amerikës u takuan në Samitin e Amerikës në dhjetor 1994. Në planin e veprimeve që hartoi Samiti, qeveritarët premtuan se do të : - _nxisin diskutime të hapura për problemet më të rëndësishme që haste qeveria dhe zhvillonin prioritete për reformat e nevojshme për t'i bërë operacionet qeveritare transparente dhe të përgjegjshme; - _sigurojë mbikqyrjen e duhur për funksionet e qeverisë duke forcuar mekanizmat e brendshëm, duke përfshirë kapacitetet hetuese dhe detyruese për veprimet korruptuese dhe lehtësuar mundësinë e publikut të njihet me informacione të nevojshëm për një pamje të jashtme kuptimplotë; - _krijojë një standart konflikti interesash për punonjësit publikë, masa efektive kundër pasurimit të pandershëm, duke përfshirë dënime të ashpra ndaj atyre që përdorin pozitën zyrtare për interesa private. - _kërkojë nga qeveritë e vendeve të tjera të krijojnë dhe zbatojnë masa efektive kundër rryshfeteve në të gjitha transaksionet financiare brenda Hemisferës (Libër Informimi I Transparencës Ndërkombëtare 2000 PERBALLJA E KORRUPSIONIT: ELEMENTET E NJE SISTEMI KOMBETAR INTEGRITETI JEREMY POPE TRANSPARENCA NDERKOMBETARE <http://www.transparency.org>.)

ekspertët e këtij lëmi, sidomos të INTERPOL-it. Kriminaliteti i organizuar, si veprim i çdo grupi të organizuar, ka për qëllim të realizojë përfitim të madh financiar në mënyrë ilegale, pa i respektuar në shumë momente edhe kufijtë ndërshtetërorë dhe rregullimet ligjore brenda shteteve ku e ka zanafillën. Qëllimi kryesor i këtyre grupeve është korrupsioni i individëve që bartin poste në struktura të ndryshme shtetërore. Kjo e fundit ka marrë përmasa më të mëdha, duke e shfrytëzuar përfitimin e madh, si dhe ndikimin për të dominuar, që kështu ta sigurojnë hierarkinë e vetë nga zbulimi i tyre dhe ndjekja. Grupet e organizuara të kriminalitetit mund të disponojnë me mjete të konsiderueshme, që mund të ndikojnë në qeveritë e shteteve të vogla në tranzicion. Ky lloj i kriminalitetit mund të radhitet edhe në dukuritë socio- patologjike, sepse e rrezikon integritetin moral të njerëzve të cilët janë mësuar të jetojnë në mënyrë të ndershme konform normave që ia lejon ligji.¹⁰²

Me qëllim që të forcohet ana parandaluese e krimit të organizuar dhe e korrupsionit si plotësim i rëndësishëm i politikës represive në këtë lëmë, duhet bëhet:

- përpunimi i programit për iniciativa juridike, administrative dhe kulturore për luftën kundër korrupsionit;
- formimi i trupit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar për eliminimin e korrupsionit
- ashpërsimi i politikës ndëshkuese për forma të caktuara të sjelljes korruptive;
- përforcimi kadrovik, material dhe teknik i shërbimeve për luftën kundër krimit të organizuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme (gjykata dhe në të gjitha segmentet e administratës shtetërore) si mundësi për krijimin e specializimit dhe përsosjes së tyre në vend dhe në botën e jashtme;
- vendosja e procedurës për konfiskimin e mallit të fituar përmes krimit të organizuar, korrupsionit dhe larjes së parave;¹⁰³

Përfundim

¹⁰² Nazmi Maliqi, Shpallje, faqe 86, IADC- Klubi Demokratik, Shkup, 2001

¹⁰³ Zami Poda, Krimi i organizuar, Libri universitar, Tiranë, 1998

Korrupsioni është njëra nga sfidat më të mëdha të kohës sonë - një sfidë që duhet dhe mund të përballohet. Korrupsioni është një dukuri shqetësuese për mbarë shoqërinë, andaj shoqëria duhet t'i kundërvihet duke u përpjekur në mënyra të ndryshme që ta parandalojë.

Reformat në organet e administratës shtetërore, në gjyqësi dhe gjetiu, do të ndihmojnë në zvogëlimin e korrupsionit, duke e rritur standardin jetësor për të varfrit dhe respektin për të drejtat humane të të gjithëve. Do të duhej të sigurohej kuadër i nevojshëm ligjor dhe institucional për krijimin dhe funksionimin e sistemit gjyqësor, si dhe trajnim i tyre vetëm për rastet e krimit të organizuar dhe të korrupsionit.

Reformat në administratën publike, përmirësimi i legjislacionit, si dhe kontrolli dhe menaxhimi i financave publike, janë shumë të rëndësishme për suksesin në luftën kundër korrupsionit.

Gjithashtu krijimi i një fronti të përbashkët të organeve shtetërore me opinionin publik, mediat elektronike dhe shtypin padyshim paraqesin kusht kryesor dhe të pazëvendësueshëm në parandalimin e korrupsionit. Pa pjesëmarrjen e këtyre institucioneve, lufta kundër korrupsionit do të ishte shumë e vështirë dhe nuk do të kishte sukses.

Korrupsioni si problem kompleks kërkon ndërmarrje të masave jo vetëm në rrafshin e zbulimit dhe goditjes së veprave penale që e përbëjnë atë, por edhe masa të karakterit parandalues propagandistik apo izolues ku të përfshihen të gjithë sektorët që ai i rrezikon duke krijuar një sistem legjislativo-administrativ kontribuues, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të konceptohet dhe të vihet në jetë plani antikorrupes.

Literatura e konsultuar

- Dr. Vlado Kambovski, Dr.Petar Naumov, Korupcijata najgolemo
- Dr. Vesel Latifi, Kriminalistika, Prishtinë, 2004.
- Luan Gjonca, Korrupsioni, veprat penale përbërëse, krimi i organizuar, Tiranë, 2004.
- Dr. JOVIÇ D., “Korupcija u Jugoistočnoj Europi”, ligjërues i politikës në Universitetin e Sterlingut në Skoci, www.pc.nen. Cg.yu/novi/analize/-2003/04/html

- Dr. sc. KREGAR J., “Korupcija”, Pravni Fakultet u Zagrebu, www.ijf.hr/pojmovnik/korupcija.html
- Lascoumes P., Korrupsioni, (përktheu nga frëngjishtja: Fotaq Andrea); (Botuar në kuadrin e programeve të Këshillit të Europës për luftën kundër korrupsionit), Tiranë, 2002;
- KOXHAI A., Administrimi i sektorit publik, Tiranë, 2002
- Prof. Dr. Luan Gjonça, Korrupsioni, Tiranë, 2004
- Dr. L. Gjonça, Korrupsioni, veprat penale përbërëse - krimi i organizuar, Tiranë, 2004
- Dr. R. Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2002, faqe 193
- Arben RAKIPI, KORRUPSIONI DHE EVAZIONI FISKAL, Tiranë, 2003
- Dr. M. Laboviq, Makedonska revija za kazneno pravo i kriminologjia, Skopje
- J. Spasevski - P Aslimovski “Siguri, mbrojtje, siguri” f. 90, Kosta Abarash, Ohër, 2000
- Nazmi Maliqi, Shpalosje, faqe 86, IADC- Klubi Demokratik, Shkup, 2001
- Libër Informimi I Transparencës Ndërkombëtare 2000 Perballja e korrupsionit: elementet e një sistemi kombëtar integriteti jeremy pope transparenca nderkombetare (<http://www.transparency.org>.)
- Zami Poda, Krimi i organizuar, Libri universitar, Tiranë, 1998

PËRFSHIRJA E SHQIPËRISË NË INTERESAT GJEOSTRATEGJIKE TË SHTETEVE TË BASHKUARA DHE ALEATEVE TË SAJ, LIDHUR ME SIGURINË E ENERGISË NË SHTRIRJEN GJEOGRAFIKE MIDIS DETIT KASPIK DHE EUROPËS JUGLINDORE

Analizë hulumtuese e fokusuar në territorin shqiptar dhe hapësirën e Ballkanit Jugor

Orion Garo, MA

Webster University Graduate Alumn,

oriongaro97@webster.edu

Abstrakt

Artikulli në vijim ofron një sintezë të natyrës hulumtuese lidhur me manovrat gjeopolitike aktuale të dy superfuqive, SHBA-së dhe Rosisë, në funksion të shfrytëzimit të Korridorit të Jugut për transportimin e gazit të rajonit të Kaspikut dhe Rosisë Juglindore në Europë. Në këtë analizë merret në konsideratë dhe përfshirja territoriale e Shqipërisë, e interesave ekonomike të saj dhe politikës së saj të jashtme për të lehtësuar realizimin e projektit fitues, TAP, i cili konsiderohet dhe si projekti inagurues i Korridorit të Jugut. Pritet që të tjera projekte të ndjekin shembullin e TAP në shfrytëzimin sa më efektiv të Korridorit të jugut si rajon tranziti për gazin e Azisë Lindore drejt një komuniteti European, kërkesa për gaz e të cilit vjen gjithnjë e në rritje. Projekti i cili mendohet se do të mbulojë në mënyrë bindëse pjesën më të madhe të kërkesës Europiane për gaz, është pikërisht projekti South Stream, iniciativë e gazsjellësit gjigand të qeverisë ruse, Gazprom. Me anë të këtij projekti Rusia planifikon që, duke përballuar pothuajse e vetme kërkesën e Kontinentit të Vjetër për gaz, të ankorojë një herë e mirë dhe bindshëm sferën e saj të influencës ekonomike – dhe jo vetëm – në këtë rajon.

Fjalë Kyce: Energji, Gaz, Korridori i jugut, Gjeopolitikë, TAP, South Stream

Hyrje: Mbetjet hidrokarbure dhe rëndësia e tyre

Shpesh dëgjojmë në lajme, në mendian vizive. të shkruar, dhe online, se lufrat dhe konfliktet post-moderne midis shteteve sovrane ndodhin – dhe do të vazhdojnë të ndodhin – për të ruajtur dhe/apo siguruar akses tek resurset. Është e kuptueshme gjithashtu pse resurset janë kaq thelbësore për prosperitetin ekonomik të një vendi. Ato shtrojnë shinat për një udhëtim më të sigurt, përtej ekzistencës dhe mbijetesës së një shteti, drejt një të ardhmeje që sa vjen e bëhet gjithnjë e më e turbullt. Fatkeqësisht për ne njerëzit, civilizimi ynë po merr një kthesë të vullshme drejt një epoke pasigurie, dhe rrethanat na gjejnë tërësisht të papërgatitur për t'u përballur me të. Kjo epokë pasigurie mund t'i atribuohet shumë mirë mungesës së resurseve.

Ekzistenca jonë si specie ka evoluar në atë pikë sa ne ta kemi pothuaj të pakonceptueshme të jetojmë jetët e 200, 2000, apo 5000 vjetëve më parë. Ajo është e lidhur pandashmërisht me mënyrën e jetesës së civilizimit tonë modern, me ndërvarësinë e plotë rajonale në tregti dhe superporodhimin në produkte ushqimore, me proceset e mekanizuara të prodhimit, me mjetet moderne dhe tejet të avancuara të transportit, me teknologjinë e informacionit, median, Internetin, etj. Në mënyrë që ne të mbajmë të pandryshuar ekzistencën tonë moderne na nevojiten resurset e planetit tonë. Në këtë stad të civilizimit tonë ne kemi nevojë të vazhdueshme dhe me trend rritës për energji, e cila është një prej resurseve tona më jetike. Ne e përdorim energjinë kryesisht për transport, për proceset e prodhimit, për nevoja industriale dhe teknologjike, për ngrohje dhe për ndricim. Sic e dimë, pjesa dërrmuese e energjisë që specja njerëzore përdor sigurohet nëpërmjet djegies së njëres prej rezervave më të cmuara që na ka siguruar planeti ynë: mbetjeve fosile. Sipas analizave projektuese të *International Energy Outlook*, në 2010-ën raporti (në përqindje) e energjisë botërore të shpenzuar e siguruar nëpërmjet djegies së mbetjeve fosile (naftës, qymyrit dhe gazit natyror së bashku) kapi shifrën 84%.¹⁰⁴

Po çfarë janë në të vërtetë mbetjet fosile? Mbetjet fosile (apo emërtuar ndryshe, mbetjet hidrokarbure) sipas *Agjencisë së Mbrojtjes Mjedisore të SHBA-ve*, janë “depozitime gjeologjike të djegshme të formuara nga mbetjet e dekombozuar të bimëve, drurëve dhe kafshëve që janë shndërruar në naftë bruto, qymyr dhe gaz natyror nëpërmjet ekspozimit ndaj të nxehitit dhe dendësisë nëntokësore në koren e Tokës përgjatë qindra milionë viteve.”¹⁰⁵ Mbetjet hidrokarbure nuk konsiderohen resurse të rinovueshme pasi ato kërkojnë miliona vite për t'u formuar, dhe rezervat aktuale po shpenzohen shumë më shpejt krahasuar me kohën e nevojshme për procesin e krijimit të rezervave të reja. Një fakt pësjtjellues është se “totali i mbetjeve fosile të konsumuara globalisht vetëm në vitin 1997 është rezultat i një procesi sintetizues 422-vjecar, gjatë të cilit u rrit dhe jetoi e gjithë lënda bimore dhe shtazore në të gjithë sipërfaqen tokësore dhe të gjitha oqeanet e Tokës së kohëve të lashta.”¹⁰⁶

Një këndvështrim teorik i rrallësisë së mbetjeve hidrokarbure në lidhje me ekonominë dhe sigurinë e shteteve

Faktet e mësipërme tregojnë sa i rëndësishëm është për kombet ky resurs i kufizuar, vecanërisht për një vend si Shtetet e Bashkuara, i cili prej rreth një shekulli e gjysëm ushtron një udhëheqje hegjemonike mbi globin. Megjithatë ne jetojmë në një kohë kur ‘Pax Americana’

¹⁰⁴ (Klare, 2013)

^{105 & 3} (Fossil Fuel Facts, 2009)

është vënë nën hijet e dyshimit; kohë kur pozicioni udheheqës i Shteteve të Bashkuara përballet me pasiguri të konsiderueshme.

Zakonisht kur njerëzit ndeshen me të panjohurën kanë tendencën të bëhen të pasigurt dhe nervozë. Një tendencë e tillë nuk është aspak e ndryshme edhe për shtetet sovraane. Natyrisht, sa më i rëndësishëm roli i një shteti në arenën globale, aq më shumë do të rëndojë mbi shpatulla barra e pasigurisë kombëtare. Në mënyrë që ta lehtësojnë sa më shumë këtë barrë, fuqitë e mëdha rajonale dhe hegjemonet globalë tregohen tepër të matur dhe alertë në lidhje me ruajtjen e resurseve, dhe marrin masa të gjera proteksioniste në fushat e ekonomisë, sigurisë, dhe pushtetit politik.¹⁰⁷ Në rastin e fuqive të mëdha botërore si Shtetet e Bashkuara (apo dhe Kina dhe Rusia në rajonet e tyre respektive) mbijetesa e një shteti – apo sundimi hegjemonik i vendosur nga shteti – garantohet nëpërmjet sigurisë, kapaciteteve ushtarake, dhe projektimit të pushtetit.¹⁰⁸ Siguria garantohet nëpërmjet prosperitetit ekonomik. Prosperiteti ekonomik garantohet nëpërmjet akumulimit të pasurisë, dhe akumulimi i pasurisë bëhet i mundur nëpërmjet: [1] tregtisë së suksesshme me vende partnere në rajone të ndryshme të botës, dhe [2] resurseve natyrore. Tregtia mund të garantohet nëpërmjet ruajtjes së marrëdhënieve të mira ekonomike me shtetet partnere, dhe nëpërmjet të sigurimit të rrugëve detare e konsolidimit të flotave tregtare kombëtare; resurset natyrore (që kryesisht konsistojnë në mbetjet hidrokarbure) garantohen nëpërmjet të sigurimit dhe mbrojtjes së impianteve dhe tubacioneve që transportojnë naftën dhe gazin nga një kontinent, rajon apo shtet, tek një tjetër.¹⁰⁹

Michael Klare (autori i botimit “Gjak dhe Naftë”) ofron një shpjegim bindës mbi dimensionin ndër-shtetëror të konkurrencës për të kontrolluar burimet e energjisë së një rajoni. Në argumentimin e tij theksohet se “politika e sotme e pushtetit rrotullohet rreth konkurrencës për sigurimin e pasurive natyrore.” Sipas Klare, “mbijetesa e një shteti dhe e shoqërisë së tij varen nga dinamizmi ekonomik, kultivimi i inovacionit teknologjik, dhe të paturit akses tek lëndët e para që nevojiten për këto të dyja.”¹¹⁰ Ndarja më e madhe e këtyre lëndëve të para për të cilat Klare shprehet, është natyrisht energjia e siguruar nga djegia e mbetjeve hidrokarbure: nafta, qymyri, dhe gazi natyror. Të marra së bashku këto mund të konsiderohen një komoditet jetik për prosperitetin e ekonomisë së një vendi. Sa më i pasur dhe i industrializuar është një vend, aq më thelbësor bëhet ky komoditet për performancën e tij ekonomike.

Pozicionet ekonomike aktuale të aktorëve më të rëndësishëm globalë, pas Luftës së Ftohtë

Nëse bëjmë një fotografim të zhvillimeve ekonomike rreth-e-qark globit sot, faktet e mëposhtme rezultojnë domethënëse. Në rajonin Amerikano-verior, Shtetet e Bashkuara kanë një ekonomi të varur tërësisht nga nafta. Në të njëjtën situatë ndodhet dhe Kanadaja, por kjo e fundit e ka pothuaj të pakonsiderueshme influencën gjeopolitike në arenën globale. Nafta është thelbësore për industrinë amerikane të transportit, dhe gjithashtu përmbush 40% të kërkesës totale për energji në SHBA. Ajo prek çdo aspekt të ekonomisë amerikane, ndaj nëse ndodh të ketë kufizim të sasisë së ofruar të naftës në vend (sic ka ndodhur periodikisht në vitet 1973, 1979, 1999 dhe 2004) gjithmonë është pasuar nga një recesion ekonomik si rezultat i rritjes së cmimit të naftës.¹¹¹ Në kushtet aktuale, ekonomia amerikane importon më shumë naftë krahasuar

¹⁰⁷ (Wendt, 1992)

¹⁰⁸ (Mearsheimer, 2004)


¹⁰⁹ (Klare M., 2005)

¹¹⁰ (Amineh & Houweling, 2007)

¹¹¹ (Klare M., 2005)

me prodhimin e saj të brendshëm. Pas viteve '70 kërkesa për naftë në SHBA mori një trend pothuaj eksponencial, ndërkohë që rezervat e provuara të naftës brenda territorit të SHBA-ve nuk rezultojnë mjaft të bollshme. Duke qenë në dijeni të këtij fakti, shteti amerikan i përdor në mënyrë të arsyeshme rezervat e tij territoriale. Ndaj e vetmja zgjidhje për të përballuar kërkesën konsumatore, ndërkohë që prodhimi i brendshëm duhet të mbahej në nivele të moderuara, ishte rritja e importeve. Grafiku i mëposhtëm paraqet nivelet e importeve të krahasuara me ato të prodhimit të brendshëm për naftën, në SHBA, nga vitet 1920 deri në 2010. Duket se gjatë fund-viteve '60 SHBA arriti pikun e prodhimit vendas të naftës me rreth 9 milion fuci në ditë, dhe që nga ajo periudhë kohore importet filluan rritjen ndërkohë që prodhimi vendas filloi rënien. Gjatë 7-8 viteve të

Prodhimi vendas kundrejt importeve të naftës në SHBA



Burimi:
TheEnergyCollective.com

fundit kërkesa për naftë në SHBA njohu rritje, e cila kulmoi në 2009-ën me 20.7 milion fuci në ditë. Por gjatë periudhës së viteve 2010-2013 kërkesa ka rënë në 18.2 milion fuci në ditë.¹¹² Gjithashtu në 2005-n vihet re një ndryshim i menjëhershëm i strategjisë së shtetit amerikan në lidhje me importet, të cilat në 8-9 vitet e fundit kanë pësuar një rënie të vullshme, dhe nivelet e larta të kërkesës vendase për naftë janë përballuar nga një rritje po aq e vullshme e prodhimit vendas.

Në Azinë veriore dhe verilindore, ekonomia e një vendi gjigand dalëngadalë po rekuperon nga shpërbërja rrënuese e Bashkimit Sovietik. Pas 20 viteve agoni, Rusia është akoma aty, tek ndjek rrugën e saj të ngjijtes ngadalë, por më imponueshëm se kurrë ndonjëherë. Rritja dramatike e cmimeve të naftës dhe gazit në fillim të viteve 2000 i ka dhënë Rusisë forcën e rigjetur ekonomike. Shtetet Baltike e kanë testuar temperamentin e saj; Ukraina, Bjellorusia dhe Gjeorgjia e dinë fort mirë sa i ashpër është dimri i veriut kur gazi rus mungon në tubacione. Më shumë se 40% e kërkesës së BE-së për gaz mbulohet nga Rusia. Finlanda, Bullgaria, Republika Ceke, Greqia, dhe treshja Baltike (Estonia, Letonia, Lituania) mbeshteten edhe më fort tek Rusia duke qenë se 78% e nevojës së tyre për gaz përmbushet nëpërmjet tubacioneve të Gazprom-it. Nafta ruse është po aq e rëndësishme për Europën, duke plotësuar pothuaj 30% të kërkesës së saj.

Ndërkohë, në rajonin e Lindjes së Largët, Kina është shfaqur si një fuqi ekonomike kolosale gjatë 35-40 viteve të fundit. Që nga 1975-a, bumi ekonomik kinez ka nxjerrë nga varfëria 250 milionë vetë. Të tilla përpjesëtime të reduktimit të varfërisë brenda një kohe kaq të shkurtër nuk kanë ndodhur kurrë më parë në historinë e dokumentuar të njerëzimit. Gjatë dekadës së fundit, etja e popullit më të madh në botë për naftë është rritur frikshëm. “Në 2007-ën Kina nxorri nga pusët e saj 3.9 milion fuci në ditë, dhe importoi 3.7 milionë të tjera për të plotësuar kërkesën vendase. Modelet projektuese tregojnë se deri në 2020-ën, shtetit kinez, për të përmbushur nevojat e ekonomisë së tij, do t’i duhet të prodhojë 3.3 milionë fuci në ditë dhe të importojë 9.1 milionë të tjera.”¹¹³ Ekspansioni i vullshëm kinez i ka rrënjët e tij në pozicionimin e stabilizuar ekonomik të vendit, si dhe në nevojën dhe qëllimin e qeverisë kineze për t’i siguruar një mirëqenie të qëndrueshme popullit të saj të shumënumërt për vitet dhe dekadat që vijnë. Për shkak të fuqisë së saj të pasoqe financiare, shumë rajone anë-e-mbanë globit po bëhen gjithnjë e më të varura nga pasuria ekonomike, tregtia, dhe potencia investuese e Kinës. Brazili ka përfituar miliarda dollarë në marrëveshje kredish në këmbim të aksesit të kompanive kineze në rezervat e tij të naftës. Përpunimin e rezervave minerare të bakrit në Afganistanin e rrënuar nga lufta e kanë marrë përsipër bizneset kineze. Republikat e Azisë Qendrore dhe të 56 milionët që jetojnë aty varen tërësisht nga tregtia dhe marrëveshjet e kredive me Kinën. I gjithë spektri i gjerë i të mirave industriale të shitura në këto vende importohet nga Kina. Në këmbim, mijëra kilometra tubacione pompojnë naftën e gjithë Azisë Qendrore drejt ekonomisë gllabëruese të Kinës. Gjatë dekadës së fundit, Kina nënshkruar një numër të pallogaritshëm marrëveshjesh edhe me vendet e varfra të Afrikës. Qeverive tejet të varfra e të korruptuara afrikane u pëlqen të bien në ujdë me Kinën, pasi Kina është aty thjesht dhe vetëm për biznes, dhe aspak për të ‘promovuar vlerat e demoracisë dhe të të drejtave njerëzore’ mbi bosët dhe padronët vendas, sic shpesh tenton të bëjë SHBA dhe vendet e tjera të Perëndimit.

¹¹² (CIA, 2013)

¹¹³ (Klare M. , Shopaholic China, 2010)

Korridori i Jugut, Ballkani dhe Shqipëria në perspektivën gjeostrategjike amerikane dhe perëndimore

Një nga arsyt kryesore (për të mos thënë më thelbësorja) të lëvizjeve, planeve dhe manovrave gjeostrategjike të këtyre tre poleve qendrore të politikës globale për pushtet, është pa dyshim rrallësia e burimeve natyrore. Bota do të kish qenë një vend shumë më pak armiqësor dhe shumë më i këndshëm nëse do të kishte sasi të pakufizuara resursesh. Për fat të keq asnjëherë nuk ka qenë kështu gjatë historisë njerëzore, dhe me siguri nuk do të jetë dhe në të ardhmen. Luftra mbi të mirat materiale dhe pasuritë natyrore (tokën pjellore, luginat përgjatë lumenjve, burimet e bollshme të ujit, arin dhe argjendin, erëzat dhe prodhimet bimore ekzotike, lëndët cilësore të drurit, gezofet e rralla të kafshëve, etj.) janë luftuar gjithmonë që nga kohët prehistorike. Edhe sot, gjërat nuk janë mjaft ndryshe. Sot, energjia është ai resurs esencial që i mobilizon vendet të përpiqen të garantojnë mbijetesën e tyre, dhe nëse e ardhmja jonë na ka rezervuar të tjera luftra, ato me siguri do të luftohen për shkak të rrallësisë së mbetjeve hidrokarbure.

Ashtu sic Kinës i intereson që rajoni e Azisë qendrore të përjetojë kohë paqeje relative, dhe sic Ruisë i intereson të vazhdojë të mbajë të gjitha vendet e ish-Bashkimit Sovietik nën sferën e saj të influencës ekonomike dhe politike, po ashtu dhe SHBA-të dhe aleatët e saj perëndimorë kanë interesa gjeostrategjike në rajone specifike të globit. Një nga këto rajone me rëndësi të vecantë për SHBA-të është dhe i ashtuquajtur i Korridorit i Jugut.

1. Korridori i Jugut

Korridori i Jugut, sic e ka përkufizuar në 2009-ën edhe Mirek Topolánek, përfaqësuesi i presidencës Ceke në BE, është një seri impiantesh dhe tubacionesh të ndërtuara për transportimin e gazit të Kaspikut dhe rajoneve të lindjes së Mesme në Europë.¹¹⁴ Pra është zona nga rajoni i Kaspikut deri në kufijtë juglindorë të Europës ku përfshihen shtete si Azerbajxhani, Armenia, Gjerorgjia dhe Turqia në Azi, si dhe Bullgaria, Greqia, Maqedonia, Shqipëria në Ballkan – por edhe disa vende të Lindjes së Mesme si Irani, Iraku, Siria dhe Egjipti të cilat në një të ardhme mund të kthehen në vende kontrubuese për plotësimin e kërkesës europiane për gaz. Ky rajon ka rëndësi të vecantë për SHBA-të pasi krijon mundësi konkrete për diversifikimin e rezervës së gazit që aleatët e SHBA-ve (kryesisht vendet e Bashkimit Europian) përfitojnë aktualisht nga një furnizues i vetëm, që është Rusia. Ruisë i intereson të jetë i vetmi furnizues i vendeve të BE-së me këtë komoditet të vyer, pasi këtë aktivitet e sheh si mënyrën më efikase të promovimit të influencës së saj gjeo-politike në hapësirën mbarë-europiane. SHBA natyrisht nuk do të ishte aspak e ngazëllyer me një skenar të tillë; për shumë vendime politike e solidaritet gjeostrategjik mbarë-global, të detyruara nga influenza ruse, aleatët historikë europiano-perëndimorë mund t'i kthenin shpinën SHBA-ve. Ndaj dhe Korridori i Jugut, një iniciativë e Komisionit Europian u ideua si një nga mënyrat për shkëputjen e vendeve të BE-së nga influenza ruse e energjisë.

2. Nabucco


Fillimisht projekti kryesor i korridorit të Jugut konsiderohej Nabucco. Me një kapacitet transportues të llogaritur në 31 miliardë m³ gaz në vit, nga Azerbajxhani në nyjen shpërndarëse të Baumgarten, Austri, ky projekt do të kish mundësuar më së miri diversifikimin e rezervave të

¹¹⁴ (Czech Presidency of the European Union, 2009)

gazit në tregje që aktualisht mbulohen nga Rusia. Vendet që kanë nevojë për diversifikim brenda BE-së janë Rumania, Bullgaria (pothuaj 100% e kërkesës së tyre për gaz mbulohet nga Rusia) dhe Hungaria (80% e gazit importohet nga Rusia). Megjithatë projekti Nabucco dështoi, dhe arsytet e dështimit të tij janë shumë më tepër sesa sipërfaqësore. Projekti që mori stafetën për vënien në funksion të Korridorit të Jugut ishte Trans Adriatic Pipeline (TAP), një projekt modest krahasuar me Nabucco-n.

3. TAP

Mund të thuhet se Trans Adriatic Pipeline (TAP) tashmë është një realitet i prekshëm... Projekti është një iniciativë e ndërmarrë për vazhdimësinë e mëtejshme të dy projekteve tashmë të realizuara për transportimin të gazit të Kaspikut në drejtim të perëndimit, që janë South Caucasus Pipeline (SCPX), dhe Trans Anatolian Natural Gas Pipeline Project (TANAP). Të dyja këto projekte mundësojnë dërgimin e gazit nga vatra gazmbajtëse natyrore “Shah Deniz” – e lokalizuar brenda ujrave territoriale të Azerbajxhanit në Detin Kaspik, 70km larg kryeqytit Baku – në Gjeorgji dhe Turqi, duke përmbushur kërkesat e këtyre vendeve me gaz. Projekti TAP fillon në kufirin e Greqisë Verilindore me Turqinë, vijon me shtrimin e tubacionit në gjithë hapësirën e Greqisë Veriore, nëpër zonën jugore të Shqipërisë, nën shtratin detar të Adriatikut, me destinacion Lecce-n, Itali. Prurja e tij fillestare është llogaritur të jetë 10 miliardë m³ në vit, por projektimi është bërë për një rritje graduale të kësaj prurjeje për të përballuar një kërkesë në rritje në të ardhmen.



Gjatësia a tubacionit brenda territorit grek rreth 545 km; seksioni më i gjatë i projektit. Seksioni grek do të përfshijë një stacion kompresimi pranë Kipoi-t, do të vijojë përmes veriut të Greqisë, dhe do të përfundojë në kufirin me Shqipërinë Jugore, në jug-perëndim të Ieropigi-t. Në rast se kapaciteti i TAP-it do të rritet në 20 miliardë m³ në vit, një tjetër stacion kompresimi prane Serres është parashikuar të ndërtohet.

Rrugëtimi i tubacionit të TAP-it nëpër territorin Shqiptar është gjithësej 271 km, nga të cilat 260 km janë në tokë, dhe 60 km janë nën shtratin detar, brenda ujrave territoriale shqiptare të Adriatikut. Shtrirja e tubacionit fillon në kufirin shqiptaro-grek pranë Bilishtit dhe vazhdon duke e prerë tërthorazi jugun e Shqipërisë, mbërrin në bregun e Adriatikut 17 km në veri-

perëndim të Fierit. Planifikohet që një stacion kompresimi të ndërtohet pranë Fierit, dhe një tjetër stacion pranë Bilishtit nëse në një të ardhme kapaciteti do të rritet në 20 miliardë m³ në vit. Përgjatë kësaj linje do të ndërtohen 9 stacione valvolash bllokimi. Në zonat malore të shtegut të projektuar të tubacionit, është parashikur që të shtrohen 58 km rrugë të reja, përmirësohen 44 km rrugë ekzistuese, të rinovohen 50 ura ekzistuese dhe të ndërtohen dy ura të reja. Planifikohet që puna të fillojë në 2015-ën. Duhet theksuar se përgjatë gjithë linjës së tij të projektuar, tubacioni do të groposet rreth 1 m nën nivelin e tokës.¹¹⁵

4. Pse u përzgjedh projekti TAP?

Arsyet pse projekti TAP mori dritën jeshile, duke ë lënë vetëm në fazën e dokumentacionit një projekt superior si Nabucco, janë komplekse dhe nuk mund të zërthehen lehtë. Është e rëndësishme që analiza të fillohet duke evidentuar që në fillim preferencën amerikane në lidhje me projektin-flamur të Korridorit të Jugut. Në lidhje të drejtpërdrejtë me këtë subjekt, në raportin e dhjetorit të 2012-ës, të përgatitur për përdorim të komitetit mbi marrëdhëniet me jashtë në Senatën amerikan, të titulluar “Energjia dhe Siguria nga Kaspiku në Europë”, cilësohet:

“...Nga terminali i TANAP-it në kufirin me BE duhet që akoma të merret një vendim në lidhje me shtegun vijues të Korridorit të Jugut... ...Dy opsione mbeten... ...pasi konsortium-i “Shah Deniz” eliminoi dy propozime për ndërtim tubacionesh, Interkonjektorin Turqi-Greqi-Itali (ITGI) dhe Southeastern Europe Pipeline (SEEP) në shkurt 2012 dhe qershor 2012, respektivisht... ...[Këto dy opsione janë] Trans-Adriatic Pipeline (TAP) nga Turqia, nëpërmjet Greqisë dhe Shqipërisë, në detin Adriatik, me destinacion Italinë; dhe Nabucco West Pipeline, një propozim më i reduktuar që ndjek shtegun fillestar të Nabucco-s nëpër BE, i cili kalon përmes Bullgarisë, Rumanisë, Hungarisë, duke e çuar gazin në nyjen shpërndarëse të Austrisë. Nabucco West është projekti që qartësisht do të conte përpara interesat amerikane të politikës së jashtme, duke siguruar në mënyrë direkte energji për ato vende në Europën Qendrore dhe Juglindore që kanë nevojë më shumë për diversifikim shkëputës nga furnizimi rus... ...Në të kundërt, dobia strategjike që BE-ja dhe Shtetet e Bashkuara do të merrnin duke favorizuar gazsjellësin TAP do të ishte tepër e ngushtë, pasi ky i fundit thjesht do të mundësonte një rezervë gazi më shumë në Itali. Ashtu sic aktualisht projektet janë të paraqitura për miratim, Nabucco West është qartësisht superior karshi TAP për interesat amerikane të politikës së jashtme në rajon.”¹¹⁶

Raporti vijon me cilësimet mbi përfitimet ekonomike-tregtare që do të sillte respektivisht Nabucco dhe TAP, duke pranuar edhe një sërë përparësish që TAP garanton kundrejt Nabucco-s. Gjithnjë sipas raportit, përparësitë specifike të TAP do të ishin:

1. TAP ka avantazhin e një stukture më të thjeshtë menaxhimi të përbërë prej tre kompanish energjitike, zviceriana EGL, gjermania E.ON, dhe norvegjezja Statoil (një partnere e Shah Deniz).

¹¹⁵ (Trans Adriatic Pipeline AG, 2013)

¹¹⁶ & ¹⁴ (For the use of the Committee on Foreign Relations, 2012)

2. TAP mund të ndihmojë në diversifikimin e burimeve energjitike të Shqipërisë, dhe të mundësojë lidhje më të ngushta të saj me vende të tjera të Ballkanit...
3. TAP gjithashtu mund të inkurajojë konkurrencën në tregun Italian të energjisë, duke nxitur reforma rregullatore tepër të nevojshme...¹¹⁷

Pjesa në raport shpreh qartë preferencën e politikës së jashtme amerikane për projektin Nabucco. Në vijimësinë e tij raporti liston dhe një numër arsyesh pse Nabucco, sipas ekspertëve të qeverisë amerikane, do të garantonte më shumë avantazhe në karahasim me TAP:

1. Ne ndryshim nga TAP, Nabucco West do të ofronte diversifikim të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm për ato vende të Europës Qendrore dhe Juglindore që kërkojnë shkëputje nga influenza ruse e energjisë, në vecanti Bullgaria (89% e varur nga Gazprom), Hungaria (57%), Rumania (23%) dhe Austria (67%). [Nga terminalet e Nabucco-s,] interkonjektorë me distancë të shkurtër dhe të mesme mund të arrijnë anëtarët e NATO-s dhe BE-së, si dhe aspirantët në Europën Qendrore që kanë edhe më tepër nevojë për diversifikim, në vecanti Slovakinë dhe Republikën Çeke.
2. Nabucco West bën të mundur plotësimin e dy objektivave kyce: dërgesë të menjëherëshme të gazit tek një numër shtetesh aleate në nevojë dëshpëruese për diversifikim, dhe përshkallëzim të masës së prurjeve për të siguruar sasi më të mëdha gazi në rajon në të ardhmen. Pa dyshim, të tjera vende aleate do të përfitonin nga projekti TAP, por presionet shtrënguese lidhur me energjinë të aplikuara nga Rusia kundër aleatëve tanë në Europën Juglindore dhe Qendrore janë të një rendi më të lartë rëndësie.
3. C'është më thelbësorja, Nabucco West do të promovonte konkurrencën ndërkombëtare në rajon, gjë e cila do të përmirësonte pozicionimin negociues me Rusinë, do të zvogëlonte mundësinë e kërcënimeve nëpërmjet prerjes së rezervave, dhe do të mbështeste stabilitetin e brendshëm të aleatëve dhe miqve të NATO-s.


Në bazë të këtij pozicionimi të hapur dhe zyrëtar të SHBA-ve në lidhje me projektet konkurruese të Korridorit të Jugut, është e lehtë të kuptohet se cili projekt gëzonte suportin më të madh politik në Washington dhe Bruksel, në fund të 2012-ës. Që atëherë kanë kaluar mëse dy vite, dhe shumë ngjarje kanë rrjedhur ndryshe nga c'parashikohej. Më 26 Qershor të 2013-ës, kompania austriake OMV, anetare aspiruese e konsortiumit për projektin Nabucco, deklaroi se operatori i zonës gazmbajtëse "Shah Deniz" në Azerbajxhan nuk kish përzgjedhur Nabucco West si rrugën për transportin e gazit të Kaspikut në Europë. Prandaj gazi do të mbërrinte në "Kontinentin e Vjetër" nëpërmjet të një tjetër tubacioni – TAP-it. TAP-AG, kompania që do të mundësojë ndërtimin e tubacionit, ka filluar prej rreth një viti të hapë zyrat e saj dhe të nisë procedurat për punësime në Greqi, Shqipëri dhe Itali. Një frymë e re bashkëpunimi zyrëtar vihet re midis përfaqësive të qeverive të këtyre tre shteteve, bashkëpunim ky i domosdoshëm për suksesin e projektit.

Shtrohen pyetjet: Për c'arsye duhet që njeri projekt të konkurrojë me tjetrin? A mund të bashkë-ekzistojnë dhe të funksionojnë paralelisht në mënyrë të suksesshme të dy gazsjellësit në Korridorin e Jugut? Natyrisht, kjo alternativë është konsideruar, por një nismë e tillë është e porealizueshme në aspektin praktik, të paktën për periudhën kohore aktuale. Rezervat e gazit në "Shah Deniz" të Azerbajxhanit janë të pamjaftueshme për të përmbushur kërkesat me trend të përshkallëzuar rritjeje për projektin Nabucco. Thënë më thjesht, vatra gazmbajtëse "Shah Deniz" e ka të pamundur të furnizojë me 31 miliardë m³ gaz në vit tubacionet e Nabucco-s, të vënë në funksionim në kapacitetin e tij të plotë. Nabucco ishte projektuar për të marrë gaz nga disa burime në Detin Kaspik dhe rajonin e Lindjes së Mesme, jo vetëm nga "Shah Deniz."

Turkmenistani dhe Iraku, për arsye që lidhen me politikat e jashtme dhe të brendshme të këtyre shteteve, nuk mund të kontribuojnë në furnizimin e Nabucco-s. Akoma më të pamundur do ta kishte “Shah Deniz” të furnizonte të dy gazsjellesit, TAP dhe Nabucco, paralelisht. Kjo ishte arsyeja pse Nabucco West – versioni i reduktuar i projektit fillestar Nabucco, me kapacitet 10 miliardë m³ gaz në vit – u propozua. Sidoqoftë, infrastruktura dhe punimet e versionit të reduktuar Nabucco West rezultuan tepër të kushtueshme, pasi bëhej fjalë për një sistem tubash që duhej të mundësonte një përshkallëzim rritës të prurjeve të gazit. TAP nga krahu tjetër, është një linjë shumë më e shkurtër se Nabucco. Edhe ai është projektuar të funksionojë sipas një përshkallëzimi rritës të prurjeve, por deri në 20 miliardë m³ në vit, ndërkohë që kapaciteti fillestar i punës do të jetë 10 miliardë m³ në vit. TAP gjithashtu mundësonte një strukturë më të thjeshtë menaxheriale dhe organizative që përfshinte vetëm tre kompani.

5. South Stream

Atëherë cilat qenë shkaqet reale që cuan në braktisjen e Nabucco-s si projekt...? Shkaku kryesor mund të ketë qenë hedhja në tavolinë e një tjetër projekti, edhe më ambicioz e të mirë-elaboruar krahasuar me këtë të fundit: projekti South Stream. Ky është projekti-flamur i Gazprom-it dhe qeverisë ruse për Korridorin e Jugut, dhe njëherësh përgjigja më e qartë e Ruisë ndaj tentativave të BE-së për t’i shpëtuar sferës ruse të influencës. Moska ishte në gjendje të manovronte bukur politikisht duke bindur pjesën më të madhe të shteteve të Europës Juglindore, si Austria, Serbia, Rumania e Bullgaria, të mos ndërmerrenin veprime lidhur me realizimin e projektit Nabucco, për t’i dhënë kështu dritën jeshile, në një të ardhme tepër të afërt, projektit South Stream. Faji për braktisjen e projektit Nabucco duhet të kërkohet tek dështimi total i diplomacisë së BE-së, dhe mungesa e vullnetit për bashkëpunim midis shteteve anëtare lidhur me këtë çështje. BE-ja shfaqti mungesë të theksuar kompetence në fushën e politikave të energjisë, dhe politika e jashtme e BE-së i solli shumë vështirësi fazës zbatuese të këtij projekti



kompleks. Diplomacia e BE-së dështoi, jo vetëm për të bindur Azerbajxhanin, por edhe të tjerë eksportues të mundshëm të gazit drejt shteteve europiane. Rusia, nga ana e saj, luajti të gjitha kartat e saj politike për të influencuar në zgjedhjen negative të Azerbajxhanit lidhur me projektin Nabucco. Ndoshta edhe vetë projekti TAP ka qenë një manovër e tërthortë e strategjive të studjuara të Rusisë, dhe ka patur si qëllim shtyrjen sa më shumë në kohë të projektit Nabucco, deri sa të kristalizohej plotësisht projekti South Stream.

Në rast se dobësia kryesore e projektit Nabucco ishte mungesa e një sasive të bollshme të gazit dhe e burimeve të mjaftueshme për furnizimin e impiantit, South Stream prezantohet si një projekt në të cilin nuk hasen të tilla probleme. Rusia i ka me bollëk burimet e gazit; puna për realizimin e projektit është ngadalësuar paksa për gjetjen e zgjidhjeve optimale për shtrimin e sistemit të tubave në hapësirën e Detit të Zi. Shtrimi i segmentit detar të tubacionit të South Stream do të fillojë në vjeshtën e këtij viti (2014).¹¹⁸ Me relaizimin e tij, projekti merr udhë për një fazë finale tepër të shpejtë dhe të suksesshme. Sipas shembullit të Bullgarisë dhe Serbisë, është Hungaria ajo që do të fillojë punimet për ndërtimin e një tubacioni tokësor gazi gjatë tremujorit të dytë të 2015-ës. Aktualisht planifikimi hapësinor dhe dokumentacioni i vlerësimeve të ndikimit mjedisor janë duke u plotësuar për segmentet e Hungarisë, Sllovenisë, dhe Kroacisë.

Konsiderime përmbyllëse

Me përzgjedhjen e projektit TAP, si projekti që do të inagurone Korridorin e Jugut, preferencat e SHBA-ve dhe të BE-së nuk u konsideruan. Konsortium-i i “Shah Deniz” përzgjodhi TAP, projektin më pak të kushtueshëm, dhe me distancën më të shkurtër. Konkurrenti direkt i projektit TAP, projekti Nabucco gëzonte suport të plotë politik nga SHBA dhe nga vendet e BE-së pasi mundësonte një diversifikim të ofertës së gazit për një numër vendesh të Europës Juglindore e Qëndrore që kanë varësi substanciale nga Rusia për këtë komoditet. Rusia nga ana e saj ishte e interesuar që projekti Nabucco të mos e shihte dritën jeshile, pasi ajo kërkonte të realizonte një plan të saj për Korridorin e Jugut: projektin South Stream. Moska i luajti të gjithë gurët e politikës së saj të jashtme dhe i ndërmori të gjitha presionet gjeostrategjike brenda sferës së saj të influencës për të eliminuar mundësitë e realizimit të Nabucco-s. Azerbajxhani nuk e preferoi variantin Nabucco, dhe në këtë përzgjedhje, krahas arsyeve ekonomike të lidhura me eficientësinë dhe kostot, mund të ketë ndikuar dhe influenca e politikës së jashtme të Moskës.

Si projekti Nabucco, ashtu dhe ai South Stream, nuk parashikojnë degëzime tubacionesh nëpër territorin shqiptar. Drejtimi i linjës së tubave të Nabucco-s nuk e konsideronte fare hapësirën territoriale të Ballbanit Jugor. Në rastin e projektit South Stream, një degëzim i rrjetit të tij të tubacioneve kalon nëpër territorin grek, përmes Adriatikut, me destinacion jugun e Italisë, por edhe ky projekt nuk ofron një degëzim për territorin shqiptar. Qeveria greke nga ana e saj ka ofruar suport të plotë për një tjetër projekt: ITGI. Ky projekt u refuzua që në fillim nga konsortium-i “Shah Deniz” i Azerbajxhanit. Edhe projekti ITGI, ashtu si degëzimi i South Stream, parashikonte një shtrim tubacioni nëpër pjesën veriore të Greqisë, duke anashkaluar Shqipërinë, përmes Adriatikut, me destinacion jugun e Italisë. Nga të gjitha këto projekte, i vetmi projekt që parashikonte një përshkim tërthorazi të territorit shqiptar ishte TAP. Dhe për fatin e mirë të Shqipërisë dhe shqiptarëve, TAP rezultoi projekti fitues.

Duke patur parasysh se Greqia dhe Italia janë anëtare të hershme të BE-së, shtete me infrastrukturë të gatshme dhe me një industri të konsoliduar në sferën e energjitikës, mund të

¹¹⁸ (Gazprom, 2014)

spekulojmë se shteti që përfiton më shumë nga ky projekt është Shqipëria. TAP është pa dyshim projekti më me shumë vlera për ekonominë shqiptare, i marrë përsipër gjatë këtyre 30 viteve të fundit. Furnizimi me gaz (një nga komoditetet më të cmueshme në kohët që jetojmë) drejtpërdrejt në shtëpitë e shqiptarëve do të sjellë një frymëmarrje të pritur gjatë në ekonominë vendase. Shqiptarët prej kohësh kanë qenë të orientuar nga përdorimi i gazit natyror për një numër aktivitete të jetësore dhe industriale që kërkojnë energji, sic janë ngrohja, gatimi, vënia në punë e makinerive prodhuese të bizneseve, etj. Megjithatë, asnjëherë në Shqipëri nuk janë krijuar konditat e një shkeputjeje substanciale nga nafta (dhe nënproduktet e saj), pasi sasi të importuara të gazit kanë qenë të vogla, dhe janë mundësuar kryesisht nëpërmjet rrugëve detare (me cisterna) dhe transportit tokësor me kamionë. Kjo, për shkak të mungesës totale të infrastrukturës gazsjellëse në Shqipëri, infrastrukturë të cilën vendi ynë nuk e ka patur të trashëguar as nga regjimi i kaluar monist (ashtu sic mund ta kenë patur të trashëguar vendet e ish-Jugosllavisë, Bullgaria, Çekia, Slovakia, etj.) Nëpërmjet projektit TAP, tani në Shqipëri po hidhen themelet për një infrastrukturë tepër solide gazsjellëse dhe gaz-përpunuese, e cila me kohë do të mundësojë një ulje të konsiderueshme të cmimeve të këtij komoditeti krahasuar me cmimet aktuale, dhe do të mbështesë një shkeputje tepër të nevojshme të ekonomisë shqiptare nga varësia e naftës (dhe e nënprodukteve të saj). Do të nevojitet fillimisht një përshtatje – nga shfrytëzimi i naftës tek ai i gazit – e të gjitha industrive përpunuese, prodhuese dhe të transportit, por prezenca e përhershme e këtij komoditeti në Shqipëri do ta bëjë shumë të lehtë këtë përshtatje.

Ma hapat e shpejta të marra për realizimin e projektit të tij South Stream në hapësirën midis brigjeve lindore të Detit të Zi dhe Europës Juglindore, konsortiumi gjigand rus Gazprom po i imponohet frikshëm vullnetit të shteteve perëndimore dhe SHBA-ve. Duket se perpjekjet e SHBA-ve dhe BE-së për një diversifikim të furnizimeve me gaz brenda hapësirës së BE-së, të paktën për periudhën aktuale kohore, nuk po rezultojnë të suksesshme. Funizimi më i madh dhe i besueshëm i Europës me gaz, Rusia, nëpërmjet investimit gjigand në ndërtimin e projektit South Stream, pretendon në mënyrë mjaft abmicioze të eliminojë mundësitë e cdo kompetitori të mundshëm që të marrë nga përqindja e tregut të saj në Europë. Interesi i Rusisë për të dominuar plotësisht tregun europian të gazit, natyrisht nuk ka të bëjë vetëm me tregtinë dhe përfitimet ekonomike, por mbi të gjitha me forcimin e pozicionit të saj politik dhe gjeopolitik në arenën ndërkombëtare, vecanërisht kundrejt SHBA-ve dhe vendeve aleate.

Bibliografia

- Amineh, M. P., & Houweling, H. (2007). Global Energy Security and Its Geopolitical Impediments - The Case of the Caspian Region. 365-388.
- CIA. (2013, March 11). The World Factbook - Oil Consumption. Washington, D.C., District of Columbia, United States of America.
- Czech Presidency of the European Union. (2009). *Topolánek: Southern Corridor should be modern Silk Road*. Prague: EU Czech Presidency.

- For the use of the Committee on Foreign Relations. (2012). *Energy and Security from the Caspian to Europe*. Washington D.C.: U.S. Government Printing Office.
- Fossil Fuel Facts. (2009, 09, 27). *Interesting Energy Facts*. Retrieved 09, 12, 2014, from <http://interestingenergyfacts.blogspot.com/2009/09/fossil-fuels-facts.html>
- Gazprom. (2014, Feb. 11). Gazprom pushing ahead with South Stream and Southern Corridor projects. Moscow, Russia.
- Klare, M. (2005). 'Citation'. In *Blood and Oil* (pp. 39-40, 71-72). New York: Henry Hold and Company.
- Klare, M. (2010). Shopaholic China. *China Dialogue*, 10-14.
- Klare, M. T. (2013, 09, 10). *Our Fossil-Fueled Future: World Energy in 2040*. Retrieved 09, 16, 2014, from EcoWatch: <http://ecowatch.com/2013/09/10/fossil-fueled-future-world-energy-in-2040/>
- Mearsheimer, J. (2004). *E.H. Carr vs. Idealism: The Battle Rages On*. Chicago: University of Chicago Press.
- Trans Adriatic Pipeline AG. (2013). *Construction of the Trans Adriatic Pipeline*. Retrieved 09, 12, 2014, from Trans Adriatic Pipeline: <http://www.tap-ag.com/the-pipeline/building-the-pipeline>
- Wendt, A. (1992, Spring). Anarchy is what States Make of it: The Social Construction of Power Politics. *International Organization*, Vol. 46, No. 2., pp. 391-425.

ALBANIAN PRIVATE INTERNATIONAL LAW

Dr. Ervis Çela¹

¹Lecturer, Faculty of Law, University of Tirana,

erviscela@hotmail.com

Abstract

New features in the EU, which distinguishes the EU from common types of international association of states is that Member States have given up some of their sovereign rights in favor of the EU and EU submitted power to act independently. In exercising this power, the EU has the ability to issue sovereign acts that have the same power as laws in individual states. Private International Law in itself is one of the disciplines of the law in a certain state legal system. Constitutes a special branch of the right of a state. This discipline is a new branch of law. There is no exact date when it was born of the right branch, but we can say without hesitation that became an integral part of most systems of law developed only in the nineteenth century. In Eastern Europe there was no convention for the unification of private international law, but between these countries (ex-communist) has had a host of bilateral agreements (about 30) with the object of legal relations in civil, family and criminal law. Here we see the premise of creating a true system of private international law between these states. The purpose of private international law is the solution of the problem which is the law that should be applied when there is a conflict of laws of different states in a legal relationship private character. So, the legal system should be established to regulate civil legal relations on the basis of which will be given to issues relevant facts solutions. So international law is applicable only in case of legal relations with foreign element. In other words we can say that private international law consists of a set of legal norms, which determine whether a civil legal relationship characterized by foreign element should be regulated according to the legal order of a given state or a state with which it presents points of contact. In a special view will see the Albanian private international law.

Keywords: *private international law, law reform, international law, contractual obligations, law applicable*

The Albanian private international law is based on international sources of law as the Conventions¹¹⁹, treaties or international agreements and internal sources of law such as the

¹¹⁹The main conventions that Albania is part: Vienna Convention on Diplomatic Relations, Vienna 18.04.1961 (date of ratification by decree of the Presidium dated 10.10.1987); Nr.7164 National Assembly; Vienna Convention on Consular Relations, Vienna, 04.24.1963 (date of ratification 10.04.1991); Convention on the Rights of the Child,

Constitution, private codes (including the Civil Code, Family Code, Civil Procedure Code, the Labour Code etc.), laws¹²⁰ and specific regulations in force.

As of 02/06/2011, the specific law regulating legal relations characterized by foreign element was Law No. 3920, dated 11.21.1964 "For the enjoyment of civil rights by foreigners and law enforcement to foreign" law which is now replaced by the Law No.10428 dated 02.06.2011 "On Private International Law".

Albanian Law on Private International Law in force includes issues related to:

- applicable rules of law that will regulate private legal relations which are characterized by the foreign element and

Jurisdiction and procedural rules regarding the Albanian courts of civil law relations, which are characterized by a foreign element.

The jurisdiction of the International Court of Albania is located in Chapter IX of "Private international law". It noted that "permanent residence" as a criterion connector is widely applied in these legal provisions in order to expand the possibility of Albanian courts to resolve disputes that characterized the foreign element.

The second issue is regulated by the Law on Private International Law is about the applicable rules of law. To determine the applicable law in a particular dispute, Albania needs guidance factors connector.

Law number 10 428, dated 02.06.2011 "On Private International Law", enacted to meet the new needs of the society, which are characterized, nowadays the intensification of international transactions, the movement of goods, services and people. In contrast with the Law No. 3920,

New York 20.11.1989 (date of ratification 27.2.1992); Convention Relating to the Status of Refugees, Geneva, 07/28/1951 (date of ratification 18.8.1992); Convention relating to the Status of Stateless Persons, New York, 09.28.1954 (date of ratification 23/07/2003); Convention on the Reduction of Stateless Persons, New York, 30/028/1961 (date of entry into force in Albania 09/07/2003); The Constitution of the United States Nations Industrial Development, Vienna, April 8, 1979 (date of entry into force in Albania April 19, 1988); Convention on Contracts for the International Carriage of Goods by Road (CMR) Geneva, May 19, 1956 (date of ratification 20/07/2006); Convention of the International Maritime Organization (IMO), Geneva, 06/03/1948 (date of ratification 24.5.1993); Assembly on the Nationality of Married Women, New York 20.02.1956 (date of entry into force in Albania July 27, 1960); Assembly on the Recognition and Enforcement of Foreign Arbitration, New York 10.06.1958 (date of ratification 27.1.2001); European Convention on International Commercial Arbitration, Geneva 04.21.1961 (date of entry into force in Albania 6/27/2001); European Agreement on the transmission of applications for legal aid, approved by Law No. 8705 dated 01/12/2000; European Convention on Information on Foreign Law, ratified by the Parliament on 12.01.2000, Law No.8703; The Hague Convention abolishing the requirement of Legalisation for Foreign Public Documents, approved by Law No. 9060 dated 08/05/2003; United Nations Convention on Contracts for the International Sale of Goods, adopted by Law No. 10,092 dated 09.03.2009 etc.

13 Article 2 of Law No. 10 428 dated 02.06.2011 "On Private International Law" provides that: implementation of international treaties ratified by law has superiority over the law, when the law giving effect to the regulation of relations with an international element as established in an international treaty

¹²⁰For example, Law No. 10 428 dated 02.06.2011 "On Private International Law", Law No.7764 dated 02.11.1993 "On foreign investments", etc.

dated 11.21.1964 "For the enjoyment of civil rights by foreigners and foreign law enforcement", 10426/2011 Law "On International Private Law" has covered a greater area application criteria, applying new criteria or upgrade existing ones.

In general terms we can say that: The law "On Private International Law" that is in effect, characterized by the following principles:

- Autonomy of the parties
- Permanent Residence
- League narrower

a) The autonomy of the parties

The autonomy of the parties is one of the fundamental principles of the legislation of private and located in many procedural elements in the private international law rules. Autonomy gives the parties the opportunity to choose a specific law to regulate their relations liability, taking into account the limitation posed by borders and customs duties. Article 17 of Law No. 3920, dated 21.11.1964 "For the enjoyment of civil rights by foreigners and foreign law enforcement", says the partial autonomy will be the main element of the contract which will dominate in choosing the applicable law (the first criterion is to be applied to contractual obligations); and in its absence criterion can be applied in connection with settlement of the parties or the law where the contract will be applied¹²¹. However there are some limitations that the applicable law chosen by the parties shall not apply, for example, if the decision is contrary to the public order of the state where the contract will be implemented governed by the law chosen by the parties¹²².

As of 02.06.2011, the Albanian private international law is governed by Law No.10 428 "on Private International Law", in which the autonomy of the parties is applied in a wider area, which includes:

- Mutual willingness of the parties to determine the content of the contract¹²³;
- Mutual willingness of the parties to choose the jurisdiction that will govern the available disputes¹²⁴;

¹²¹ Article 18, Law number 3920, dated 11.21.1964 "For the enjoyment of civil rights by foreigners and foreign law enforcement"

¹²² Article 26, Law number 3920, dated 11.21.1964 "For the enjoyment of civil rights by foreigners and law enforcement foreign "

¹²³ Article 676 of the Albanian Civil Code, approved by Law no. 7850 dated 29.07.1994, amended by Law no. 8536 dated 18.10.1999, 03.05.2001 and dated Nr.8781 'contract is concluded when the parties have expressed mutual will and have accepted the main conditions. The expression of the will may be expressed or can be silent "

¹²⁴ Article 73 of Law no. 10 428 dated 02.06.2011 "On the private international law"

- Mutual willingness of the parties to choose the applicable law that will govern their contractual relationship¹²⁵.

The first situation is regulated by the Albanian Civil Code and can be interpreted in the context of partial material autonomy, while the second could be interpreted in the context of partial formal autonomy. Article 73 of Law No. 10,428, dated 02.06.2011 "On Private International Law provides that:" The Albanian court has international jurisdiction even if the parties to the agreement allocate international jurisdiction Albanian courts. This agreement should: a) be in writing or in the form verbal, but verbal agreement must be evidenced in writing. b) it must be in accordance with international trade practices, which are considered to be known by the parties. This is an innovation in doctrine and our legislation, because in provisions of Law No. 3920, dated 11.21.1964 "For the enjoyment of civil rights by foreigners and foreign law enforcement" was not given such an opportunity and also Civil Procedure Code provides that the Republic of Albania: Albanian court's jurisdiction to foreign natural persons and legal entities is regulated by law. Albanian jurisdiction cannot be delegated to deal in foreign jurisdiction, unless the judgment relates to a liability to foreigners or between a foreigner and an Albanian citizen, or a legal person not residing or staying in Bangladesh and these exceptions regulated by international agreements ratified the Republic of Albania¹²⁶. So, if the parties are from different states that can apply to the selected jurisdiction clause in their agreement in order to specify that any dispute arising under the contract will be judged according to state court jurisdiction that they have chosen or by an arbitral tribunal and the parties may also specify that any dispute arising under the contract shall be determined in accordance with the law of the country they have chosen or parties can apply a choice of law combined.

According to Article 45 of Law No. 10,428, dated 02.06.2011 "On Private International Law provided that" The contract will be governed by the law chosen by the parties. With their choice the parties can select the law applicable to all or part of contract. "If the parties have chosen jurisdiction to resolve disputes arising from the contract, it is presumed that the law of that state will govern their contract. the choice must be expressed or demonstrated with reasonable certainty by the terms of the contract or the circumstances of the case . At any time the parties may choose another law to govern their contract. Any subsequent change in the applicable law, after signing the contract, will not affect the formal validity of the contract or the rights of third parties. While it has a real connection with another country from the one chosen by the parties, the applicable law chosen by the parties will not affect the application of provisions of the law of another state, which can not be avoided by the agreement. The existence and validity of the contract or any condition of its governed by the law applicable to the contract¹²⁷.

¹²⁵ Article 45 of Law no. 10 428 dated 02.06.2011 "On the private international law"

¹²⁶ Article 20 of the Civil Procedure Code of Albania approved by Law no. 8116 dated 03.29.1996, amended by Law no. 8431 dated 14.02.1998, Nr. 8491 dated 27.05.1999, Nr. 8535 dated 18.10.1999, Nr. 8812 dated 17.05.2001, Nr. 9953, dated 14.07.2008, Nr. 10 052 dated 29.12.2008.

¹²⁷ Article 45 of Law no. 10 428 dated 02.06.2011 "On the private international law"

Based on the interpretation of this article, we can say that Law No. 10428/2011 "On the Right Private International ", gives a detailed priority autonomy contract members and also for the first time the party autonomy can be applied even in non contractual¹²⁸ obligations. But on the other hand this autonomy is not unlimited because the law contains certain restrictions applicable law chosen by the parties as a primary applicable law, that will not apply if the decision is contrary to the public order of the state where it is applied¹²⁹. Also we can find a limited choice of the right of autonomy the parties that the contract includes Transportation¹³⁰, with consumer contract¹³¹, insurance contract¹³², matrimonial property regime¹³³, testament¹³⁴, validity and freedom of choice of law applicable to non contractual obligations¹³⁵.

b) Permanent Residence

Rules of private international law can provide various personal factors that connect a person with a legal system. Most often used include: citizenship, residence and permanent residence.

"Nationality / citizenship represents the political status of a person, which he or she owes allegiance to a particular country. Except in cases of naturalization, it depends mainly on the place of birth of the person or his origin. Nationality as a factor connector is approved for the first time in France in 1803 with the promulgation of the Code Napoleon, depending on residence, which had generally prevailed throughout Europe before that time "¹³⁶.

This effect is observed even in the Albanian Law No. 3920, dated 11.21.1964 "For the enjoyment of civil rights by foreigners and foreign law enforcement", where nationality is usually used as a factor connector ¹³⁷. In residence jurisdictional issues as a factor connector, is used as the concept of "habitual residence" was not part of the Albanian legislation since 2011.

Civil Code of the Republic of Albania in accordance with this matter provides that: "The settlement is where a person is related to his work because of service or permanent, due to the location of his property, or because of compliance of his interests, his habitual residence or most

¹²⁸ Article 57 of Law no. 10 428 dated 02.06.2011 "On the private international law"

¹²⁹ Article 7 of Law no. 10 428 dated 02.06.2011 "On the private international law"

¹³⁰ Article 50 of Law no. 10 428 dated 02.06.2011 "On the private international law"

¹³¹ Article 52 of Law no. 10 428 dated 02.06.2011 "On the private international law"

¹³² Article 51 of Law no. 10 428 dated 02.06.2011 "On the private international law"

¹³³ Article 24 of Law no. 10 428 dated 02.06.2011 "On the private international law"

¹³⁴ Article 35 of Law no. 10 428 dated 02.06.2011 "On the private international law"

¹³⁵ Article 57 of Law no. 10 428 dated 02.06.2011 "On the private international law"

¹³⁶ http://www.lawreform.ie/_fileupload/consultation%20papers/wpHabitualResidence.htm.

¹³⁷ Article 3, 5, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 21, 23, 27, Law number 3920, dated 21.11.1964 "For the enjoyment of civil rights by foreigners and law enforcement foreign "

Article 32 7/3, 18, 24, 28 / b, 29, 30, Law number 3920, dated 11.21.1964 "For the enjoyment of civil rights by the Foreigners and foreign law enforcement "

of the time "¹³⁸. The following rules determine residence Albanian Civil Code of adults and minors residence / children. So the act provides that“every person can choose their residence his when he reaches adulthood”, the act provides that“a person can not have in the same time more than one residence. Residence for children who has not attained the age of fourteen years shall have the same dwelling with their parents, and if the child's parents are not in the same residence then the residence of the child who has not attained the age of fourteen years should have the domicile of the parent with whom the child lives. "Furthermore, the law provides that "in the case of persons who are deprived of the ability to act and children under guardianship must be their legal guardian¹³⁹". Albanian law, specifically Law Nr.10129 dated 11.05.2009 "On Civil Status" with the Articles 14 and 15 provide for the obligation of a party to declare his place of residence and the office of the registrar. Albanian Civil Code also provides that: "the residence of a person is where he resides to perform certain tasks or to attend an education program or a course, to have a medical treatment, to serve a criminal sentence and the situation other similar ". Residence must be proved in each case in practice; stay is not the obligation of the registration in the registry office. So, residence and domicile provided by the above articles are not synonymous even if they may be in the same place. A person can have only one domicile which has to do with fulfilling a legal procedure of registration and may have more than one residence and no registration requirements.

In the context of free movement of people, capital and goods is necessary to use the most flexible criteria such as "domicile", as it is perceived as providing an alternative to nationality as well as relief of difficulties associated with residence, such as those regarding the purpose, origins and dependence ¹⁴⁰. The concept of habitual residence reflects the factual relationship between a person and place, but not a relationship in the legal sense.

In the international arena, permanent residence appears to a number of international private and has also been used as a primary or secondary factor in EU legislation in relation to the rules of private international law, including:

- Regulation on the law applicable to contractual obligations (Rome I);
- Regulation on the law applicable to non-contractual obligations (Rome II);
- Regulation on the law applicable to divorce and separation (Rome III);
- Regulation on jurisdiction, recognition and enforcement of judgments in matrimonial matters and the matters of parental responsibility; and

¹³⁸ Article 12 of the Albanian Civil Code, approved by Law no. 7850 dated 07.29.1994, amended by Law no. 8536 dated 18.10.1999 and Law no. 8781 dated 05.03.2001

¹³⁹ Article 13 of the Albanian Civil Code, approved by Law no. 7850 dated 07.29.1994, amended by Law no. 8536 dated 18.10.1999 and Law no. 8781 dated 05.03.2001

¹⁴⁰35 http://www.lawreform.ie/_fileupload/consultation%20papers/wpHabitualResidence.htm.

- Regulation on jurisdiction, applicable law, recognition and enforcement of decisions and cooperation in matters relating to the duties of maintenance¹⁴¹.

However, under current legislation Albanian private international law, Article 12, provides that “the permanent residence of a natural person is the place where a person has decided to stay in most of the time, even in the absence of a registration, permit or authorization to live”. In determining their residence the court must consider the circumstances of personal and professional nature, which show a stable relationship with this place or person for the purpose of staying in this country. This, of course, on the one hand helps to expand the scope of legal criteria, but on the other hand it can be difficult to prove. However factors that should be considered include regularity, purpose, reasons of personal or professional nature, duration, and permission to live or authorization are not an essential element to prove residency .

c) The narrow connection

Rules of private international law can also provide practical criteria applicable as of the close link. Criteria of the nearest / closer connection is generally based on the Law No. 10 428 dated 02.06.2011 "On the international law Private ". It is applied not only in the field of contracts, but also to some particular issues in the field of private international law. Article 12 paragraph 2 "Private International Law" provides that "The court shall determine the closest connection, based on the factual circumstances." So, when you apply the criteria of close bonding, Albanian Court will consider the relationship between Albania and the dispute even greater interest, in order to decide whether the closest connection is that Albania has great link with relations characterized by legal foreign element or not.

The narrow applicable criteria connection is provided by the Albanian Private International Law to manage situations such as: when a foreigner has two or more nationalities, national law will be the law of his habitual residence; If a foreigner does not have a habitual residence in each of the countries of his nationality then in these conditions shall apply the law of the country with which he is most closely connected (Article 8.3); If a party does not have his citizenship or nationality cannot be determined, shall apply the law of the habitual residence. If a party is domiciled, or cannot be determined shall apply the law of the country with which it has a closer connection (Article 9/2).

For more parties to a contract involving foreign elements may choose the law applicable by virtue of the contractual context. If the parties to a contract involving foreign elements fail to make such a choice, the contract will be governed by the applicable criteria provided for in Article 46 of the Private International Law, and as a last resort, would apply the law of the country with which it is most closely link. Transportation contract, rules for non-contractual

¹⁴¹ [http://www.europarl.europa.eu/RegData/bibliotheque/briefing/2013/130427/LDM_BRI\(2013\)130427_REV1_EN.pdf](http://www.europarl.europa.eu/RegData/bibliotheque/briefing/2013/130427/LDM_BRI(2013)130427_REV1_EN.pdf).

damages, unfair enrichment¹⁴² etc, contain similar rules. The narrow criteria connection plays a very important role in the Albanian Private International Law especially in the absence of a choice of law, whether express or implied, where the contract shall be governed by the law more closely connected with contract.

Conclusions

Private International law is also known as the right of conflicts (Conflict of Laws). It is part of the private law of a particular country. This is done to fix disputes private nature. So that private international law to be effective, the conflict between the parties must have a connection with at least one foreign legal system. Any modern legal system has private international law is not the same in all countries.

Increased trade between countries resulted in an increase in the number of conflicts during the XIX and XX century. This led to the development of trade between countries in the international harmonization of different legal systems. I think that legal harmonization legislation governing the relationships that have a foreign element should be governed by multinational conventions in order to minimize conflicts more and more and it is necessary to adjust the rules according to the time change.

In the context of internal, private international law is that part of the Albanian law, which comes into action whenever the court is faced with a request that contains a foreign element. This means that private international law is a domestic law that regulates the legal relationships of a private law nature featuring an international dimension, so consequently private international rules are different from country to country. Foreign element can be located in each of the following components a relationship that is free as an object, or subject¹⁴³ or to content. If foreign element¹⁴⁴ is located in one or more than one of these components, the legal relationship will be characterized by the international character which means that this link will include two or more states. Foreign element can appear in many forms such as: One of the parties may be of foreign nationality or residence, the action may be a property that is located abroad, or an agreement made overseas property situated in Albania, the contract may be made in one place and to be performed in another country etc.

¹⁴² Article 4, 8/3, 9/2, 12/2, 23/3, 46/4, 50/3, 56/4, 63/3, 68/4, 69/4 i Law no. 10428 dated 02.06.2011 "Private international law"

¹⁴³ Article 1 (2) of the Law number 10 428, dated 02.06.2011 "On the private international law". Give the definition of a foreign element which includes any legal circumstance relating to the subject, content or scope of a civil and legal relationship and that is grounds for concluding that relationship with a particular legal system.

¹⁴⁴ 38 Dr. Hajredin Kuqi, Dr. BILJALI Asllan, "Private International Law", "The General, Pristina, 2008, IPristines University, Faculty of Law, p. 162.

References

- Law number 10 428, dated 02.06.2011 "On the private international law"
- Law number 3920, dated 21.11.1964 "For the enjoyment of civil rights by foreigners and application of foreign law "
- F. Mosconi, Diritto Internazionale Privato second edition, 2001 UTET
- 20 of the Civil Procedure Code of Albania approved by Law no. 8116 dated 03.29.1996, amended by Law no. 8431 dated 14.02.1998, Nr. 8491 dated 27.05.1999, Nr. 8535 dated 18.10.1999, Nr. 8812 dated 17.05.2001, Nr. 9953, dated 14.07.2008, Nr. 10 052 dated 29.12.2008.
- http://www.lawreform.ie/_fileupload/consultation%20papers/wpHabitualResidence.htm
- Dr. Hajredin Kuqi, Dr. BILJALI Asllan, "Private International Law ", part of General, Pristina, 2008, University of Prishtina, Faculty of Law
- [http://www.europarl.europa.eu/RegData/bibliotheque/briefing/2013/130427/LDM_B_RI\(2013\)130427_REV1_EN.pdf](http://www.europarl.europa.eu/RegData/bibliotheque/briefing/2013/130427/LDM_B_RI(2013)130427_REV1_EN.pdf).
- Pepe Norman, Rome I and Rome II: A Handbook to Determine the Law Governing Contractual and Non-Contractual Obligations, October 2010
- The Law of Contract under the Rome Convention
- Madel Pilar Perales Viscasillas, Modification and Termination of the Contract
- Michael G. Bridge, Issues arising under articles 64, 72 and 73 of the United Nations
- Convention on Contracts for the International Sale of Goods.

PROTECTION OF COPYRIGHT IN THE DIGITAL WORLD

MND. Radovan Çela

Municipality of Tirana,
radovan.cela@gmail.com

Abstract

Removal (download) of art works in Internet is a reality that is not yet fully involved in Albanian law. The issues raised by this technique in practice are not assimilated although Albanian current doctrine has begun to address this issue, analyzing mainly foreign jurisprudence and practice. However, the myriad of Albanian jurisprudence regarding copyright, namely to enforce copyright in the digital area is small and does not address the dismissal of the criminal and the problems arising from this technique.

But this issue should not be overlooked. Albanian legislation, case law and Albanian professionals should be aware about this issue, so that in practice not exceed the right, but the right to be prepared for any eventuality that may present practice. For example, market entry system photocopying, tapes and gramophone discs created new avenues of transmission to the public because of their proliferation was established a direct connection between the offense and the individual. An even closer connection between them was created with the birth of digitizing technique, which allows multiplication technique in various physical supports work in the same quality of the original work. Works, in the form of digital copy, can spread throughout the world and therefore such a suite could not have consequences on using it economically. Download a movie on the Internet or a musical album entails quite naturally in a *lucrum cessans* for the producer and for their author. Digital Copy inevitably has an effect on the fairly broad economic exploitation of the work.

Keywords : copyright, digital word, cyber crime, european legislation

Abstrakt

Shkarkimi (downloadimi) i veprave artistike në Internet është një realitet që ende nuk është përfshirë tërësisht në të drejtën shqiptare. Problematikat që ngrenë kjo teknikë në praktikë nuk janë asimiluar edhe pse doktrina aktuale shqiptare ka filluar të trajtojë këtë çështje, duke analizuar kryesisht jurisprudencën dhe praktikën e huaj¹⁴⁵. Megjithatë, moria e jurisprudencës shqiptare në lidhje me të drejtën e autorit, më saktësisht të drejtën e autorit zbatuar në fushën dixhitale është e pakët dhe nuk trajton shkarkimin e veprave dhe problematikat që rrjedhin nga kjo teknikë.

Por kjo problematikë nuk duhet anashkaluar. Edhe legjislacioni shqiptar, praktika gjyqësore shqiptare dhe profesionistët e fushës duhet të ndërjegjësohen në lidhje me këtë çështje, në mënyrë që në Shqipëri praktika mos të tejkalojë të drejtën, por e drejta të jetë e përgatitur për çdo eventualitet që mund të paraqesë praktika. Për shembull, hyrja në treg e sistemit të fotokopjes, e kasetave dhe e disqeve të gramafonit krijuan shtigje të reja të përcjelljes së veprës në publik dhe për shkak të masivizimit të tyre u krijua një lidhje më direkte midis veprës dhe individit. Një lidhje edhe më të ngushtë midis tyre u krijua me lindjen e teknikës së dixhitalizimit, teknikë e cila lejon shumëfishimin në suporte fizike të ndryshme të veprës në cilësi të njëjtë me origjinalin e veprës¹⁴⁶. Vepra, në formën e kopjes dixhitale, mund të përhapet në të gjithë botën dhe rrjedhimisht një përcjellje e tillë nuk mund të mos ketë pasoja në shfrytëzimin e saj ekonomikisht. Shkarkimi i një filmi në Internet ose i një albumi muzikor passjell në mënyrë krejt të natyrshme një *lucrum cessans*¹⁴⁷ për prodhuesin dhe për autorin e tyre. Kopja dixhitale në mënyrë të paevitueshme ka një pasojë mjaft të gjerë mbi shfrytëzimin ekonomik të veprës. Dy përgjigje të mundshme ekzistojnë ndaj këtij fenomeni.

Shpërblimi për shkak të ekzistencës së paevitueshme të përjashtimit nga zbatimi i të drejtave pasurore

Në radhë të parë, në legjislacionet e huaja njihet mekanizmi i kompensimit të fitimit të munguar nga autorët për shkak të kopjimit të veprës në mënyrë dixhitale nga vet individët. Në këtë rast, kompensimi i ofrohet autorëve, të cilët nuk mund të përfitojnë shpërblimin nga e drejta e tyre ekskluzive si autor, pasi ata nuk kanë asnjë mundësi praktike të frenojnë kopjimin e veprave. Duhet thënë se në shume vende të Europës, teknika e shpërblimit për kopje për përdorim vetjak është shtrirë në të gjitha suportet ekzistuese (dixhitale dhe analoge)¹⁴⁸. Fatkeqësisht, në Ligjin

¹⁴⁵ Mariana Tutulani-Semini, "E drejta e autorit në Shqipëri", Skanderbeg Books, 2009.

¹⁴⁶ Yves Gaubiac, "Dimension de la copie privée dans le monde numérique de la communication", Revista CCE (Communication – Commerce Electronique), f. 13, qershor 2008.

¹⁴⁷ Michel Vivant, Jean-Michel Bruguiere, "Droit d'auteur", Dalloz, Botimi I - 2009, f. 394.

¹⁴⁸ Neni 311-4 i Kodit francez të Pronësisë Intelektuale: "Shpërblimi i parashikuar derdhet nga fabrikuesi, importuesi ose personi që realizon blerjet brenda Komunitetit, të suporteve të regjistrimit të përdorur për ripordhimin për përdorim vetjak të veprave, gjatë vënes në qarkullim në Francë të këtyre suporteve. Vlera e shpërblimit varet nga lloji i suportit dhe kohëzgjatja e regjistrimit që ai lejon. Kjo vlerë llogaritet në bazë të sasisë së përdorimit të mjeteve teknike dhe të pasojave që kanë ato mbi përdorimet që lidhen me përjashtimet për kopje

nr.9380, « Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të »¹⁴⁹, shpërblimi nuk parashikohet. Një mangësi e tillë duhet rregulluar, në mënyrë që dhe legjislacioni shqiptar të përqafojë një realitet që dhe në Shqipëri është i pranishëm.

Filozofia e shpërblimit për kopje private është mjaft e thjeshtë. Ajo qëndron në zbatimin e një kompensimi të fitimit të munguar për autorët nga kopjimi i veprave të tyre në suportet e materializuara si për shembull disqet CD ose DVD, ose kasetat audio dhe video të quajtura të virgjëra (suporte bosh). Shpërblimi rëndon mbi prodhuesit dhe shpërndarësit e suporteve që përmendëm më lart. Tarifimi i shpërblimit për kopjen për përdorim vetjak bëhet në bazë të kapacitetit të regjistrimit që ka çdo suport. Kështu, për shembull, në Francë për DVD-R ose DVD-RW me kapacitet total 100 Go, aplikohet pagesa në formën e shpërblimit që është 27,02 Euro¹⁵⁰. Gjithashtu, për një CD-R ose CD-RË me kapacitet total 100 orë, pagesa do të jetë 45,73 Euro. Këto tarifa janë fiksuar nga një komision special i përbërë nga gjyqtarë, nga përfaqësues të titullarëve të të drejtave dhe nga disa përfaqësues të përdoruesve (zakonisht këto të fundit të mbrojtura nga shoqatat e konsumatorëve). Këto shpërblime u derdhen normalisht organizmave përkatës, të cilat pasi marrin shumat i shpërndajnë ndërmjet autorëve, interpretëve dhe prodhuesve. Ky shikim i shpejtë i mekanizmit të shpërndarjes së shpërblimit ndihmon të kuptohet mekanizmi i shpërblimit, dhe pse jo dhe të zbatohet në Shqipëri, ku fenomeni i piratimit të veprave ka arritur përmasa shqetësuese edhe pse nuk ekziston ende një studim i mirëfilltë i impaktit të piratimit të veprave mbi të drejtën e autorit në Shqipëri. Zbatimi i parimit të shpërblimit nëpërmjet formës që paraqitëm më lart nuk mund të bëhet pa një bashkëpunim vendimtar midis Zyrës Shqiptare të së Drejtës së Autorit, dhe organeve përkatëse tatimore, të cilat do të kontrollojnë në zbatimin e përpiktë të këtij parimi. Kjo do të ndihmonte në rimëkëmbjen e artit shqiptar, dhe do të kufizonte deri në një farë mase humbjen e konsiderueshme që vuan industria shqiptare e muzikës nga piratimi i veprave. Mekanizmi që parashtrua është interesant dhe në një pikëpamje tjetër, atë të neutralizimit të abuzivitetit në lidhje me vjeljen e të drejtave të autorit¹⁵¹. Ky mekanizëm paraqet një thjeshtësi si në diskutimin për ngritjen e taksës që do të shërbejë si shpërblim, ashtu dhe në zbatimin e tij, pasi shpërblimi do të bazohet në çdo shitje suporti që do të kryhet, gjë që është lehtësisht e kontrollueshme.

Pasoja e dixhitalizimit të informacionit mbi kopjen private janë mjaft të konsiderueshme. Siç e pamë dhe më lart, në vitet '80, përballë masivizimit të mundësive për të kopjuar veprën, titullarët e të drejtave duhet të përgjigjeshin sa më shpejt kundër humbjeve ekonomike që ata po pësonin. Kështu, u vendosën regjime kompensimi, si për shembull shpërblimi, që e trajtuam pak më lart. Në atë periudhë, teknologjia analoge bënte që çdo kopje e regjistruar në një suport të përdorur humbiste cilësinë, aq herë sa ky suport përdorej. Në këtë aspekt, dhe pse humbja nga përhapja e

private. Nuk mund të ketë shpërblim për aktet që lidhen me kopjen private për të cilat është kryer një kompensim financiar.”

¹⁴⁹ Ligji gjendet në faqen www.ligjet.org.

¹⁵⁰ Tarifa të fiksuar nga Komiteti i Posaçëm i Aktimit të shpërblimit për kopjen për përdorim vetjak. Kapaciteti nuk duhet kuptuar si kapaciteti i një suporti vetëm, por shuma e kapaciteteve të shumë suporteve jep totalin e shënuar më sipër (100 orë, 100 Go...).

¹⁵¹ Për referencë, mund të marrim procesin gjyqësor, aktualisht nën analizën e Gjykatës së Lartë, me palë Albautor vs Vodafone Albania sh.a, ku Albautor kërkon pagesën për të drejtat e autorit për përdorimin nga ana e shoqërisë Vodafone të ringtoneve të pre-inkorporuara në celularët që përdorin kartën SIM Vodafone. Kjo çështje do të jetë objekt i një sqarimi të mëvonshëm, pasi shtrun për diskutim shumë pikëpyetje, njëra prej të cilave është dhe legjitimiteti i agjencive të mbrojtjes së të drejtave të autorit...

veprave në formën e kopjes private ishte e konsiderueshme, ajo mbetej gjithësi e kufizuar, pasi konsumatori arrinte të bënte dallimin ndërmjet një kopje origjinale e vënë në shitje nga vetë prodhuesit e diskut ose të kasetës video, dhe një kopje e bërë privatisht, pasi hendeku cilësor në teknologjinë analoge ishte i pranishëm.

Testi i tre etapave – ngushtimi i parë i kuptimit të përjashtimit nga zbatimi i të drejtave pasurore

Por sot, riprodhimi numerik i veprës krijon mundësinë e një klonimi gati perfekt të saj, pasi kopja është mjaft identike me origjinalin¹⁵². Ky fenomen ka një pasojë mbi shpërndarjen numerike të veprës, pasi një transpozim gati identik i kopjes private për përdorim personal mund të sjellë një goditje ndaj kësaj shpërndarjeje, pasi nën petkun e përdorimit vetjak të veprës, mund të riprodhohen në mënyrë numerike veprat pambarim. Kështu del në pah kompleksiteti i çështjes, pasi një shpërndarje pa pagesë e veprave në Internet është një humbje për industrinë muzikore. Shtrohet çështja se cila e drejtë ka më tepër të drejtë. Duke përdorur këtë sofizëm, arrijmë në përfundimin se kemi dy të drejta kontradiktore deri diku që përplasen në terrenin e tolerancës së krijuar, atë të kopjes për përdorim vetjak. Këto dy të drejta janë e drejta e autorit, dhe e drejta e publikut¹⁵³ për të gëzuar tolerancën e ofruar nga ligji. Nëse shihet neni L.122-5 i KfPI-së, arrijmë në konkluzionin se ekzistojnë dy baza për nocionin e kopjes private. Kështu, për përjashtimet e karikaturës... etj, e drejta e autorit frenohet para lirisë së të tretëve për të krijuar dhe për t'u shprehur (një lloj e drejte legjitime për të bërë keq¹⁵⁴ ...). Në këtë rast, nuk ekziston asnjë kompensim për dëmin e shkaktuar për shkak të parodisë që i bëhet veprës¹⁵⁵. Për sa i përket kopjes private *stricto sensu*, pra kopjes që përdoret si zëvendësues i produktit që mund të përfitohej në treg, ekziston një gjendje pamundësie materiale për të penguar kryerjen e kopjeve. Në këtë aspekt, themi se përjashtimi për të kryer kopjen private nuk është veçse një tolerancë në favor të publikut që ky i fundit të bëjë kopje për përdorimin e tij vetjak. Çka shpjegon mjaft qartë dhe nomenklaturën në të cilën ndodhet kopja private, pasi jo vetëm që duhet të përdoret vetëm në një kuadër veçse personal, por duhet gjithashtu që të ketë një identitet të njëjtë midis kopjes dhe personit që kryhen kopjen.

Frika në botën numerike është pikërisht lejimi i kopjes private nëpërmjet shkarkimit. Pasi kopja është gati perfekte, vënia në shitje ose thjesht në qarkullim e veprës pa lejen e autorit vë në vështirësi parimin e të drejtës ekskluzive. Dhe nëse zbatohet parimin e kopjes private në botën dixhitale, a nuk do të ketë një konflikt me shpërndarjen normale të veprës drejtpërdrejt tek konsumatori-individ, çka mund të bëhet rregulli ekonomik në fushën e shpërndarjes së veprave

¹⁵² Në të vertetë, ndryshime ka për shembull kopja mp3 nuk është e krahasueshme me origjinalin e saj, pasi e dyta ka një cilësë më të lartë. Kjo vjen pasi kopja mp3 është një format i kompresuar i informacionit. Por dallime të tilla subtile mund të bëhen vetëm pas një analize të hollësishme të ndryshmeve, pasi praktikisht, për veshin e një dëgjuesi normal, ndryshimet nuk ekzistojnë.

¹⁵³ E drejta e publikut është një togfjalësh që nuk ka forcë juridike per se, por ajo nënkupton gëzimin ng apubliku të disa të drejtave që janë të rëndësishme për mirëqënien kulturore të tij, të cilat sipas skemës së fair use të përdorur në Amerikën Veriore mund të analizohen si të drejta që kanë më tepër rëndësi sesa mbrojtja e së drejtës ekskluzive të autorit (për referencë, procesi gjyqësor Napster, Betamax...)

¹⁵⁴ Pierre-Yves Gautier, *Propriété littéraire et artistique*, PUF (Presses universitaires françaises)

¹⁵⁵ Në mënyrë të qëllimtë është marrë shembulli i parodisë, pasi një përjashtim i tillë nuk parashikohet në Ligjin shqiptar për të drejtën e autorit...

në Internet. Nëse instalohet një sistem i tillë, përjashtimi për kopje private nuk do të ketë më arsye të jetë. Parimi aktual i përjashtimit për kopje vetjake me qëllim përdorimi vetjak, i parashikuar në tekstet kombëtare dhe ndërkombëtare është në rrezik për shkak të shkarkimeve të jashtëligjshme. Edhe pse parimi ekziston, duket se nxirren gjithmonë teori të ndryshme të shpjegimit të përjashtimit, që e bëjnë atë të evoluojë. Përgjithësisht, ekzistojnë dy sisteme të zbatueshëm për përjashtimet nga të drejtat e autorit; sistemi i parë merr në konsideratë qëllimin e përdorimit në mënyrë parësore në krahasim me natyrën e veprës së mbrojtur. Kjo është ajo që karakterizon sistemin e *fair use*¹⁵⁶, i cili lejon marrjen në konsideratë të evolucioneve shoqërore, dhe si pasojë e bën të drejtën e autorit më të hapur ndaj ndryshimeve. Në sistemin e dytë, që mund të quhet sistemi evropian, përjashtimet janë objekt i një liste të detajuar veprimesh të cilat i shpëtojnë të drejtës së autorit¹⁵⁷. Këto përjashtime kufizohen megjithatë duke aplikuar disa kondita të cilat janë të parashikuara në nenin 5.5 të Direktivës nr. 2001/29, “Mbi shoqërinë e informacionit“, në të cilën thuhet, ndër të tjera: “Përjashtimet dhe kufizimet e parashikuara në nenet 1, 2, 3 dhe 4 janë të zbatueshme në disa raste speciale që nuk prekin shfrytëzimin normal të veprës ose të çdo objekti tjetër të mbrojtur, as nuk shkaktojnë një dëm të pajustificuar interesave legjitime të titullarit të të drejtave”. Ky paragraf ndryshon natyrën e sistemit të mbyllur evropian të përjashtimeve nga e drejta ekskluzive. Ai shton një element të ri që e përafuron me sistemin amerikan, dmth, pasojat e përdorimit të veprës mbi tregun potencial të saj ose të vlerës së saj. Gjithashtu, ai zbaton Traktatet OBPI të vitit 1996, ku në mënyrë të veçantë, në nenin 10 të Traktatit mbi të Drejtën e Autorit thuhet se “palët kontraktuese mund të parashikojnë në legjislacionet e tyre kufizime ose përjashtime nga të drejtat e parashikuara në këtë traktat, në disa raste speciale ku nuk preket shfrytëzimi normal i veprës as nuk shkakton një dëm të pajustificuar interesave legjitime të autorit.” Këtu bëhet fjalë për lindjen e testit të tre etapave. Sipas këtij parimi, kopja private lejohet vetëm nëse : (i) përbën një rast special , (ii) nuk prek shfrytëzimin normal të veprës , (iii) nuk shkakton dëm të pajustificuar ndaj titullarit të të drejtave.

Ky sistem filtrimi nuk ka pasojë tjetër vetëm frenimin në maksimum të mundësisë të kryerjes së kopjes për përdorim vetjak. Hyrja në lojë e testit me tre etapa zbeh seriozisht pretendimet e atyre që mendonin në ekzistencën e një të drejte për të kryer kopje private.

Sistemi i tre etapave është parashikuar fillimisht në Konferencën e Stokholmit ku u rishikua Konventa e Bernës e vitit 1967. Ky sistem është rikonfirmuar më vonë nga marrëveshjet ADPIC, traktati i Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale më të drejtën e autorit i datës 20 dhjetor 1996. Së fundi, ky test u bë pjesë e legjislacionit amerikan (duke qënë pjesë e Digital Millenium Copyright Act) dhe e Direktivës snr. 2001/29 eëdatës 22 maj 2001, në lidhje me shoqërinë e informacionit.

¹⁵⁶ Kjo teori e parashikuar në ligjin amerikan të së drejtës së autorit « Copyright Act » parashikon disa raste në të cilën e drejta e autorit nuk quhet e shkelur. Sipas kësaj teorie, nëse një individ riprodhon një vepër të mbrojtur, Gjykata mund të arrijë në përfundimin se nuk ka shkelje të së drejtës së autorit nëse një nga konditat e mëpohtme plotësohet : 1) qëllimi dhe karakteri i përdorimit, dmth nëse përdorimi i veprës ka një natyrë tregtare ose nuk jep asnjë përfitim riprodhuesit ; 2) lloji i veprës së mbrojtur ; 3) sasia dhe substanca e veprës së përdorur ; 4) efekti mbi tregun, dhe nëse ky treg është potencial.

¹⁵⁷ E njëjta logjikë ndiqet si në Francë ashtu dhe në Shqipëri, me një listë shteruese të veprimeve që përfitojnë nga përjashtimi i zbatimit të të drejtave pasurore.

Qëllimi i testit me tre etapa është i qartë: të vendosë një kufi kundër përdorimit të tepruar të përjashtimeve të të drejtave pasurore të autorit. Rastet speciale që përmend testi janë pikërisht rastet që parashikohen në direktivën 2001 ashtu si dhe në ligjet përkatëse kombëtare¹⁵⁸. Përjashtimet jo vetëm janë të kufizuara në mekanizmin e tyre por ato nuk duhet të prekin shfrytëzimin normal të veprës, as të shkaktojnë një dëm të pajustificuar ndaj interesave të titullarit të të drejtave.

Një ilustrim gjyqësor i zbatimit të tre etapave është Vendimi i Gjykatës franceze të Kasacionit i datës 28 shkurt 2006, “UFC Que Choisir? Vs. Universal Pictures France dhe Studio Canal”.

Ky vendim ishte i një rëndësie të veçantë pasi shtron jo vetëm një interpretim gjyqësor të testit të tre etapave por edhe çështjen e vlefshmërisë së masave teknike të mbrojtjes së veprës, të cilat do të shqyrtohen më poshtë. Çështja vinte përballë Shoqatën e mbrojtjes së konsumatorëve (UFC Que Choisir?) me shoqëritë Universal Pictures France dhe Studio Canal. Padiësit vërenin se shoqëritë kishin bllokuar mundësitë e kopjimit të DVD-ve për shkak të mjeteve teknike të mbrojtjes. Gjykata hedh poshtë pretendimet me arsyetimin se “ligjvënësi nuk ka dashur të veshë askënd me të drejtën për të realizuar një kopje private, por ai organizon kushtet të cilat kopja e një vepre t’i shpëtojnë monopolit që mbahet nga autorët..”. Gjyqtarët arrijnë në këtë konkluzion pasi bëjnë adoptojnë arsyetimin e testit me tre etapa. Duhet të kujtojmë se në atë periudhë, direktiva nuk ishte transpozuar ende në të drejtën franceze. Gjyqtari mënjanon zbatimin strikt të ligjeve të viteve 1957 dhe 1985 (ligjet bazë mbi të drejtën e autorit, që sanksiononin parimin e kompensimit të drejtë për çdo kopje private), pasi në këto dy periudha, ligjvënësi nuk mund të parashikonte pasojat e dixhitalizimit mbi përhapjen e veprës. Gjykata zbaton testin tre etapa në një këndvështrim tepër “ekonomist”¹⁵⁹, pasi analizon me shumë saktësi pozicionin e industrialistëve që shpërndajnë veprat në format DVD. Në vendim thuhet: “tregtia e DVD-ve gjeneron të ardhura tepër të nevojshme për të ruajtur ekuilibrin buxhetor të prodhimit të tyre”. Më pas, ajo shton: “shfrytëzimi i një filmi në DVD përbën një model shfrytëzimi normal të veprave”. Po të ndjekim arsyetimin *a contrario* kuptojmë që për gjykatën kopja numerike e një vepre të regjistruar në DVD është anormale. Dhe në fakt, këtë gjë e thotë vetë vendimi disa linja më poshtë: “Kopja private e një vepre filmografike e botuar në një suport numerik nuk mund veçse të prekë shfrytëzimin normal të veprës”. Pra, sipas Gjykatës amortizimi i filmave me anë të DVD është pjesë e shfrytëzimit normal të veprës dhe prishja ose anashkalimi i mjeteve teknike përbën shkelje të parimit të amortizimit¹⁶⁰. Gjyqtari nisat nga një fakt i njohur, ai i situatës së piraterisë në masë, për të arritur detyrimisht në konkluzionin e sipërcituar, dhe për të kufizuar në maksimum kopjen private. Kështu, nëse bëjmë një përmbledhje të situatës së kopjes private, arrijmë në përfundimin se jo vetëm ajo kufizohet në rastet e parashikuara në ligj, por ajo duhet të kapërcejë testin e tre etapave, pasi të ketë thyer barrierën e mbrojtjes nga masat teknike që do të përmbahen në suportet ku qëndrojnë veprat. Nëse një person dëshiron të bëjë një kopje për përdorim vetjak, atij do t’i duhet të thyejë mjetet teknike të mbrojtjes së veprës, pavarësisht se qëllimi për të cilin e bën është thjesht për përdorim personal, pasi thyerja e mbrojtjes me anë të mjeteve teknike është krejt indiferente ndaj qëllimit për të cilin individi thyen sistemin e

¹⁵⁸ Pwr mw shumw, shih nenet 26, 27 dhe 28 tw Ligjit 9830.

¹⁵⁹ Christophe Soulié, « Copie Privée et mesures techniques de protections », Lamy Droit des médias et de la communication, qershor 2004.

¹⁶⁰ Yves Gaubiac, “Dimension de la copie privée dans le monde numérique de la communication”, Revista CCE (Communication – Commerce Electronique), f. 13, qershor 2008.

mbrojtjes. Gjithashtu, një tjetër non sens është ai i kompensimit të drejtë ose shpërblimit që parashikohet nga direktiva, por një gjë e tillë bie ndesh me sistemin e mbrojtjes, pasi me hyrjen në qarkullim të veprave të mbrojtura teknikisht, kompensimi e humb vlerën e tij. Direktiva nuk thotë nëse të dy sistemet duhet të bashkekiztojnë ose nëse kompensimi do të jetë veçse i përkohshëm. Së fundi, zbatimi i parimit të testit në tre etapa për një vendim gjyqësor mund të shprehë idenë se kemi të bëjmë me vendim që shkojnë përtej analizës së objektit që vë përballë palët dhe e shikon problemin e prekjes së shfrytëzimit të veprës jo brenda kuadrit të objektit që i është paraqitur por duke analizuar pasojat e saj në përgjithësi¹⁶¹.

Megjithatë, ligjvënësi francez nuk e ka penalizuar këtë Vendim, edhe pse asokohe direktiva nuk ishte transpozuar ende, por përkundrazi inkorporoi testin e tre etapave në nenin e Kodit të Pronësisë Intelektuale ku flet për përjashtimet, pikërisht neni L.122-5 i tij. Një formulim i ngjashëm ndodhet dhe në ligjin shqiptar të së drejtës së autorit nr 9830, por testi në fjalë nuk del mjaft qartë. Kështu, në pikën "ç" të nenit 26 të Ligjit, thuhet se riprodhimi i plotë ose i një pjese të veprës lejohet për përdorim vetjak, por pa cenuar shfrytëzimin tregtar të veprës. Megjithatë, duhet thënë se futja e këtij togfjalëshi, sado i papërkufizuar mirë, shpreh njëfarë dëshire të ligjvënësit shqiptar për t'u përshtatur me direktivat e Bashkësisë. Priten amendimet ligjore që Parlamenti shqiptar i ka parashikuar për votim në korrik të këtij viti për të parë sanksionimin e plotë nga e drejta shqiptare të këtij testi.

Mjetet teknike mbrojtëse – eliminimi i konceptit të kopjes për përdorim vetjak

Në radhë të dytë qëndrojnë mjetet teknike të mbrojtjes së veprave të parashikuara fillimisht nga Traktati i OBPI-së i vitit 1996 si dhe mbrojtjes së tyre juridike¹⁶². Ligji shqiptar nuk jep përkufizim të mjeteve mbrojtëse teknike. Megjithatë, një përkufizim mund t'a gjejmë në Kodin francez të Pronësisë Intelektuale ku thuhet se mjetet teknike janë « çdo teknikë, dispozitiv, përbërës [...] i cili bën të mundur moslejimin ose kufizimin e përdorimeve të paautorizuara nga titullarët e të drejtave »¹⁶³. Mjetet teknike, në një pikëpamje praktike, janë bllokimet e mundësisë së kopjimit të veprës, kriptimi i tyre etj... Në njëfarë mënyre, titullari i të drejtës mbi veprën kufizon përdorimin e lirë të suportit material nga ana e zotëruesit të këtij suport.

Ligji ynë parashikon në nenet 26 dhe vijues të tij kufizimet në ushtrimin e të drejtës së autorit dhe përdorimin e veprës pa leje. Sipas dispozitave të parashikuara në këto nene shohim se përdorimi i veprës lejohet të përdoret me kusht që të mos cenohet e drejta e autorit¹⁶⁴. Gjithashtu lejohet riprodhimi i plotë ose i një pjese të veprës për përdorim vetjak, me kusht që të mos cenohet shfrytëzimi tregtar i veprës¹⁶⁵. Një mënyrë e mbrojtjes së shfrytëzimit tregtar janë mjetet teknike të mbrojtjes. Ato janë parashikuar gjithashtu nga direktiva e datës 22 maj 2001¹⁶⁶, direktivë e cila ka frymëzuar ndryshimet legjislative të ndodhura në Francë vitin e kaluar si dhe

¹⁶¹ Valerie Laure Benabou, "Les dangers de l'application judiciaire du triple test a la copie privee, juriscom.net, 20 prill 2006.

¹⁶² Gjithashtu të njohura me acronimi DRM (Digital Rights Management).

¹⁶³ Neni L.131-5 i Kodit francez të Pronësisë Intelektuale

¹⁶⁴ Neni 26 paragrafi i parw i Ligjit 9380.

¹⁶⁵ Neni 26 pika ç i Ligjit 9380.

¹⁶⁶ Kjo direktivë gjendet në këtë adresë: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:32001L0029:FR:NOT>

pjesërisht ligjin e ri shqiptar të së drejtës së autorit¹⁶⁷. Duhet nënvizuar fakti se adoptimi i direktivës shënon një periudhë të re të së drejtës europiane, pasi nëse ato transpozohen nga vendet anëtare, gjë për të cilën nuk duhet të ketë asnjë dyshim, do të vendosin një regjim të përbashkët të së drejtës së pronësisë letrare dhe artistike.

Zhvillimi i mjeteve teknike me qëllim mbrojtjen e veprave ndiqet nga një arsenal juridik që ka si qëllim mbrojtjen jo vetëm të veprave, por edhe neutralizimin e thyerjes së dispozitave teknike ekzistuese nga hackers-at, ose piratët informatikë. Gjatë Konferencës diplomatike të vitit 1996, vendet anëtare të OBPI-së adoptuan traktatin OBPI mbi të drejtën e autorit që fiksonte objektiva të ndryshëm për shtetet palë. Detyrë për ta, ndër të tjera, ishte adoptimi i mbrojtjes juridike kundër neutralizimit të mjeteve teknike që janë vënë në jetë nga ana e autorëve dhe prodhuesve të veprave të tyre, në kuadrin e ushtrimit të të drejtave të tyre, dhe që reduktojnë mundësinë e kryerjes së akteve që nuk janë të autorizuar nga autorët ose të lejuara nga ligji. Ndërsa për sa i përket mekanizmave praktikë të mbrojtjes, dokumenti ndërkombëtar nuk shprehet, duke e lënë këtë fushë në duar të shteteve palë, dhe veçanërisht legjislacioneve europiane dhe amerikane. Prurja kryesore e direktivës është parashikimi i sanksioneve, pasi në të parashikohen dhe aktet që përgatisin neutralizimin e mjeteve teknike: fabrikimi, importimi, shpërndarja, shitja, dhënia me qira... Me këtë parashikim, Direktiva synon qartësisht t'i mveshë mjetet teknike mbrojtëse me një mbrojtje të natyrës juridike¹⁶⁸. Megjithatë direktiva ka vënë një kufi aplikimit të mbrojtjes së masave teknike, të cilat do jenë objekt mbrojtjeje vetëm në rastin kur do të kenë si objekt një krijim të mveshur nga një e drejtë ekskluzive¹⁶⁹.

Interpretimi që i është bërë mjeteve teknike mbrojtëse në këtë rast është se ato do të jenë të efektshme kur përdorimi i një veprë të mbrojtur kontrollohet prej titullarëve të të drejtave nëpërmjet zbatimit të kodeve ose kriptideve ose transformimi të veprës ose një mekanizëm për kontrollin e kopjimit të veprës me anë të të cilit arrihet qëllimi i mbrojtjes së veprës¹⁷⁰.

Rëndësia që i akordohet mjeteve teknike mbrojtëse të veprave¹⁷¹. Ata arrijnë në konkluzionin se ka një ndryshim në lidhje me përkufizimin që i jep direktiva e majit 1999 për mjetet teknike, ku thuhet se ato janë të destinuar të parandalojnë ose të mënjanojnë një shkëlqje të pronësisë intelektuale, por duke mos u dhënë një mbrojtje të veçantë juridike. Me përkufizimin e ri dhe me parashikimin e mbrojtjes juridike për mjetet teknike të mbrojtjes, është e nevojshme të kihet parasysh një ekuilibër i arsyeshëm midis interesave të titullarit dhe përfituesve të përjashtimeve,

¹⁶⁷ Ligji aktual është në një proces të rëndësishëm rishikimi dhe përshtatjeje me parimet e direktivës së 22 majit 2001. Mendohet se në muajin korrik 2011 do të kalojë në Parlamentin shqiptar.

¹⁶⁸ Neni 6.1 i Direktivës së datës 22 maj 2001.

¹⁶⁹ Neni 6.3 i Direktivës datë 22 Maj 2001 : « Në bazë të kësaj direktive, me « mjete teknike » do të kuptojmë cdo teknologji, dispozitiv ose përbërës, i cili në kuadrin normal të funksionimit të tij, është i destinuar të parandalojë ose të kufizojë, për sa i përket veprave ose objekteve të tjera të mbrojtura, aktet e pa autorizuar nga titullari i të drejtave të autorit, ose nga një e drejtë e lidhur me të e parashikuar me ligj, ose të një të drejte sui generis parashikuar në kapitullin III të direktivës 96/9/CE. Mjetet teknike quhen si eficientë kur përdorimi i një veprë të mbrojtur, ose të një objekti tjetër të mbrojtur, është kontrolluar nga titullarët e të drejtave falë zbatimit të një kodi hyrës ose të një procedimi mbrojtjeje sic mund të jetë kriptimi, ose cdo transformim tjetër i veprës ose të objektit të mbrojtur ose të një mekanizmi kontrolli të kopjes që përmbush synimin e mbrojtjes. »

¹⁷⁰ Neni L. 331-5 i Kodit francez të Pronësisë Intelektuale.

¹⁷¹ Olivier Masset, koment i një vendimi gjyqësor të Gjykatës Paris, 30 prill 2004, in www.juriscom.net/document/pla20040727.pdf

dhe në këtë kuadër, direktiva parashikon¹⁷² njëfarë gëzimi të qetë të të drejtave për ata që përfitojnë nga përjashtimet. Por ky gëzim i të drejtave duhet parë si tolerancë që direktiva u lejon shteteve t'a organizojnë vet pasi këto të fundit duhet të gjejnë një harmoni midis "të drejtës së krijuesve dhe interesave të përdoruesve. Me këtë dispozitiv del qartë favorizimi që i bën direktiva krijuesve dhe titullarëve të të drejtave në përgjithësi"¹⁷³.

Vendosja e mbrojtjes juridike të mjeteve teknike ofron një shtresë të tretë mbrojtjeje për veprat. E para është ligji që mbron të drejtat e autorit, e dyta janë mjetet teknike në vetvete, si dhe së fundi mbrojtja juridike e mjeteve teknike. Kështu, teknikat në vetvete, bëhen objekt mbrojtjeje. Shtrohet pyetja mëse legjitime nëse me mbrojtjen e teknikave, të cilat në fund të fundit kanë si synim mbrojtjen e së drejtës së autorit, nuk krijohet një bllokadë e tërë kundër aksesit drejt informacionit. Zgjerimi i monopolit të së drejtës së autorit (që në fakt është e drejta e titullarëve të të drejtave) tejkalon kufijtë e tij të pritshëm duke hyrë kështu dhe në aksesin drejt informacionit.

Duke patur parasysh këtë rrezik, legjislacionet evropiane, në rastin konkret, ai francez, kanë parashikuar një autoritet administrativ i cili përcakton fushën e veprimit të mjeteve teknike mbrojtëse. Ky autoritet i quajtur Autoriteti i rregullimit të Mjeteve teknike ka për qëllim të mbikqyrë zbatimin e mjeteve teknike në mënyrë të tillë që përdoruesit të përfitojnë nga përjashtimet ligjore nga të drejtat pasurore të titullarëve të veprave. Ky Autoritet kujdeset që mjetet teknike të mos kenë për efekt të privojnë përdoruesit nga këto përjashtime: (i) kopjet dhe riprodhimet të rezervuara për përdorimin vetjak të kopjuesit dhe jo për një përdorim kolektiv, (ii) analizat, citimet, materialet përmbledhës të shtypit, (iii) riprodhimi i pjesshëm ose i plotë i veprave të artit në katalogje shitjeje ose në procedura gjyqësore¹⁷⁴.

Çdo person që përfiton nga përjashtimet e cituara mund të paraqesë kërkesë pranë Autoritetit në lidhje me fushën e zbatimit të mjeteve teknike mbrojtëse. Në fushën e riprodhimit për kopjet vetjake, siç e pamë dhe me jurisprudencën e përmendur, fusha e saj e zbatimit ngushtohet së tepërmi. Nëse Kodi francez i Pronësisë Intelektuale parashikon se "Autoriteti përcakton fikson numrin minimal të kopjeve në kuadrin e përjashtimit për kopje vetjake në funksion të llojit të veprës dhe në funksion të llojeve të ndryshme të komunikimit drejt publikut..."¹⁷⁵. Këtu shtrohet çështja e përcaktimit të numrit minimal të kopjes, Sipas interpretimit që ka bërë Gjykata Kushtetuese franceze në Vendimin e saj datë 27 korrik 2006, "autorët mund të kërkojnë mbrojtjen nëpërmjert mjeteve teknike duke kufizuar kopjen në një të vetme, ose duke ndaluar çdo lloj kopjeje, në rastet kur një zgjidhje e tillë do të siguronte shfrytëzimin normal të veprës dhe nuk do të shkaktojë atij një dëm të pajustificuar". Ky interpretim e kthen kopjen vetjake në një nocion bosh. Megjithatë, ligjvënësi ka dashur të mbrojë konsumatorin duke parashikuar një

¹⁷² Pika 31 e Direktivës së datës 22 maj 2001.

¹⁷³ Michel Vivant, Jean-Michel Bruguiere, "Droit d'auteur", Dalloz, Botimi I - 2009, f. 377.

¹⁷⁴ Sipas parashikimeve të nenit L-331-8 të Kodit francez të Pronësisë Intelektuale.

¹⁷⁵ Sipas parashikimeve të nenit L-331-8 të Kodit francez të Pronësisë Intelektuale, paragrafi i fundit.

detyrim informimi që rëndon mbi titullarët e të drejtave në rast se suporti në të cilin ndodhet vepra është pajisur me mjete teknike mbrojtëse¹⁷⁶.

Së fundi, Autoriteti është pajisur me kompetenca vendimmarrëse, të cilat ai i ushtron pasi të jetë siguruar se procedurat e pajtimit nuk kanë funksionuar¹⁷⁷.

Konkluzion

Edhe pse nocionet që përmendëm në këtë shkrim ende janë në hapat e parë në Shqipëri, paraqitet e nevojshme që ato të njihen. Së pari sepse Shqipëria ka hyrë në epokën dixhitale dhe do të ballafaqohet shpejt me problemet që mbart kjo teknologji dhe së dyti se ajo duhet të jeta gati dhe të jetë në gjendje të ngrëjë strukturat e nevojshme, të cilat janë Autoriteti që përmendën dhe nëj entitet që do të merret me kompensimin financiar të humbjeve për shkak të kopjeve private të paligjshme, në mënyrë që e drejta e autorit në Shqipëri të mos jetë më iluzive dhe teorike, por konkrete dhe e zbatuar në praktikë.

Bibliografia

- Ligji nr. 9380, datë 28.04. 2005 “Për të drejtën e autorit dhe për të drejtat e lidhura me të”, i ndryshuar;
- Kodi francez i Pronësisë Intelektuale, Dalloz, 2007
- Direktiva BE, datë 22 Maj 2001 « E drejta e autorit në shoqërinë e informacionit »;
- Marjana Tutulani-Semini, « E drejta e autorit në Shqipëri », Skanderbeg Books, 2009
- Michel Vivant, Jean-Michel Bruguiere, “Droit d’auteur”, Dalloz, 2009 ;
- Pierre-Yves Gautier, Propriété littéraire et artistique, PUF (Presses universitaires françaises) ;
- Celine Castets-Renard, « Le droit de l’internet », Cours, Montchrestien, 2010 ;
- Yves Gaubiac, “Dimension de la copie privée dans le monde numérique de la communication”, Revista CCE (Communication – Commerce Electronique), f. 13, qershor 2008 ;

¹⁷⁶ Neni L-331-12 i Kodit francez të Pronësisë Intelektuale: Kushtet e aksesit në leximin e një vepre, videogrami, programi ose fonogrami dhe kufizimet e mundshme përkundrejt përjashtimeve për kopje private [...] nëpërmjet zbatimit të kopjeve vetjake, duhet t’u vihen në dijeni përdoruesve. »

¹⁷⁷ Neni L-331-5 i KfPI.

- Valerie Laure Benabou, “Les dangers de l’application judiciaire du triple test a la copie privée, juriscom.net, 20 prill 2006 ;
- Christophe Soulié, « Copie Privée et mesures techniques de protections », Lamy Droit des médias et de la communication, qershor 2004 ;
- Carine Bernault, Audrey Lebois, “Peer 2 Peer dhe pronësia letrare dhe artistike”, qershor 2005, Instituti i kërkimeve në të drejtën private, Universiteti i Nantes ;
- Pamela O'Brien, Judicial Response: A safe harbour in the Fair Use Doctrine, 2 février 1998, <http://infoeagle.bc.edu/bc.org/avp/law>;
- www.juriscom.net (në lidhje me vendimet e jurisprudencës franceze)
- www.sacem.fr (në lidhje me tarifatat e shpërblimit për përdorim vetjak)

THE HUMAN RIGHTS AND THE SOCIAL GROUPINGS IN THE AGE OF GLOBALIZATION DEMOCRACY AND OTHER CONCEPTS

SAFET KRASNIQI - PHD

PROFESSOR AT THE UNIVERSITY COLLEGE OF "FAMA" IN PRISTINA

7 "GUSTAV MAJER" STREET

PROFESSOR AT THE PUBLIC UNIVERSITY OF PRIZREN

"UDHA E SHKRONJAVE" STREET

LAWYER

"WILLIAM WALKER" STREET

E-mail: valmirpz@hotmail.com

Abstract

The aim of this study of this subject is the issue of democracy as the ideology, the antagonism, and the globalization, particularly the human rights and freedoms. This is conceived by two aspects: social and the public aspect and that of the hegemony of democracy.

Individualization today is the basic principle of the western political class that articulated in practice the European Right which is in the process of being established. The foundation of individualism is linked to the French shibboleth "neither God nor a gentleman" despite the fact that this concept has its foundation in theocracy, the least is referred to supernatural connections of a human being and the human society.

The question that can be asked today is if the human rights as a being are compatible with the rights of the social groups exactly, if the human rights are complete without the collective rights? Are the collective rights a priority as a condition for the implementation of the individual rights?

The comparative method is the main aim of this work whereas the historical method as the source of this work.

In the spirit of this work, undoubtedly the individual rights not necessarily should be self-approximation but very often also depended on the rights of social groups always in the spirit of the natural right and in the spirit of the cultural diversity of the human society parallel with the complexity of Globalization as an ideology.

The Christianity compares the individualism or it encases with the Catholic social ethics, the western one connects the representation or the representative with the political concept whereas the political concept of Islam connects the individual with the social grouping. The right of the legislature is conveyed from the citizens to the mujtahids.

Parallel to all this there is an approximation and inconsistency between the natural right and that of the positive one as far as the role of the individual is concerned and the social groups in the field of the rights, the misapplication, the revival of the philosophical anthropology and the “retrieval of the natural right”.

Key words: Democracy, human rights, social groups

TE DREJTAT E NJERIUT DHE GRUPIMET SHOQERORE NE EPOKEN E GLOBALIZMIT

DEMOKRACIA DHE KONCEPTET TJERA

DEMOKRACIA SI IDEOLOGJI

Nocioni demokraci, nënkupton ekzistimin e një entiteti politik, një formë shteti e qeverisjeje. Nisur nga këto fakte, demokracia nuk është e kundërta e regjimit shtypës dhe e tiranisë. Mjaft autorë, demokracinë e konceptojnë si një strukturë shoqërore horizontale. Nga kjo, lë të kuptohet se, prej këtij kuptimi hyrës për demokracinë, mund të nxirret edhe kuptimi i demokracisë shoqërore si “shoqëri shumëgrupesh” që ka kuptimin e “infrastrukturës së mikrodemokracive” që mbështet tërësinë e makrodemokracisë gjegjësisht, superstrukturën politike.¹⁷⁸

Ceshtja e demokracisë si ideologji, sigurisht që ka antagonizmat e veta, veçanërisht në kohën e modernizmit dhe globalizimit të botës. Kjo konceptohet nga dy aspekte: aspekti social e shoqëror dhe aspekti i hegjemonisë së demokracisë, e mbështjellur me konceptin e neoliberalizmit që d.m.th. ekonomia e lire e tregut. Ka mendime dhe mendimtarë të ndryshëm që vejnë theksin në frymën e të drejtës evropiane duke iu referuar Konventave ndërkombëtare, konceptin e krishter për njeriun dhe shoqërinë si kolektivitet, konceptin e Fukujamës për fundin e historisë dhe konceptit lindor (Islam) për ndarjen e shoqërisë në dijetarë dhe masat e gjera popullore duke pasur si pikësynim parësor Deklaratën e Kajros, Kuranin dhe synetin e Profetit Muhamed.

Globalizimi i ka vënë në funksion: Të drejtat e njeriut – Kapitalizmi- Ekonomia e tregut të lirë. Këto shtylla, nisen nga parimet politike të demokracisë që janë: Individualizmi, delegimi apo përfaqësimi i shumicës dhe e drejta e votes krahas administrimit në pajtim me shumicën.

Individualizmi, sot është parim themelor i klasës politike perëndimore që e ka artikulluar në praktikë në të drejtën evropiane që është në formim e sipër. Themelet e individualizmit lidhen në

¹⁷⁸Gjovani, Sartori, Çështje Demokracia, shtëpia botuese, Dituria, Tiranë, 1998, fq. 8-11.

parullën franceze “as Zot as zotëri” perkundër faktit se, ky koncept e ka bazën në teokraci, më së paku apo hiç, i referohet lidhjeve mbinatyrore që ka fillimisht njeriu si individ e mëpas, tërë shoqëria njerëzore. Ky sistem filozofik fillimisht e mëpas, politik, njeriun e vendos mbi çdo gjë. Koncepti individualist refuzon ekzistimin e autoritetin mbinjerëzor Zotin, nuk e përfill as konceptin metafizik dhe shpirtëror por, njeriun e ven mbi çdo gjë.

Nga këto, individualizmi si filozofi politike, i identifikuar me stoicizmin grek, pikëpamjen krishtere për “Zotin njeri” dhe me traditën e të drejtës natyrore, është bërë parim kryesor i demokracisë perëndimore. Konform këtij koncepti kapitalizmi, individualizmin e ka ngritur në shkallë të filozofisë jetësore. Kjo është zbrëthyer në çasjen ekonomike të shoqërisë njerëzore kjo e cila, shoqërinë njerëzore e ven në varësi të individit.¹⁷⁹

Krahas kësaj, principet e demokracisë adoptohen edhe me konceptin fetar evropian, të dominuar nga krishterimi. Koncepti kristian është koncept i bazuar në individualizëm. Demokracia kristiane, njeriun e ven në piadestalin më të lartë. Njeriu nuk është eksponent i një klase sociale por, është unik dhe i paprekshëm. Kristianizmi, individualizmin e krahason me etikën sociale katolike. Etika sociale, deri në vitet 90 krahasohej në mes të asaj që është individuale (etika individuale) dhe etikës shtetërore që d.m.th. bënte krahasimin në mes të individualizmit dhe kolektivitetit në sferën e dobisë së përgjithshme.¹⁸⁰

Etika sociale evangjeliste, ndërtoi parime tjera të me të cilat, u orvat që të përafrohen dallimet në mes të individit dhe kolektivitetit nën prizmen e përgjegjësive të përgjithshme. Kjo u argumentua me thënjet: “nuk është përgjegjës vetëm sipërmarrësi por edhe sipërmarrësit, nuk është përgjegjës vetëm shkencëtari por edhe shkenca” etj. Megjithatë, përkundër një risie pozitive që solli etika sociale evangjeliste, prapë se prapë, nuk u harmonizuan apo, nuk u eliminuan në tërësi dallimet në mes të individit dhe masave të gjera popullore.

Bërthama e tërë etikës sociale është “subsidiariteti” Pra kuptimi i fjalës “subsidiariteti” është i qartë: njësitë e vogla të shoqërisë si familja, bashkitë apo komunat duhet të jenë aktorët e vërtetë të jetës shoqërore. Ata duhet të jenë në gjendje t’i japin formë përgjegjësive të tyre në jetë. Shteti dhe njësitë shoqërore të niveleve më të larta qëndrojnë fillimisht si “rezervë”, dmth. Ata aktivizohen vetëm kur njësitë më të vogla nuk është në gjendje të bëjnë një jetë të përgjegjshme. Pra shteti ushtron vetëm një funksion ndihmës dhe shërbyes ndaj njësitë më të vogla. Parimi i subsidiaritetit përbëhet nga dy komponentë: “privati përpara shtetit” dhe “i vogli përpara të madhit”.¹⁸¹

Idea e lirisë individuale e përforcuar me doktrinën kristiane se “njeriu është shëmbëllesë e Zotit në tokë” u përforcua në periudhën e iluminizmit ku, ndarja nga kisha dhe të drejtat e njeriut ishin qëllim absolut. Këto ide, u manifestuan nga I. Kanti. Në fakt, ky ishte iluminizëm politik ku si pike thelbësore u bë dinjiteti i njeriut.¹⁸² Idea për dinjitet dhe barabarësi, shtrihet vetëm përse i përket të drejtës për të jetuar dhe manifestuar aftësitë e tij individuale?¹⁸³

¹⁷⁹ Bulac, Ali, fq. 41 – 46.

¹⁸⁰ Demokracia Kristiane: Parime dhe politikëbërje, Manual për Bashkëpunim Evropian dhe Ndërkombëtar të Fondacionit Konrad Adenauer, botues Fondacioni Konrad Adenauer.

¹⁸¹ Termi Evangjelizëm është përdorur qysh në shek e XVI-të nga shkrimtarët katolikë duke u kthyer me dëshirë shumë besimtarëve Biblikë praktikant që i shoqëronin ata në kishën e hershme mesjetare. Ky term veçanërisht është përdorur në vitin 1520, ku termi Evangjelic në gjermanisht do të thotë Evangelisch, në Gjermani vjen dhe dallohet në polemikën e shkrimtarëve të reformës së hershme. Tashmë ky term është i përdorur gjërsisht duke ju referuar prirjes transdimensionale në teologji dhe spiritalizëm, e cila veçanërisht lidh theksimin e shkrimeve të shenjta në jetën Kristiane.

¹⁸² Martin Kriele, *Befreiung und politische Aufklärung. Plädoyer für die Würde des Menschen*, Freiburg 1980, 49

¹⁸³ Hans Georg Gadamer, *Die Menschenwürde auf ihrem Weg von der Antike bis heute*, Stuttgart 1988, 96

Përderisa, demokracia në përgjithësi dhe demokracia kapitaliste në veçanti, bazohet në besimin e pakufishëm në individin. Interesi individual është garantues i interesit shoqëror dhe, idea se Përkundër favorizimit ekstrem të demokracisë liberale, pamëdyshje autorë dhe dijetarë të ndryshëm perëndimorë, të drejtat e pakufizuara të individëve i reduktojnë në shumicë dhe pakicë. Pikërisht, ekzistimin e pakicave e determinojnë si kusht për ekzistimin e demokracisë dhe reduktimin e pushtetit të pakufishëm të individit. Tomas Xheferson, ish president i SHBA , ekzistimin e pakicave e sheh si kusht për kufizueshmërinë e pushtetit të individit. Argumentimi më i saktë janë periudhat e ndryshme të sistemeve shoqërore, deri në ditët e sotme ku, grupacionet shoqërore janë sunduar, persekutuar dhe çnjerëzuar nga individë të ndryshëm të shndërruar në diktatorë, tiranë dhe kriminel.¹⁸⁴

Kristianizmi, individualizmin e krahason apo e mbështjell me etikën sociale katolike. Etika sociale, deri në vitet 90 krahasohej në mes të asaj që është individuale (etika individuale) dhe etikës shtetërore që d.m.th. bënte krahasimin në mes të individualizmit dhe kolektivitetit në sferën e dobisë së përgjithshme dhe jo vetëm të të drejtave por edhe të detyrimeve me çka grupimet shoqërore apo thënë më ndryshe, bashkësitë civile i bënë më të forta se sa ato politike gjë që, do të ishte barometër i sigurt për kualitetin e të drejtave dhe lirive në përgjithësi.

Individin nuk e forcojnë të drejtat e dhëna nga shteti apo organizatat tjera por, atë e forcon vetë bashkësia e cila është parësore. Duke qenë shteti më i fuqishëm se individ, ai edhe ia dikton të gjitha të drejtat dhe mbi këtë, njeriu bëhet pjesë e presioneve “të më të fortit” ashtu që, individ, gradualisht humbet karshi origjinës së tij etnike, fetare apo racore e me këtë, reduktohet maksimalisht grupimi civil apo shoqëror dhe arrinë të shndërrohet në objekt.¹⁸⁵

Kur flasim për këtë lidhmëri, pa diskutim se, shumë autorë bashkëpunimin ndërmjet tre faktorëve, Shteti – Individ-Grupet shoqërore e shtrijnë edhe më gjerë, veçanërisht përfaqësimin dhe përfaqësuesit e grupeve shoqërore dhe karakterin e përfaqësimit joshoqëror të legjislaturës e që nënkupton prejardhjen e përfaqësuesit. Përderisa, koncepti perëndimor, përfaqësimin dhe përfaqësuesin e lidhin me konceptin politik, në mendimin politik Islam, kjo dallon. Sipas këtij koncepti politik Islam, përfaqësuesi i zgjedhur i një grupimi shoqëror gjegjësisht, e drejta e legjislaturës nga qytetarët të bartet tek muxhtehidët. Muxhtehidët nuk janë kategori politike e rreshtuar në struktura politike por, vijnë nga radhët e qytetarëve që kanë ngritje dalluese intelektuale veçanërisht janë njohës të mire të problemeve themelore në relacion me kërkesat e qytetarëve. praktikisht, Muxhtehidi nuk i nënshtrohet votimit gjë që, përjashton domosdoshmërinë e të pasurit të statusit politik. Njerëzit e dëgjojnë, e pranojnë, pajtohen me mendimin e tij dhe, nëse e shohin të arsyeshme, i ndjekin vendimet e tij. Gjendja e tillë e ngre muxhtehidin në shkallë të liderit natyror të xhematit (bashkësisë).

Të drejtën e popullit apo të një pjese të tij për të ndjekur muxhtehidin, nuk mund ta pengojë muxhtehidi tjetër por, as shteti. Përkundrazi, shteti është i obliguar që ta pranojë dhe mbrojë çdo person për tu angazhuar në ixhtihat. Reciprokisht, muxhtehidi është i obliguar që zgjidhjen e çfarëdo problem ta bazojë në Kuran dhe sunet me çka, kufizimi i të drejtës së muxhtehidit kufizohet vetëm nga sheriat, Kurani dhe suneti i profetit Muhamed. Në rast se, Muxhtehidi dështon në zbatimin e plotë të sheriatit, atëherë, vetë masa e gjerë popullore do ta mënjanojë dhe i njëjti do të spostohet sikur të mos ketë ekzistuar fare.

Sipas filozofisë politike të Islamit, funksionimi i tillë i shoqërisë në raport me të zgjedhurin dhe të zgjedhurit, gjithsesi është i lidhur me vendimin e “UMETIT” gjegjësisht, ky Umet është

¹⁸⁴Million – Delsol, Chantal. “Idetë politike të shekullit XX –të”, Onufri, Tiranë, 2000, fq. 283

¹⁸⁵Bulaç, Ali, Din ve Modernizm (Feja dhe modernizmi), Stamboll, 1993.

vendimtari gjatë gjithë jetës së muxhtehidit. per dallim nga sistemi i demokracisë ku, shumica zgjedh përfaqësuesin e tij dhe atë për një periudhë të caktuar kohore dhe vendos vetëm një here në një periudhë kohore.¹⁸⁶

Tek muxhtehidi, studimi dhe Ixhtihadi nuk përqendrohet vetëm në shkencat e shariatit, por hulumtimi dhe studimi përqendrohet edhe në rregullimin e mendimit njerëzor. Fjala “Ixhtihad” do të thotë përpjekje, angazhim, shpenzim, kërkim etj.

Në prizmin e analizës së mëspërme, sigurisht se, duhet ti referohemi edhe doktrines së krishtere e cila, shumë ngajshëm, në parim, harmoninë shoqërore e barazon me individin nën prizmin e “Adamit të ri” por, duke e vendosur në qendër të synimit të kishës katolike, doktrinën shoqërore. Enciklika “Populorum progression” e cilabë menjëherë pas përmbylljes së Koncilit II Ekumenik të Vatikanit, në paragrafet e para, thekson marrëdhënien e vet të ngushtë me Koncilin e cila lidhet me Magjisterin e mëtejshëm shoqëror të Papëve.¹⁸⁷

Kisha katolike, individin e ven në maje të kësaj bote, megjithatë, ajo zgjeron gamën e shtrirjes së interesave të vetë kishës në rrafshin më të gjerë që tregon domosdoshmërinë e unifikimit dhe nevojës së përafritimit të njeriut si individ dhe grupeve shoqërore si domosdoshmëri e ekzistimit të shoqërisë si tërësi. Pali VI e kuptoi qartë se çështja shoqërore ishte bërë botërore dhe dalloi tërheqjen e ndërsjellë mes shtytjes për njësimin e njerëzimit dhe idealit të krishterë të një familjeje të vetme të popujve, solidarë në vëllazërinë e përbashkët. Tregoi se zhvillimi, i kuptuar nga ana njerëzore dhe e krishterë, është zemra e mesazhit shoqëror të krishterë dhe e paraqiti dashurinë e krishterë si forcë në shërbim të zhvillimit. I nxitur prej dëshirës për ta bërë dashurinë e Krishtit plotësisht të dukshme për njeriun bashkëkohor, Pali VI përballoi me vendosmëri çështje të rëndësishme etike, pa u lëshuar pe dobësive kulturore të kohës së vet.¹⁸⁸

Sipas Palit të VI. çështja shoqërore ishte bërë botërore dhe dalloi tërheqjen e ndërsjellë mes shtytjes për njësimin e njerëzimit dhe idealit të krishterë të një familjeje të vetme të popujve, solidarë në vëllazërinë e përbashkët., Kjo është zemra e mesazhit shoqëror të krishterë dhe e cila, paraqiti dashurinë e krishterë si forcë në shërbim të zhvillimit.¹⁸⁹

¹⁸⁶Dr. Vërbani, Musli, Ixhtihadi, Kacanik, 2012. Ixhtihadi është bazë prej bazave të Usuli Fikhut dhe planprogram Islam. Usuli Fikhu konsiderohet si sinonim i kësaj shkence. Imam Raziu Usuli Fikhun e përkufizon kështu: 1. Studim dhe analizë e argumenteve të fikhut në përgjithësi - kjo është baza e parë; 2. Mënyrë e përpunimit dhe e përfundimit (konkluzionit) prej argumenteve - kjo është baza e dytë; 3. Studim dhe elaborim i sërishëm pas përfundimit (konkluzionit) - kjo është baza e tretë. Për këtë arsye kjo shkencë titullohet në shumës dhe jo në njëjës “Bazat e bazave”. Nga kjo që përmendëm më lart kuptohet se Usuli Fikhu merret me studimin e Burimeve të studimit dhe konkludimit prej atij studimi, pra merret me studimin e rrugëve të studimit, kushteve të studimit, dhe kjo është ajo, siç e quajnë perëndimorët, si Rogjer Bekoni, e të tjerët - thelb i shkencave, program shkencor në shkencë, ndërsa tek muslimanët është program shkencor i shkencave të tyre.

¹⁸⁷Krh. Gjon Pali II, Let. enc. *Sollicitudo rei socialis* (30 dhjetor 1987), 6-7: AAS 80 (1988), 517-519.

¹⁸⁸ Letra Enciklike Caritas In Veritate e Atit të Shenjtë Benedikti i XVI drejtuar Ipeshkvijve Presbiterëve dhe Diakonëve, personave të kushtuar Zotit, besimtarëve laikë dhe të gjithë njerëzve vullnetmirë mbi zhvillimin e tërësishëm njerëzor në të vërtetë dhe në dashuri.

¹⁸⁹Krh. Let. enc. *Populorum progressio*, 3: l.c., 258.

E DREJTA NATYRORE, DEKLARATA UNIVERSALE PER TE DREJTAT E NJERIUT DHE DEKLARATA E KAJROS

E drejta natyrore (lat. jus naturale) sipas definicionit leksikor dhe në filozofinë juridike, është e drejtë mbinacionale - Mbishtetërore dhe mbi të drejtën pozitive që nuk mbështetet në ligjet të hartuara nga njeriu e që, në situatë të caktuara mund të jetë në kundërshtim me të drejtën shtetërore apo të pushtetit shtetëror. Kjo është e drejta e vërtetë.¹⁹⁰

Keqperdorimi i të drejtës pozitive shtetërore në shek. XX, pas vitit 1945, ka çuar kah ringjallja e antropologjisë filozofike dhe "rikthimit të së drejtës natyrore". Kjo ka shtyrë njeriun që sipas nevojave të adaptojë këto të drejta të cilat, qëndrojnë mbi normat e të drejtës pozitive.¹⁹¹

Nisur nga ndryshimet kohore për shkak të situatave të ndryshme që ka kaluar shoqëria njerëzore dhe konceptin hegjemonist brenda vetë shoqërisë njerëzore, ka ardhur deri tek revidimi i tërësishëm i drejtësisë dhe të drejtës natyrore. Kjo është manifestuar me shkatërrime dhe dëmtim të skajshëm shoqëror.

Andaj, bota e gjetur para një rreziku të tillë, duke ditur se, vlera themelore është njeriu dhe vetë shoqëria njerëzore, pas luftës së dytë botërore, aprovoi Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, 19 dhjetor, viti 1948. Nga aspekti i këtij punimi, ajo që e karakterizon preambullën e kesaj Deklarate janë dy parime të njëkohësishme, njeriu dhe shoqëria njerëzore. "Njohja e dinitetit të lindur të të drjetave të barabarta dhe nxitja e marrëdhënieve miqësore në mes të kombeve "përbëjnë lidhmërinë dhe harmoninë detyruese në mes të shoqërisë njerëzore dhe anëtarëve të kësaj shoqërie. Ajo që e karakterizon Deklaratën Universale, është bazueshmëria në Kartën e OKB gjë që, vetë deklaratës i jep konotacion shoqëror dhe ashtu si e tillë, të drejtat njerëzore shndërrohen në të drejta të grupeve shoqërore.¹⁹²

Nëse të gjithëlindin të lirë dhe të barabartë dhe se, askush askujt nuk mund dhe nuk duhet t'ia cenojë të drejtat e përcaktuara me këtë deklaratë përfshirë faktin se të gjithë janë të barabartë në çdo porë të pushtetit shtetëror.¹⁹³

Ky domen shoqëror, vërehet menjëherë tek neni 21 i Deklaratës ku vullneti i popullit është baza e pushtetit shtetëror i cili pushtet ekskluzivisht varet nga vetë grupet shoqërore që janë faktor determinues për ushtrimin e pushtetit shtetëror. Deklarata, me tutje thekson domosdoshmerinë në të drejtën e sigurimit shoqëror dhe realizimit të të drejtave ekonomike, sociale, kulturore të domosdoshme për jetë të dinjitetshme dhe për zhvillimin e lirë të personalitetit, me ndihmën e shtetit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në përputhje me organizimin dhe mundësitë e çdo shteti. Kur themi me ndihmën e shtetit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, kjo d.m.th. se shoqëria pjesë e së cilës janë grupet shoqërore, janë kyçe në funksionalizimin e vetë të drejtave të njeriut dhe mbrojtja e tyre nga çfarëdo lloji abuzimi i atyre të drejtave që nënkupton faktin se, grupet shoqërore janë garancioni i vetëm i respektimit të të drejtave individuale.

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, padyshim se, individin e ngrit në nivelin "Sui generis" dhe të drejtat e tij e kanë burimin në të drejtën natyrore.¹⁹⁴ Deklarata e Kajros për të

¹⁹⁰ http://www.see-educoop.net/education_in/pdf/dad-alb-aln-t03 / mensche_nrechte/ grundkurs_mr2 / Naturrecht/naturrecht.htm

¹⁹¹ Nxjerrë nga: Bertelsmann Discovery Lexikon

¹⁹² Preambulla e Deklarates Universale Per te Drejtat e Njeriut

¹⁹³ Po aty, nenet 1-7

¹⁹⁴ Po aty nenet , 5,7 dhe 21 te Deklaratës Universale për të drejtat e Njeriut

Drejtat në Islam, burimin e të drejtave natyrore të individit e ka në të drejtën hyjnore atë që është dhuratë nga Zoti.¹⁹⁵

Ky dallim vërehet përse i përket realizimit të të drejtave politike dhe civile në shoqëri, njëkohësisht edhe mbrojtjes së tyre nga shteti. Deklarata e Kajros, padiskutim, të drejtën për jetë ven si kulm i të drejtave, e cila është e dhënë nga Zoti, në këtë frymë, ka përcaktuar edhe ligjin absolut –Sheriatin i cili përmes rregullave të përhershme, specifikon lëminë e të drejtave të cilat, nuk tejkalojnë Kuranin dhe Sheriatin.

Nenet 24 dhe 25 ia nënshtrojnë të gjitha të drejtat dhe liritë të përcaktuara në deklaratën e Kajros shariat-it si burimi i vetëm kompetent për interpretimin ose shpjegimin e secilit nen të kësaj deklaratë. Kjo shpreh kufizimet përse i përket thyerjes së rregullave absolute të përcaktuara nga Krijuesi i gjithësisë .Esenca e tërë kësaj është se, të drejtat e njeriut, duke mos u përkufizuar, shumë here keqpërdoren , nga grupet shoqërore e madja, edhe nga vetë njeiru, duke mos qenë i vetëdijshëm vetë njeriu e mëpas edhe nga grupet shoqëror.¹⁹⁶

GLOBALIZIMI DHE DEMOKRACIA

Globalizmi si rend botëror bazohet në vlerat e demokracisë liberale, e lidhur më së shumti me dy faktorë: njeriun - individin dhe kapitalin. Individu konsiderohet si tezë e vlerësimit material nga të cilët, shihet formimi i kulturës që nxit shkallën e gatishmërisë për ndryshime. Në teori, kjo d.m.th. se, çdo shoqëri duket ti kultivojë vlerat kulturore bashkarisht. Megjithatë, vlerësimi i individit sipas fuqisë së tij materiale (vlera tregtare që nënkupton atë se çka pjesëmarrësit në treg kanë vullnet ti paguajnë njëri - tjetrit), nënkupton vështirësinë e globalizimit për tia arritur qëllimit që të shndërrohet në ide të përgjithshme.¹⁹⁷

Nisur nga principet e globalizimit e bazuar në neoliberalizëm kapitalist, në rrafshin e dallimeve individ dhe grupe shoqërore, përpos faktorëve politik, juridik, shoqëror etj. një faktor shtytës dhe shumë i rëndësishëm që evidenton domosdoshmërinë e lidhshmërisë individ - grupe shoqërore sot, është faktori ekonomik. Ndarja ekonomike e botës pas viteve të 90, padiskutim, ka krijuar vetëm dy shtresa: pakicën e pasur dhe shumicën e varfër. Tani janë tri institucione kryesore: FMN, Banka Botërore dhe Organizata Botërore e Tregtisë.¹⁹⁸

Në frymën e zhvillimeve globale, hendeku i dallimeve në mes të individit dhe grupeve shoqërore është shprehur edhe në frymën e e konflikteve ekonomike, sociale e politke të cilat, qyshë më pare janë mbishtresuar nga kundërshtitë etnike, gjuhësore, fetare e kulturore.Në Evropën e sotme, kjo manifestohet ndaj të huajve dhe azilantëve.Si rezultat i këtyre dallimeve, është në zbehje e sipër autoriteti shtetëror mu për shkak të paqartësisë (dallimeve) në strukturat e shoqërisë.¹⁹⁹

¹⁹⁵Deklarata e Kajros për të Drejtat në Islam. Deklarata e Kajros për të drejtat e njeriut në islam është një deklaratë e ratifikuar në vitin 1990 nga shtetet anëtare të Organizatës së Konferencës Islamike, e cila e përcakton shari'an si bazë të vetme për "të drejtat e njeriut". Kjo deklaratë shihet nga apologjetët islamikë si e kundërta e Deklaratës së Përgjithshme të të Drejtave të Njeriut, nga e cila ajo devijon në mënyrë të konsiderueshme. Këshilli i ligës së shteteve arabe ka ratifikuar më vete në shtator 1994 një Kartë Arabe të të Drejtave të Njeriut dhe në janar 2004 një version të përpunuar të saj.

¹⁹⁶Deklarata e Kajros për të drejtat e njeriut në islam nenet, 24-25. Deklarata e Kajros për të drejtat e njeriut në islam, Neni 24 përcakton: "Të gjitha të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë deklaratë janë të nënrenduara shari'as islame".

¹⁹⁷Jasna Plevnik, Pas globalizmit, Gjeoekonomia e marredhenieve nderkombetare, K.U."VICTORY", Prishtine, 2003, fq 62-78.

¹⁹⁸Stiglitz E., Joseph, Globalizmi dhe pakenaqesite e shkaktuara prej tij, K.U."VICTORY", Prishtine, 2007, fq.29-42

¹⁹⁹Urs Altermatt, Etnonacionalizmi ne Evropë, Shtëpia e librit dhe komunikimit,Tiranë,2002, fq. 162-168.

PERFUNDIMI

Respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut në epokën e modernizmit të sotëm, konsideroj se nuk mund të ndahet nga të drejtat e grupeve shoqërore. Nëse të drejtat e njeriut ishin problem serioz i viteve të 90 ta, tanimë në rafshin shoqëror e global, kjo kërkon një përkushtim më të theksuar në drejtim të shoqërorizimit të njerëzimit në frymën e zhvillimeve të reja.

Pikërisht, demokracia liberale si ideologji e rendit të sotëm botëror, ka thelluar akoma më shumë dallimin brenda vetë shoqërisë njerëzore. Demokracia, është shoqëri shumëgrupesh kurse, individualizmi, sot është parim themelor i klasës politike perëndimore. Kjo lë të kuptohet se, shoqëria njerëzore gjithnjë e më shumë polarizohet dhe mbi këtë bazë, antagonizmat bëhen më të theksuar nga të cilët, shkaktohen luftëra me përmasa shkatërruese.

Shtrohet pyetja: Nëse në epokën në të cilën sot ne po jetojmë a duhet që çështja shoqërore të bëhet çështje botërore?

Ngjashmëra në domethënje në mes të demokracisë sot dhe, diktaturës së proletariatit ekziston në fushën e domethënies së tyre por, edhe në të zbatuarit të tyre në periudha kohore të caktuara. Po ti referohemi diktaturës së proletariatit, ashtu sic propagonte Socializmi, kjo d.m.th. se, sundimi i përkiste shumicës që realisht ishte shumicë klasa punëtore anipse, ishte vënë në shërbim të klasës komuniste dhe furnizonte dhe mbante klasën komuniste realisht, demokracia si ideologji e shekullit XXI, në esencë proklamonte sundimin e shumicës – popullit e që ky sundim shpeshherë shpërdorohet. Megjithatë, demokracia shihet si avancim i të drejtave njerëzore e njohur në teorinë dhe praktikën shkencore si "diktaturë demokratike". Nëse Brajsi, theksonte se demokracia në radhë të parë është koncept politik dhe se demokracia amerikane karakterizohet si "nje barazi vlerësimi", Tokëvili në librin e tij "De la democratie es Amerique" në vitin 1831 kur kishte vizituar Amerikën ishte befusuar nga gjendja e shoqërisë amerikane të cilën, evropianët nuk e njihin. Prandaj, konsideroj se demokracia sikurse edhe ideologjitë tjera është çështje e arsitokracisë e pandashme me të drejtat dhe liritë shoqërore.

REKOMANDIME

Nisur nga rrjedha e tërësishme globale, fakti se koncepti I të drejtave dhe lirive të njeriut është e formësuar, është e nevojshme që:

1. Harmonizimi i të drejtave të dhe lirive të njeriut dhe grupeve shoqërore me qëllim të evitimit të evitimit të ndasive shoqërore ;
2. Koncepti i shtetit qytetar dhe hartimi i legjislacionit vendor sipas parimit , të gjithë janë të njëjtë me cka eliminon privilegjimin e individit apo grupimeve të caktuara brenda shtetit që prodhon dallime politike, etnike e racore brenda vetë shoqërisë;
3. Afirmimi i Kartës së OKB në njohjen e të drejtave të grupeve shoqërore duke refuzuar krijimin e enklavave politike brenda territorit të një shteti dhe
4. Vetëdijesimi global për nevojën e ndarjes së të mirave shoqërore në proporcion me nevojat shoqërore duke zbutur dallimin e madh që ekziston sot dhe afirmimin e klasës së mesme shoqërore.

REFERENCA

- Gjovani Sartori, Çështë Demokracia, shtëpia botuese, Dituria, Tiranë, 1998, fq. 8-11.
- Bulac, Ali, fq. 41 – 46.
- Demokracia Kristiane: Parime dhe politikëbërje, Manual për Bashkëpunim Evropian dhe Ndërkombëtar të Fondacionit Konrad Adenauer, botues Fondacioni Konrad Adenauer.
- Termi Evangjelizëm është përdorur qysh në shekullin XVI-të nga shkrimtarët katolikë duke u kthyer me dëshirë shumë besimtarëve Biblikë praktikë që i shoqëronin ata në kishën e hershme mesjetare. Ky term veçanërisht është përdorur në vitin 1520, ku termi Evangjelic në gjermanisht do të thotë Evangelisch, në Gjermani vjen dhe dallohet në polemikën e shkrimtarëve të reformës së hershme. Tashmë ky term është i përdorur gjërsisht duke ju referuar prirjes transdimesionale në teologji dhe spirirtualizëm, e cila veçanërisht lidh theksimin e shkrimeve të shenjta në jetën Kristiane.
- Martin Kriele, Befreiung und politische Aufklärung. Plädoyer für die Würde des Menschen, Freiburg 1980, 49.
- Hans Georg Gadamer, Die Menschenwürde auf ihrem Weg von der Antike bis heute, Stuttgart 1988, 96.
- Million – Delsol, Chantal. “Idetë politike të shekullit XX –të”, Onufri, Tiranë, 2000, fq. 283.
- Bulaç, Ali, Din ve Modernizm (Feja dhe modernizmi), Stamboll, 1993.
- Dr. Vërbani, Musli, Ixhtihati, Kacanik, 2012. Ixhtihadi është bazë prej bazave të Usuli Fikhut dhe planprogram Islam. Usuli Fikhu konsiderohet si sinonim i kësaj shkence. Imam Raziu Usuli Fikhun e përkufizon kështu:
 - Studim dhe analizë e argumenteve të fikhut në përgjithësi - kjo është baza e parë;
 - 2. Mënyrë e përpunimit dhe e përfundimit (konkluzionit) prej argumenteve - kjo është baza e dytë;
 - Studim dhe elaborim i sërishëm pas përfundimit (konkluzionit) - kjo është baza e tretë. Për këtë arsye kjo shkencë titullohet në shumës dhe jo në njëjës “Bazat e bazave”. Nga kjo që përmendëm më lart kuptohet se Usuli Fikhu merret me studimin e Burimeve të studimit dhe konkludimit prej atij studimi, pra merret me studimin e rrugëve të studimit, kushteve të studimit, dhe kjo është ajo, siç e quajnë perëndimorët, si Rogjer Bekoni, e të tjerët - thelb i shkencave, program shkencor në shkencë, ndërsa tek muslimanët është program shkencor i shkencave të tyre.
- Krh. Gjon Pali II, Let. enc. *Sollicitudo rei socialis* (30 dhjetor 1987), 6-7: AAS 80 (1988), 517-519.

- Letra Enciklike Caritas In Veritate e Atit te Shenjtë Benedikti i XVI drejtuar Ipeshkvijve Presbiterëve dhe Diakonëve, personave të kushtuar Zotit, besimtarëve laikë dhe të gjithë njerëzve vullnetmirë mbi zhvillimin e tërësishëm njerëzor në të vërtetë dhe në dashuri.
- Krh. Let. enc. Populorum progressio, 3: l.c., 258.
- http://www.see-educoop.net/education_in/pdf/dad-alb-aln-t03 / mensche_nrechte/grundkurs_mr2 / Naturrecht/naturrecht.htm
- Nxjerrë nga: Bertelsmann Discovery Lexikon.
- Preambulla e Deklarates Universale Per te Drejtat e Njeriut.
- Po aty, nenet 1-7.
- Po aty nenet , 5,7 dhe 21 te Deklaratës Universale për të drejtat e Njeriut.
- Deklarata e Kajros për të Drejtat në Islam. Deklarata e Kajros për të drejtat e njeriut në islam është një deklaratë e ratifikuar në vitin 1990 nga shtetet anëtare të Organizatës së Konferencës Islamike, e cila e përcakton shari'an si bazë të vetme për “të drejtat e njeriut”. Kjo deklaratë shihet nga apologetët islamikë si e kundërta e Deklaratës së Përgjithshme të të Drejtave të Njeriut, nga e cila ajo devijon në mënyrë të konsiderueshme. Këshilli i ligës së shteteve arabe ka ratifikuar më vete në shtator 1994 një Kartë Arabe të të Drejtave të Njeriut dhe në janar 2004 një version të përpunuar të saj.
- Deklarata e Kajros për të drejtat e njeriut në islam nenet, 24-25. Deklarata e Kajros për të drejtat e njeriut në islam, Neni 24 përcakton: “Të gjitha të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë deklaratë janë të nënrenduara shari’as islame”.
- Jasna Plevnik, Pas globalizmit, Gjeoekonomia e marrëdhënieve nderkombetare, K.U.”VICTORY”, Prishtine, 2003, fq 62-78.
- Stiglitz E., Joseph, Globalizmi dhe pakenaqesite e shkaktuara prej tij, K.U.”VICTORY”, Prishtine, 2007, fq.29-42
- Urs Altermatt, Etnonacionalizmi ne Evropë, Shtëpia e librit dhe komunikimit, Tiranë, 2002, fq. 162-168.

SFIDAT E KOSOVËS DREJT RRUGËS SË INTEGRIMIT EKONOMIK. POLITIKAT TREGTARE TË KOSOVËS DREJT RRIJES EKONOMIKE

Përkufizimi i problemit

Integrimet ndërkombëtare paraqesin një rrethinë nxitëse për zhvillimin ekonomik të çdo vendi ngase mundësojnë transferin e kapitalit, teknologjisë, specializimin etj. Janë edhe arsytet politike të integrameve ekonomike ngase bashkëpunimi ekonomik nxit bashkëpunimin politik si dhe shmangë mosmarrëveshjet eventuale ndërshtetërore.

Gadishulli ballkanik ka qenë historikisht regjion i mosmarrëveshjeve politike. Ndryshimet e thella politike dhe ekonomike gjatë tranzicionit edhe më tepër i kanë shtuar nevojat për procese integruese. Nga zhvillimi i deritanishëm i ekonomisë botërore mund të shihet se vendet që zbatojnë politikat e zhvillimit të marrëdhënive ndërkombëtare dallohen për zhvillim të shpejtuar ekonomik, për hapje të vendeve të reja të punës etj. Edhe vendet ballkanike, pas një periudhe të konflikteve dhe shkatërrimeve nga luftërat dhe izolimet, synojnë proceset integruese si mundësi për ta kapërcyer ngecjen ekonomike.

Kohët e fundit është folur shumë për tregtinë e jashtme dhe për CEFTA-n dhe ndikimin e tyre në zhvillimin ekonomik të vendeve. Përgjithësisht, diskutimet janë përqendruar në aspekte të shkëputura të CEFTA-s, sidomos në liberalizimin e tarifave doganore me vendet e rajonit. Mirëpo, në të vërtetë, duke qenë një marrëveshje me një natyrë shumëdimensionale, CEFTA është shumë më tepër sesa, thjesht, një marrëveshje për tarifat doganore. Në këtë aspekt, është shumë e rëndësishme që CEFTA të shihet në një kontekst më të gjerë dhe nga këndvështrime të ndryshme, ku më kryesori për ne është këndvështrimi politik në mënyrë që të kuptohet për atë çfarë ajo është në të vërtetë.

Gjithashtu analizimi i infrastrukturës ligjore që e rregullon tregtinë e jashtme të Kosovës është e rëndësishme së veçantë prandaj edhe do të jetë pjesë e studimit tim. Prandaj duke ofruar analizën statistikore mbi pjesëmarrjen e eksporteve dhe importeve në të ardhurat e tregtisë së jashtme dhe një shpjegim mbi barrierat dhe problemet me të cilat po ballafaqohet komuniteti i biznesit për plasmanin e produkteve të tyre jashtë vendit do i afrohem qëllimit për të gjykuar se kur dhe çfarë masash duhet të ndërmarrin institucionet qeveritare dhe joqeveritare për të krijuar lehtësira në eksport dhe treg konkurrues në Kosovë për të ulur deficitin tregtar që është i lartë që nga paslufta dhe kështu të ndikoj në zhvillimin ekonomik të vendit tonë.

Qëllimet dhe objekti i studimit

Në rrugën e gjatë dhe të vështirë të shtetndërtimit dhe konsolidimit ekonomik, ndër prioritetet kryesore të Kosovës janë edhe zhvillimi ekonomik dhe perspektiva evropiane. Menjëherë pas shpalljes së pavarësisë, udhëheqësia dhe populli shqiptar i Kosovës dëshmoi vullnetin e tij në rrugën e integritimeve evropiane si e vetmja alternativë për një shtet stabil, mirëqenie ekonomiko-sociale dhe paqe në rajon. Përkundër obstrukcioneve të shumta, Kosova me ndihmën e miqve të saj ndërkombëtar arriti të anëtarësohet në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Bankën Botërore.

Këto janë arritje të mëdha, që krahas njohjeve nga shtetet tjera, e bëjnë Kosovën subjekt të njohur ndërkombëtar. Një ndër sfidat kryesore të Kosovës është edhe integrimi i saj në iniciativat dhe bashkëpunimet rajonale, në veçanti në fushën e tregtisë.

Qëllimi themelor i këtij punimi masteri është paraqitja e gjendjes aktuale të tregtisë së jashtme të Kosovës dhe ndikimit të saj në zhvillim ekonomik, identifikimi i problemeve, pengesave dhe barrierave që ngulfasin tregun e lirë rajonal dhe më gjërë, duke identifikuar njëkohësisht nevojat dhe kërkesat për përmirësimin e gjendjes, avancimin e proceseve zhvillimore dhe zhvillimin e trendëve pozitive në aspektin strategjik.

Qëllimi tjetër i këtij hulumtimi është të nxjerrë rezultate të rëndësishme për shkallën e shkëmbimeve tregtare të Kosovës me vendet tjera, strukturën, problemet, vështirësitë dhe për të matur ndikimin e tregtisë së jashtme në zhvillimin ekonomik të vendit tonë, dhe për të dhënë rekomandime mbi mundësinë e krijimit të lehtësirave tregtare në favor të mbështetjes së zhvillimit të bizneseve të vendit tonë nga ana e institucioneve qendrore dhe lokale.

Metodat e studimit

Gjatë punimit janë përdorur dhe zbatuar metoda të ndryshme shkencore siç janë: Metoda e trajtimit historiko-zhvillimor të marrëdhënieve ndërkombëtare me theks të veçantë në tregtinë mes vendeve, Metodën e analizës përmes së cilës kam analizuar politikën tregtare të Kosovës, gjendjen e bilancit tregtar dhe fushat në të cilat institucionet qendrore dhe lokale mund të ndikojnë në përmirësimin e bilancit tregtar të vendit tonë, Metodën e hulumtimit, përmes së cilit në mënyrë tabelare dhe statistikore kam prezantuar dinamikën dhe strukturën ekonomike të Kosovës, ndikimin e marrëveshjes CEFTA në ekonominë e Kosovës dhe ndikimin që mund të ketë eksporti dhe importi në zhvillimin ekonomik të vendit tonë, Metodën teknike, në përputhje me rregulloren për punimin e diplomës, dhe metodën e konsultimeve, rekomandime dhe mbështetje nga mentori.

Rëndësia teorike dhe praktike e punimit

Arsyet që më kanë shtyrë në zgjedhjen e kësaj teze janë të shumta por mund të veçoj disa prej tyre, të renditura si më poshtë:

- Rritja e eksporteve si komponent thelbësor i zhvillimit ekonomik;
- Përmirësimi i infrastrukturës ligjore për lehtësimin e tregtisë së jashtme për bizneset që zakonisht janë burim i konsiderueshëm punësimi dhe ndihmojnë në stimulimin e novacionit, dinamizmit ekonomik dhe konkurrencës.
- Analiza e pengesave dhe vështirësive për zhvillimin e tregtisë së jashtme që ofrojnë mundësinë e krijimit dhe hulumtimit të metodave dhe metodologjive për mbështetjen e tyre;
- Të dhënat makroekonomike dhe sektoriale të kombinuara me rezultatet e anketimit, të cilat do të paraqes në këtë punim mund të jenë udhërrëfyese për caktimin e prioriteteve të strategjive të përkrahjes dhe për orientimin e politikave që e ndihmojnë arritjen e misionit për rritjen e eksportit dhe uljen e deficitit tregtar të cilat do të kishin efekte të menjëhershme në zhvillimin ekonomik të vendit tonë.

Ndikimi i zhvillimit të tregtisë së jashtme në ekonominë e Kosovës

Të dhënat e shkëmbimeve tregtare në tri vitet e fundit do të shërbej për të analizuar rritjen ekonomike dhe zhvillimin e tregtisë së jashtme së Kosovës me vendet tjera, si ato në rajon ashtu edhe me gjithë vendet tjera²⁰⁰.

Sipas këtyre analizave del se Kosova vazhdon të ketë probleme serioze me deficitin tregtar. Eksportet vazhdojnë të jenë simbolike përball importeve të larta. Ky deficit është rritur nga 1.77 milion euro sa ishte në vitin 2009 në 1.85 milion në vitin 2010, dhe vazhdon të ketë trend të njëjtë rritës edhe për vitin 2011. Në terma relativ rritja vjetore e deficitit tregtar është 4.6%. Pjesëmarrja e deficitit tregtar në BPV në vitin 2010 ka pësuar rënie të lehtë nga 45.8 % sa ishte në 2009 në 45.0 %.

²⁰⁰ Igballe Rexha - Jashari, MTI, "Rritja ekonomike dhe zhvillimi i tregtisë së jashtme", Konferenca e dhjetë ndërkombëtare "Biznesi dhe Punësimi", Instituti i Financave i Kosovës – IFK, Prishtinë, Tetor 2011.

Bazuar në raportin e Bankës Qendrore, rritja vjetore e çmimeve të derivateve të naftës në tregjet ndërkombëtare prej 25% ka ndikuar në rritjen e produkteve të importuara. Edhe pse ka pasur një rritje relativisht të lartë të eksporteve në raportin eksport/import, të cilat janë rritur nga një bazë shumë e ulët por duket të jetë larg nga korigjimi i jobalanceve tregtarë ekonomik. Niveli (i ulët) dhe struktura e tregtisë së jashtme duket se tregon konkurrencë të ulët të produkteve kosovare edhe në tregun e brendshëm dhe atë të jashtëm.

Një disbalanc i tillë tregtar në rritje vazhdon të jetë shqetësues për Kosovën. Mosaftësia e zëvendësimit të importit me produkte vendore ka ndikuar mjaft në rritjen e hendekut.

Eksporti në vendet e CEFTA-s në vitin 2010 ka pësuar rënie krahasuar me atë të vitit të kaluar. Në vitin 2009, 32.4% të eksportit të përgjithshëm të Kosovës është realizuar në vendet anëtare të CEFTA-s, ndërsa në vitin 2010 këto eksporte kanë rënë në 24.1%²⁰¹. Vendet e CEFTA-s në të cilat Kosova ka eksportuar më së shumti në vitin 2010 kanë qenë Shqipëria dhe Maqedonia me 11% respektivisht 8.9%.

Në anën tjetër, në vitin 2010, importi nga këto vende vetëm sa është rritur në krahasim me vitin 2009. Sipas Doganave të Kosovës (2011), Kosova në vitin 2010 krahasuar me vitin 2009 ka importuar rreth 22% më shumë nga Serbia dhe rreth 39% më shumë nga Bosnia dhe Hercegovina²⁰². Trendi i njëjtë ka vazhduar edhe në gjashtëmujorin e parë të vitit 2011.

Në muajin korrik të vitit 2011 Kosova ka vendosur t'i aplikoj masat e reciprocitet karshi Serbisë dhe Bosnje Hercegovinës. Për të parën herë, qeveria e Kosovës vendosi që t'ia ndalojë importin e të gjitha produkteve, ndërsa për të dytën vendosi që të aplikojë një taksë doganore prej 10%. Vënia e masave të reciprocitetit nuk reflektoi me ndonjë çrregullim ekonomik në Kosovë. Përkundrazi, Kosova arriti ti zëvendësojë produktet serbe me ato të vendeve fqinje. Ndonëse mbyllja tregtare nuk është në frymën e integritimeve evropiane, zgjidhja e problemit kërkon kompromis të dyanshëm.

²⁰¹ Iniciativa për Progres (INPO), Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Instituti për Hulumtime Zhvillimore (RIINVEST), Klubi për Politikë të Jashtme (KPJ), Lëvizja FOL, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) dhe Nisma e të Rinjve për të Drejta të Njeriut (YIHR); "Raporti i Progresit – made in Kosova 2011", Prishtinë, Tetor 2011.

²⁰² Doganat e Kosoves (2011), Raporti vjetor 2010, http://dogana.rks-gov.net/Uploads/Documents/Raporti_Vjetor_2010.pdf

Masat tregtare preferenciale të BE-së

Me përmirësimin e tregjeve në Bashkimin Evropian në vitin 2010 u rriten edhe eksportet Kosovës në vendet e këtij unioni. Sipas raportit të Bankës Qendrore, në 2010 eksporti i produkteve në vendet e Bashkimit Evropian është rritur në 44.7% krahasuar me 43.1 në vitin 2008²⁰³. Megjithatë, nga fillimi i vitit 2011, Kosova mbetet vendi i vetëm në rajon pa preferenca tregtare me BE-në. Heqja e preferencave tregtare për Kosovën nga BE-ja ka qenë një goditje e rëndë ekonomike për eksportet simbolike të Kosovës.

Përspektiva e zhvillimit të tregtisë së jashtme në kuadër të strategjisë së zhvillimit ekonomik të Kosovës

Politikat afatshkurta

Disa nga masat afatshkurta përfshijnë refondimin dhe përjashtimin nga pagesa e tarifave doganore si dhe skemat për financim të eksportit dhe të stimulimeve. Nga aspekti i politikës zhvillimore të lidhur me tregtinë, ekzistojnë mundësi për përdorimin e zbritjes për amortizim të përshpejtuar si dhe të mekanizmave tjerë, p.sh. në politikën industriale.

Në mënyrë më specifike, programi do të fokusohet në²⁰⁴:

- Identifikimin e masave të politikës fiskale dhe industriale për t'i dhënë shtytje eksportit me synim të rritjes së kualitetit dhe kuantitetit të punësimit në afat të shkurtë. Këto masa mund të përfshijnë ide inovative (të bazuara edhe në përvojat e vendeve tjera) për skemat e promovimit të eksportit për sektorët ekzistues, financimin dhe nxitjet e eksportit, dhe opsionet e politikave sektoriale të bujqësisë, industrisë dhe shërbimeve siç është zbritja e

²⁰³ Banka Qendrore e Kosovës (BQK) 2011, Raporti vjetor 2010, <http://bqk-kos.org/repository/docs/2011/Raporti%20Vjetor%202010.PDF>

²⁰⁴ Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, "Politika tregtare e Kosovës", Qeveria e Kosovës, Prishtinë, Gusht 2009.

amortizimit të përshpejtuar (për industrinë). Një platformë e makro politikave lidhur me tregtinë e cila do të ishte më e favorshme për promovimin e eksportit si dhe të komplementaritetit të tij (siç janë politikat alternative të menaxhimit të kërkesës) duhet gjithashtu të konsiderohet. Këto alternativa makro synojnë përmirësimin e konkurrueshmërisë së sektorit të jashtëm.

- Masat fiskale dhe masat e tjera për menaxhimin e importeve me synim të promovimit të mëtejshëm të eksportit. Kjo duhet të përfshijë analizat dhe rivlerësimin e përvajave me rikthimin të tarifave doganore bazuar në përvajat e vendeve tjera. Kjo duhet gjithashtu të përfshijë mjete inovative siç janë linjat kreditore të lehta për t'iu qasur, të cilat lehtësojnë transaksionet ndërmjet blerësve ndërkombëtarë dhe shitësve.

Politikat afatmesme

Kosova duhet të tejkaloj disa çështje të rëndësishme të lidhura me infrastrukturën e tregtisë (lehtësimi i tregtisë) dhe koston e të bërit biznes. Përderisa disa nga çështjet infrastrukturore mund adresohen vetëm në afat të gjatë, është vlerësim i përgjithshëm brenda MTI-së se shumica e këtyre çështjeve mund të adresohen brenda një periudhe afatmesme kohore. Rrjedhimisht, disa veprime të propozuara mund të përfshijnë²⁰⁵:

- Identifikimin e masave për krijimin e një fushe të veprimit të barabartë për aktorët në treg, si për eksportuesit komercial ashtu edhe ata industrial në Kosovë. Kjo përfshin identifikimin dhe propozimet për eliminimin e pengesave ekzistuese dhe atyre të ardhshme për bërjen biznes të eksportuesëve Kosovar (në të gjithë sektorët e këmbimit) konkurrent në tregun e jashtëm. Kjo duhet të fokusohet jo vetëm në eksport dhe eksportues por edhe në import në përgjithsi. Qasja më e lehtë në lendët e para dhe në të mirat kapitale të ndërmjeme të importuara është esenciale. Kjo gjithashtu do të ndihmojë lehtësimin e presioneve të mundshme në sektorët vendorë (të tregtueshëm dhe jo të

²⁰⁵ Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, “Shkëmbimet tregtare të Kosovës”, Qeveria e Kosovës, Prishtinë, Korrik 2009.

tregtueshëm) pas anëtarësimit në OBT. Kjo kërkon identifikimin e kostos së kapitalit (dhe kostos së bërjes biznes në përgjithësi) sipas kërkesave të regjimit tregtar dhe përfshirjen e masave për zvogëlimin e kostos së bërjes biznes në Kosovë. Njësoj me rëndësi, kjo duhet t'i adresojë pyetjet që kanë të bëjnë me infrastrukturën tregtare, prodhuese dhe financiare (të përgjithshme dhe sektoriale) dhe të identifikoj fushat në të cilat vendi ka mungesë të infrastrukturës si dhe të vij me propozime operationale. Në fushën e sektorit financiar, rëndësia e zhvillimit të tregut afatgjatë të kapitalit për përmirësimin e konkurrueshmërisë në sektorët kyq dhe lehtësimit të investimeve shpesh (për modernizim) është shumë e madhe. Më tutje, duhet të adresohen çështjet e lidhura me qasjen në kredi të NVM-ve të orientuara në eksport. Ristrukturimi në disa nga këta sektorë do të jetë i domosdoshëm dhe kjo mund të bazohet në përvojën e vendeve të tjera. Aktivitetet gjithashtu duhet të prekin mbi çështjet e kontrollit të kualitetit dhe masave Sanitare dhe Fitosanitare dhe qështjet e barrierave teknike në tregti, si dhe çështjet që janë të lidhura me lehtësimin e tregtisë; mekanizmave për krijimin e nxitjeve apo stimujve, transferit të duhur teknologjik si dhe të praktikave më të mira. Transferi i duhur teknologjik apo gjenerimi teknologjik është posaçërisht i rëndësishme si aktivitet afatmesëm. Lloji i transferit teknologjik i nevojshëm për rritjen e konkurrueshmërisë në Kosovë do të duhet gjithashtu të marrë parasysh brengat për krijimin e mundësive të barabarta dhe të qëndrueshme të punësimit. Lloji i transferit teknologjik dhe/ose kërkesat për hulumtim dhe zhvillim gjithashtu do të përcaktohen sipas nevojave dhe strukturës sektoriale.

- Identifikimi i tregjeve të reja dhe atyre në tranzicion për eksportet Kosovare. Ky aktivitet do të duhet të përfshij identifikimin e modeleve të reja dhe atyre në tranzicion të marrëveshjeve tregtare, përfshirë hulumtimin e opsioneve regjionale dhe bilaterale dhe tregjeve për promovimin afatshkurtër dhe afatmesëm të eksportit. Mundësitë e politikave të ndryshme tregtare (afatmesme) që varen nga mjedisi rajonal dhe ai i vendit gjithashtu duhet të hulumtohen. Përfundimisht, duhet të eksploroohen mundësitë për marketingun e jashtëm dhe aktivitetet për ndërtim të imazhit, siç janë përfaqësitë për shitje me pakicë, përfaqësitë tregtare dhe qendrat e biznesit.

Politikat afatgjata

Si shtesë të këtyre aktiviteteve afatshkurta dhe afatmesme, ekziston nevoja për formulimin e opsioneve të politikave të cilat do të adresonin problemet përgjatë një periudhe afatgjate. Aktivitetet afatgjata duhet kryesisht të fokusohen në aspektet e investimeve vendore të orientuara në eksport (përmes investimeve të përbashkëta të cilat garantojnë transferin e duhur teknologjik në varshmëri nga sektori ekonomik). Gjithashtu duke pasur parasysh përparësitë e mëdha demografike, duhet të eksplorohej edhe mundësitë siç është transferimi i një pjese të aktivitetit te firmat tjera të cilat mund ta realizojnë aktivitetin/et e caktuar/a në mënyrë më efikase (proces ky i njohur si *outsourcing*).

*Disa nga hapat e propozuar përfshijnë*²⁰⁶:

- Identifikimin dhe aplikimin e skemave për rritje të efikasitetit (si ato të marketingut dhe prodhuesve) në grupet themelore të sektorëve (ekzistues) të eksportit. Ky aktivitet i politikave do të kërkonte përdorimin e vlerësimit të nevojave sektoriale dhe nën-sektoriale dhe zhvillimin e opsioneve të politikave në nivelin mikro. Gjithashtu duhet të ketë fokus të qartë NVM-të. Kjo do të përfshinte poashtu propozimet mbi skemat trajnuese për ndërmarrësit, menaxherët dhe punëtorët (si mbi OBT-në gjithashtu edhe mbi çështjet specifike sektoriale).
- Identifikimi i sektorëve zhvillimorë shtesë me qëllim të diversifikimit të eksportit të qëndrueshëm dhe të orientuar në punësim, i cili si rrjedhojë kërkon identifikimin e sektorëve ku vendi ka përparësi dinamike konkurruese dhe krahasuese. Puna aktuale e APIK-ut duhet të përkrahet dhe zgjerohet me një program i cili do të bëjë analiza të thella të përparësive dinamike (dhe statike) konkurruese dhe krahasuese dhe identifikojë sektorët të cilët kanë potencial dhe rritje të qëndrueshme të eksportit. Praktika duhet poashtu të krijojë masa për krijimin dhe implementimin e skemave nxitëse dhe mbrojtëse në këto fusha ashtu që sektorët e identifikuar të mund të operacionalizohen shpejtë dhe të jenë të

²⁰⁶ Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, “Politika tregtare e Kosovës”, Qeveria e Kosovës, Prishtinë, Gusht 2009.

gatshëm për t'u ballafaquar me konkurrencën e jashtme (përfshirë skemat efikase të marketingut dhe produktivitetit, të modeluara sipas përvojave të vendeve tjera). Skemat stimuluuese duhet të jenë selektive dhe saktësisht të precizuara në kohë sipas specifikave sektoriale. Skemat e trajnimit për punëtorë, (të cilat gjithashtu duhet të ngriten në afat të mesëm), do të përfshijnë skemat trajnuese profesionale për punëtorët (e punësuar dhe potencial) në fushat alternative të diversifikimit të eksportit. Zhvillimi dhe aplikimi i trajnimit dhe ritrajnimit dhe skemat për përmirësimin e prodhimit dhe efikasitetit si për formimin e kapitalit ekzistues ashtu edhe për industrinë e reja duhet të zënë vend si pjesë e aktiviteteve afatgjata të politikave. Më tutje, pilotimi i sektorëve potencial dhe skemave nxitëse poashtu duhet të zërë vend.

Stimulimi dhe promovimi i rritjes së eksportit në Kosovë

Pavarësisht nga sa pamë më sipër, fakti që vendi ka mundur të eksportojë me sukses disa produkte, është një provë që tregon se ekziston një potencial i përgjithshëm për eksport dhe mund të ngrihet një bazë, mbi të cilën mund të bëhen përpjekje për të përmirësuar dhe për të zgjeruar bazën e eksportit. Ekonomia kosovare nuk ka shfrytëzuar si duhet kapacitetet e brendshme, kjo edhe për shkak të krizës energjitike e cila ka ndikim të rëndësishëm në rentabilitetin e të gjithë sektorëve të ekonomisë.

Duke u nisur nga situata e viteve të fundit të eksporteve, e ritmeve të rritjes, nga arritjet në disa segmente të ekonomisë, në importet e makineri e pajisje për bujqësinë dhe për sektorë të tjerë të ekonomisë, nga investimet publike që janë realizuar dhe nga shumë reforma në proces, nga hapja dhe zgjerimi i tregut të rajonit, sidomos me Maqedoninë dhe nga intensifikimi i marrëdhënieve tregtare me Kosovën, shpresohet një zhvillim dhe përmirësim i aftësisë konkurruese në perspektivën rajonale.

Kusht esencial për promovimin e eksportit është strategjia e integruar në bazë të së cilës konkurrenca në tregun e brendshëm është njësoj e rëndësishme si konkurrenca në tregun e jashtëm. Duke u bazuar në atë që u tha më lart dhe në eksperiencat ndërkombëtare, duhet të ndërmerren këto hapa: dizajnimi i një politike të integruar për inkurajimin e eksportit, dhe organizimi dhe koordinimi më i mirë institucional.

Zhvillimi i një politike të integruar për eksport

Qasja ndaj politikës së eksportit vë theksin në tri elemente siç janë:

- Elementi i parë përfshin një gamë të politikave që merren me “çështjet brenda kufijve”, ku përfshihen masat që merren me rritjen e konkurrencës ndërmjet kompanive në tregun e brendshëm.
- Elementi i dytë ka të bëjë me politikat që merren me “çështjet në kufi” - masat që tentojnë të përmirësojnë procedurat në kufi dhe të zvogëlojnë shpenzimet e transaksioneve me të cilat ballafaqohen bizneset me rastin e kalimit të kufirit. Nganjëherë këto masa quhen “masa të lehtësimit të tregtisë”.
- Elementi i tretë përfshin politikat që kanë të bëjnë me “çështjet jashtë kufijve”. Këto janë politikat tradicionale të promovimit të eksportit që fokusohen në përmirësimin e performancave të ndërmarrjeve të vendit në tregjet e jashtme, nëpërmes ofrimit të informatave mbi tregjet e jashtme, mënyrat për kërkimin e partnerëve të jashtëm si nëpër panaire dhe vizita tregtare, marketingu për ndërmarrjet eksportuese, krijimi i web-sajtit për eksportues dhe bazës së të dhënave, trajnimi për procedura dhe teknika të eksportit, dhe masat tjera për promovimin e eksportit.

Një politikë e integruar për eksport duhet të fokusohet si në promovimin e konkurrencës ashtu edhe në lehtësimin e tregtisë dhe në promovimin e eksportit. Është shumë vështirë që të gjitha këto çështje të rregullohen nga një institucion i vetëm. Kjo për arsye se shumë

institucione (si ministri të ndryshme, agjencione etj.) merren me këto çështje dhe ato janë shumë të ndërlidhura dhe të ndërvarura, gjë që tregon edhe përvoja e UNCTAD-it. Një qasje e integruar

dhe e koordinuar është një alternative ndaj qasjes “one-stop-shop” e cila ofrohet nga organizatat që merren me promovimin e eksportit. Qasja e integruar e vë theksin në forcimin e konkurrencës dhe jo thjesht në zhvillimin e tregut dhe lehtësimin e tregtisë.

Kjo qasje ka të bëjë me pjesëmarrjen e një numri të konsiderueshëm të institucioneve të specializuara që punojnë së bashku, shkëmbejnë informata, bashkëpunojnë së bashku për të ofruar një gamë të shërbimeve për forcimin e konkurrencës dhe për përmirësimin e shërbimeve për përkrahje të tregtisë. Duke u bazuar në këtë qasje të integruar, institucionet ekzistuese mund të ridefinojnë përpjekjet e tyre për zhvillim drejt prioriteteve të reja që kanë të bëjnë me forcimin e konkurrencës dhe promovimin e tregtisë.

Shtyllat kryesore për rritjen e eksportit

Përparësitë e një politike të integruar për promovimin e eksportit duhet të materializohen nëpërmjet ngritjes së proceseve drejt progresit të qëndrueshëm në fusha si²⁰⁷: Zhvillimi i NVM-ve dhe Privatizimi.

Zhvillimi i NVM-ve

Zhvillimi i NVM konsiderohet si një orientim strategjik në zhvillimin e ardhshëm të vendit, me rol të veçantë në transformimin e bizneseve ekzistuese, zhvillimin e bizneseve të reja prodhuese dhe krijimin e strukturave të reja eksportuese. Përvoja e shumë vendeve të tjera dëshmon për rolin e rëndësishëm të NVM-ve në rritjen ekonomike dhe atë të eksportit. Me qëllim të tejkalimit të situatës aktuale dhe promovimit më të fokusuar të bizneseve prodhuese dhe eksportuese është

²⁰⁷ RIINVEST “Politika tregtare dhe promovimi i eksportit në Kosovë” (Raport Hulumtues), Nëntor 2003

kritike ndërmarrja e këtyre masave të politikave ekonomike të cilat duhet të zhvillohen në këto drejtime:

- Korrigjimi i politikave ekzistuese ekonomike me qëllim të krijimit të parakushteve institucionale për stimulimin e bizneseve ekzistuese prodhuese dhe të reja. Në veçanti stimulimi i investimeve të reja nëpërmjet uljes së tarifave doganore dhe të taksave për pajisjet dhe teknologjitë që nuk prodhohen në Kosovë, me qëllim të forcimit të aftësisë konkurruese të bizneseve vendore për gara në rrethanat e veprimit të tregtisë së lirë në rajon.
- Është e nevojshme që të ndiqen politika ekonomike në drejtim të përmirësimit të cilësisë dhe uljes së çmimeve të shërbimeve publike nëpërmjet liberalizimit të tregut dhe duke siguruar participimin e sektorit privat.
- Në kuadër të politikave për mbështetjen institucionale është e nevojshme që të krijohet një sistem kreditor afatgjatë me kushte më të favorshme për NVM-të prodhuese e shërbyese, sidomos për eksportuesit. Skema kreditore aktuale është e “pakapshme” për shumicën e bizneseve të vogla, e sidomos për bizneset prodhuese dhe eksportuese. Zgjidhjet duhet kërkuar në rritjen e ofertës së kredisë nëpërmjet rritjes së kursimeve afatgjata, mbështetjes financiare ndërkombëtare dhe kanalizimit të mjeteve të disaporës në aktivitetet ekonomike. Mirëpo, nëse analizojmë vizionin e shprehur vërehet një tendencë e ruajtjes së bizneseve ekzistuese. Krijimi i një linje kreditore specifike për NVM prodhuese me performansë eksportuese do të ishte një zgjidhje e favorshme në rastin e Kosovës.
- Përmirësimi i ambientit afarist dhe krijimi i klimës miqësore për investime do të shprehen esencialisht në forcimin e sektorit privat e në veçanti të bizneseve prodhuese. Analizat dhe anketat e “Riinvestit” mbi zhvillimin e NVM në Kosovë dëshmojnë veprimin e një numri të madh të pengesave institucionale, administrative dhe pengesa specifike për firmën si dhe pengesa që lidhem me tregun, politikat tregtare, infrastrukturën, etj. Nga rangimi i pengesave vërehet se bizneset prodhuese më së shumti janë të goditura nga konkurrenca e padrejtë, mungesa e ligjeve, taksat e larta dhe vështirësitë në qasjen në kredi. Politikat ekonomike duhet t’i adresojnë të gjitha pengesat, në veçanti ato që kanë lidhje me bizneset prodhuese.

Privatizimi paraqet mundësi reale për inkurajimin e investitorëve për blerjen e ndërmarrjeve shoqërore nga sektorët prodhues dhe eksportues. Privatizimi është një shansë e veçantë për ish-sektorët eksportues që tani janë ndërmarrje shoqërore. Meqenëse ndërmarrjet shoqërore i përkasin më shumë lëmisë së industrisë, pritet që privatizimi i tyre, i cili është duke vazhduar, do të ndikojë edhe në rritjen e eksportit. Në të kaluarën, në kuadër të këtyre ndërmarrjeve realizohej i tërë eksporti i Kosovës. Metoda spin-off nga aspekti i investitorëve potencialë paraqet një model atraktiv për investitorët për riaktivizimin e disa ish-kapaciteteve eksportuese²⁰⁸.

Megjithatë, privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore është duke u ballafaquar me vështirësi të shumta si:

- politikat ekonomike jostimulative
- teknologjia e prapambetur,
- konkurrenca e padrejtë,
- tregu i brendshëm i kufizuar.

Barrierat në këmbimin e mallrave – determinantet dhe ndikimi

Një sërë problemesh ndikojnë në aktivitetet eksportuese në Kosovë, këto probleme i kanë rrënjët në ekonomi dhe politikë, janë probleme të brendshme dhe të jashtme, kurse disa prej tyre janë të trashëguara e disa janë të lidhura me tranzicionin.

Së pari, mosnjohja e shtetit të Kosovës nga pesë vende të BE-së e vendos Kosovën në një pozitë të pabarabartë me fqinjët e saj në kontekstin e nismave rajonale si Stabilizim-Asociimi dhe Pakti i Stabilitetit.

²⁰⁸ RIINVEST “Politika tregtare dhe promovimi i eksportit në Kosovë” (Raport Hulumtues), Nëntor 2003

Së dyti, politika tatimore nuk e favorizon prodhimin vendor dhe norma uniforme e doganave dekurajon zhvillimin e bizneseve prodhuese në Kosovë.

Së treti, firmat në Kosovë përballen me probleme të brendshme, si mungesa e kapitalit, mungesa e përvojës në tregjet e huaja, mungesa e ekspertizës, si dhe marketingu dhe aktivitetet promovuese të dobëta.

Së katërti, ndërmarrësit në Kosovë përballen me barriera që e pengojnë operimin e tyre normal, përfshirë këtu shumat e kufizuara të kredive dhe normat e larta të kamatës, infrastrukturën e dobët, mungesën e informatave, përkrahjen e dobët institucionale, si dhe ngarkesa të tjera administrative.

Së pesti, edhe sikurse Kosova të kalonte një proces normal të transformimit politik dhe ekonomik, struktura industriale e trashëguar nga periudha jugosllave, e mbështetur në industrinë e rëndë, tregon se Kosova ende është e paaftë të përballlet me kërkesat dhe standardet e ekonomisë së tregut.

Kosova po përballlet me probleme me të cilat janë përballur edhe vendet tjera të Evropës Qendrore dhe Juglindore në fillim të transformimit.


Një vëmendje e posaçme i është kushtuar pengesave me të cilat ballafaqohen eksportuesit kosovarë në tregjet e jashtme. Ndërmarrësit kanë vlerësuar ndikimin e 14 pengesave të radhitura në listë (1 paraqet pengesë shumë të madhe; 5 nuk paraqet pengesë). Gjithashtu, edhe një mori pyetjesh të tjera janë të lidhura me çështjen e pengesave në eksport me qëllim të identifikimit të faktorëve të cilët determinojnë performansën e dobët të kompanive kosovare në tregjet e huaja.

Pengesat janë ndarë në dy lloje të veçanta, në ato të shkaktuara nga faktorët e jashtëm si dhe pengesat specifike për vet firmën. Pengesat e brendshme janë të lidhura me strukturën organizative të firmës apo me aftësitë e kufizuara menaxhuese. Në të kundërtën, pengesat e jashtme burojnë nga rrethina jostabile makroekonomike si dhe institucionet dhe politikat e qeverisë.

Në përgjithësi, pengesat e jashtme dhe të brendshme kanë ndikim të fuqishëm në eksportin e kompanive në tregjet e jashtme. Sidoqoftë, siç tregon grafiku, problemet me të cilat ndeshen bizneset kosovare janë kryesisht të natyrës eksterne. Mungesa e financimit për nevoja eksportuese, pengesat në pikat doganore, mundësitë e kufizuara për lëvizje, etj. janë një sërë barrierash të cilat burojnë nga legjislacioni qeveritar apo burokracia qeveritare, si dhe janë pasojë e moskrijimit të institucioneve të shëndosha të tregut.

Problemet e brendshme pengojnë në masë të madhe aktivitetet e firmës, intensiteti i ndikimit të barrierave të jashtme është vlerësuar të jetë më i madh nga respondentët.

Grafiku 4. Pengesat në eksportin e kompanive kosovare



Burimi: Anketa e “Riinvestit” me 110 eksportues kosovarë

4.7.1. Ndikimi i faktorëve të brendshëm në eksport

Shumë studime, qofshin ato teorike apo empirike, koncentrohen kryesisht në nivelin e zhvillimit menaxherial si dhe në resurset e kufizuara si pengesa të brendshme kryesore në aktivitetin e firmës. Në mënyrë më specifike, ato koncentrohen në problemet që dalin nga struktura organizative, shkalla e edukimit dhe trajnimit të personelit, përcaktimi dhe qasja menaxheriale për eksport, përvoja menaxheriale, etj²⁰⁹.

²⁰⁹ Hübner, W. “Zhvillimi i NVM-ve në vendet e Azisë Qendrore (Kazakistan, Kyrgistan dhe Uzbekistan): Pengesat, aspektet kulturore dhe roli i ndihmës ndërkombëtare”, UNIDO, Vienë 2000.

Tabela 7: Pengesat specifike për firmën (shpërndarja e përgjigjeve në %)

<i>Lloji i pengesës/Rangu</i>	1	2	3	4	5
Aftësitë dhe përvojat e menaxherëve	1.8	6.4	11.0	14.7	66.1
Mungesa e informatave	17.3	17.3	21.8	10.0	33.6
Vështirësitë në gjetjen e partnerëve afaristë	9.1	11.8	30.9	9.1	39.1
Shpenzimet e prodhimit	10.9	13.6	20.0	10.0	45.5
Njohja e gjuhëve të huaja	10.0	10.0	10.9	9.1	60.0

Burimi: Anketa e “Riinvestit” me 110 eksportues kosovarë.

Rezultatet nga anketa demonstrojnë se për eksportuesit kosovarë njohuritë menaxheriale dhe eksperiencia e tyre nuk paraqesin problem sinjifikat për zgjerimin e tyre në tregjet e huaja. Kjo pengesë është klasifikuar si pengesa më me pak influencë në aktivitetet eksportuese të kompanisë nga 14 pengesat e specifikuar. Mesatarisht kjo pengesë është ranguar më tepër se 4 me variancë dhe devijim standard relativisht të ulët.

Andaj, në përgjithësi, sipas të gjithë indikatorëve statistikor, kjo pengesë konsiderohet si shumë e ulët apo pa kurrfarë ndikimi në eksport. Ngjashëm, në tabelën 7 shihet se pjesa më e madhe e përgjigjeve janë të grumbulluara në rangun 4 dhe 5.

Menaxherët e anketuar posedojnë edukim të lartë më tepër se dy të tretat e të anketuarve kanë edukim të lartë apo superior (diplomë universiteti apo më lart). Andaj, edhe perceptimi i kësaj pengese si e ulët është si rrjedhojë e këtyre fakteve. Pavarësisht nga kjo, një person afarist mund të ketë diplomë të nivelit të lartë që nuk ka lidhje me aktivitetin afarist, në këtë rast diploma nuk ka rëndësi. Prandaj, çështja qëndron në cilësinë dhe “përshtatshmërinë” e edukimit e jo në nivelin e edukimit.

Grupi i dytë i pengesave për internacionalizimin e aktivitetit të ndërmarrjeve janë shpenzimet e transaksioneve. Këto shpenzime janë shumë më të larta kur bëhet biznes jashtë kufijve sesa kur bëhen transaksione të brendshme për arsye të qarta. Faktorët të cilët i bëjnë këto shpenzime më të larta për këmbime ndërkombëtare janë diferencat në gjuhë dhe kulturë, zakone, ligje, burimet

e informacioneve, mënyra si operojnë tregjet, niveli dhe karakteri i konkurrencës, vështirësitë në fuqizimin e kontratave, etj. Në literaturë veçohen disa lloje të këtyre shpenzimeve:

- Gjetja e informatave për tregjet e huaja;
- Gjetja e partnerëve të besueshëm;
- Negociimi, shkrimi dhe fuqizimi i kontratës;
- Financimi i kontratës si dhe bartja e rrezikut të dështimit; dhe
- Ndryshimi i kontratës si pasojë e ndryshimit të rrethanave.


Në mesin e kostove të lartpërmendura, gjetja e informatave për tregjet e huaja është qenësore. Besimi se informatat lehtësojnë procesin e marrjes së vendimeve dhe reduktojnë paqartësitë në biznes ka çuar në krijimin e një konsensusi shkencor se rritja dhe ekzistenca e bizneseve të sotme varet në tërësi nga strategjitë për menaxhimin dhe procesimin e informatave²¹⁰.

Të dhënat japin një pasqyrë të paqartë. Në bazë të perceptimeve të përgjithshme, nuk krijohet ndonjë përshtypje se ekziston ndonjë pengesë e madhe nga mungesa e informatave (Tabela 7). Mungesa e informatave është e ranguar si pengesa e gjashtë më e madhe në bazë të rangimit mesatar – me variancë relativisht të lartë, që tregon se përgjigjet e të anketuarve janë relativisht shumë të shpërndara.

Prapë, siç shihet, sigurimi i informatave për tregjet relevante është i kënaqshëm për bizneset kosovare. Në njëfarë mënyrë, kjo është e kuptueshme, sepse eksportuesit kosovarë tregtojnë kryesisht me vendet fqinje, për të cilat nuk është vështirë të gjenden informatat. Sidoqoftë, duke marrë parasysh disa indikacione të tjera të prodhuara nga anketa, situata me nivelin e informimit nuk është edhe aq e kënaqshme. Burimet informative për tregjet e huaja si dhe informimi mbi trajtimin preferencial nga BE-ja japin një pasqyrë tjetër (Grafiku 5).

²¹⁰ Hare, P. G.; "Politikat tregtare gjatë tranzicionit: Mësimet nga të '90-tat", Economic Survey of Europe, Issue 2 2001.

Grafiku 5. Burimet e informatave për tregjet e huaja



Më tepër se 58 për qind e ndërmarrësve të anketuar nuk kanë fare informacione se produktet kosovare kanë një tretman preferencial në BE. Kjo është një e dhënë mahnitëse e cila nuk kërkon koment. Burimet kryesore të informatave për eksportuesit kosovarë janë prezentuar në grafikun 5.

Burimet kryesore të informatave janë kontaktet personale me afaristë, si dhe takimet në panaire. Vetëm 2 për qind e informatave është siguruar nga agjencionet qeveritare, ndërsa 10 për qind e tyre janë siguruar nga OEK-u apo shoqatat e biznesit. Ky është një indikacion se sa dobët në Kosovë menaxhohet dhe transmetohet infomata në mënyrë insitucionale.

Nga ajo që u tha më lart, siç shihet, çështja e sigurimit të informatave mund të konceptohet nga këndi i brendshëm i firmës si dhe nga aspekti eksternal. Ndërmarrjet bëjnë ç'është e mundur të sigurojnë sa më tepër informacione, meqenëse rëndësia e tyre, siç dihet, është kruciale. Në anën tjetër, nga aspekti institucional informata nuk iu ofrohet në sasi të mjaftueshme palëve të interesuara. Duke u nisur nga këto dy kënde, mund të konkludohet se informata është problem ekstern i kompanisë, janë institucionet qeveritare, OEK-u si dhe shoqatat afariste ato të cilat nuk

e bëjnë punën e tyre si duhet. Studimet e bëra në vendet tjera kanë treguar se mungesa e informatave afariste është kritike për performansën e eksportit.

Për shembull, Kostecki et al., (1996) ka demonstruar se njohja e tregjeve të huaja është problem kyç për ndërmarrjet polake²¹¹. Edhe këta të fundit barrën më të madhe të problemit e vënë në institucionet të cilat duhet të ofrojnë informacione (posaçërisht në mosefikasitetin e tyre), që është pasojë e kufizimit të madh buxhetor si dhe burokracisë tejet të lartë. Andaj, edhe çështjen e informatave në rastin e Kosovës duhet trajtuar në kategorinë e problemeve të nxitura nga mosfunksionimi i mirë i institucioneve si dhe politikat joadekuate. Vështirësitë në gjetjen e partnerëve të besueshëm për biznes janë një dimension tjetër i shpenzimeve të transaksioneve.

Ndikimi i faktorëve të jashtëm në eksport

Barrierat e jashtme burojnë nga sistemi ekonomik dhe afarist, i cili i rrethon kompanitë. Sistemi i jashtëm përfshin rrethinën ekonomike, socio-kulturore, politiko-legale, teknologjike, demografike, si dhe rrethinën fizike të ndërmarrjes. Në këtë kontekst, shitja në tregun e jashtëm involvon një numër të madh rreziqesh për kompaninë që është rezultat i mungesës së njohurive për tregun e caktuar apo rrethinën - e cila është heterogjene, e sofistikuar dhe turbulente. Në anketën me eksportues kryesisht janë potencuar barrierat e jashtme si në vijim: financimi, çështjet e politikës tatimore, faktorët rregullues, procedurat administrative dhe burokracia. Në përgjithësi, barrierat e jashtme janë rezultat i raporteve në treg (psh. financimi, konkurrenca) dhe i organizimit institucional (psh. tatimet, legjisllacioni, burokracia).

Anketa fokusohet në pengesat që lindin si rezultat i politikave ekzistuese dhe i organizimit institucional. Sipas Hare (2000) këto barriera kanë të bëjnë kryesisht me mosfunksionimin e plotë të sistemit bankar, posaçërisht në menaxhimin e sigurt dhe me kosto të ulët të transaksioneve ndërkombëtare, mungesa e skemave garantuese për kreditë

²¹¹ Kostecki, M. M., Nowakowski, M. K. & Walkowicz, "Bregat e NVM-ve në Poloni sa i përket eksportit", Journal of East-West Business, Vol. 1, No. 4, 1996, fq. 95-115.

për eksport dhe forma të tjera të promovimit të eksportit; së fundi, sigurimi i dobët transaksioneve dhe shërbimeve të tjera të lidhura me aktivitetet eksportuese²¹². Për më tepër, këto barrierë institucionale marrin formën edhe të pritjeve të gjata në kufi, të cilat njëkohësisht shoqërohen me korrupsion të madh me qëllim të përshpejtimit të lëvizjes së mallrave

Në këtë kontekst, në mesin e 14 barrierave të potencuara në anketë janë, financimi është problemi kryesor i ndërmarrësve. Me rangim mesatar afër 2 dhe me median dhe modë të barabartë me 1, kjo pengesë është ranguar si më me efekt në internacionalizimin e aktiviteteve (shih shpërndarjen e përgjigjeve në tabelën 8). Vështirësitë e kompanisë me financim janë të lidhura me kushtet (kohëzgjatja dhe normat e kamatës) me të cilat akordohet kredia në përgjithësi (posaçërisht kreditë për eksport). Për më tepër aspektet financiare përfshijnë: mungesën e qasjes në financim, nivelin e kamatës, mungesën e kredive eksportuese, historiatin e firmës në aspektin e financimit etj.

Rezultatet nga kryqëzimi i të dhënave japin të dhëna të papritura, në veçanti del se kompanitë më të mëdha kanë gjithashtu edhe probleme më të mëdha me financimin. Zakonisht supozohet se sa më e madhe të jetë kompania edhe resurset e tyre financiare si dhe resurset tjera të saj janë më të mëdha, dhe si të tilla, ato kanë edhe influencë “politike”, andaj edhe kanë qasje më të lehtë në financimi.

Nga anketa e kryer nga Riinvest, më tepër se 90 për qind të kompanive të mëdha (ato me më tepër se 250 punëtorë) e kanë ranguar problemin e financimit si kryesorin, të përcjellura nga ndërmarrjet e mesme dhe të tretat janë ato të voglat. Sipas pronësisë, pjesa më e madhe e ndërmarrjeve në pronësi shoqërore (rreth 90 për qind), të cilat njëkohësisht i takojnë kategorisë të ndërmarrjeve të mëdha, e kanë ranguar financimin në kategorinë 1 dhe 2. Duke pasur parasysh gjendjen e përgjithshme të tyre në Kosovën e pasluftës, brengat e tyre janë të kuptueshme²¹³.

²¹² Hare, P. G.; “Politikat tregtare gjatë tranzicionit: Mësimet nga të ‘90-tat”, Economic Survey of Europe, Issue 2 2001.

²¹³ RIINVEST “Politika tregtare dhe promovimi i eksportit në Kosovë” (Raport Hulumtues), Nëntor 2003.

Sipas kategorive të aktiviteteve, distribuimi i përgjigjeve është i shpërndarë njëjtë ndërmjet prodhuesve, tregtarëve si dhe kategorive të tjera. Del se paratë që kërkojnë eksportuesit kosovarë janë për qëllime prodhuese. Në bisedimet e zhvilluara me disa nga respondentët, pasi është kryer anketa, ata janë shprehur se financimi do të shfrytëzohej për qëllime të kapitalit punues. Për më tepër, ata thonë se paratë iu mundësojnë atyre krijimin e linjave të reja prodhuese dhe përmirësimin e teknologjisë.

Tabela 8. Lloji i pengesave dhe shpërndarja e tyre

<i>Lloji i pengesave / Rangu</i>	1	2	3	4	5
Mungesa e mbështetjes kreditore	51.8	18.2	10.9	2.7	16.4
Tatimet doganore me vendet tjera	44.0	15.6	18.3	5.5	16.5
Vonesat në kalimet kufitare	27.3	20.9	23.6	9.1	19.1
Mungesa e dok. pers. dhe vizat	26.4	16.4	10.9	10.0	36.4
Marrëdhëniet tregtare me vendet fqinje	14.5	24.5	19.1	10.9	30.9
Imazhi i dobët i produkteve	11.8	9.1	25.5	10.0	43.6
Transporti	12.7	8.2	19.1	11.8	48.2
Çertifikata mbi origjinën e mallit	14.5	5.5	15.5	9.1	55.5
Çertifikata për shëndetësi dhe sigurim	3.6	3.6	16.4	9.1	67.3

Ndikimi i investimeve të jashtme për zhvillimin e tregtisë së jashtme

Integrimi i ekonomisë në kushtet e tregtisë dhe integrimi i investimeve është esencial për të qenë konkures në tregun e BE-së të cilit Kosova aspiro ti bashkangjitet. Në dekadën e fundit, ekonomia e Kosovës ka qenë shumë liberale ndaj importeve, por ajo ka dështuar të eksportoj produktet dhe shërbimet dhe të tërheqë përbrenda investimet e huaja direkte.

Duke u mbështetur në eksportin e burimeve natyrale dhe/ose te produkteve të procesuara si lëndë e parë për të mbyllur deficitin e jashtëm tregëtarë nuk është as i qëndrueshëm as i favorshëm në rritjen e produktivitetit ose krijimin e punës në ekonomi. Niveli (i ulët) dhe struktura e tregtisë së

jashtme duket se tregon konkurrencë të ulët të produkteve Kosovare edhe në tregun e brendshëm dhe atë të jashtëm.

Duke konsideruar se firmat Kosovare – si ato të ekonomive tjera në tranzicion, por edhe më tepër për shkak të problemeve politike përgjatë dekadës së fundit– kanë tendencë për të mbetur mbrapa në drejtim të teknologjisë, përderisa në të njëjtën kohë duke u përballur me kosto shumë të lartë në financimin e investimeve, investimet e huaja direkte (IHD) të brendshme duket të jenë veqanarisht të dobishme për këtë ekonomi. Përveq sigurimit të mënyrës së financimit të investimeve përfshirë edhe punësimin, IHD mund potencialisht të kontribuojë në rritjen e produktivitetit përmes transferimeve të teknokogjisë, zhvillimit të aftësive të fuqisë punëtore dhe efekteve në firmat vendore.

Deri më sot Kosova nuk ka qenë e sukseshme në tërheqjen e IHD, me përjashtim të sektorit të shërbimeve financiare dhe sektorit të telekomunikacionit. Për më tepër, për shkak (parcialisht) të krizës globale ekonomike, të hyrat e IHD në Kosovë kanë rënë gradualisht që nga 2007 kur ato arrinin kulminacionin prej rreth 440€ milion.


Përkundër rëndësisë së investimeve të jashtme për zhvillimin e bizneseve prodhuese, trendet aktuale nuk janë të favorshme. Inkurajimi i investitorëve të jashtëm në zhvillimin e sektorit privat e sidomos të bizneseve tregtare është i kushtëzuar nga thellimi i reformës ekonomike, ndjekja e politikave ekonomike stimulative, stabiliteti makroekonomik dhe politik dhe përmirësimi i imazhit të vendit nëpërmjet forcimit të institucioneve të ekonomisë së tregut, forcimit të shtetit ligjor dhe pavarësisë së gjyqësorit. Krijimi i bizneseve të reja prodhuese, zgjerimi i atyre ekzistuese dhe eksportuese nëpërmjet pjesëmarrjes së kapitalit të jashtëm paraqet një mundësi reale për zhvillim. Politikat ekonomike duhet të adresojnë këto çështje specifike:

- Përmirësimin e ambientit afarist dhe krijimin e një klime miqësore investuese me qëllim të inkurajimit të iniciativave të reja në biznes që vijnë nga investitorët e jashtëm. Në këtë aspekt është i nevojshëm eliminimi i barrierave administrative në nivel të pushtetit lokal

dhe qendror, me qëllim të lehtësimit të qasjes së bizneseve të huaja në treg, në informata dhe në lokacionin konkret.

- Krijimi i instrumenteve garantuese për riskun makroekonomik në bazë të marrëveshjeve bilaterale me vendet tjera.
- Krijimit i një zyre në kuadër të qeverisë që do të koordinojë rrjetin e institucioneve qeveritare dhe joqeveritare që kanë për qëllim promovimin e IHD-ve.

Grafiku 6. Investimet e Huaja Direkte në Kosovë (në milion euro)



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës 2010

Njëri nga faktorët për të cilin është argumentar se ka kontribuar në deficitin e lartë tregtarë dhe në tërheqjen e pamjaftueshme të investimeve të huaja është dështimi në implementimin e marrëveshjes së CEFTA-s²¹⁴. Problemi më i dallueshëm lidhur me CEFTA është vendimi i dy antarëve të CEFTA-s, Serbia dhe Bosnia Hercegovina, të ndalojë importin dhe tranzitin e produkteve kosovare e cila është vlerësuar të ketë shkaktuar 9.8% ulje në eksportet kosovare dhe rritjen e kostove të transportit për eksportet tjera për 5-10%²¹⁵.

²¹⁴ Banka Qendrore e Kosovës; "Raporti vjetor 2011", Prishtinë, Qershor 2012.

²¹⁵ GAP, "Kosova në CEFTA – të jesh apo të mos jesh", analizë politikash, Prishtinë, Mars 2011.

Dështimi në implementimin e marrëveshjes për tregti të lirë me - apo përmes - këtyre shteteve dukshëm zvogëlon potencialin e tregut të Kosovës (d.m.th tregun e vet dhe qasjen në tregjet tjera) dhe si e tillë është e mundshme të ketë efekt të dëmshëm në të hyrat e IHD në shtet.

Përfundimet dhe rekomandimet

1. *Si një ekonomi e vogël, pa dalje në det, e ardhmja e Kosovës varet në mënyrë kritike nga aftësia e saj për t'i hapur kufinj të dhe për të përfituar nga tregtia ndërkombëtare. Dëshmitë empirike vërtetojnë se shtetet e vogla mund të arrijnë norma të larta rritjeje kur ekonomia është e hapur, nuk ka kontrole të lëvizjeve të kapitalit, ambienti i biznesit nuk pengohet nga rregulloret dhe ekziston një treg liberal i punës që rezulton në një fuqi punëtore të lëvizshme.*

Deri tani, Kosova ka ndjekur politika tregtare që e vendosin atë në rrugën drejt regjimeve tregtare më liberale në botë. Ka vend për ta përmirësuar edhe më tej këtë regjim dhe një reduktim i përgjithshëm i normës tarifore në 5 përqind është i rekomanduar. Duhet të kihet parasysh implikimet në të ardhura, dhe duhet të merren masa për të rritur të ardhurat nga TVSH aty ku është e nevojshme.

Kosova ka një regjim liberal të tregtisë, i cili karakterizohet me thjeshtësi dhe neutralitet, tipare kryesore që konsiderohen të jenë të rëndësishme për stimulimin e rritjes së sektorit privat, si dhe për krijimin e kushteve për eksport të mirë. Mirëpo, pasi që liberalizimi i tregtisë nuk ka qenë i shoqëruar me përmirësimin e aftësisë konkurruese të sektorëve prodhues vendorë të sapo krijuar, Kosova po ballafaqohet me deficit të lartë tregtar.

Pra, prirja e këtyre viteve ka qenë shtimi i deficitit tregtar. Raporti i eksportit ndaj BPV-së (GDP) ose quajtur ndryshe përqindja e eksportimit, krahasimisht me vitet e mëparshme ka patur rënie. Ky deficit tregtar dëshmon vështirësitë financiare në bilancin e pagesave me jashtë, çka do të thotë se ekonomia jonë duhet të shesë disa nga aktivet (asetet) e saj ose të presë ndihma (grante) financiare nga vende të tjera. Për të zbutur këtë shpërpjesëtim midis eksport-importit janë dy rrugë të mundshme: rritja e promovimi i eksporteve si dhe prodhimi në vend i disa produkteve, që importohen dhe që ekonomia kosovare i ka mundësitë reale për t'i hequr nga lista e importit.

Raportet jo të mira midis eksportit dhe importit janë me pasoja të rënda në zhvillimin e ekonomisë në përgjithësi, kur dihet se aktualisht kompensimi nga sektori i shërbimeve (turizëm, transport, financë etj.) është i pamundur, mbasi edhe ky sektor është në nivele të

ulëta zhvillimi. Gjithashtu, edhe shitja e aktiveve të ekonomisë ka kufijtë e saj, donacionet janë të përkohshme dhe të ardhurat nga emigrantët po vijnë në rënie. Pra, parë në këtë këndvështrim, mund të themi se deficitin tregtar po të vazhdojë të thellohet, do të bëhet pengesë për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë në tërësi. Mbas vitit 2011 veç ka filluar zbutja e deficitit tregtar.

Nxitja e eksporteve, pa dyshim është një mekanizëm shumë i fuqishëm i rregullimeve strukturore, që ka efektin e tij në bilancin e pagesave. Në kuadrin e politikës ekonomike të Kosovës, zhvillimi i eksporteve konsiderohet si një faktor kyç për përmirësimin e treguesve makroekonomikë, veçanërisht nga pikëpamja e përmirësimit të bilancit tregtar (aktualisht mjaft negativ) dhe krijimit të vendeve të punës.

2. *Si përfundim mund të konkludojmë se* perspektiva e eksportit të mallrave paraqitet optimiste nisur nga shumë faktorë të ndryshëm, që kanë ndikim të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në rritjen e nivelit të eksportit të mallrave si:
- Politikat e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik të vendit dhe angazhimet për një politikë tregtare në rajon e më gjerë gjithnjë e më liberale.
 - Ekzistenca e strategjisë së zhvillimit të eksporteve dhe të strukturës përkatëse për implementimin e saj.
 - Përmirësimi i sistemit financiar dhe bankar si dhe rritja e aftësisë kredituese në ekonomi.
 - Rritja e investimeve publike në infrastrukturën e rrugëve, të hekurudhës, të ujit si dhe të shërbimeve telefonike etj.

Si përfundim mund të themi se Kosova duhet të ketë një ekonomi të qëndrueshme dhe të jetë vend konkurrent në rajon. Tregu kosovar duhet të jetë treg liberal, i hapur, të përmbajë stimulime për prodhuesit vendor. Duhet të ndryshohet struktura e tregut të eksportit dhe importit për arsye se tregu i Kosovës mbizotërohet me 70% nga importi.

3. *Strategjia e orientuar kah rritja e eksportit* duhet të konsiderohet si një faktor kyç në sendërtimin e ekonomisë së hapur dhe të lirë të tregut dhe në reduktimin e debalanceve të mëdha në Kosovë. Dizajni dhe implementimi i strategjisë së integruar të promovimit të

eksportit kërkon koordinimin e aktiviteteve nga Qeveria, shoqatat afariste dhe akterë të tjerë në disa fusha të rëndësishme:

- Përmirësimi i organizimit institucional dhe koordinimi i aktiviteteve ndërmjet ministrive dhe akterëve të tjerë përmes krijimit të një trupi koordinues në zyrën e Kryeministrit;
- Të zhvillohet qasja integrale e politikës së orientuar kah rritja e aftësisë konkurruese të kompanive kosovare në tregun e brendshëm dhe të jashtëm, si dhe në lehtësimin e aktiviteteve eksportuese;
- Politikat qeveritare për përmirësimin e aftësisë konkurruese përfshijnë:
 - Ndryshimin e politikës tatimore për të qenë më mbështetëse ndaj investimeve;
 - Përmirësimin e kushteve kredituese në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare financiare, donatorët dhe bankat, për eksportuesit dhe sektorët prodhues;
 - Përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike, veçanërisht të energjisë elektrike dhe telekomunikimeve;
 - Zhvillimin e aftësisë konkurruese të prodhuesve vendorë, posaçërisht në bujqësi duke dizajnuar dhe implementuar një politikë agrare aktive;
 - Në bashkëpunim me donatorët dhe shoqatat afariste, mbështetjen e NVM-ve përmes aktiviteteve promovuese, pjesëmarrjes në panaiet ndërkombëtare dhe trajnimet e eksportuesve;
 - Mbështetjen aktive për IHD-ve dhe privatizimin.
- Të vazhdohet me vendosjen e marrëdhënieve tregtare me vendet në rajon, bazuar në interesat e dyanshme dhe në reciprocitet nëpërmjet pjesëmarrjes në aktivitetet e Paktit të Stabilitetit dhe negociimit të marrëveshjeve të tregtisë së lirë. Nëpërmjet bashkëpunimit në bazë bilaterale dhe gjithashtu nëpërmjet Paktit të Stabilitetit dhe organeve të BE-së, insistimi në heqjen e kuotave specifike tranzitore për eksportuesit/importuesit kosovarë në vendet fqinje dhe gjithashtu në njohjen e dokumenteve të udhëtimit dhe dokumenteve zyrtare për vetura dhe mjete të tjera transportuese;

4. *MTI, Oda Ekonomike dhe shoqatat afariste duhet të koordinojnë aktivitetet e tyre drejtë:*

- Përmirësimin të informatave rreth tregjeve të huaja
- Gjetjen e partnerëve dhe realizimin e takimeve
- Krijimin të bazës së të dhënave, sajteve dhe sistemit informativ të eksportit dhe sistemeve informative për eksportin
- Zhvillimit sistematik të programeve trajnuese për eksportuesit
- Konsiderimit të mundësisë për krijimin e komiteteve/organeve për bashkëpunim ekonomik me partnerët nga vendet tjera.

- Rekomandohet që Qeveria e Kosovës të vendos bashkëpunimin me organizata rajonale dhe ndërkombëtare, të orientuara në promovimin e eksportit (siç janë Qendra Ndërkombëtare e Tregtisë – Gjenevë, WTO, UNCTAD, Qendra Rajonale e Ballkanit për Promovimin e Tregtisë, etj.)

Literatura e shfrytëzuar

1. **Ahmet Mançellari;** "Tregtia ndërkombëtare – Teori dhe Politika", SHB "ADA" Tiranë, 2004.
2. **Hare, P. G.;** "Politikat tregtare gjatë tranzicionit: Mësimet nga të '90-tat", Economic Survey of Europe, Issue 2, 2001.
3. **Hill, C. W. L.,** "International Business: Competing in the Global Marketplace", edicioni i gjashtë, New York 2007: McGraw-Hill
4. **Hübner, W.** "Zhvillimi i NVM-ve në vendet e Azisë Qendrore (Kazakistan, Kyrgistan dhe Uzbekistan): Pengesat, aspektet kulturore dhe roli i ndihmës ndërkombëtare", UNIDO, Vienë 2000.
5. **Igballe Rexha, MTI,** "Implementimi i marrëveshjes CEFTA – Kosova një hap para për në BE", Konferenca e gjashtë ndërkombëtare "Biznesi dhe Punësimi", Instituti i Financave i Kosovës – IFK, Prishtinë, 2007.
6. **Igballe Rexha - Jashari, MTI,** "Rritja ekonomike dhe zhvillimi i tregtisë së jashtme", Konferenca e dhjetë ndërkombëtare "Biznesi dhe Punësimi", Instituti i Financave i Kosovës – IFK, Prishtinë, Tetor 2011.
7. **Ilia Kristo,** "Biznesi Ndërkombëtar", Pegi, Tiranë, 2004.
8. **Isak Mustafa,** "Biznesi dhe Punësimi", Konferenca e gjashtë ndërkombëtare, Instituti i Financave i Kosovës – IFK, Prishtinë, 2007.
9. **Isak Mustafa,** "Biznesi dhe Punësimi", Konferenca e tetë ndërkombëtare, Instituti i Financave i Kosovës – IFK, Prishtinë, 2009.
10. **Isak Mustafa,** "Biznesi dhe Punësimi", Konferenca e dhjetë ndërkombëtare, Instituti i Financave i Kosovës – IFK, Prishtinë, 2011.
11. **Kostecki, M. M., Nowakowski, M. K. & Walkowicz,** "Bregat e NVM-ve në Poloni sa i përket eksportit", Journal of East-West Business, Vol. 1, No. 4, 1996.
12. **Muhamet Sadiku dhe Isa Mulaj;** "Evropa juglindore si hapësirë e përbashkët ekonomike dhe konsiderimi i dimensionit social", publikim shkencor, Sarajevë, Qershor 2009.
13. **Musa Limani,** "Hyrje në ekonomi", Prishtinë, 2002.
14. **Musa Limani;** Politika ekonomike, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Ekonomik, Prishtinë, 1994

15. **Musa Limani**, “Makroekonomia aplikative”, Prishtinë, 2003.
16. **Musa Limani**; “Aspekti regjional i zhvillimit ekonomik”, Universiteti i Kosovës në Prishtinë, Fakulteti Ekonomik, Prishtinë, 1986.
17. **Myrvete Badivuku-Pantina**; “Kosova dhe bashkëpunimi ekonomik regjional”, Prishtinë, Kosovë 2005.
18. **Skender Ahmeti**; “Nxitja e rritjes së eksporteve dhe ndikimi në rritjen ekonomike të Kosovës”, Prishtinë 2007.
19. **Skënder Berisha**, “Ekonomia ndërkombëtare”, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Ekonomik, Prishtinë, 2002.
20. **Ylber Rraci**; “Sistemi doganor në Kosovë”, Prishtinë, 2003.

ROLI I QEVERISË GJATË TRAJTIMIT TË KRIZËS EKONOMIKE DHE FINANCIARE

Dr. Avdi Jakupi

Menaxher i Buxhetit dhe Financave ne Administratën Tatimore te Kosovës, Adresa: Marin Barleti p.n. Ferizaj, E-mail adresa: avdi.jakupi@atk-ks.org

Fjalët kyçe; Zhvillimi ekonomik, vendet e eurozonës, ekonomia globale, strategjia ekonomike, politikat ekonomike, remitencat, tranzicioni etj.

Abstrakt: Termi krize ekonomike kohëve te fundit është bere një teme aktuale dhe ka ngjalle diskutime ne forma te ndryshme përmes debateve dhe tryezave me përmbajtje ekonomike, financiare dhe sociale. Është një teme qe kërkon trajtim te veçantë dhe arsyeja e ngritjes se kësaj çështje është se kriza ekonomike tani me është prezentë edhe ne Kosovë dhe ka prekur çdo sektorë te ekonomisë sikurse ne vendet e eurozonës por edhe shume vende te botes.

Duke u bazuar ne trendët globale dhe zhvillimet ekonomike vlerësojmë se kriza ekonomike tani me qe është prezentë ne shume vende te botes, e ne veçanti ne shtetet e bashkimit evropian, ka filluar ta atakon edhe shtetin me te ri ne Ballkan Republikën e Kosovës. Çdo lëvizje ekonomike qe ndodhe ne vendet e eurozonës nga aspekti i zhvillimit apo edhe elementet e krizës qe lëkundin ekonominë e këtyre vendeve do te ndikon ne stabilitetin e ekonomisë Kosovare. Kur është ne pyetje jo stabiliteti ekonomik, debatet e shumta te organizuara ne tryeza te ndryshme, qëndrimet rrethe ofrimit te zgjidhjes dhe ballafaqimi me vete procesin e krizës ekonomike financiare, është pa mundur te mos analizohet gjendja ekonomike globale ne vendet e eurozonës, nga e cila do te pëson edhe ekonomia e Kosovës.

Kriza ekonomike është bere një teme e përditshme dhe e diskutueshme ne tere globin por edhe një teme shume e përfolur ne mjediset shoqërore dhe familjare. Bazuar ne faktin se vendi gjendet edhe me tej ne fazën e mos zhvillimit ekonomik, ku si produkt i kësaj gjendje është rritja e papunësisë ne vendin tone dhe ne përgjithësi ne vendet e Ballkanit. Prandaj bazuar ne aktualitetin e Kosovës ku çdo dite e me tepër kemi rendje ekonomike, rritje te papunësisë për shkak te mungesës se prodhimit, mungesa e eksportit rendja e fuqisë blerëse ne mungese te parasë se gatshme, e cila edhe ajo sasi qe është del jashtë shtetit me rastin e importit. Këto elemente qe paralajmërojnë krizën ekonomike vetëm sa shkojnë e bëhen te pa durueshme për qytetarin, kjo gjendje rendohet edhe me shume, ku si rezultat i krizës politike qe aktualisht mbretëron ne shtetin e Kosovës ka ndikuar qe gjate këtij viti te kemi tendenca te rritjes se deficitit te hyrave dhe rritjes se borxhit publik. Ne këto kushte jo te favorshme te zhvillimit ekonomik, me te drejte qytetaret fitojnë një pasiguri për te jetuar, nuk ka elemente te rritjes se investimeve dhe mungon një

mjedis i shëndoshë për zhvillimin e biznesit për shkak të mungesës së infrastrukturës ligjore për zbatim dhe bashkëveprim me operatoret.

Ruajtja e stabilitetit ekonomik e politik të vendit bëhet vetëm me tërheqjen e investimeve të huaja përmes të cilave do të kishim rritje ekonomike dhe stabilitet financiar, kjo mund të arrihet përmes bashkërendimit të disa elementeve esenciale të ekonomisë.

Kriza në vendet e eurozonës ka ndikuar që Kosova ta ndjenë në masë të madhe krizën ekonomike, për shkak të zvogëlimit të investimeve nga mjetet e diasporës që kjo ka arritur shifrën 30-40% të zvogëlimit të mjeteve të ardhura nga emigracioni, prej të cilave mjete varet edhe ekzistimi i parasë së gatshme në qarkullim. Disa nga elementet që prodhojnë krizën është shkalla e ende e lartë e importit në krahasim me eksportin që ka një shkallë shumë të ulët, mungesa e prodhimit, dalja e parasë jashtë shtetit, shkalla e lartë e ekonomisë jo formale në pa mundësi të parandalimit të kësaj dukurie dhe shpëlarja e parasë.

Gjithashtu edhe mungesa e strategjive zhvillimore për të shfrytëzuar tërë potencialin ekzistues të Kosovës të të gjitha resurseve njerëzore dhe natyrore, ku mos angazhimi i plote i tyre bënë që të mbretëron kriza ekonomike dhe financiare.

Në këtë punim do të trajtohet ekonomia e rënduar nga kriza financiare, ndikimi i krizës botërore në ekonominë e Kosovës dhe roli që ndërmerr shteti për të dalë nga kriza.

Ndikimi i krizës botërore në ekonominë e Kosovës

Kriza ekonomike është bërë një temë e përditshme dhe e diskutueshme në tërë globin por edhe një temë shumë e përfolur në mjediset shoqërore dhe familjare. Bazuar në faktin se vendi gjendet edhe më tej në fazën e mos zhvillimit ekonomik, ku si produkt i kësaj gjendje është rritja e papunësisë në vendin tone dhe në përgjithësi në vendet e Ballkanit.

Zhvillimet ekonomike në nivel global gjatë vitit 2013 u karakterizuan me trendë pozitive, por se normat e rritjes ekonomike ishin lehtë më të ulëta në krahasim me vitin paraprak. Vlerësimet e FMN-së janë se rritja ekonomike globale më vitin 2013 ishte 3.0 përqindje, krahasuar me 3.2 përqindje në vitin 2012. Aktiviteti ekonomik në nivel global është nxitur nga vendet e zhvilluara, ndërsa vendet në zhvillim, edhe pse u karakterizuan me trendë pozitive, kishin norma më të ulëta të rritjes.²¹⁶ Kjo gjendje e zhvillimeve ekonomike pasqyrohet edhe përmes një tablele në vijim e cila pasqyron indikatorët makroekonomik të ekonomisë në eurozone.

²¹⁶ Raporti vjetor 2013, BQK

Tabela 1. Indikatorë të zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	PBB		Inflacioni		Llogaria rrjedhëse (% e PBB-se)	
	2012	2013	2012	2013	2012	2013
Ekonomia Globale	32	30	39	36		
Eurozona	-0.7	-0.5	2.5	1.3	2	2.9
vendet ne Zhvillim	5	4.7	6	5.8	1.4	0.7
Evropa Evropiane ne Zhvillim	1.4	2.8	5.8	4.1	-4.5	-3.9

Burimi: FMN (Prill 2014)

Bazuar ne zhvillimet ekonomike qe janë duke ndodhur ne rajon, vlerësohet se ekonomia e eurozonës ka gjasa te ngadalëson zhvillimin nga viti ne vit. Bazuar ne trendët e zhvillimit ekonomik e politik vlerësojmë se kjo krize ekonomike ne shume vende te botes e ne veçanti ne shtetet e Bashkimit Evropian, ku merre pjese Kosova ka filluar ndjeshëm kriza ekonomike, e posaçërisht ne sferën e te ardhurave nga diaspora apo remitencat.

Themi këtë nga se Kosova është nja nga vendet qe është e varur shume nga dërgesat qe vijnë nga diaspora, prandaj bazuar ne trendët globale dhe zhvillimet ekonomike ne shume vende te botes, bene qe kjo te reflektohet te diaspora Kosovare gjë qe do te këtë reflektime te drejtpërdrejta ne ekonominë e Kosovës.

Ndikimi i dërgesave nga diaspora për ekonominë e Kosovës është me rëndësi, nga se këto pritje janë treguar një nga te ardhurat me stabile për ekonominë e Kosovës, qe vite me radhe kane mbajte te gjalle ekonominë e këtij vendi, duke përfshirë periudhën para luftës dhe atë pas luftës. Vetëm nga viti i kaluar kemi pasur dërgesa nga diaspora ne vlere rrethe 600 milion euro dhe bazuar ne faktin se ne vendet evropiane ku diaspora jone është prezentë dhe ekonomia e tyre vazhdon te ketë rënie ekonomike, atëherë këto janë mundësitë te cilat mund ta rendojnë Kosovën ne fushën e krizës ekonomike globale.

Bazuar ne statistikat zyrtare konsiderohet se afër 25% e popullsisë se Kosovës apo mbi 500 mije emigrante Kosovar jetojnë dhe veprojnë ne vende te ndryshme te Evropës. Sipas një sondazhi te Institutit te hulumtimeve Gallup ku pas anketimeve te zhvilluara ne 135 vende te botes rezulton se Kosova radhitet

larte ne listën e vendeve qe pranojnë remitenca, ku arrijnë shifrën 23%, apo me përqindje me më së shumti në rajon.²¹⁷

Kosovarët kanë pasur disa periudha të emigrimit masiv që nga vitet e 60-ta të shekullit të kaluar. Sot, emigrimi i kosovarëve vlerësohet prej 0.4-1% të popullatës aktive për punësim.²¹⁸ Me një papunësi prej 44% dhe një varfëri të skajshme prej 17% dërgesat vazhdojnë të jenë burimi kryesor i mbijetesës për shumë familje. Një studim i USAID²¹⁹ tregon se dërgesat nga jashtë kanë ndikuar pozitivisht në të gjitha rajonet, megjithatë ndikim më të lartë kanë rajonet më pak të zhvilluara, duke zvogëluar kështu pabarazinë në të ardhurat mesatare për kokë banori. Dërgesat e emigrantëve në Kosovë kanë shënuar rritje ndër vite (përpos në vitin 2009 kur është shënuar rënie e dërgesave si pasojë e krizës financiare globale ne vendet ku kane qëndruar emigrantët e Kosovës), duke arritur pothuajse në dyfishin e investimeve të huaja direkt në vend. Në vitin 2010 dërgesat e emigrantëve të pranuar në Kosovë ishin 511.6 milion euro, përderisa Investimet e huaja direkt ishin 311.2 milion euro.

Edhe pse deri me tani shumica e dërgesave kanë ardhur nga Zvicra dhe Gjermania, kohëve të fundit po vërehet një fluks i madh i të ardhurave nga shtetet e Azisë, si Afganistani e Iraku. Një numër i konsiderueshëm i kosovarëve janë punësuar në kompanitë amerikane të cilat merren me ndërtimin dhe mirëmbajtjen e bazave ushtarake në këto dy vende, si dhe në sektorë tjerë jashtë bazave ushtarake. Pas zvogëlimit të forcave ushtarake në Irak, një numër i madh i bazave ushtarake janë mbyllur dhe si rrjedhojë ka rënë edhe numri i të punësuarve në këtë shtet. Kurse, edhe më tutje ekziston një numër i madh i punonjësve të huaj të angazhuar në Afganistan.²²⁰ Bazuar ne gjendjen e zhvillimit ekonomik rezulton se rritja ekonomike e Kosovës ne mase te madhe është e varur nga zhvillimi ekonomik dhe financat e realizuara nga te hyrat e diasporës qe punojnë ne shumicën e vendeve te eurozonës, ku veprojnë emigrantet tanë. Prandaj çdo lëvizje ekonomike apo edhe elementet e krizës qe lëkundin ekonominë e këtyre vendeve do te ndikonin ne stabilitetin e ekonomisë Kosovare.

Mirëpo kriza ekonomike ne vendet e eurozonës jo vetëm qe do te ndikoj ne rënien e dërgesave nga diaspora, por kjo do te ndikon edhe ardhjen e investimeve te huaja, çka ne mase te madhe do te ndikon edhe ne zhvillimin ekonomik te Kosovës. Kur është ne pyetje jo stabiliteti ekonomik, debatet e shumta te organizuara ne tryeza te ndryshme, qëndrimet rrethe ofrimit te zgjidhjes dhe ballafaqimi me vete procesin e krizës ekonomike financiare, është e pa mundur te mos analizohet gjendja ekonomike globale ne vendet e eurozonës, nga e cila do te pëson edhe ekonomia e Kosovës. Një nga mësimet me te rëndësishme te

²¹⁷ Organizata Gallup, Sondazhi mbi remitancat <http://www.gallup.com/poll/147446/three-percent-worldwide-international-remittances>.

²¹⁸ Raporti i Bankës Botërore "Memorandumi Ekonomik i një shteti: 'Kosovo Unlocking Growth potential: Strategies, Policies, Actions'", 2010

²¹⁹ USAID dhe UNDP, "Studimi i Remitencave në Kosovë 2010"

²²⁰ Analize, nga Instituti GAP 2011.

krizës botërore është ruajtja e qëndrueshmërisë së çmimeve, do të thotë trajtimi i stabilitetit monetar dhe stabilitetit financiar. Në një ekonomi të brishtë sikurse është ekonomia e Kosovës e cila sa ka filluar një zhvillim pas një periudhe të pas luftës dhe kryesisht ekonomi e vogël, nga se nuk ka zhvillim të industrisë së rëndësishme, lehtë mund të ndikohet nga kriza ekonomike botërore. Fakti i ndikimit të krizës botërore në ekonominë e Kosovës është se ekonomia varet shumë nga investimet e huaja dhe ato nga emigracioni, prandaj gjendja ekonomike e vendeve prej nga vijnë investimet në mënyrë të drejtpërdrejt do të reflekton edhe në ekonominë e Kosovës.


Është me rëndësi të ceket se në stabilitetin e çdo ekonomie ndikojnë dhe tre elemente me rëndësi, të cilat sigurisht se duhet respektuar si: duhet të ketë një normë interesi, një masë kritike të ndërmjetësimit financiar dhe një ekuilibër të sektorit financiar, që garanton zhvillimin e qëndrueshëm dhe afatgjatë të vendit. Për të pasur një qëndrueshmëri financiare një ekonomi duhet të ketë harmonizim të këtyre tre objektivave, të cilat konsiderohen të jenë kusht i domosdoshëm për ruajtjen e ekuilibrit financiar të ekonomisë. Atëherë kur mund të kemi një harmonizim të këtyre tre objektivave, për ekonominë e vendit vlerësojmë se kemi një zgjidhje optimale për të garantuar stabilitet ekonomik e financiar të vendit.

Ruajtja e stabilitetit ekonomik e politik të vendit behet vetëm me tërheqjen e investimeve të huaja përmes të cilave do të kishim rritje ekonomike dhe stabilitet financiar, kjo mund të arrihet përmes bashkërendimit të disa elementeve esenciale të ekonomisë.

Kriza ndjehet edhe në ekonominë e Kosovës


Bazuar në aktualitetin e Kosovës ku çdo ditë e më tepër kemi rënie ekonomike, rritje të papunësisë për shkak të mungesës së prodhimit, mungesa e eksportit, rënia e fuqisë blerëse në mungese të parasë së gatshme, e cila edhe ajo sasi që është del jashtë shtetit me rastin e importit. Kriza ekonomike në Kosovë tani më është si pasojë edhe e rënies së të hyrave brenda vendit dhe rënia e dërgesave nga diaspora që vijnë nga shtetet e eurozonës, në të cilat ekonomia e tyre veç tani është e prekur nga kriza, që njëkohësisht kjo gjendje do të ndikon edhe në rënien e investimeve të huaja që vijnë nga këto shtete. Këto elemente që paralajmërojnë krizën ekonomike vetëm sa shkojnë e bëhen të pa durueshme për qytetarin, kjo gjendje rëndohet edhe më shumë, ku si rezultat i krizës politike që aktualisht mbretëron në shtetin e Kosovës ka ndikuar që gjatë këtij viti të kemi tendencë të rritjes së deficitit të hyrave dhe rritjes së borxhit publik. Në vazhdim përmes një diagrami do të shohim se vetëve të fundit të hyrat buxhetore janë në rënie, gjithashtu edhe importi e eksporti janë në rënie. Këto janë indikatorët që pasqyrojnë gjendjen ekonomike të vendit dhe kjo tregon se vendi është duke shkuar drejt krizës ekonomike. Në vazhdim figurat në vijim a tregojnë të dhënat elementare për të hyrat, shpenzimet dhe bilancin tregtar të Kosovës.

Figura 2. Raporti shpenzime dhe të hyra



Burimi: BQK (2014)

Figura 2. Importet, Eksportet dhe Bilanci tregtar



Burimi: ASK (2014)

Ne këto kushte jo te favorshme te zhvillimit ekonomik, me te drejte qytetaret fitojnë një pasiguri për te jetuar, nuk ka elemente te rritjes se investimeve, mungon një mjedis i shëndoshë për zhvillimin e biznesit për shkak te mungesës se infrastrukturës ligjore te përshtatshme për biznesin, kemi sundim të dobët të ligjit, mos zbatimi juridik i kontratave dhe legjislacioni për zbatim nuk është komplet.

Kriza ekonomike luftohet me fuqizimin e këtyre elementeve te cekura me larte te cilat janë edhe kriteret domosdoshme për tërheqjen e investimeve nga jashtë, si te investimeve te huaja direktë dhe investimeve nga emigracioni, te cilat kishin me ndikua ne rritjen e zhvillimit ekonomik dhe krijimin e vendeve te punës.

Një nga faktorët negativ qe e favorizojnë krizën ekonomike është ikja e investitorëve te huaj për te investuar ne Kosove, qe vijnë nga vendet e eurozonës ku ekonomia e tyre është ne krize. Mirëpo një element tjetër qe kishte me ndikuar ne ikjen e investimeve te huaja është se shteti ende nuk ka krijuar mekanizmat për te pasur garanci dhe siguri juridike ne investime. Kjo ka ndikuar qe shume investitorë te huaj duke mos pasur sigurinë e tyre potenciale kane hequr dore për te investuar ne ekonominë e Kosovës, përkundër asaj qe ekziston një potencial i larte i fuqisë punëtore, rezervave te energjetikes, kushtet e favorshme për turizëm dhe pasurive nëntokësore. Kjo pasiguri te investitorët është reflektuar nga fakti se edhe vete shteti i Kosovës duket te mos ketë vetëbesimin, nga se mjetet te cilat janë depozituar ne fondin e privatizimit te ndërmarrjeve shtetërore dhe mjetet e grumbulluara ne fondin e Trustit për Pensione janë investuar jashtë shtetit, për çështje sigurie.

Investimi i këtyre mjeteve jashtë shtetit është bere ne baze te ligjeve te cilat janë ende ne fuqi, vlere e këtyre mjeteve tani arrijnë shifrën prej 2 miliard €, mirëpo këtë çka është me rëndësi te theksohet se

kthimi i këtyre investimeve ne vend nuk mund te behet për deri sa nuk ndryshon Ligji për Trustin për Pensione dhe Ligji për privatizimin.


Prandaj kur kemi te bëjmë me çështjen e sigurisë juridike dhe kur mjetet e këtyre dy fondeve vendore (trustit dhe privatizimit) qëndrojnë te investuara jashtë vendit, atëherë me te drejte investitorët e jashtëm mund te keni dozën e frikës për te investuar ne Kosovë për shkak te sigurisë juridike dhe mungesë te zbatimit te ligjit.

Prandaj kriza ekonomike është një temë qe kërkon trajtim te veçantë dhe arsyeja e ngritjes se kësaj çështje është se duke marre për baze këto fakte kriza ekonomike tani me është prezentë edhe ne Kosovë dhe ka prekur çdo sektorë te ekonomisë sikurse ne vendet e eurozonës por edhe shume vende te botës.

Si studiues i çështjeve ekonomike duke u bazuar ne trendët globale dhe zhvillimet ekonomike vlerësojmë se kriza ekonomike tani me qe është prezentë ne shume vende te botes, e ne veçanti ne shtetet e bashkimit evropian, ka filluar ta atakon edhe shtetin me te ri ne Ballkan Republikën e Kosovës.

Kriza ekonomike do te jete ndjeshme ne Kosove për faktin se shteti jone është shume i varur nga investimet qe vijnë nga diaspora, prej te cilave mjete mbanë ekzistencën ekonomia familjare. Prandaj nëse kriza reflektohet ne vendet e eurozonës prej nga vijnë këto te hyra (investime), atëherë edhe Kosova do te jete vendi ne te cilën kriza do te atakon ekonominë Kosovare. Kjo ndodhe për faktin se ekonomia e Kosovës për vite te tera është e varur nga dërgesat e emigranteve dhe se kriza ekonomike ne eurozone do te ketë efektet negative.²²¹


Figura 3. Remitencat



Burimi BQK 2014

Figura 4: Remitancat dhe Investimet e Huaja

Direket në Kosovë 2007-2010



Burimi BQK

²²¹ www.telegrafi.com/ekonomi

Bazuar ne gjendjen çfarë është tani ekonomia e Kosovës, lirisht mund te themi se për shkak te situatës se rëndë politike qe aktualisht mbretëron, ajo po e rendon ekonominë dhe po shkon drejt një krize ekonomike, duke rene investimet dhe te hyrat. Kjo situatë është duke reflektuar me se shumti te biznesi, qe njëherë është bartës i zhvillimit ekonomik te një vendi, ka gjase qe kjo gjendje te vazhdon edhe me tej ne vitet ne vijim qe kishte me krijuar probleme serioze te biznesi ne rritjen e shpenzimeve, zvogëlimin e fitimeve dhe deri te ndërprerja e veprimtarisë se tyre. Kur dihet fakti se përmes këtyre bizneseve varet edhe zhvillimi ekonomik i vendit, atëherë kjo kishte me ndikuar ne mase te madhe ne ikjen e investimeve, ne rritjen e papunësisë duke shkurtuar vendet e punës dhe krijimin e rasteve sociale, qe edhe ashtu janë ne numër te madhe ne Kosove. Kjo situatë bene qe gjatë kësaj periudhe te kemi ndërprerje te investimeve te cilat kane qene te planifikuara te arrijnë ne Kosove, kjo bene qe te kemi zvogëlim te eksporti, nga se ka ndërprerje te afarizmit te bizneset, ndërprerje te prodhimit dhe ndërprerje te krijimit te vendeve te reja te punës, për mungesë te investimeve. Mirëpo mendoj se për te krijuar kushte te favorshme për biznesin dhe për te ngrite ekonomia e Kosovës, duhet qe te kërkohen burimet e financimit brenda vendit, duke shfrytëzuar te gjitha kapacitetet ne respektimin dhe përshtatjen e legjislacionit për te bere biznes dhe luftimin e korrupsionit. Tani me jemi ne gjendjen ku Kosova ka pësuar ngecje te zhvillimit ne disa sektorë te ekonomisë me rëndësi, një nga elementet e ngecjes se zhvillimit përveç krizës ekonomike si faktorë me rëndësi për ngecje vlerësohet te jene edhe pasojat e zhvillimeve politike qe aktualisht po mbretëron ne Kosove.²²² Mirëpo kjo situatë vlerësohet te ketë ndikuar te gjitha investimet, si ato qe vijnë nga investitorët e huaj dhe investimet brenda vendit, për arsye te krijimit te një gjendje te pasigurisë se investimeve. Sipas te dhënave te fundit te Bankës Qendrore te Kosovës thuhet se vendi ka ngecje edhe tek investimet kapitale, kjo ka ndikuar qe si pasoje e zhvillimeve politike edhe investimi ne realizimin e projektit madhor te autostradës Prishtine-Shkup te ngec ne realizim. Bazuar në të dhënat e fundit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), në bazë sektoriale, gjatë kësaj periudhe kishte ngecje që erdhën nga sektori i jashtëm, si rezultat i thellimit të deficitit tregtar. “Zhvillimet negative nga sektori i jashtëm u neutralizuan deri në një masë nga zgjerimi më i theksuar i aktivitetit kreditor të sektorit bankar”, thuhet në raportin e BQK-së. Ndërsa, sektori fiskal, përkundër se u karakterizua me rritje të shpenzimeve, ndryshoi strukturën duke rritur shpenzimet rrjedhëse, ndërsa shpenzimet kapitale gjatë kësaj periudhe shënuan rënie të konsiderueshme.²²³ Prandaj bazuar ne faktin se Kosova ka një ekonomi te hapur te tregut dhe pasi qe nuk ka politike monetare te veten qe do te mund te ndikonte me masa tjera ne mbrojtjen e ekonomisë, andaj e vetmja gjë qe mund tani te bënte Kosova është krijimi i politikave ne uljen e deficitit tregtar. Kjo mase do ishte zbatuar duke aplikuar kuota ne produktet e importuara, e cila do te kishte ndikuar ne rritjen

²²² <http://04online.net/slide/kriza-politike-atakoj-ekonomine> , 31 Gusht 2014.

²²³ <http://04online.net/slide/kriza-politike-atakoj-ekonomine> , 31 Gusht 2014.

e te ardhurave për buxhetin e shtetit, te cilat kishin me plotësua zvogëlimin e te dërgesave nga diaspora qe viteve te fundit është ne rënie.

Efektet e krizës financiare dhe dalja prej saj

Kriza ne vendet e eurozonës ka ndikuar qe Kosova ta ndjenë ne mase te madhe krizën ekonomike, për shkak te zvogëlimit te investimeve nga mjetet e diasporës qe kjo ka arritur shifrën 30-40% te zvogëlimit te mjeteve te ardhura nga emigracioni, prej te cilave mjete varet edhe prezenca e parasë se gatshme ne qarkullim. Disa nga elementet qe prodhojnë krizën ekonomike janë; shkalla e ende e larte e importit ne krahasim me eksportin qe ka një shkalle shume te ulet, mungesa e prodhimit, dalja e parasë jashtë shtetit, shkalla e larte e ekonomisë jo formale ne pa mundësi te parandalimit te kësaj dukurie dhe shpëlarja e parasë.

Edhe pse sipas disa te dhënave te Fondit Monetar Ndërkombëtar është prite qe gjate vitit aktual te kemi rritje te Bruto produkti Kombëtar (BPK) deri ne masën 4%, duke u bazuar ne rritjen ekonomike te disa vendeve prej nga vijnë dërgesat nga diaspora, mirëpo kriza ekonomike vazhdon te jete prezentë. Vetëm me rritjen e investimeve te huaja duke krijuar kushte te favorshme për investime edhe pse nga përfaqësuesit e Ministrisë se Tregtisë dhe te Industrisë theksojnë se klima për investime po përmirësohet gradualisht, bazuar ne faktin se janë duke u lehtësuar procedurat e regjistrimit te biznesit. Megjithëqë është evidente se sistemi gjyqësor duhet përmirësuar, ne mënyrë qe investitorët e huaj te ndihen te sigurt për te investuar kapitalin e tyre ne Kosovë. Prandaj vlerësojmë se Kosova duhet te ndërmerre masa urgjente ne përmirësimin e politikave qe nxisin zhvillimin ekonomik, duke krijuar kushte te favorshme për investime, ngritjen e infrastrukturës ligjore te përshtatshme dhe te krijimit te sigurisë për te investuar kapitalin e huaj ne Kosove. Nëse nuk ndërmerren këto masa sigurisht qe vendi do kaloj ne një situatë edhe me te rende ekonomike dhe si pasoje e kësaj do thellohet kriza deri ne masën e pa durueshme për te ecur përpara. Kjo mund te arrihet nëse Kosova do te kishte një qasje gjithëpërfshirëse te gjithë sektorëve, jo vetëm te ekonomisë por edhe te fushave tjera te legjislacionit, te zbatueshme risë dhe te sigurisë se investimeve, qe te koordinohen te gjithë këta faktorë dhe te kemi mundësi te fillojmë te dali nga kriza ekonomike, e cila dite e me shume është duke na renduar.

Ndërtimi i strategjive për zhvillim dhe përmirësimi i mjedisit përmes politikave fiskale

Me qellim te ruajtjes së stabilitetit ekonomik te Kosovës është nevojë urgjente qe te krijohet një strategji gjithëpërfshirëse te gjithë sektorëve atyre re ekonomisë, te infrastrukturës ligjore qe të rishikohet legjislacioni me të cilin krijohen kushtet e favorshme për investitorët. Ndërtimi i kësaj strategjie ka te beje me ngritjen ne nivel zbatimin e ligjeve, ngritjen e infrastrukturës ne aspektin e sigurisë juridike ne zbatimin e marrëdhënieve kontraktuale dhe financiare te lidhura ne mes te bizneseve. Përkundër te

arriturave te deritanishme drejt krijimit te bazës ligjore qe hap rrugën për investitorët e huaj, ajo ende është e pamjaftueshme dhe e pa sigurt nga aspekti i zbatimit te legjislacionit dhe sigurisë se investimeve.

Shikuar nga aspekti i zhvillimit dhe krijimit te vendeve te reja te punës qe kishte me ndikuar ne strategjinë e uljes se papunësisë kërkohet qe te kthehen ne vend fondet e mjeteve te trustit dhe privatizimit dhe nga këto mjete te krijohet fondi për ngritjen e ekonomisë se vogël me qellim punësimi dhe zhvillimi. Nga këto mjete te cilat kapin një vlere mjaft te larte te hyrave mbi 2 miliard €, me te cilat mjete është mundësi e madhe te investohet ne zhvillimin e biznesit te vogël dhe te mesëm, përmes te cilëve do te kemi rritje te prodhimit dhe do krijohen vende te reja te punës. Mirëpo mungesa e strategjisë për te ecur përpara ne zhvillimin e mjedisit dhe mungesa e vullnetit politik për te shtyre proceset ne përshtatjen e legjislacionit gjendjes faktike me te cilën përballet ekonomia e vendit ka shtyre qe te kemi krize ekonomike dhe financiare. Për këtë arsye edhe ato biznese qe sot operojnë ne Kosovë, e qe numri i tyre është mbi 60 mijë, te cilat operojnë me shume probleme te natyrave te ndryshme, nga mungesa e kushteve te pa përshtatshme për te bere biznes, për shkak te kredive me kamata te larta nga bankat komerciale, mungesa e parasë se gatshme ne qarkullim dhe pengesat te herëpashershme te krijuara nga mungesa e energjisë elektrike e cila ju krijon humbje te mëdha. Gjithashtu edhe mungesa e strategjive zhvillimore për te shfrytëzuar tërë potencialin ekzistues te Kosovës të te gjitha resurseve njerëzore dhe natyrore, ku mos angazhimi i plote i tyre bënë qe te mbretëron kriza ekonomike dhe financiare. Prandaj është detyre dhe përgjegjësi institucionale qe me qellim te luftimit te krizës ekonomike, politike dhe financiare, te krijohet një strategji e veprimit te gjithë faktorëve, për te krijuar një klime te përshtatshme për te tërheq investimet e huaja dhe ato vendore.

Dihet se për te pasur një zhvillim ekonomik te kënaqshëm kërkohet angazhim i pa kompromis institucional dhe biznesor, duke krijuar kushte për veprim dhe harmonizim te infrastrukturës ligjore dhe lehtësira fiskale për tërheqjen e investimeve. Ekonomia e Kosovës duhet te orientohet drejte rrugës se integritit ne Bashkësinë Evropiane, ne ngritjen dhe zhvillimin e kualitetit dhe standardizimit e shërbimeve dhe produkteve te përshtatshme për tregun Evropian. Procesi i integritit te ekonomisë ka si rezultat final rritjen e mirëqenies se ekonomisë, duke nënkuptuar edhe integrimin e plote ne zingjiret tregtar, industrial dhe financiar. Mirëpo një integrim i ekonomisë te vendit tone drejt Bashkësisë Evropiane nuk mund te behet nëse nuk gjen zbatim një praktike e vetme e menaxhimit ekonomik e institucional dhe duke harmonizuar rregullat e veprimit ne tere hapësirën Evropiane. Nga këndvështrimi jone mendojmë se për te pasur një mirëqenie ekonomike dhe një integrim ekonomik, duhet plotësuar një mori kriteresh te cilat janë te domosdoshme për një ekonomi te gjere. Një nga ato kriteret është reforma strukturore, qe ka te beje me ndryshimet ne bazën ligjore dhe rregulltave, institucionale, infrastrukturore dhe atë politike. Gjithashtu një kriter tjetër me rëndësi te veçantë është qe komuniteti i biznesit Kosovar

duhet te zhvillohet dhe te inkurajohet me shume për te nxitur dhe për te shtyre përpara procesin e integritimit ekonomik. Kjo mund te arrihet me një përkushtim me te madhe te biznesit dhe aktivitetit te shtuar drejt avancimit dhe aplikimit te teknologjisë se re, kjo mund te arrihet përmes organizimit dhe standardizimit te proceseve prodhuese, ngritja e shkalles se larte te menaxhimit. Një prej nga proceset tjera me rëndësi është sektori financiar, për te cilin duhet krijuar politika te reja te shpërndarjes se burimeve financiare dhe ndikimi ne aspektin e krijimit te kushteve optimale ne tërheqjen e investimeve te huaja përmes formave te bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit ne mes te biznesit lokal dhe atij ndërkombëtar.

Parandalimi i krizës ekonomike

Për te evituar krizën ekonomike dhe financiare shteti i Kosovës duhet te ndryshon edhe politiken ekonomike, duke ndërmarrë masat ne drejtimin e ecurive ekonomike, kundrejt objektivave te dëshiruara, duke ndërtuar një ekonomi konkurruese, duke ngritur zhvillimin e strategjive te sektorëve profitabil, siç është zhvillimi i sektori i turizmit për te cilën ekziston potenciali, por i anashkaluar deri me tani nga planifikimet strategjike ekonomike.

Kosova si një vend ne tranzicion i përcjellë me një zhvillim ekonomik historikisht jo te kënaqshëm, është me e ndjeshme ndaj krizave ekonomike financiare prandaj kërkohet ndërtimi i strategjive adekuate dhe ndërtimi i politikave ekonomike stabile.

Mirëpo deri sa Kosova vazhdon te mbaje një shume te parave jashtë shtetit, ne vlere prej mbi 2 miliard € dhe atë te investuara me një norme te interesit shume simbolike, e cila mund edhe te humbet duke pasur parasysh lëvizjet ne tregun financiar ku inflacioni here pas here e humb vlerën e interesit te realizuar nga investimi i këtyre mjeteve. Prandaj investimi i këtyre mjeteve ne tregun e jashtëm bene qe Kosova për nevojat e zhvillimit detyrohet te aranzhon kredi për programe te caktuara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe nga Banka Botërore. Bazuar ne atë qe Kosova është një vend i vogël dhe kryesisht i varfër ekonomikisht dhe kur një shume e mjeteve te konsiderueshme te saj qarkullojnë jashtë vendit, ka bere qe bankat komerciale te cilat operojnë ne Kosove te realizojnë përfitime te mëdha nga kreditë për te cilat qytetaret janë detyruar të marrin për nevoja te zhvillimit ekonomik.

Kriza ekonomike financiare bene qe te kemi një frenim te rritjes ekonomike ne shume vende te Evropës, ku nder te prekurit janë vendet me te brishta ekonomikisht, e cila ndikon ne uljen e eksportit, zvogëlimin e investimeve, rritjen e borxhit publik dhe rritjen e pa punësisë.

Mirëpo sa i përket krizës ekonomike është vështirë te japim një recete adekuate për dalje nga kriza, megjithatë themi se dalja nga kriza nuk është çështje e lehte për tu menaxhuar, nga se është një lidhshmëri ne mes te shume sektorëve dhe është komplekse. Dalja nga kriza ekonomike kërkon përgatitjen e një

strategjive te veprimit, përmes se cilës kërkohet ndërmarrja e te gjitha aktiviteteve qe me realizimin e tyre mund te krijohen një rritje ekonomike te qëndrueshme. Roli i shteti këtu është esencial ne përgatitjen e strategjive adekuate për tërheqjen e investimeve, me një ofrim te sigurisë maksimale për kapitalin e investuar, duke bere stimulimin e investimeve ne ata sektorë te ekonomisë qe gjenerojne punësim dhe prodhojnë për konsumin vendor. Nxjerrja e vendit nga kriza ekonomike dhe mundësia për te pasur një zhvillim ekonomik te qëndrueshëm është e lehte për te thënë, por është e vështirë për ta realizuar. Prandaj kërkohet një intensifikim dhe një stimulim i sektorëve me prioritet te ekonomisë, ata sektorë prodhues te cilët ndikojnë ne rritjen e produktivitetit ne pune, rritjen e prodhimit dhe rritjen e punësimit. Rolin primar e zënë investimet ne sistemin ekonomik ku garantohen rezultatet ne rritjen ekonomike, krijimin e kushteve te nevojshme për ndryshimin e strukturës ekonomike, duke realizuar një version strategjik te sektorëve te prodhimit dhe aplikim e teknologjisë se re ne prodhim.

PËRFUNDIM

Ne punim është trajtuar roli i institucioneve qeveritare ne rast te prezencës se krizës ekonomike ne vend dhe ne rajon. Duke pasur parasysh zhvillimet ekonomike qe janë duke ndodhur ne vendet e eurozonës, ka gjasa qe ekonomia nga viti ne vit te ngadalëson zhvillimin e saj. Bazuar ne këtë trendë te zhvillimit ekonomik e politik, sidomos ne vendet ne zhvillim si është Kosova, kriza ka fillua ndjeshëm sidomos ne sferën e te ardhurave nga diaspora dhe investimeve te huaja. Ne punim kemi trajtuar elementet e krizës dhe pasojat qe mund te sjelle ajo ne ekonominë e brishte te shtetit tone, ku si pasoje e këtij zhvillimi tani kemi rënie edhe ne grumbullimin e te hyrave vendore, gjë qe dhe me shume e bene te kemi një situatë me te rende ekonomike.

Nëse vazhdon kjo gjendje, duke mos arritur te priturat ne te hyrat vendore dhe ne rënien e vazhdueshme te investimeve, rënien e remitencave dhe ikjen e investitorëve ne vendet e rajonit, sigurisht qe vendi do te ballafaqohet me krizën ekonomike dhe politike.

Prandaj roli i shtetit ne këtë drejtim është i nevojshëm, duke analizuar me kujdes situatën ekonomike dhe politike ne vend dhe te ngrite kapacitetet ne grumbullimin e fondeve për investime, duke ofruar lehtësira tatimore dhe krijim te kushteve te favorshme te berit biznes. Tema ne vazhdim trajton problemin e investimeve në institucionet publike duke u mbështetur në faktin se projektet ndihmojnë realizimin e synimeve të definuar me programet zhvillimore dhe strategjike te vendit. Duke pasur parasysh rëndësinë qe kane Investime Publike për jetën dhe funksionimin e shtetit, qe janë edhe objektive kryesore për zhvillimin strategjik, kërkohet qe ky instrument te ketë te rregulluar bazën juridike dhe ligjore te përshtatshme për investitorët. Përmes këtij punimi do te trajtojmë procesin e investimeve, problemin e krizës ekonomike dhe politike, prandaj vlerësojmë se Kosova duhet te ndërmerre masa urgjente ne përmirësimin e politikave qe nxisin zhvillimin ekonomik, duke krijuar kushte te favorshme për investime,

ngritjen e infrastrukturës ligjore te përshtatshme dhe te krijimit te sigurisë për te investuar kapitalin e huaj ne Kosove.

Për te ruajtur një stabilitet ekonomik te vendit është nevoja urgjente te krijohet një strategji gjithëpërfshirëse e te gjithë sektorëve, te ekonomisë, te infrastrukturës ligjore, sigurisë etj, qe te krijohen kushte te favorshme për investime. Punimi trajton çështjen si te dilet dhe si te intervenohet ne parandalimin e krizës ekonomike, ku për te evituar krizën ekonomike dhe financiare shteti i Kosovës duhet te ndryshon edhe politiken ekonomike, duke ndërmarrë masat ne drejtimin e ecurive ekonomike, kundrejt objektivave te dëshiruara, duke ndërtuar një ekonomi konkurruese, duke ngritur zhvillimin e strategjive te sektorëve profitabil, siç është zhvillimi i sektori i turizmit për te cilën ekziston potenciali, por i anashkaluar deri me tani nga planifikimet strategjike ekonomike. Punimi do te bazohet ne te dhënat e shpenzimit te parasë publike ne periudha te caktuar për te cilat do vlerësohet performanca e respektimit te legjislacionit dhe performanca e investimeve te parasë publike me qellim te ngritjes se zhvillimit ekonomik te vendit

Literatura:

1. <http://www.dw.de/kriza-ekonomike-globale->
2. Raporti Vjetor i punës 2013, BQK
3. <http://www.evropaelire.org/>
4. <http://arkivamediatike.com/>
5. Migrimi Kosovar, Agjencia e Statistikave te Kosovës, Prill 2014 Prishtine,
6. Migrimi dhe Zhvillimi Ekonomik në Kosovë, Njësia për zvogëlimin e varfërisë dhe menaxhimin ekonomik Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore, 25 maj 2011.
7. Kriza ekonomike Globale, Analizë dhe implikime.
8. Hyrje ne historinë e ekonomisë, 2013,
9. Diaspora dhe Politika e Emigracionit, 2007
10. Strategjia për bashkëpunim dhe zhvillimin e vendit, Kosove 2014-2014, USAID,
11. www.telegrafi.com/ekonomi
12. <http://04online.net/slide/kriza-politike-atakoj-ekonomine> , 31 Gusht 2014.
13. Organizata Gallup, Sondazhi mbi remitancat
14. <http://www.gallup.com/poll/international-remittances>.
15. Raporti i Bankës Botërore “Memorandumi Ekonomik i një shteti: ‘Kosovo Unlocking Growth potential: Strategies, Policies, Actions’”, 2010
16. USAID dhe UNDP, “Studimi i Remitencave në Kosovë 2010”
17. Analize, nga Instituti GAP 2011.

BALISTIKA KRIMINALISTIKE

Mr. Dashmir Nasufi

1) HYRJE

Balistika kriminalistike ose ligjore është degë e shkencës kriminalistike e cila përpunon me mënyrat, mjetet, metodat shkencore ekzaminimin e provave materiale, që kanë lidhje të drejtëpërdrejtë ose të ndërsjelltë me armë zjarri, municionet dhe objektet ku kanë mbetur gjurmë. Balistika kriminalistike mbështetet në disa fusha si; Fushat e kimis, fizikës, ushtarake, mjeksisë, biologjisë etj .Objektët e përdorura nga autori i veprës penale janë :- Armë luftarake- Armë sportive- Armë gjahu që janë (Cifte / teke)- Armë speciale që përdorët në fusha të caktuara- Armë atipike jo standarte. Organët e procedurës në ngjarjet ku si mjetet për të realizuar qellimet e tyre kriminale, autorët përdorin armë zjarri, kërkohet për të përcaktuara: a). Përcaktimi i armës së përdorur për kryerjen e një krimi; b). A është ajo arma më të cilin është kryer krimi. Problemeve të mësipërme u jepet zgjidhje pas gjetjes, fiksimit, dhe marrjes së armës, predhave dhe gëzhgojave nga vendi i ngjarjes, fishekët si pjesë studimi kriminalistik bazuar ne armët që përdorin i klasifikojmë: a). Fishek për revole; b). Fishek për pistoletë; c). Fishek për pushkë. Fishekët ne vetëvete përbëhen nga: Predha dhe Gëzhoja. Predhat kanë përmasa të ndryshme në varësi të armës që përdorët. Nga përbërja e tyre ato i ndajmë: a). Sipas llojit të metalit të veshjës së tyre (Këmishëza); b). Sipas formës së majës (që mund të jetë ovale, e sheshtë, formë kryqi,gropëzuar); c). Sipas formës së truqit të tyre (që mund të jetë cilindrik apo komik); d). Sipas kalibrit në varësi të armës që përdorët.Kërkimi i predhës paraqete vështirësi të madhe se sa në rastet kur kërkohet gëzhonë. Kur predha ka goditur viktimën por nuk ka dal në krahun tjetër, është e domosdoshme ndërhyrja e ekspertit mjekut-ligjor për ta nxjerr atë në kohën e kryerjes sëautopsisë. Kërkimi, gjetja, fiksimi i predhës dhe i gëzhgojave në vendin e ngjarjes, bëhet sipas metodikëskriminalistike në përgjithësi dhe asaj balistike në vecanti.

Shenjat karakteristike të evidentuara në predhë janë :

- a). Gjurmët e shenjave të përsëritura, këto shenja tregojnë saktësinë e një veprimi të kryer ne vendin e ngjarjes.
- b). Gjurmët e shenjave të rastit, nuk kanë ndonje vlerë nëidentifikimin e predhës, por ato na cojnë në kërkimin e disa karakteristikave që nuk ekzistojnë dhe nuk formohen gjatë funksionimit të armës si objekt ekspertimit, sidhenja të rastit mund të jenë si : gërvishnja të ndryshme gjatë predhës, gjatë prodhimit, gjatë ambalazhimit,transportite

2. KERKIMI , FIKSIMI , MARRJA NGA VEND NGJARJA E PREDHES

Në ngjarje të ndryshme ku per te kryer krim janë përdorur armët e zjarrit, predha nuk i bindet vullnetit të autorit të krimit për tu fshehur. Në shumicën e rastëve predha gjendet ne kufomë, dyshek, mur, si ne objekte të ndryshme që ndodhën në vend ngjarje. Ndodh që predha të

coptohet mbasi takon pjesë të forta objektësh, predha e cila është prove problem457 në vend ngjarje konkrete konsiston në:

- a). Pranine e oksidit të barutit (që kane një ngjyrë të gjelbërt)
- b). Ekzistenca e një sasie ndryshku mbi sipërfaqën e vetë predhës

A). Marrja e predhave nga objekti ku kanë mbetur

- Në vend ngjarje duhet fiksohen këta tregues si: 1). Forma e vrimës së hyrjes së predhës që është: a). E rumbullakët b). Ovale c). Formë ylli d). Formë kryqi: 2). Forma e kanalit të plumbit nëobjektin e goditur 457roblem, dru ku është : a). Cilindrike b). Sidhe në formë hinike 3). Shpërndarja e pjesëzave metale të objektëve të goditur duke i matur keto nëmarrëdhënie me vrimën e hyrjes së predhës; 4).Brezi i fërkimit rotull vrimës e nga cila anë është e dukshme; 5). A ka në kanal in e vrimës së plumbit pjesëza të huaja të lëna në nga sipërfaqja e predhës, copa të ndryshme të këmishëzës së predhës .

B). Gjurmët që i shkaktohen predhës nga pëngesat që përshkon

Këto gjurmë formohen gjatë daljes së predhës prej tytës së armës nga takimi i saj me sipërfaqen e ndonjë objekti që ka keto shenja: a). Pjesëza që kanë hyrë në brendësi të shtresës së saj sipërfaqësore; b). Stampimi i relievit të sipërfaqës së pëngesave; c). Deformimi i predhës; d). Coptimi i predhës në disa pjesë

C). Ekzaminimi i predhave dhe paketimi i tyre

Gjatë këqyrjes së predhës në rradhë të 457rob i kushtohet vëmendje nëse kagjurmë blozë, pjesëza baruti të padjegura, lëndë të huaja, gjurmë gjaku, boje,ndryshku, xhama, etj. Gjatë këqyrjes fiksohen :1). Karakteristikat e ndërtimit të predhës2). Forma e majës3). Dimensionët e saj4). Pështa nëse është emundur5). Lloji i këmishës6). Mënyra embërthimit me gëzhjojën7). Sasi evjaskave & shenja të tjera të mundshme8).Kalibri i predhës9). Drejtimi i vjaskave, këndin dhe gjërësin e tyre.

Disa 457roblem që mund të zgjidhë ekspertit në lidhje më predhat janë: 1). Predha është fabrikuar apo është pordhim artisanal; 2). C‘farë tipi fisheku i takon predha e fiksuar në vendngjarje; 3). Nga cfarë arme është qitur predha; 4). A është qitur predha e fiksuar në vendin e ngjarjes nga arma e objektit; 5). A mund të deformohet predha në rrethanat e dhëna; 6). A ka gjurmë mbi trupin e predhës dhe a ka kaluar pengesa predha;7). A janë predhat dhe gëzhhojat object ekspertimi; 8). A është qitur me të njëjtën armë; 9). C‘farë kalibri është arma që ka qitur predhën a gëzhjojën.

3. IDENTIFIKIMI DHE KARAKTERISTIKAT E ARMEVE

3.1 IDENTIFIKIMI I ARMES ME ANE TE VJASKAVE TE PREDHA

Përcaktimi i llojit, modelit, dhe identifikimi i armës me anë të vjaskave bëhet sipas të dhënave të ndertimit dhe të gjurmëve që ekzistojnë në kanalin e tytës së armës nga e cila është qitur ajo predhë. Për të përcaktuar llojin dhe modelin e armës me anë të predhës do të bazohemi.- Në të dhënat e ndertimit të vetë predhës- Sasinë e viaskave- Drejtimi i pjerrtësisë së vjaskave,- Gjerësia e vjaskave dhe këndi i pjerrtësisë së vjaskave .

3.2 IDENTIFIKIMI I ARMEVE MBI BAZEN E SHENJAVE KARAKTERISTIKE NE GEZHOJE

1. Gjilpëra godet mbi kapsollen e fishekut që ndodhët në folenë e tij, duke bërënjë gropëzim karakteristik, gëzhjoja përplasët mbi kokën e shulit, kemi: Nxjerrësin,që shërben për të nxjerrë jashtë gëzhjojen ngafoleja e fishekut, Jashtëqitësin, i cili ndihmon për hedhjen jashtë nepërmjet dritares së gëzhjojës.

2. Për identifikimin e karakteristikave në gëzhjojëkombinohën karakteristika të përgjithshme dhe karakteristika individuale të armës: a). Me karakteristika të përgjithshme, do të kuptojmë atokarakteristika të tipit markës, dhe modelin e armës, që varët nga prodhimi i armëve; b). Me karakteristika individuale, janë të vecanta për armët, keto armës i jepen si pasaportë identifikimi në momentët e para. Ato janë të pranishme si rezultat i :- Funksionimit jo të mirë të armës - Karakteristikave dhe mekanizmave që kanë shërbyer për prodhimin - Veprimëve të mevonshme mbi keto armë, veprime keto të kryera nga vetedija ose jo nga autori i veprës penale, ose nga persona të tjerë të interesuar për mos identifikimin e armëve, etj

3.3 KARAKTERISTIKAT E LENA NGA KOKA E SHULIT MBI GEZHOJEN

Për të arritur në identifikim duhet të studiojmë qëndrushmërin e karakteristikavetë përfituara nga koka e shulit, kjo qëndrushmëri do varët nga disa faktor si: Karakteristikat e përfituara nga prodhimi, Karakteristika, të cilat lindin nga vecorit e bëra nga konstruktori, Vjetërimi i armës, si ndryshku , pastrimi i saj etj .

Këto vecori gjatë fabrikimit apo që i ka fituar gjatë më pas pasqyrohen mbi gëzhjojë e na lejon të identifikojmë armën që është goditur, kurse pasqyrimi i qartë i kokës së shulit ne gëzhjojë do të varët nga:

- a).Trashësia e fortësisë së materialit të gëzhjojës dhe të kapsollës,
- b).Papastërtia gëzhjojës/kokës së shulit,
- c). Ngarkesa jo e plot e barutit në fishekë

- d).Vëndosja e kapsollës sipas kërkesave të caktuara,
- e).Stampimet e fabrikes nje problemë seriozë.
- f). Llakimi i sipërfaqëve të gëzhojëve është pengesë.

3.4 KARAKTERISTIKAT E LENA NGA MAJA E GJILPERES NE KAPSOLLE

Gjilpëra godet kapsollën , duke krijuar mbi të një gropëzim , forma dhe përmasa është në varësi të përmasës së gjilpërës, që e godet, maja e gjilpërës është hemisferike, tek disa armë të tjera ajo është e sheshtë. Përmasat e majëve të gjilpërave janë tëndryshme në varësi të llojit të armëve që përdoret, e vetmja gjë e përbashkët është setë gjitha gjilpërat pas goditjes nga rrafësi lën mbi kapsolle nje gropëz, karakteristik për armët është: a). *Madhësia e gropëzës së hapur në kapsollë;* b). *Karakteristik në fund të gropëzës kemi : sipërfaqe të rrafshita, sferike, më reliev të thyer;* c). *Kur materiali i kapsollës është i fortë, gropëza do jetë e cekët në keto raste ndodhë edhe kur maja e gjilpërës nuk është e gjatë.*

Autorët e kimit ndërhyjnë mbi gjilpërën e armës duke eshtrembëruar, që e godasin memjete të forta.

3.5 KARAKTERISTIKAT E NXJERESIT DHE JASHTEQITESIT MBI GEZHOJE

Mbas realizimit të shkrepjes, gëzhoja lëviz nën veprimin e forcës shtytëse të gazrave të drejtimit të predhës, gëzhoja gjatë rrugës së saj kontakton me jashtëqitësin dhe del nga dritarja e armës: a). Shenjat e nxjerrësit , duke patur parasysh se modele të ndryshme armësh kanë pozicione të caktuara të nxjerrësit, ku përcaktojmë modelin e armës që ka realizuar qitjen; b). Shenjat e jashtëqitësit, jepen si gërvishtje, thellësia dhe shprehja e të cilave është në varësi të kontaktit që ndodh midis gëzhojës dhe jashtëqitësit si dhe sipas llojit të materialit të gëzhojës apo të fortësisë së saj, jashtëqitësi vndosët në raport të kundërt më nxjerrësin .

3.6 KARAKTERISTIKAT E BUZEVE TE JASHTEME NE FOLEN E FISHEKUT

Nga nje kqyrje e kujdesshme në pjesën e parë të gëzhojës, në një anë të saj vihen re disa gërvishtje dhe fërkime, të cilat shkaktohen në momentin kur shuli merr fishekun e radhës nga krëhëri dhe me forcë e fut atë në folenë e tij, dhe varet nga disa karakteristika që janë: a). Materiali i gëzhojës; b). Ashpërsimi dhe relievi i thyer i prerjës së fundit të tytës; c). Momenti i goditjes, forcës dhe kontakti gëzhojë-tytë.

3.7 KARAKTERISTIKAT E LENA NGA BUZET E KREHERIT MBI GEZHOJE

Krëhëri në të gjitha llojet e armëve shërben si një depozitë fishekësh, në momentin fillestar të mbushjes së armës, ndodh pikërisht kur fisheku shpëputët nga krëhëri, ky i fundit lë në buzët e tij gjurmë në formë gërvishtje, sidomos kur susta e ngritjes së krëhërit është shumë e fortë .

3.8 KERKIMI , ZBULIMI , FIKSIMI , MARRJA E GEZHOJAVE NGA VENDI INGJARJES

Gjatë qitjëve në përgjithësi armët automatike gëzhoja del vetë në menyrë të pa pavullnetshme. Gëzhoja nuk ngelen në vend-ngjarje ne raste kur: a). Kur qitja është bërë me armë automatike dhe jashtqitja nuk është bërë nën forcën e ndonjë pengese; b). Qitja është bërë me revolver; c). Qitja është bërë me armë gjahu dhe qitësi s'ka nevojë të bëj rimbushje; d). Qitja është bërë me armë të prodhuar në mënyrë artizanale.

Nga kqyrja e kujdesshme në pjesën e parë të gëzhjës, në një anë të saj vihen re disa gërvishtje dhe fërkime, të cilat shkaktohen në momentin kur shuli merr fishekun erradhës krëhëri dhe me forcë e fut atë në folenë e tij, dhe varet nga disa karakteristika që janë :a). Materiali i gëzhjës b). Ashpërsimi dhe relievi i thyer i prerjës së fundit tëtytës .c). Momenti i goditjes, forcës dhe kontakti gëzhjës-tytë.

Krëhëri në të gjitha llojet e armëve shërben si një depozitë fishekësh, nëmomentin fillestar të mbushjës së armës, ndodhë pikërisht kur fisheku shkëputët nga krëhëri,ky i fundit lë në buzët e tij gjurmë në formë gërvishtje, sidomos kur susta e ngritjes sekrëhërit është shume e fort .

Gjatë qitjeve në përgjithësi armët automatike, gëzhoja del vetë në menyrë të pa pavullnetshme. Gëzhoja nuk ngel në vend-ngjarje ne raste kur: a). Kur qitja është bërë me armë automatike dhe jashtqitja nuk është bërë nën forcën e ndonjë pengese; b). Qitja është bërë me revolver; c). Qitja është bërë me armë gjahu dhe qitësi s'ka nevojë të bëj rimbushje; d). Qitja është bërë me armë të prodhuar në mënyrëartizanale; e). Kur qitësi është i interesuar të gjejë dhe të mbledhë gëzhojat.

- Në vend-ngjarje duhet të jemi të kujdesshëm & të vlersojmë & rrethan negative nene keto raste kur:

Nuk gjenden gëzhojat që në fillimin e këqyrjës së vendit-ngjarjës, duhet të përcaktohet vendi i qitësit, dhe duhet të kërkojmë me kujdes aty. Rreth vrimës së hyrjes ka faktor plotësuës që dëshmojnë se qitja është bërënga distanca të afërta gëzhoje, që duhet kërkuar në një rreze prej 9 m. Gjatë kërkimit të gëzhjës të shikohet mundësia e rikoshetimit të saj. Kërkimi i gëzhjës në dhoma të mbyllura të bëhet në objekte në të cilët mund të hidhet gëzhoja.

– Para se të merrët gëzhoja fiksohet vendi i saj në procesverbal nga dy pika fikse:

a). Fotografi të shkallëzuar, b). Si dhe bëhet skica

– Paketimi i gëzhjave ka të bëjë me ruajtën e vetë provës. Gëzhoja paketohet në zarfa letre dhe mbi te vëndosen shënimet përkatëse.

– Cështje që zgjidhën nga ekspertimi gëzhjës janë: Cfarë lloj modeli është arma që ka qitur këtë gëzhjës, a është e një grupi gëzhoja objekt me atë model krahasues, gëzhoja objekt a është qitur nga një armë e dhënë, gëzhojat objekt janë qitur nga një apo më shumë armë, a janë pjese

përbërëse të një fisheku gëzhoja & predha e fiksuar, gëzhojat a kane dalur nga një krehër, a mund të përcaktohet se sa herë është qëlluar kapsolla e gëzhojës

3.9 RIKOSHETIMI I PREDHAVE

Shpesh në vend-ngjarje ndodhemi para ardhjes së një pasoje sirezultat i rikoshetimit të predhave, rikosheta ndodh dhe varet ngafaktorë të ndryshëm si :a). Natyra e predhës b). Forma e pjesës së përparme të predhës c). Shpjëtesia e lëvizjës së predhës d). Drejtimi dhe këndiqë formon në objektin e rikoshetimit e). Fortësia e objektit që rikosheton predha .

Nga pikpamja kriminalistike fenomeni i rikoshetimit nuk është studjuar me gjithë hollesit e fazat e tij. Vrojtimet eksperimentale nxjerrin disa konkluzione si:

a). Rikosheta në pëngesa të forta si guri, hekuri, betone të ndryshme, mermer,asfalt,

b). Si dhe ne raste kur kendi i takimit do të rritet më shumë se 60% - 70%

Ne rastet e rikoshetimit të predhës, shpejtësia e saj bie në mënyrë të theksuar, por forca e saj shpuese mund të paraqesë rrezik për jetën e njerzve

3.10 RESTAURIMI I NUMRAVE OSE SIGLAVE MBI ARME

Ndodh që në armën e gjetur në vend-ngjarje vërejmë fshirjën enumrave të serisë së këtyre, kjo realizohet me anë të limosjës ose gerryerjës me gur, frezë/ letër zmerile. Ky restaurim mund të bëhet mbicdo llojë metali duke përdorur një reaktiv të përshtatshëm, mbishkrimi ifshirë stampohet me metodën e rrahjës mekanike. Metalët e armëvetrajtohen me disa reagente si: acidi nitrik që reagon në zonat që nuk janë në tendosje. Teknika e përdorimit të reagentëve është e njëjtë në gjitha llojet e metaleve dhe konkretisht konsiston: a). Bëhet pastrimi i vendit ku ndodhen numrat e serisë më ujë të distiluar, bikarbonatnatriumi ose solvent për të larguar e pastruar vajrat e papastërtit e tjera; b). Pastrohët sipërfaqe e limuar me pambuk të lagur.

3.11 PERCAKTIMI I DISTANCES SE QITJES

Distancë quajmë largësin prej tytës së armës deri tek vrima e hyrjës së predhës ne objektin e dëmtuar në kriminalistik distancat, largësit e qitjës do të përshkallëzohen ose do të ndahen në:

1). Qitje me Puqitje është ajo qitje, kur gryka e tytës së armës në momentin e qitjës ndodhë e puthitur plotësishtë me sipërfaqën e objektit që goditët, sipasmenyrës së vëndosjës së grykës së tytës mbi sipërfaqën e objektit kemi:

a). Qitje me puqitje hermetike (të plotë), kur gryka e armës është mbështetur mbi sipërfaqen e objektit .

b). Qitje jo-hermetike (jo të plotë), kemi në ato raste kur gryka e armës prek lehësishtë sipërfaqën e objektit ose qitja bëhet me puthitje të pjeshme në pjesën e objektit të goditur.

Karakteristikat kryesore në këto llojë qitjesh janë: carjet në formë ylli ose shumëkëndëshi, stampimi i grykës së armës, shënjestrës në efektin etemperaturës së lartë, ekzistenca e një sasive të vogël bloze baruti

2). Qitje ne Distançë të afërt ,

është ajo qitje kur mbi sipërfaqën e objektit të dëmtuar, gjenden veprime të gjurmëve plotësuese të qitjës si veprim mekanik dhe termik i gazrave të barutit, gjurmë të blözës si dhe pjesëza të pa djegura, gjurmët e qitjes ne distancë të afërt janë:

a). Gjurmët e veprimit të gazrave të barutit; b). Gjurmë të blözërave të barutit; c). Gjurmët e vajrave të armës; d). Pjesëzat e barutit të padjegur ose të djegur plotësisht.

3). Qitje nga Larg , konsidërohet si rezultat i sipërfaqës së objektit të dëmtuar që nuk ka mbetur asnjë gjurmë tjetër përveçse vrimës së hyrjes së predhës.

3.12 PERCAKTIMI I VEND-NDODHJES SE QITESIT

Përcaktimi i vend-ndodhjes së qitësit do të varët nga provat materiale dheobjektët e dëmtuara të cilat fiksohen në vendin e ngjarjes, metodat më të përhapura janë :

a). *Me anë të vijëzimit të vendëve të goditura nga predha*;- kjo metode kosiston në bashkimin e dy pikave të goditjes kur predha ka prekur dyobjekte .

b). *Percaktimi i vend-ndodhjes së qitësit mendihmën e një tubi*;- kjo metode përdorët në rastet kur dy vrimat e hyrjes së predhës janë largë njëra tjetrës vetëm disa cm.

c). *Vijëzimi i skicës*;- bazë e kësaj metode është bashkimi me një vijë i vendëve ku ka kaluar predha, vijë e cila tregon fluturimin e kësaj predhe

d). *Metoda me anë të vijëzimit fotografik*;- në këtë rastë përdorët objektivi i aparatit i cili vendosëtnë pikë e takimit të predhës që përshkon vendin e goditur nga predha .

e). *Përcaktimi i vend-ndodhjes së qitësit me anë të llogaritjëve algjebrike dhe me metodën endërtimit gjeometrik*;- për të realizuar përcaktimin e drejtimit të qitësit me anëtë predhës është e domosdoshme që :- Predha tëketë shpuar dy objekte afër njëri-tjetrit -Predha të ketë kaluar njerin objekt kurse tjetërin të ketë lën vetëm goditje - Kur predha nuk ka kaluar matanë objektit të goditur, por kanali që ka bërë në këtëobjektë është disa herë më i gjatë se kalibri i vetë predhës

4. GJETJA, MARRJA PER EKZAMINIM DHE EKSPERTIMI I ARMEVE TE ZJARRIT

1. Gjetja e armës së zjarrit.

Gjatë kqyrjes së vendit të ngjarjes nëse janë përdorur armë zjarri, duhet gjetur edhe arma e kimit. Në rast kur kemi vetvrasje, vrasje apo vetvrasje të skenuara si vetvrasje, si rregull në

duart e viktimës ose në afërsi të tij mbetet arma e përdorur, autorët e krimi e hedhin armën në afërsi të vendit të ngjarjes me qëllim që të mos diktohen nga provat e krimit. Kufijtë e kërkimit të armës caktohen rast pas rasti duhet bërë shumë kujdes në kqyrje kur arma është fshehur.

2. Marrja e armës.

Para se kjo armë të merrët kryhën keto veprime: a). Përcaktimi i pozicionit të armës në lidhje me sendet që e rrethojnë; b). Matet distanca nga tyta në dy pika fikse të palëvizshme; c). Kur arma ndodhet afër viktimës duhet të matet në distancë, skicohet dhe fotografohet dhe shënohet në procesverbal .Pasi arma ngrihet, vendosen dy shenja në tokë (nga tyta tek qyta), që të dihet pozicioni i saj, arma është mirë që të merrët me doreza plastike, me qëllim që të mos prishen shenjat e gishtave mbi armë.

Duhet të kemi parasysh se nuk lejohet:

a). Ngritja e armës me shkop nga tyta; b). Prekja e kembëzës së shkrepjës, pasi mund të bëhet qitje aksidentale; c). Pasi merret arma, vendosët mbi një letër të bardhë; d). Arma dergohët në laboratorin e kriminalistikës.

3. Kqyrja e armës.

Para se të fillojë këqyrja e armës nga specialisti mbahët parasyshë :a). Pozicioni i rrafësit b). Nëse kafishek në fole apo në kreher, mbetje trunore, kocka, gjak etj.

4. Paketimi i armës.

Para se të paketohet arma kontrollohet nëse ka ose jo fishek, ndahet nga krëhri, si dhe mbështillet me letër të pastër të bardhë.

4.1 ZBULIMI I DORËS QË KA QITUR

Një nga problemët që haset shpesh në praktikën hetimore është përcaktimi i personit i cili mund të këtë përdorë ose jo armën e zjarrit, edhe pse është problem i vështirë, është gjetur një zgjidhje. Gjatë kryerjes së qitjes ndodhin efekte të ndryshme . Gëzhoja ku delhidhët jashtë dhe gjatë rrotullimit të shkaktuar nga forca midis nxjerrësit dhe jashtëqitësit, rrotullohet, shkundët dhe rrëzon mbi dorën e qitësit një sërë mbetjesh të barutit të padjegur kuvërtetojmë :a). Një shpërndarje të rastësishme të barutit mbi dorën e qitësit b). Ekzistenca dhe prania e grimcave të barutit të padjegur mbi dorën e qitësit c). Grimcat e barutit gjenden në pjesë jo koresponduese të hapësirave apo dritarës së xjerrësit.

Sasia e depozitimit në dorën e qitësit do varët nga :

a). Tipi i armës, b). Lloji i municionit të përdorur, c). Numri i qitjëve në njësinë e kohës, d). Koha që ka kaluar nga qitja e parë, e dytë e me rradhë, e). Koha që ka kaluar nga qitja deri në momentin e kqyrjes së dorës që ka gjuajtur.

4.2 METODAT E IDENTIFIKIMIT TE ARMEVE TE ZJARRIT ME ANE TE PREDHAVE E GEZHOJAVE

Legjislacioni Procedural Penal ngarkon ekspertin kriminalist në bazë të një vendimi të ardhur nga organi i procedimit brenda mundësive teknike, mundësive të tij profesionale dhe shkencore që disponon, t'iu përgjigjet këtyre pyetjeve të shtruara, në praktikën shumëvjeçare kriminalistike. Për identifikimin e predhave dhe gëzhgojave pyetjet bazë që bëhen janë: 1. Predha ose gëzhgoja a janë të fabrikuara apo prodhim artizanal; 2. Predha ose gëzhgoja c'farë tip prodhimi janë; 3. Predha ose gëzhgoja c'farë modeli dhe kalibri i përket; 4. predha ose gëzhgoja kujt lloji fisheku i përket; 5. A ka në predhë dëmtime të cilat vërtetojnë kalimin e saj nëpër pengesa; 6. A ka kaluar predha objektete forta si metal, dru, pjesë kockore etj; 7. C'fare pjesësh metalike janë fiksuar në vend-ngjarje; 8. Kujt modeli dhe arme i përketë predha.

PERFUNDIME DHE REKOMANDIME

Balistika kriminalistike ose ligjore është degë e shkencës kriminalistike e cila përpunon me mënyrat, mjetet, metodat shkencore ekzaminimin e provave materiale, që kanë lidhje të drejtëpërdrejtë ose të ndërsjelltë me armë zjarri, municionet dhe objektet ku kanë mbetur gjurmë.

Në ngjarje të ndryshme ku për të kryer krim janë përdorur armët e zjarrit, predha nuk i bindet vullnetit të autorit të krimit për tu fshehur. Në shumicën e rastëve predha gjendet në kufomë, dyshek, mur, si në objekte të ndryshme që ndodhën në vend ngjarje. Ndodh që predha të coptohet mbasi takon pjesë të forta objektësh.

Balistika kriminalistike është degë shumë e rëndësishme kriminalistike, e cila ka një rëndësi të vecante për zbulimin e veprave penale të kryera me armë zjarri. Për fat të keq, mendoj se në vendet ballkanike nuk është zhvilluar aq sa duhet dhe nuk i kushtohet aq shumë rëndësi kësaj lëmie, si dhe ekspertet kriminalistik nuk janë të trajnuar sic duhet, prandaj dhe kemi një numër të konsiderueshëm të veprave penale të kryera me armë zjarri të pa zgjidhura.

Mendoj se këto duhet të merret me seriozitet nga ekspertet e kësaj fushe për të arritur qëllimet kriminalistike, zbardhjen e këtyre veprave me anë të balistikës kriminalistike ligjore.

Bibliografia:

- 2- Analiza me aktivacion neutronik e mbetjeve të qitjeve me armëzjarri, 1979.
- 3- Avdejev, M.I.: Sudiebno medicinanseja ekspertiza zhivih lic, Moskva, 1968.
- 4- Begeja S.: Kriminalistika, Tiranë, 1971.
- 5- Bitri, P.: Patologjia morfologjike, Tiranë, 1975.
- 6- Balthazalt, V.: Precis de medicina legale, Paris, 1962.